
Daljet në publik të
Guvernatorit për vitin 2020

Botuar nga: © Banka e Shqipërisë

Adresa: Sheshi "Skënderbej", Nr. 1, Tiranë, Shqipëri
Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419401/2/3
Faks: + 355 4 2419408
E-mail: public@bankofalbania.org
Printuar në:
Printuar nga:
ISBN: 978-9928-262-33-2

PËRMBAJTJA

KAPITULLI I

Prezantime në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave 5

KAPITULLI II

Konferenca për shtyp për vendimmarrjen e politikës monetare 27

KAPITULLI III

Konferenca për shtyp me Shefin e Misionit të FMN-së dhe Ministrin e Financave 65

KAPITULLI IV

Fjalime dhe prezantime në konferenca 71

KAPITULLI V

Intervista 99

FOTO GALERI

250



Gent Sejko, Guvernator i Bankës së Shqipërisë, 2020

KAPITULLI I

PREZANTIME NË KOMISIONIN E EKONOMISË DHE FINANCAVE

- *Fjala e Guvernatorit Sejko gjatë prezantimit të Raportit Vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2019 në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave, 1 qershor 2020*
- *Fjala e Guvernatorit Sejko gjatë prezantimit të Raportit Vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2019 në Kuvendin e Shqipërisë, 2 korrik 2020*

Prezantimet në Kuvend

Banka e Shqipërisë është një institucion i pavarur, transparent dhe llogaridhënës. Procesi i llogaridhënies realizohet nëpërmjet një sërë instrumentesh, ku vendin më të rëndësishëm e zënë seancat dëgjimore të Guvernatorit në Komisionin Parlamentar të Ekonomisë dhe Financave dhe Kuvendin e Shqipërisë. Çdo vit, Guvernatori prezanton Raportin Vjetor të Bankës së Shqipërisë në këtë Komision dhe Parlament, duke iu përgjigjur edhe interesit të deputetëve për çështje të veçanta të lidhura me të. Sipas rastit, zhvillohen edhe seanca të veçanta dëgjimore mbi aktivitetin operacional të Bankës së Shqipërisë dhe sistemit bankar.



FJALA E GUVERNATORIT SEJKO GJATË PREZANTIMIT TË RAPORTIT VJETOR TË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR VITIN 2019 NË KOMISIONIN E EKONOMISË DHE FINANCEVE - 1 qershor 2020 -

Gjatë vitit 2019, politika monetare lehtësuese e Bankës së Shqipërisë:

- *ka sjellë uljen e çmimit të kredisë dhe ka nxitur rritjen e kreditimit;*
- *ka sjellë reduktimin e kostos së shërbimit të borxhit për bizneset dhe familjet;*
- *ka krijuar premisa për një kurs këmbimi më të qëndrueshëm gjatë vitit 2019;*
- *me orientimin e tregut mbi të ardhmen e politikës monetare, ka ndihmuar në qartësimin e aktorëve të tregut mbi trajektoren e pritur të inflacionit dhe të normave të interesit.*

*E nderuar zonja Kryetare e Komisionit,
Të nderuar zonja dhe zotërinj Deputetë,*

Më lejoni t'ju falënderoj, pavarësisht rrethanave jo të zakonta, për mundësinë që më keni dhënë për të prezantuar përpara jush mesazhet kryesore të Raportit tonë Vjetor.

Ky Raport përshkruan punën e kryer nga Banka e Shqipërisë për përbushjen e mandatit të saj ligjor, e objektivave strategjike të zhvillimit, si dhe të rekomandimeve të dhëna nga Kuvendi në Rezolutën për Vlerësimin e Veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë. Me kënaqësi konstatoj se puna jonë ka pasur një kontribut pozitiv në forcimin e stabilitetit monetar e financiar të vendit. Si gjithnjë, gjej me vend të theksoj se Banka e Shqipërisë e konsideron këtë stabilitet si një parakusht të domosdoshëm për zhvillimin e qëndrueshëm dhe afatgjatë, si dhe për të kapërcyer me sukses sfidat që kemi përpara.

Të nderuar zonja dhe zotërinj Deputetë,

Prej kohës së përgatitjes së Raportit Vjetor, vlerësimet tona mbi situatën aktuale dhe perspektivën ekonomike e financiare të vendit kanë ndryshuar qenësisht. Pandemia COVID-19 shkaktoi një goditje të fortë

mbi ekonominë dhe financat shqiptare. Për këtë arsye, në fjalën time sot e gjej me vend të ndalem jo vetëm në drejtimet dhe rezultatet kryesore të punës së Bankës së Shqipërisë gjatë vitit të shkuar, por edhe në kontekstin aktual dhe pritjet tona për të ardhmen.

Mesazhi ynë kryesor është se ekonomia shqiptare i ka premiset ta përballojë me sukses këtë sfidë, duke devijuar vetëm përkohësisht nga rruga e rritjes së qëndrueshme dhe afatgjatë. Megjithatë, minimizimi i kostove të pandemisë kërkon reagimin e vendosur dhe të koordinuar të autoriteteve publike, si dhe fleksibilitet dhe kurajë nga sektori privat.


Më lejoni ta filloj prezantimin me arritjet kryesore të punës së Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2019.

1. EKONOMIA SHQIPTARE DHE POLITIKA MONETARE GJATË VITIT 2019

Në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, objektivi kryesor i punës së Bankës së Shqipërisë është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Për përmbushjen e këtij objektivi, Banka e Shqipërisë vijoi të ndjekë një politikë monetare stimuluese gjatë vitit 2019. Ky qëndrim u diktua nga nivelet ende të ulëta dhe nën objektiv të inflacionit.

Viti 2019 ishte një vit sfidues për ekonominë shqiptare. Mjedisi i huaj ekonomik u shfaq i pafavorshëm, i karakterizuar nga ngadalësimi i ritmeve të rritjes ekonomike, nga inflacioni i ulët, si dhe nga pasiguri të shtuara, si pasojë e forcimit të masave proteksioniste në tregjet botërore. Nga ana tjetër, ekonomia shqiptare vijoi të përfitojë nga rritja e konsumit privat, si dhe nga zgjerimi i eksportit të shërbimeve, kryesisht si pasojë e vijimit të trendit pozitiv të turizmit. Megjithatë, aktiviteti ekonomik në vend u ndikua negativisht nga rënia e fortë e prodhimit të energjisë elektrike, nga përfundimi gradual i investimeve në projektet madhore energjetike, si dhe nga tërmeti i muajit nëntor, i cili shkaktoi dëme dhe humbje të konsiderueshme ekonomike. Për rrjedhojë, rritja ekonomike e vitit 2019 rezultoi në nivelin 2.2%, në rënie kundrejt nivelit 4.1% të shënuar në vitin paraardhës.


Grafik 1. Produkti i brendshëm bruto nga ana e prodhimit dhe treguesit e besimit



*Të dhënat janë gjysmë-përfundimtare. **Një vlerësim i parë.
Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Në gjykimin tonë, goditjet që pësuam ngadalësuan tempin e rritjes ekonomike, por nuk e shmangën ekonominë shqiptare nga trendi pozitiv i zhvillimit. Kjo ecuri u pasqyrua në reduktimin e normës së papunësisë, e cila zbriti në minimumin historik prej 11.2% në fund të vitit, në rritjen e punësimit dhe të pagave, si dhe në reduktimin e borxhit të huaj dhe të borxhit publik të vendit. Paralelisht me to, treguesit kryesorë të shëndetit të sektorit bankar mbetën në nivele të kënaqshme.

Grafik 2. Ecuria e inflacionit dhe norma bazë e interesit (në përqindje)



Burimi: Instat, Banka e Shqipërisë.

Inflacioni mesatar i vitit 2019 rezultoi në nivelin 1.4%, duke ardhur në rënie nga viti i shkuar. Reduktimi i inflacionit pasqyroj përcjelljen më të plotë të mbiçmimit të kursit të këmbimit dhe rënien e inflacionit të mallrave në tregjet ndërkombëtare, ndërkohë që presionet e brendshme inflacioniste erdhën në rritje.

Nivelet ende nën objektiv të inflacionit, diktuan ruajtjen e kahut stimules të politikës monetare gjatë vitit 2019. Kështu, Banka e Shqipërisë mbajti të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 1.0%, orientoi tregun drejt ruajtjes së kahut lehtësues të politikës monetare në horizontin afatmesëm, si dhe furnizoi bankat me të gjithë likuiditetin e nevojshëm.

Në përgjigje të politikës sonë monetare, kushtet financiare ishin stimulese për rritjen e kërkesës agregate dhe të përshtatshme për kthimin e inflacionit në objektiv. Më lejoni të evidentoj kanalet kryesore nëpërmjet të cilave politika jonë monetare lehtësuese ndihmoi ekonominë.

Së pari, stimuli monetar sollti uljen e çmimit të kredisë dhe nxiti rritjen e kreditimit. Tregjet financiare u karakterizuan nga nivele të ulëta të normave të interesit, nga një situatë e mirë likuiditeti dhe nga një qëndrueshmëri në rritje e kursit të këmbimit.

Në këto rrethana, kreditimi i sektorit privat përjetoi rritje relativisht të shpejtë dhe shfaqti shpërndarje më të mirë. Duke shmangur efektin e kredive të nxjerra jashtë bilancit dhe atë të kursit të këmbimit, kjo kredi shënoi një normë mesatare rritjeje prej 8% gjatë vitit 2019, duke u përshpejtuar ndjeshëm në krahasim me vitet e kaluara. Po ashtu, kreditimi i sektorit privat shfaqti një orientim në rritje drejt financimit të nevojave të biznesit për investim, ndërsa struktura valutore e kredisë vijoi të përmirësohet. Raporti i kredisë në lekë ndaj kredisë totale u rrit në 48.7%, nga 44.7% në vitin 2017.

Trendi pozitiv i kreditimit përfitoi nga rritja e kërkesës dhe e ofertës për kredi. Në veçanti, ndërkohë që normat e ulëta të interesit kanë nxitur kërkesën për kredi, përmirësimi i ofertës pasqyroj rrezikun në rënie të kreditimit në vend, sikundër ilustron nga rënia e kredive me probleme, si dhe efektin pozitiv të ristrukturimit dhe të rritjes së konkurrencës në sektorin bankar.

Së dyti, stimuli monetar ka sjellë reduktimin e kostos së shërbimit të borxhit për bizneset dhe familjet. Vlerësimet tona sugjerojnë se ky efekt për vitin 2019 është në intervalin 14-15 miliardë lekë. Këto fonde ndihmojnë në përmirësimin e gjendjes së tyre financiare dhe përbëjnë një burim shtesë financimi për konsum dhe investime.

Së treti, stimuli monetar ka krijuar premisa për një kurs më të qëndrueshëm këmbimi gjatë vitit 2019. Ndonëse Banka e Shqipërisë nuk ishte e pranishme në tregun e brendshëm valutor për të ndikuar kursin, krijimi i një ambienti të qetë monetar ndihmoi stabilizimin e tij.

Së katërti, orientimi i tregut mbi të ardhmen e politikës monetare ka ndihmuar në qartësimin e aktorëve të tregut mbi trajektoren e pritur të inflacionit dhe të normave të interesit.

Nëpërmjet këtyre kanaleve, politika jonë monetare stimuluese ka kontribuar në nxitjen e rritjes ekonomike dhe në forcimin e presioneve të brendshme inflacioniste. Vlerësimet tona empirike tregojnë se, falë stimulit monetar, rritja ekonomike dhe inflacioni gjatë tre viteve të fundit janë përkatësisht dhe mesatarisht rreth 0.6 dhe 0.7 pikë përqindjeje më të larta se ç'do të ishin në mungesë të tij.

Sikurse e përmenda dhe më parë, përhapja e pandemisë ka ndryshuar realitetin ekonomik dhe perspektivën për të ardhmen. Me fillimin e krizës, Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë një paketë të plotë masash për adresimin e situatës imediate dhe për krijimin e një baze solide për rikuperimin e shpejtë të ekonomisë. Shtjellimin e tyre do ta lë për në fund. Ndërkohë, tani do të vazhdoj me një drejtim tjetër të punës sonë: Promovimin e stabilitetit financiar, nëpërmjet forcimit së qëndrueshmërisë të sektorit bankar dhe funksionimit eficient dhe të sigurt të sistemeve të pagesave.

“...përhapja e pandemisë ka ndryshuar realitetin ekonomik dhe perspektivën për të ardhmen. Me fillimin e krizës, Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë një paketë të plotë masash për adresimin e situatës imediate dhe për krijimin e një baze solide për rikuperimin e shpejtë të ekonomisë.”

2. MBIKËQYRJA BANKARE DHE STABILITETI FINANCIAR

Drejtimet kryesore të Bankës së Shqipërisë për forcimin e mbikëqyrjes bankare dhe për mbështetjen e stabilitetit financiar:

- përfundoi punën mbi administrimin e procesit të konsolidimit të sektorit bankar gjatë vitit 2019;
- ka pëmbushur të gjitha detyrimet e saj në kuadër të planit kombëtar për reduktimin e kredive me probleme;
- punoi me rigorozitet për pëmbushjen e rekomandimeve të Komitetit të Ekspertëve të Këshillit të Evropës për Vlerësimin e Masave kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (MONEYVAL);
- vijoi të jetë pjesëmarrëse e kolegjeve mbikëqyrëse të organizuara nga Banka Qendrore Evropiane, edhe gjatë vitit 2019.

Situata financiare e sektorit bankar paraqitet e shëndetshme dhe e qëndrueshme. Kjo ecuri lexohet në zgjerimin e aktivitetit të sektorit bankar, në rritjen e treguesve të kthimit nga aktivet dhe kapitali, përkatësisht në 1.4% dhe 13.5%, si dhe në ruajtjen e një niveli të lartë, prej 18.3%, të raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit. Po ashtu, ushtrimet tona të provave të rezistencës tregojnë se ekspozimi i sektorit bankar ndaj rreziqeve sistematike është i kontrolluar dhe se aftësia e tij për të përballuar këto rreziqe është e fortë.

Tabelë 1. Treguesit kryesorë të përfitueshmërisë (në përqindje; kumulative)

Treguesit	Dhjetor 2019	Dhjetor 2018	Dhjetor 2017	Dhjetor 2016
RoAA	1,39	1,32	1,56	0,69
RoAE	13,45	12,96	15,71	7,15

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Më poshtë do të rendis shkurtimisht disa nga drejtimet kryesore të punës sonë për forcimin e mbikëqyrjes bankare dhe për mbështetjen e stabilitetit financiar.

Së pari, Banka e Shqipërisë përfundoi punën mbi administrimin e procesit të konsolidimit të sektorit bankar gjatë vitit 2019. Gjatë kësaj periudhe, ne kemi koordinuar dhe monitoruar me kujdes procesin, për të shmangur çdo efekt negativ dhe për të siguruar mbarëvajtjen e aktivitetit të bankave. Sot, numri i bankave në sistem është 12 nga 16 banka në vitin 2018. Gjatë vitit 2019 u mbyll procesi i transferimit të pronësisë për dy banka, përrthithja e një banke, si dhe vetëlikuidimi i një banke

tjetër. Ky proces riformatoi tregun bankar vendas, i cili tashmë gëzon prani më të lartë të kapitalit vendas dhe rritje të konkurrencës.

Së dyti, Banka e Shqipërisë ka përbushur të gjitha detyrimet e saj në kuadër të planit kombëtar për reduktimin e kredive me probleme. Falë masave të marra ndër vite, raporti i kredive me probleme nga një maksimum prej pothuaj 25% në vitin 2014, u ul në 8.4% në fund të vitit 2019. Vetë stoku i kredive me probleme u zvogëlua me rreth 25%, duke reflektuar uljen e kredive me probleme për biznesin. Gjatë vitit 2019, u finalizua miratimi i kuadrit rregullator për zbatimin e projektit Tirana Approach, i cili synon të krijojë një platformë jashtëgjyqësore bashkëpunimi midis bankave dhe klientëve për trajtimin e kredimarrësve në vështirësi. Zbatimi i kësaj platforme do të ndikojë në uljen e mëtejshme të nivelit të kredive me probleme në të ardhmen afatmesme dhe afatgjatë.

Së treti, Banka e Shqipërisë punoi me rigorozitet për përbushjen e rekomandimeve të Komitetit të Ekspertëve të Këshillit të Evropës për Vlerësimin e Masave kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (MONEYVAL).

Në raundin e pestë të vlerësimit të Masave kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, Banka e Shqipërisë ka luajtur një rol të rëndësishëm mbështetës, duke qenë autoriteti mbikëqyrës për pjesën më të madhe të sistemit financiar. Në raportin vlerësues të Moneyval-it, subjektet financiare u vlerësuan në nivelin “substantial/ i konsiderueshëm” të efektivitetit, për arsye se veçanërisht bankat paraqesin një njohje të mirë të rreziqeve dhe të detyrimeve ligjore, si dhe kanë marrë përgjithësisht masat e duhura për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Procesi i vlerësimit u shoqërua me disa rekomandime dhe me një plan masash për adresimin e tyre. Këto rekomandime janë zbatuar gjatë vitit 2019, nëpërmjet ndryshimeve në kuadrin rregullator dhe forcimin e efektivitetit të procesit mbikëqyrës në vend.

Së katërti, edhe gjatë vitit 2019, Banka e Shqipërisë vijoi të jetë pjesëmarrëse e kolegjeve mbikëqyrëse të organizuara nga Banka Qendrore Evropiane, me qëllim shkëmbimin e informacionit për disa banka që e kanë origjinën në BE dhe operojnë në tregun shqiptar.

Puna për nxitjen e kreditimit të shëndetshëm të ekonomisë është shoqëruar në vazhdimësi nga një monitorim i kujdesshëm në vend i sistemit financiar. Gjatë vitit 2019, janë zhvilluar 17 ekzaminime

të plota dhe të pjesshme, duke mbuluar pothuaj të gjitha bankat, 3 subjekte jobanka, 1 shoqëri të kursim-kreditit dhe 97 zyra të këmbimit valutor. Programi i inspektimeve ka marrë parasysh edhe përmbushjen e rekomandimeve të ekspertëve të Moneyval dhe disa ekzaminime janë kryer në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP).

Tabelë 2. Numri i ekzaminimeve sipas viteve dhe sipas tematikës

Inspektime të kryera në subjekte	Rezikulu Strategjik	Rezikulu Organizativ	Rezikulu i Kreditit	Rezikulu i Likuiditetit	Rezikulu i Normës së Interesit	Rezikulu i Tregut	Teknologjia e Informacionit dhe e Komunikimit	Rezikulu Operacional	Rezikulu Reputacional	Përfundueshmëria	Kapitali
2017	9	12	13	10	10	9	11	8	11	10	11
2018	8	10	9	8	8	8	9	8	48	9	8
2019	13	13	16	13	13	14	13	13	113	13	15

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë ka vijuar të adoptojë akte të reja rregullatore të aktivitetit bankar, apo të rishikojë ato në fuqi, me synim përafrimin e mëtejshëm me direktivat dhe rregulloret e Bashkimit Evropian dhe me dokumentet e Komitetit të Bazelit.

Në cilësinë e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, Banka e Shqipërisë ka punuar për fuqizimin e aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme, nëpërmjet hartimit të planeve specifike për çdo bankë sistemike, si dhe përmirësimit të vazhdueshëm të raportimit të bankave.

Në funksion të stabilitetit financiar, Banka e Shqipërisë ka një rol parësor në hartimin dhe zbatimin e politikës makroprudenciale. Kjo politikë parandalon akumulimin e rreziqeve dhe forcon rezistencën e sistemit financiar. Puna jonë në këtë drejtim u përqendrua në prezantimin e shtesave rregullatore të kapitalit, si instrument makroprudencial, si dhe në zhvillimin e një pakete treguesish analitike për paralajmërimin e rreziqeve sistemike, në përputhje me kërkesat dhe praktikën e autoriteteve mbikëqyrëse evropiane.


Në kuadër të zbatimit të strategjisë ndërinstitucionale për fuqizimin e përdorimit të monedhës vendase, Banka e Shqipërisë ka vlerësuar periodikisht efektivitetin e masave të marra. Këto efekte, ndonëse të vogla, kanë qenë pozitive. Megjithatë, materializimi i plotë i tyre kërkon më shumë kohë dhe angazhimin e plotë dhe të vazhdueshëm të të gjitha institucioneve përgjegjëse.

Realizimi i detyrave institucionale nënkupton dhe një vëmendje konstante ndaj fushave të tjera të aktivitetit të Bankës së Shqipërisë, ku, për mungesë kohe, do të nënvizoj vetëm ato kryesoret.

3. AKTIVITETE TË TJERA

Funksionimi i ekonomisë dhe i sistemit bankar është mbështetur nga një sistem eficient dhe i sigurt i pagesave. Dy sistemet që operon Banka e Shqipërisë në lekë - ai për pagesat me vlerë të vogël, AECH, dhe ai për pagesat me vlerë të madhe, AIPS - kanë funksionuar në mënyrë të sigurt dhe efikase. Viti 2019 ka shënuar rritje të përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave nga publiku, ku numri i pagesave me këto instrumente është 24% më i lartë se një vit më parë.

Grafik 3. Ecuria e numrit të instrumenteve të pagesave në vite (majtas) dhe përdorimi në numër instrumenteve të pagesave, gjatë 2019, nga individët dhe bizneset (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2019, ka nisur puna për përmirësimin e kuadrit rregullator që lidhet me operimin e këtyre sistemeve, për të mundësuar aksesin e institucioneve financiare jobanka në sistemin AECH, si dhe krijimin

e kushteve për promovimin e pagesave elektronike. Po ashtu, Banka e Shqipërisë i ka kushtuar vëmendje rregullimit të aktivitetit të sistemeve të shlyerjes së titujve nga operatorët privatë dhe licencimit të operatorit që do të realizojë shlyerjen dhe regjistrimin e titujve të emtuar nga kompanitë private. Prania e këtij operatori ndihmon në plotësimin e infrastrukturës për funksionimin e tregjeve të kapitaleve në Shqipëri.

Në kuadër të promovimit të reformave në tregun e pagesave, Banka e Shqipërisë ka luajtur një rol aktiv në zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël (2018-2023). Ajo ka bashkëpunuar për nxitjen e projekteve që lidhen me formalizimin e ekonomisë (i njohur ndryshe si “Projektligji për fiskalizimin”); me zhvillimin e infrastrukturës përkatëse për realizimin e pagesave në kohë reale (instant payment) dhe atë për shlyerjen e pagesave në euro brenda vendit; si dhe me përpjekjet për rritjen e edukimit financiar. Nga pikëpamja e përmirësimeve ligjore, arritja kryesore ishte hartimi dhe dorëzimi për miratim i projektligjit “Për shërbimet e pagesave”, i cili transponon direktivën përkatëse të Bashkimit Evropian. Ky projektligj u miratua në 30 prill të këtij viti nga Kuvendi. Përdorimi i tij do të shërbejë për promovimin dhe zgjerimin e përfshirjes financiare të popullatës, reduktimin e kostove të shërbimeve të pagesave dhe nxitjen e përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave.


Banka e Shqipërisë është emetuese ekskluzive e monedhës dhe e kartëmonedhës shqiptare. Gjatë vitit 2019, në përfundim të një pune shumëvjeçare, Banka e Shqipërisë prodhoi serinë e re të kartëmonedhave “Lek” me qëllim rritjen e cilësisë së tyre. Gjithashtu, 5 prerjeve ekzistuese u shtua dhe një prerje e re, ajo prej 10 000 Lekësh.

Më 30 shtator 2019 u hodhën në qarkullim prerjet e para të serisë së re, ato 200 lekë dhe 5000 Lekë, ndërsa brenda vitit 2020 pritet të hidhen në qarkullim seritë e reja të prerjeve 1000 Lekë dhe 10 000 Lekë. Prezantimi i serisë së re u shoqërua me një fushatë njohjeje me karakter edukues, e shtrirë në të gjithë vendin. Në zbatim të rezolutës së Kuvendit, një prej objektivave të fushatës edukuese ishte dhe ndërgjegjësimi i publikut për mospërdorimin e terminologjisë “lek i ri – lek i vjetër”.

Banka e Shqipërisë është autoriteti kombëtar për ruajtjen dhe administrimin e rezervës valutore. Në këtë proces, ajo udhëhiqet nga një listë hierarkike objektivash, të cilat nënkuptojnë ruajtjen e likuiditetit të rezervës, të sigurisë së saj, si dhe të të ardhurave. Në fund të vitit 2019, rezerva valutore është e investuar në aktive likuide 0-3 vjet dhe rreth 84% e portofolit është e investuar në letra me vlerë të emtuara nga

institucione që kanë renditje të cilësisë së lartë. Kthimi nga investimi i rezervës është pozitiv, por në nivele të ulëta, si pasojë e një mjedisi me norma të ulëta interesi.

Grafik 4. Ecuria e rezervës valutore



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë është edhe një prej agjencive statistikore publike. Në këtë kuadër, gjatë vitit 2019 u arrit që statistikatat e sektorit të jashtëm të hartohen në përputhje me kërkesat e Eurostatit, si dhe u punua për krijimin e të ashtuquajturave “të dhëna të grimcuara”.

Si një nga institucionet e përfshira në planin kombëtar për integrimin evropian, Banka e Shqipërisë ka përmbyshur të gjitha detyrimet për raportim, si dhe ka integruar rekomandimet e Komisionit Evropian në realizimin e detyrave të saj të përditshme. Në raport me publikun, ajo ka qenë vazhdimisht transparente dhe e pranishme nëpërmjet mjeteve të komunikimit vizual dhe online. Ky komunikim ka synuar të jetë i qartë dhe i kuptueshëm.

Së fundi, një vëmendje e veçantë i është kushtuar përmirësimit të qeverisjes së brendshme. Pas ngritjes dhe funksionimit të infrastrukturës për administrimin e rrezikut operacional, në vitin 2019 përfundoi zbatimi i platformës për menaxhimin e vijueshmërisë së veprimtarisë. Kjo platformë orienton njësitë në Bankën e Shqipërisë të reagojnë me efikasitet për të siguruar vazhdimësinë e proceseve kritike gjatë një krize, si dhe të rimëkëmbin veprimtarinë normale sa më shpejt të jetë e mundur. Platforma për menaxhimin e vijueshmërisë së veprimtarisë e

kaloi me sukses testin e saj, kur masat e parashikuara në të i mundësuan institucionit të vazhdonte normalisht punën dhe gjatë periudhës së pandemisë.

***E nderuar zonja Kryetare e Komisionit,
Të nderuar zonja dhe zotërinj Deputetë,***

Kohën e mbetur në dispozicion dëshiroj ta përdor për të ndarë me ju opinionin e Bankës së Shqipërisë mbi situatën ekonomike aktuale dhe të pritur, si dhe masat që ne kemi ndërmarrë gjatë muajve të fundit për të neutralizuar ndikimin në ekonomi të pandemisë.

Kjo pandemi përbën, padyshim, një goditje të fortë negative për ekonominë dhe financat e vendit, si dhe rrit pasigurinë për të ardhmen. Masat parandaluese të distancimit social dhe mbylljes së përkohshme të disa aktiviteteve ekonomike, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, kanë pasur një ndikim negativ në konsum, në investime, dhe në eksportin e mallrave e shërbimeve. Ekonomia shqiptare pritet të shënojë rënie gjatë vitit 2020, rënie e cila do të shoqërohet me reduktim të punësimit e rritje të papunësisë, me rënie të të ardhurave për familjet, si dhe me përkeqësim të situatës financiare të bizneseve dhe shtim të kredive me probleme në sektorin bankar. Kjo goditje erdhi në një moment delikat për ekonominë shqiptare, e cila pësoi dëme dhe humbje ekonomike të vlerësuara në 7.5% të PBB-së nga tërmeti i datës 26 nëntor të vitit të kaluar.

“...masat e marra nga Banka e Shqipërisë në kuadër të pandemisë sigurojnë likuiditetin e nevojshëm për sistemin bankar dhe për ekonominë në tërësi, mbrojnë fluksin e pandërprerë të kreditimit të familjeve e të firmave dhe ruajnë kushte financimi të favorshme për to.”

Stimujt e koordinuar fiskalë, monetarë e financiarë, kanë synuar të ndihmojnë familjet dhe bizneset e prekura, të ruajnë stabilitetin monetar dhe financiar dhe të krijojnë premisa që efektet e kësaj krize të mbeten kalimtare.

Në këtë mjedis ekonomik tejet të vështirë, Banka e Shqipërisë, prej fillimit të pandemisë, ka ndërmarrë një paketë të plotë masash për të siguruar mbështetje për familjet dhe sektorët më të prekur nga kriza. Këto masa sigurojnë likuiditetin e nevojshëm për sistemin bankar dhe për ekonominë në tërësi, mbrojnë fluksin e pandërprerë të kreditimit të familjeve e të

firmave dhe ruajnë kushte financimi të favorshme për to.

Paketa e masave të marra nga ne përfshin:

- uljen në 0.5% të normës bazë të interesit dhe furnizimin e pakufizuar me likuiditet të sistemit bankar, me synim nxitjen e funksionimit sa më normal të tregjeve financiare dhe uljen e kostos së kredisë për sektorin privat;
- lehtësimin e përkohshëm të rregulloreve bankare, për të mundur shtyrjen e përkohshme, me dy tremujorë, të pagesës së kësteve të kredisë, me synim ruajtjen e pozicionit likuid të bizneseve dhe të individëve në vështirësi të përkohshme;
- eliminimin e kostove të operimit të sistemit të pagesave elektronike, në përgjigje të rritjes së kërkesës për këtë lloj aktiviteti;
- rritjen e kapaciteteve operacionale për të garantuar furnizimin e ekonomisë me para fizike, duke siguruar një stok të mjaftueshëm për përballimin e rritjes së kërkesës së tregut për cash.

Në gjykimin tim, Banka e Shqipërisë ka marrë masat e duhura në kohën e duhur. Në përgjigje të tyre, tregjet financiare vazhdojnë të funksionojnë normalisht, me gjithë kërkesën e rritur të sektorit publik për financim dhe pasigurinë e shtuar për thellësinë dhe kohëzgjatjen e impaktit negativ të pandemisë në ekonomi.

Këto masa mundësojnë dhe plotësojnë paketën fiskale të Qeverisë Shqiptare. Pa një reagim të përbashkët e të koordinuar të politikave makroekonomike, perspektiva ekonomike e vendit do të ishte më sfiduese dhe rimëkëmbja ekonomike më e vështirë.

Të nderuar zonja dhe zotërinj Deputetë,

Kohët që po jetojmë janë të jashtëzakonshme dhe të vështira, por shikimi ynë duhet të jetë i drejtuar tek e ardhmja, tek formulimi dhe implementimi i politikave publike të nevojshme për rimëkëmbjen e vendit. Të gjithë aktorët duhet të luajnë rolin e tyre.

Së pari, politika fiskale duhet të vijojë të luajë një rol primar për përballimin e situatës. Garantimi i fondeve të nevojshme për sistemin shëndetësor, ndihma financiare për punonjësit e prekur, si dhe masat për përmirësimin e likuiditetit të biznesit, nënkuptojnë rritje

“... politika fiskale duhet të vijojë të luajë një rol primar për përballimin e situatës. Garantimi i fondeve të nevojshme për sistemin shëndetësor, ndihma financiare për punonjësit e prekur, si dhe masat për përmirësimin e likuiditetit të biznesit, nënkuptojnë rritje të borxhit publik por janë dhe mbeten të pazëvendësueshme.”

të borxhit publik, por janë dhe mbeten të pazëvendësueshme. Në rrethanat që ndodhemi, rritja e borxhit është një kosto e pranueshme për të garantuar ruajtjen e ekuilibrave ekonomikë dhe financiarë.

Së dyti, Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të ndjekë një politikë monetare stimuluese, të kombinuar me një mbikëqyrje dhe rregullim të kujdesshëm të sektorit bankar. Nga njëra anë, stimuli monetar – i lëvruar në kohën e duhur dhe i bazuar në instrumentet që mundëson kuadri ligjor i Bankës së Shqipërisë dhe nevojat e tregut shqiptar – do të krijojë premisa për nxitjen e kërkesës dhe për reduktimin e kostove financiare. Nga ana tjetër, mbikëqyrja dhe rregullimi i kujdesshëm i sektorit bankar do të orientohen drejt ruajtjes së treguesve të shëndetit të tij dhe drejt ruajtjes së kursimeve të familjeve shqiptare.

Së treti, sektori privat duhet të jetë i gatshëm për të rishikuar modelin e biznesit, për të adoptuar forma novatore dhe eficiente prodhimi. Po ashtu, ai duhet të kujdeset për menaxhimin optimal të likuiditetit dhe për një shpërndarje sa më efektive të kostove të goditjes në zinxhirët e prodhimit, për të mundësuar riaktivizimin sa më të shpejtë të tyre me përfundimin e pandemisë.

Të nderuar zonja dhe zotërinj Deputetë,

Parashikimi i zhvillimeve të ardhshme është relativisht i vështirë, edhe pse logjika e ngjarjeve diktohet në një masë të madhe nga konsiderata të natyrës shëndetësore. Në skenarin tonë bazë, ne presim që tremujori i dytë të shënojë dhe pikun e goditjes në ekonomi, e më pas situata të vijë në përmirësim, fillimisht gradual në dy tremujorët në vazhdim dhe më tej të dukshëm e të preکشëm gjatë vitit 2021.

Në çdo rast, ne mbetemi të bindur se përballimi i goditjes është brenda mundësive tona, nëse secili nga ne do të bëjë më të mirën e vet dhe nëse do të vazhdojmë të garantojmë me prioritet stabilitetin monetar dhe financiar të vendit.

Ju faleminderit!

“Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të ndjekë një politikë monetare stimuluese, të kombinuar me një mbikëqyrje dhe rregullim të kujdesshëm të sektorit bankar.”

FJALA E GUVERNATORIT SEJKO GJATË PREZANTIMIT TË RAPORTIT VJETOR TË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR VITIN 2019 NË KUVENDIN E SHQIPËRISË - 2 korrik 2020 -

*I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,
Të nderuar zonja dhe zotërinj Deputetë,*

Më lejoni t'ju falënderoj për ftesën dhe mundësinë që më keni dhënë për të prezantuar përpara jush Raportin Vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2019.

Në vija të përgjithshme, konstatoj se puna e Bankës së Shqipërisë ka pasur një kontribut pozitiv në forcimin e stabilitetit monetar dhe financiar të vendit. Ky stabilitet është një parakusht i domosdoshëm për zhvillimin e qëndrueshëm dhe afatgjatë të vendit. Po ashtu, Banka e Shqipërisë ka përmbushur detyrat e tjera ligjore të saj, ka shënuar progres në implementimin e Strategjisë Afatmesme të Zhvillimit, si dhe ka zbatuar rekomandimet e lëna nga Kuvendi i Shqipërisë.

“... puna e Bankës së Shqipërisë ka pasur një kontribut pozitiv në forcimin e stabilitetit monetar dhe financiar të vendit. Ky stabilitet është një parakusht i domosdoshëm për zhvillimin e qëndrueshëm dhe afatgjatë të vendit.”

Në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, objektivi kryesor i punës së Bankës së Shqipërisë është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve.

1. EKONOMIA SHQIPTARE DHE POLITIKA MONETARE GJATË VITIT 2019


Viti 2019 ishte një vit sfidues për ekonominë shqiptare. Aktiviteti ekonomik vijoi të përfitojë nga rritja e konsumit privat dhe zgjerimi i shpejtë i turizmit. Megjithatë, mjedisi i huaj u shfaq i pafavorshëm, ndërkohë që rënia e prodhimit të energjisë elektrike, përfundimi gradual i investimeve në projektet madhore energjetike, si dhe tërmeti i muajit nëntor patën efekte të forta negative. Për rrjedhojë, rritja ekonomike e vitit 2019 rezultoi në nivelin 2.2%, në rënie kundrejt nivelit 4.1% të shënuar vitin paraardhës.

Goditjet që pësuam ngadalësuan tempin e rritjes, por nuk e devijuan ekonominë shqiptare nga trendi pozitiv i zhvillimit. Kjo ecuri u pasqyrua në reduktimin e normës së papunësisë, në rritjen e punësimit dhe të pagave, si dhe në reduktimin e borxhit të huaj dhe të borxhit publik të vendit. Paralelisht me to, treguesit kryesorë të shëndetit të sektorit bankar mbetën në nivele të kënaqshme.

Inflacioni mesatar i vitit 2019 rezultoi në nivelin 1.4%. Ecuria ende nën objektiv e inflacionit kërkoi ruajtjen e kahut stimulus të politikës monetare gjatë vitit 2019. Për këtë arsye, Banka e Shqipërisë mbajti të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 1.0%, orientoi tregun mbi ruajtjen e kahut lehtësues të politikës monetare në horizontin afatmesëm, si dhe furnizoi bankat me likuiditetin e nevojshëm.

Në përgjigje të politikës sonë monetare, kushtet financiare ishin stimuluese për rritjen e kërkesës agregate dhe të përshtatshme për kthimin e inflacionit në objektiv. Stimuli monetar solli uljen e çmimit të kredisë dhe nxiti rritjen e kreditimit. Në këto rrethana, kreditimi i sektorit privat përjetoi një rritje relativisht të shpejtë dhe shfaqti një shpërndarje më të mirë. Po ashtu, stimuli monetar reduktoi koston e shërbimit të borxhit për bizneset dhe familjet, si dhe krijoi premisa për një kurs më të qëndrueshëm këmbimi.

Grafik 5. Transmetimi i stimullit monetar në normat e interesit të kredisë, depozitave dhe bonove të thesarit*




* Ndryshime kumulative prej fillimit të ciklit lehtësues të politikës monetare (në pikë përqindjeje). Burimi: Banka e Shqipërisë.

Krahas mbështetjes së stabilitetit të çmimeve, Banka e Shqipërisë i ka kushtuar rëndësi dhe promovimit të stabilitetit financiar, nëpërmjet mbikëqyrjes dhe rregullimit të kujdesshëm të sektorit bankar, si dhe nëpërmjet koordinimit të punës me autoritetet e tjera mbikëqyrëse të sektorit financiar.

2. MBIKËQYRJA BANKARE DHE STABILITETI FINANCIAR

Sektori bankar shqiptar vijon të mbetet financiarisht i shëndetshëm dhe ka shfaqur një dinamizëm në rritje. Ky sektor ka qenë rentabël gjatë vitit 2019, ndërkohë që treguesit e tij të likuiditetit dhe kapitalizimit janë mbi kërkesat tona rregullatore. Po ashtu, ushtrimet e provave të rezistencës tregojnë se ekspozimi i sektorit bankar ndaj rreziqeve sistematike është i kontrolluar dhe se aftësia e sektorit bankar për të përballuar rreziqet është e fortë.

Grafik 6. Vlerësimi i bankave mbi rreziqet kryesore sistematike në vend



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Më poshtë do të rendis shkurtimisht disa nga drejtimit kryesore të punës sonë për forcimin e mbikëqyrjes bankare dhe për mbështetjen e stabilitetit financiar.

- Së pari, Banka e Shqipërisë administroi me sukses procesin e konsolidimit të sektorit bankar. Ky proces riformatoi tregun bankar vendas, duke sjellë aktorë të rinj e të motivuar, si dhe rritje të kapitalit vendas.

- Së dyti, Banka e Shqipërisë përmbushi të gjitha detyrimet e saj në kuadër të planit kombëtar për reduktimin e kredive me probleme. Falë masave të marra ndër vite, raporti i kredive me probleme ra nga një maksimum prej pothuaj 25% në vitin 2014, në 8.4% në fund të vitit 2019.
- Së treti, Banka e Shqipërisë punoi për përmbushjen e rekomandimeve të Komitetit të Ekspertëve të KiE-së për Vlerësimin e Masave kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (MONEYVAL). Në raportin vlerësues të Moneyval-it, subjektet financiare u vlerësuan në nivelin e efektivitetit "*substantial*" ose "i konsiderueshëm".
- Së katërti, Banka e Shqipërisë ka vijuar të adoptojë akte të reja rregullatore të aktivitetit bankar apo të rishikojë ato në fuqi, me synim përaftrimin e mëtejshëm me direktivat dhe rregulloret e Bashkimit Evropian dhe me dokumentet e Komitetit të Bazelit.
- Së fundi, puna për nxitjen e kreditimit të shëndetshëm të ekonomisë është shoqëruar nga mbikëqyrja e kujdesshme e sistemit bankar, nëpërmjet ekzaminimeve të plota dhe të pjesshme.

Realizimi i detyrave institucionale nënkupton dhe një vëmendje konstante ndaj fushave të tjera të aktivitetit të Bankës së Shqipërisë. Këtu gjej me vend të theksoj zhvillimin e mëtejshëm të funksionit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, nxitjen e zhvillimit të sistemit të pagesave, rritjen e cilësisë së kartëmonedhës, administrimin e rezervës valutore, përmirësimin e statistikave, mbështetjen e integritimit evropian, si dhe punën për edukimin e publikut dhe përmirësimin e komunikimit me të.

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Momenti në të cilin po bëj këtë prezantim është jo i zakonshëm. Pandemia COVID-19 dhe masat e nevojshme për kontrollin e saj, kanë dhënë një goditje të fortë mbi familjet dhe bizneset shqiptare gjatë tre muajve të fundit. Ekonomia shqiptare pritet të shënojë rënie gjatë vitit 2020, rënie e cila do të shoqërohet me rritje të papunësisë, me rënie të të ardhurave familjare, si dhe me përkeqësim të situatës financiare të bizneseve dhe shtim të kredive me probleme në sektorin bankar.

Kjo goditje kërkoi një reagim të shpejtë dhe të gjithanshëm të autoriteteve publike, si në planin shëndetësor dhe në atë ekonomik e social.

Krahas masave lehtësuese fiskale, Banka e Shqipërisë ndërmori një paketë të plotë masash për të siguruar likuiditetin e nevojshëm për

sistemin bankar, për të nxitur kreditimin dhe për të kontrolluar kostot e shërbimit të borxhit. Kjo paketë përfshin:

- uljen në 0.5% të normës bazë të interesit dhe furnizimin e pakufizuar me likuiditet të sistemit bankar;
- lehtësimin e përkohshëm të rregulloreve bankare, për të mundësuar shtyrjen e përkohshme të pagesës së kësteve të kredisë për klientët në vështirësi dhe ristrukturimin konsensual të kredive për klientët me perspektiva solide biznesi, duke ndihmuar financat e bizneseve dhe rritur shanset e tyre për mbijetesë;
- eliminimin e kostove të operimit të sistemit të pagesave elektronike, në përgjigje të rritjes së kërkesës për këtë lloj aktiviteti;
- rritjen e kapaciteteve operacionale për të garantuar furnizimin e ekonomisë me para fizike.

“Banka e Shqipërisë ndërmori një paketë të plotë masash për të siguruar likuiditetin e nevojshëm për sistemin bankar, për të nxitur kreditimin dhe për të kontrolluar kostot e shërbimit të borxhit.”

Në përgjigje të këtyre masave, tregjet financiare vazhdojnë të funksionojnë normalisht, me gjithë kërkesën e rritur të sektorit publik për financim dhe pasigurinë e shtuar në ekonomi. Po ashtu, ato mundësojnë dhe plotësojnë paketën fiskale të qeverisë shqiptare.

Në planin ekonomik, masat e koordinuara fiskale, monetare dhe makroprudenciale, kanë zbutur pjesërisht efektet negative të pandemisë. Gjithsesi, sfidat që kemi përpara mbeten serioze. Në gjykimin tonë, ekonomia shqiptare i ka premisat ta përballojë me sukses këtë goditje. Megjithatë, kjo kërkon që të gjithë aktorët publikë dhe operatorët e sektorit privat të marrin vendimet e duhura, në kohën e duhur dhe në mënyrë sa më të koordinuar.

Përballimi i goditjes është brenda mundësive tona, nëse secili nga ne do të bëjë më të mirën dhe nëse do të vazhdojmë të garantojmë me prioritet stabilitetin monetar dhe financiar të vendit.

Ju faleminderit!



KONFERENCË PËR SHTYP

RAPORTI I NDËRMJETËM I POLITIKËS
MONETARE

1 KORRIK 2020



KAPITULLI II

KONFERENCA PËR SHTYP PËR VENDIMMARRJEN E POLITIKËS MONETARE

- *Fjala e Guvernatorit Sejko mbi vendimmarrjen e politikës monetare të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, 5 shkurt 2020*
- *Fjala e Guvernatorit Sejko mbi vendimmarrjen e politikës monetare të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, 25 mars 2020*
- *Fjala e Guvernatorit Sejko mbi vendimmarrjen e politikës monetare të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, 6 maj 2020*
- *Fjala e Guvernatorit Sejko mbi vendimmarrjen e politikës monetare të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, 1 korrik 2020*
- *Fjala e Guvernatorit Sejko mbi vendimmarrjen e politikës monetare të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, 5 gusht 2020*
- *Fjala e Guvernatorit Sejko mbi vendimmarrjen e politikës monetare të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, 7 tetor 2020*
- *Fjala e Guvernatorit Sejko mbi vendimmarrjen e politikës monetare të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, 16 dhjetor 2020*

Konferencat për shtyp për vendimmarrjen e politikës monetare

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë zhvillon 15 mbledhje në vit, nga të cilat 8 i dedikohen vendimmarrjes së politikës monetare. Politika monetare hartohet në funksion të objektivit kryesor të Bankës së Shqipërisë - arritjes dhe ruajtjes së stabilitetit të çmimeve. Pas çdo mbledhjeje, në orën 16:00, Guvernatori i shpjegon publikut në prani të medias në një konferencë për shtyp vendimin e marrë nga Këshilli Mbikëqyrës mbi qëndrimin e politikës monetare dhe analizën e përdorur në mbështetje të këtij vendimi. Në fund të konferencës, Guvernatori i përgjigjet dhe pyetjeve të ngritura nga gazetarët pjesëmarrës në konferencë.

BANKA E SHQIPËRISË MBAN TË PANDRYSHUAR NORMËN BAZË TË INTERESIT NË NIVELIN 1.0% - 5 shkurt 2020 -

Aktiviteti ekonomik në vend përjetoi goditje nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019.

Pasojat e tërmetit pritet të kenë një efekt rezultat ngadalësues në rritje ekonomike dhe inflacion gjatë vitit 2020.

Ritmi i rritjes do të përshpejtohet në vitet në vazhdim, i cili pritet të kthejë ekonominë në ekuilibër dhe inflacionin në objektiv brenda vitit 2021.

Të nderuar përfaqësues të medias,

Sot, në mbledhjen e datës 5 shkurt 2020, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim dhe miratoi Raportin Tremujor të Politikës Monetare.

Informacioni i ri i marrë në analizë sugjeron se aktiviteti ekonomik në vend u godit nga tërmeti i datës 26 nëntor, por kjo goditje nuk ka dëmtuar trendin afatmesëm dhe afatgjatë të zhvillimit. Pasojat e tërmetit pritet të kenë një efekt rezultat ngadalësues në rritje dhe në inflacion, por ky ngadalësim pritet të jetë i përkohshëm dhe i përqendruar gjatë vitit 2020.


Përditësimi i skenarit bazë të parashikimeve tona sugjeron se ritmi i rritjes do të përshpejtohet në afatin e mesëm. Ky përshpejtim pritet ta kthejë ekonominë në ekuilibër dhe inflacionin në objektiv brenda vitit 2021. Në këto rrethana, Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi se niveli aktual i stimulit monetar vijon të mbetet i përshtatshëm.

Paralelisht me skenarin bazë, Këshilli Mbikëqyrës konstatoi se rreziqet e kahut të poshtëm janë shtuar. Materializimi i tyre do të kërkonte një rishikim në kahun lehtësues të qëndrimit të politikës monetare.

Në vijim do të paraqes më në detaje konkluzionet e raportit dhe arsyet e vendimarrjes.

Inflacioni mesatar i tremujorit të katërt regjistroi vlerën 1.3%, duke shënuar rënie krahasuar me tremujorin paraardhës dhe duke mbetur poshtë objektivit tonë prej 3%. Rënia e normës së inflacionit pasqyroi rritjen më të ngadaltë të çmimeve të ushqimeve, një fenomen ky i pranishëm veçanërisht në muajin dhjetor. Ndërkohë, çmimet e artikujve të tjerë të shportës shënuan luhatje të pakta.

Grafik 7. Inflacioni total dhe objektiv




Burimi: INSTAT, baza e të dhënave Tradings Economics dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Në aspektin makroekonomik, normat e ulëta dhe nën objektiv të inflacionit pasqyrojnë rritjen ende të pamjaftueshme të pagave dhe të kostove të brendshme të prodhimit, inflacionin e ulët në partnerët tanë tregtarë, si dhe efektet prapavepruese të forcimit të shpejtë të kursit të këmbimit gjatë vitit 2018.

Efekti frenues i këtyre faktorëve do të zbutet gradualisht në afatin e mesëm.

Sipas të dhënave të INSTAT-it, ekonomia shqiptare shënoi një rritje vjetore prej 3.8% në tremujorin e tretë, duke u përshpejtuar kundrejt gjysmës së parë të vitit dhe duke qenë në kahun e sipërm të pritjeve tona. Në terma sektorialë, ky përshpejtim u diktua nga sezoni i mirë turistik dhe reduktimi i efektit negativ të ardhur nga rënia e prodhimit të energjisë elektrike. Në terma të kërkesës agregate, ai pasqyroi rritjen më të shpejtë të konsumit dhe eksporteve, ndërkohë që investimet private shënuan rënie.

Grafik 8. Produkti i brendshëm bruto nga ana e prodhimit dhe tregesis e besimit



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë. *Të dhënat janë gjysmë-përfundimtare. **Një vlerësim i parë.

Zgjerimi i kërkesës agregate është shoqëruar me përmirësimin gradual të pozicionit ciklik të vendit gjatë katër viteve të fundit. Në përgjigje të këtyre trendeve, norma e papunësisë shënoi vlerën 11.4% në tremujorin e tretë, çka përbën dhe normën më të ulët historike të regjistruar në Shqipëri, ndërsa paga mesatare regjistroi një rritje vjetore prej 3.7%.

Megjithatë, rritja e pagave dhe e kostove të prodhimit mbetet ende e pamjaftueshme për kthimin e inflacionit në objektiv, çka dëshmon se ekonomia shqiptare është ende larg punësimit të plotë të kapaciteteve të saj prodhuese.


Informacioni i disponuar mbi zhvillimet ekonomike të tremujorit të katërt është ende jo i plotë. Analiza e të dhënave paraprake sugjeron se tërmeti i datës 26 nëntor pati një ndikim negativ në ritmin e rritjes ekonomike. Ky ndikim pritet të mbartet edhe gjatë vitit 2020. Dëmtimi i ambienteve të biznesit, rritja e pasigurisë dhe riorientimi i shpenzimeve drejt riparimit të dëmeve, pritet të materializohen në ngadalësim të prodhimit në disa sektorë, përfshi dhe turizmin. Nga ana tjetër, procesi i rindërtimit pritet të japë një efekt pozitiv në rritje, por ky efekt do të jetë më i vonë në kohë krahasuar me atë të goditjeve negative dhe as mjaftueshëm i fortë sa të kompensojë efektet e tyre.

Duke gjykuar mbi informacionin e disponuar dhe përvojën botërore, Banka e Shqipërisë vlerëson se tërmeti nuk ka dëmtuar bazat afatmesme dhe afatgjata të rritjes e zhvillimit të vendit.

Riparimi i dëmeve dhe normalizimi i situatës do të ndihmojë në rigjenerimin e kapaciteteve prodhuese dhe zgjerimin më të shpejtë të kërkesës agregate në vitin 2021, e në vazhdim. Rritja e punësimit dhe e pagave do të mbështesë zgjerimin e konsumit familjar, rritja e shkallës së shfrytëzimit të kapaciteteve do të rrisë kërkesën për investime, ndërsa eksportet shqiptare do të vijojnë të përfitojnë nga zgjerimi i sektorit të turizmit.

Paralelisht me to, ambienti i përgjithshëm financiar paraqitet i favorshëm. Tregjet financiare janë relativisht të qeta, kostot e financimit janë të ulëta, ndërsa kursi i këmbimit paraqitet më i qëndrueshëm. Politika jonë monetare stimuluese, ristrukturimi i sektorit bankar dhe përmirësimi i bilanceve të tij, kanë nxitur një rritje më të shpejtë të kreditimit. Portofoli i kredisë shënoi një rritje mesatare prej 7.8% gjatë tremujorit të katërt, i mbështetur nga zgjerimi i kredisë për biznese dhe i kredisë në lekë. Struktura e rritjes së kredisë jep sinjale inkurajuese, si për sa i takon ndikimit të saj në rritjen ekonomike ashtu dhe për cilësinë e portofolit të kredisë në afatin e gjatë. Në të njëjtën kohë, raporti i kredive me probleme zbriti në nivelin 8.4% në muajin dhjetor, duke pasqyruar masat konkrete të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë për reduktimin e tyre, si dhe përmirësimin e ambientit ekonomik dhe të gjendjes financiare të kredimarrësve.

Grafik 9. Struktura e kredisë për biznese sipas madhësisë së biznesit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Duke parë nga e ardhmja, Banka e Shqipërisë gjykon se ndikimi i tërmetit në ekonomi pritet të jetë i përqendruar në vitin 2020. Rritja

ekonomike dhe inflacioni mesatar i këtij viti pritet të jenë në nivele të krahasueshme me normat e shënuara gjatë vitit 2019. Nga ana tjetër, tejkalimi i pasojave të tërmetit pritet t'i hapë rrugë një rritjeje më të shpejtë të ekonomisë dhe të inflacionit në periudhën pasuese.

Krahasuar me raundin paraardhës, projeksioni ynë bazë shfaq një lëvizje të dukshme në kahun e poshtëm për vitin 2020, por ruan të njëjtat trajektore për vitet 2021 e në vazhdim. Këto parashikime kanë një dozë të shtuar pasigurie, e cila lidhet në masën më të madhe me pamundësinë e parashikimit të saktë të ndikimit të tërmetit në rritjen ekonomike. Po ashtu, balanca e rreziqeve rreth parashikimit tonë qendror është e zhvendosur në kahun e poshtëm.

Duke gjykuar mbi këto parashikime, Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi se qëndrimi aktual i politikës monetare mbetet i përshtatshëm. Në këto rrethana, ai vendosi:

- të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit në nivelin aktual prej 1.00%; dhe,
- të mbajë të pandryshuara normat e interesit të depozitës dhe të kredisë njëditore, përkatësisht në nivelet 0.1% dhe 1.9%.

Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi se përmbushja e objektivit tonë të stabilitetit të çmimeve do të kërkojë ruajtjen e kahut stimulues të politikës monetare përgjatë gjithë horizontit afatmesëm.

Nga ana tjetër, Këshilli Mbikëqyrës konstaton se rreziqet e kahut të poshtëm mbeten të pranishme. Këto rreziqe burojnë si nga ambienti i jashtëm, ku përmirësimi i ekonomisë së Eurozonës mbetet ende i brishtë, ashtu dhe nga ai i brendshëm. Në veçanti, Këshilli Mbikëqyrës vlerëson se rreziqet potenciale me ndikim të mundshëm negativ janë:

- një intensitet më i fortë i efekteve negative të tërmetit në ecurinë e ekonomisë përgjatë vitit 2020 e në vazhdim – ky skenar mund të materializohet nëse efektet psikologjike të tërmetit tejkalojnë ndikimin e tij material në ekonomi;
- vonesa kohore në programin e rindërtimit, apo një mbështetje më e madhe e tij në burimet e brendshme të financimit.

Adresimi i këtyre rreziqeve mbetet atribut i strukturave të qeverisjes qendrore dhe vendore, por materializimi i tyre do të kërkonte një rishikim në kahun lehtësues të qëndrimit të politikës monetare.

Së fundi, Këshilli Mbikëqyrës thekson nevojën e përshejtit të mëtejshëm të reformave strukturore, si instrumenti kryesor për gjenerimin e një rritjeje ekonomike të shpejtë, të qëndrueshme dhe afatgjatë, si dhe nevojën e ruajtjes së fokusit të politikave ekonomike drejt ruajtjes së qëndrueshmërisë afatgjatë të vendit.

“Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi se përmbushja e objektivit tonë të stabilitetit të çmimeve do të kërkojë ruajtjen e kahut stimulus të politikës monetare përgjatë gjithë horizontit afatmesëm.”

BANKA E SHQIPËRISË UL NORMËN BAZË TË INTERESIT NË NIVELIN 0.5%

- 25 mars 2020 -

Ulja e normës bazë të interesit në vazhdim të masave të mëparshme të Bankës së Shqipërisë për zbutjen e ndikimit të pandemisë COVID-19 në shëndetin ekonomik dhe financiar të vendit.

Banka e Shqipërisë ka rritur kapacitetet operacionale për të garantuar furnizimin e ekonomisë me monedhë dhe kartëmonedhë, si dhe për të garantuar funksionimin normal të sistemit të pagesave elektronike.

Masat tona monetare, rregullatore dhe institucionale, do të qëndrojnë në fuqi për sa kohë do të jetë e nevojshme.


I nderuar publik,

Ndodhem sot para jush, në këtë format jo të zakonshëm komunikimi, për t'ju bërë me dije vendimin e fundit të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë. Ky vendim merret në vazhdim të masave të mëparshme të Bankës së Shqipërisë për zbutjen e ndikimit të pandemisë COVID-19 në shëndetin ekonomik dhe financiar të vendit.

Sot, në mbledhjen e datës 25 mars 2020, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi të lehtësojë më tej qëndrimin e politikës monetare dhe kushtet monetare e financiare në vend. Më konkretisht, Këshilli Mbikëqyrës vendosi:

- të ulë normën bazë të interesit, nga 1.0% në 0.5%;
- të ulë normën e interesit të kredisë njëditore, nga 1.9% në 0.9%;
- të mbajë të pandryshuar normën e interesit të depozitës njëditore, në nivelin 0.1%.

Grafik 10. Norma bazë e interesit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Përhapja e pandemisë COVID-19 në Shqipëri përbën një sfidë për ekonominë dhe sektorin tonë financiar. Masat e nevojshme të kujdesit, të marra nga autoritetet publike dhe private për të kufizuar përhapjen e virusit COVID-19 në popullsi, do të kenë dhe një ndikim të dyfishtë në aktivitetin ekonomik. Nga njëra anë, reduktimi i përkohshëm i prodhimit dhe punësimit sjell uljen e ofertës së mallrave e shërbimeve në treg dhe reduktimin e të ardhurave të familjeve. Nga ana tjetër, distancimi social sjell rënien e kërkesës, si dhe tkurrjen e shitjeve, të të ardhurave dhe të likuiditetit të bizneseve.

Në gjykimin e Këshillit Mbikëqyrës, ulja e normës bazë të interesit është një masë e nevojshme për reduktimin e kostos së huamarrjes së re, për reduktimin e kostos së shërbimit të borxhit ekzistues dhe për lehtësimin e qarkullimit të likuiditetit në bizneset dhe familjet shqiptare. Ajo ndihmon funksionimin sa më normal të mekanizmit të transmetimit të politikës monetare, si dhe lehtëson presionin mbi bilancet financiare të operatorëve ekonomikë, duke iu dhënë atyre më shumë kohë, hapësirë dhe frymëmarrje për përbalimin e goditjes.

Ky vendim i sotëm plotëson masat e tjera që kemi marrë për minimizimin e efekteve të pandemisë. Gjatë ditëve të fundit:

- Banka e Shqipërisë ka rritur kapacitetet operationale për të garantuar furnizimin e ekonomisë me monedhë dhe kartëmonedhë, si dhe për të garantuar funksionimin normal të sistemit të pagesave

elektronike. Brenda kufizimit orar të lëvizjes të vendosur nga autoritetet publike, të gjithë operatorët ekonomikë duhet të jenë të vetëdijshëm se sistemi i pagesave do të funksionojë normalisht.

- Banka e Shqipërisë ka adoptuar strategjinë operacionale të injektimit të pakufizuar të likuiditetit në sektorin bankar. Ky sektor, dhe nëpërmjet tij bizneset, familjet dhe sektori publik, do të kenë mundësi të tërheqin pranë Bankës së Shqipërisë të gjithë likuiditetin e nevojshëm dhe të kërkuar prej tyre.
- Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi të lehtësojë procedurat e shtyrjes me një tremujor të pagesës së kësteve të kredisë për bizneset dhe familjet e prekura nga kriza, duke i ofruar sektorit bankar hapësirat e nevojshme rregullatore për ta bërë këtë.

Këto masa që ne kemi marrë, brenda fushës sonë të kompetencës, mundësojnë dhe plotësojnë paketën fiskale të shpallur nga qeveria shqiptare, e cila synon të zhvendosë një pjesë të faturës financiare të përballimit të krizës nga sektori privat në sektorin publik.

Këshilli Mbikëqyrës mbetet në monitorim të vazhdueshëm të situatës. Në linjë me masat e marra nga bankat e tjera qendrore dhe në varësi të evoluimit të situatës, Banka e Shqipërisë mbetet e gatshme të përdorë të gjitha instrumentet operacionale dhe hapësirën rregullatore që disponon, për të minimizuar pasojat e pandemisë në ekonominë dhe sistemin financiar shqiptar.

Në çdo rast, objektivi i aksionit tonë do të jetë ruajtja e stabilitetit monetar dhe financiar të vendit, lehtësimi i kostove të krizës për bizneset dhe familjet shqiptare, dhe krijimi i premisave për një rimëkëmbje sa më të shpejtë të ekonomisë në periudhën vijuese. Plotësimi i këtyre parakushteve i hap rrugë respektimit të objektivit tonë të stabilitetit të çmimeve në afatin e mesëm dhe të gjatë.

“... objektivi i aksionit tonë do të jetë ruajtja e stabilitetit monetar dhe financiar të vendit, lehtësimi i kostove të krizës për bizneset dhe familjet shqiptare, dhe krijimi i premisave për një rimëkëmbje sa më të shpejtë të ekonomisë në periudhën vijuese.”

Masat tona monetare, rregullatore dhe institucionale, do të qëndrojnë në fuqi për sa kohë do të jetë e nevojshme.

Në një perspektivë më afatgjatë, Këshilli Mbikëqyrës gjen me vend të theksojë se mesazhet që kemi dhënë në vazhdimësi mbi shëndetin e ekonomisë dhe të sistemit bankar shqiptar mbeten të vlefshme. Më lejoni t'i ritheksoj:

- Shqipëria gëzon shëndet të mirë ekonomik dhe financiar;
- parametrat e funksionimit të ekonomisë dhe të sektorit bankar janë të shëndetshëm;
- rezervat e likuiditetit dhe të kapitalit të sektorit bankar shqiptar janë të larta.

Në këtë kontekst, Këshilli Mbikëqyrës vëren se minimizimi i pasojave afatgjata të pandemisë kërkon përpjekje serioze, të koordinuara dhe të harmonizuara, nga të gjitha autoritetet publike dhe private në vend.

“... Banka e Shqipërisë mbetet e gatshme të përdorë të gjitha instrumentet operacionale dhe hapësirën rregullatore që disponon, për të minimizuar pasojat e pandemisë në ekonominë dhe sistemin financiar shqiptar.”

BANKA E SHQIPËRISË MBAN TË PANDRYSHUAR NORMËN BAZË TË INTERESIT NË NIVELIN 0.5% - 6 maj 2020 -

Qëndrimi aktual i politikës monetare mbetet i përshtatshëm për përballimin e emergjencës.

Masat e distancimit social dhe rritja e pasigurisë kanë sjellë ngadalësim të komponentëve të kërkesës agregate dhe rënie të mëtejshme të prodhimit.

Përshkallëzimi i mëtejshëm i goditjes apo vështirësitë në mekanizmin e transmetimit të politikës monetare, do të kërkonin rritjen e stimullit monetar.

Të nderuar përfaqësues të medias,

Sot, në datën 6 maj 2020, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim dhe miratoi Raportin Tremujor të Politikës Monetare 2020/II.

Analiza e situatës ekonomike dhe financiare të vendit, diskutimi i skenarëve të zhvillimeve të mundshme në të ardhmen, si dhe identifikimi i strategjisë së reagimit të politikës monetare, u dominuan nga efektet aktuale dhe të pritura të pandemisë COVID-19 në Shqipëri.

Në përfundim të diskutimit, Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi se qëndrimi aktual i politikës monetare mbetet i përshtatshëm për përballimin e emergjencës, por përshkallëzimi i mëtejshëm i goditjes apo krijimi i vështirësive në mekanizmin e transmetimit të politikës monetare, do të kërkonin rritjen e stimullit monetar dhe, potencialisht, adoptimin e instrumenteve jokonvencionale të saj.

Emergjenca shëndetësore e shkaktuar nga përhapja e COVID-19 dhe masat e autoriteteve publike për kontrollin e saj, në Shqipëri dhe në botë, përbëjnë një sfidë për stabilitetin ekonomik dhe financiar të vendit, për shëndetin e financave të bizneseve dhe familjeve, si dhe për qëndrueshmërinë e rritjes ekonomike të vendit, në afatin e mesëm dhe të gjatë.

Informacioni i disponueshëm tregon se COVID-19 do të ketë një ndikim të fortë në të gjithë treguesit ekonomikë dhe financiarë të vendit.

Masat e distancimit social dhe rritja e pasigurisë kanë sjellë një ngadalësim të përgjithshëm të thuajse gjithë komponentëve të kërkesës agregate: eksportit të mallrave e shërbimeve, konsumit familjar dhe investimeve. Paralelisht me to, mbyllja e përkohshme e disa aktiviteteve të prodhimit e shërbimit, ka sjellë një rënie të mëtejshme të prodhimit. Kjo goditje e dyfishtë, kërkesë dhe oferte, do të pasqyrohet në rënie të aktivitetit ekonomik gjatë vitit 2020. Më tej, rënia e prodhimit pritet të shoqërohet me rënie të punësimit, rritje të papunësisë, rënie të të ardhurave familjare dhe vështirësi financiare për bizneset.

Dinamika afatmesme dhe afatgjatë e zhvillimit ekonomik, në Shqipëri sikundër dhe në botë, do të varet nga kohëzgjatja e pandemisë.

Në skenarin pozitiv, atë të një reduktimi gradual të masave të distancimit social gjatë tremujorit të dytë, aktiviteti ekonomik në vend pritet të shënojë pikun e ngadalësimit në tremujorin e dytë, të vijojë të mbetet në territor negativ gjatë dy tremujorëve në vijim, dhe t'i kthehet rritjes në vitin 2021. Ky skenar parashikon një normë inflacioni relativisht të qëndrueshme gjatë vitit 2020 dhe një rritje graduale të saj drejt objektivit në dy vitet pasuese. Në këtë skenar, pandemia do të lërë gjurmë të dukshme, por kalimtare, në ekonominë dhe financat e vendit. Mbi të gjitha, ajo nuk do të cenojë ekuilibrat ekonomikë e financiarë dhe trendet afatmesme dhe afatgjata të zhvillimit.


Nga ana tjetër, një zgjatje potenciale e pandemisë përtej tremujorit të dytë nënkupton dhe një ndikim proporcionalisht më të lartë negativ në treguesit ekonomikë dhe financiarë të vendit.

Këshilli Mbikëqyrës gjykon se objektivi primar i politikave publike, si dhe i reagimit të sektorit privat, duhet të jetë marrja e masave për përballimin e emergjencës dhe krijimi i premisave për rikuperimin sa më të shpejtë të rritjes ekonomike në të ardhmen. Kjo do të kërkojë, së pari, ruajtjen e stabilitetit monetar dhe financiar të vendit dhe, së dyti, kufizimin e dëmeve mbi kapacitetet prodhuese të vendit.

Në këtë kontekst, Këshilli Mbikëqyrës vlerëson se politika fiskale ka një rol primar në përballimin e situatës. Alokimi i fondeve të nevojshme për përballimin e emergjencës shëndetësore, ndihma sociale për familjet e prekura dhe në nevojë, si dhe masat fiskale për përmirësimin e gjendjes

së likuiditetit të bizneseve, janë masa të nevojshme për adresimin e situatës. Rritja e borxhit publik është një kosto e pranueshme për ruajtjen e ekuilibrave ekonomike dhe financiare të vendit.

Grafik 11. Orientimi i politikës fiskale*



*Orientimi i politikës fiskale është përafshuar me ndryshimin e raportit të deficitit primar kumulativ për një periudhë 12-mujore ndaj PBB-së, krahasuar me një vit më parë. Ndryshimet negative, pra vlerat e këtij treguesi nën zero, tregojnë që pozicioni fiskal është përmirësuar, çka në mënyrë indirekte tregon për vlera negative të impulsit fiskal në ekonomi.

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, INSTAT, dhe Illogaritje të stafit të Bankës së Shqipërisë.

Po ashtu, Këshilli Mbikëqyrës vëren se biznesi privat duhet të jetë fleksibël në adoptimin e modeleve të reja të biznesit, i kujdesshëm në administrimin e situatës së likuiditetit, si dhe largpamës në një ndarje të drejtë të kostove, në interes të ruajtjes së zinxhirëve të prodhimit e shërbimit.

Nga ana e saj, Banka e Shqipërisë ka marrë një paketë të plotë masash për adresimin e situatës.

- Lehtësimi i qëndrimit të politikës monetare nga Banka e Shqipërisë, nëpërmjet uljes në 0.5% të normës bazë të interesit dhe nëpërmjet furnizimit të pakufizuar me likuiditet të sistemit bankar, duke nxitur funksionimin sa më normal të tregjeve financiare dhe duke mundësuar rritjen e vëllimit dhe uljen e kostos së kredisë për sektorin privat.
- Prezantimi i masave lehtësuese në fushën e rregullimit bankar ka inkurajuar shtyrjen e përkohshme, me një tremujor, të pagesës së kësteve të kredive, duke përmirësuar gjendjen e likuiditetit të bizneseve dhe individëve në vështirësi të përkohshme dhe shanset e tyre për mbijetesë.
- Paralelisht me to, ne kemi lehtësuar koston e operimit të sistemit të pagesave elektronike, duke iu përgjigjur nevojave në rritje për

këtë lloj shërbimi, si dhe jemi kujdesur për furnizimin normal të ekonomisë me para fizike.

Këshilli Mbikëqyrës vlerëson se Banka e Shqipërisë ka marrë masat e duhura në kohën e duhur. Në përgjigje të tyre, tregjet financiare vazhdojnë të ushtrtojnë aktivitet brenda kufijve të normalitetit, me gjithë kërkesën e rritur të sektorit publik për fonde dhe pasigurinë e shtuar mbi të ardhmen ekonomike dhe financiare të vendit.

Në mbyllje të diskutimeve, duke gjykuar dhe mbi projeksionet e skenarit të përfundimit të shpejtë të pandemisë, Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi se qëndrimi aktual i politikës monetare është i përshtatshëm. Për këtë arsye, ai vendosi:

- të lerë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 0.5%;
- të lerë të pandryshuara normat e interesit të depozitave dhe kredive njëditore, respektivisht në 0.1% dhe 0.9%.

Gjithashtu, konfirmimi i skenarit pozitiv nënkupton se politika monetare do të vijojë të mbetet lehtësuese gjatë gjithë horizontit të parashikimit.

Nga ana tjetër, Këshilli Mbikëqyrës vëren se pasiguria në parashikime, kësaj here, është tejet e lartë. Po ashtu, kjo pasiguri ka formën e një probabiliteti relativisht të lartë që zhvillimet e ardhshme të rezultojnë në kahun e poshtëm të pritjeve tona. Rreziqet e kahut të poshtëm burojnë veçanërisht nga:

- zgjatja e mundshme e pandemisë përtej tremujorit të dytë;
- krijimi i problemeve në mekanizmin e transmetimit të politikës monetare, në formën e rritjes së normave të interesit dhe kostove të financimit të sektorit privat, në formën e përkeqësimit të ofertës së kredisë bankare, apo në formën e luhatjeve të forta të treguesve të tjerë të tregut financiar.

Këshilli Mbikëqyrës vëren se materializimi i këtyre rreziqeve mund të kërkojë një lehtësim të mëtejshëm të qëndrimit të politikës monetare. Në përputhje me planet tona të kontigjencës, ky lehtësim mund të marrë dhe formën e instrumenteve jokonvencionale, instrumente të cilat do të jenë gjithnjë në përputhje me realitetin dhe nevojat e tregut financiar shqiptar dhe me kuadrin ligjor që rregullon aktivitetin e Bankës së Shqipërisë.

“...politika monetare do të vijojë të mbetet lehtësuese gjatë gjithë horizontit të parashikimit.”

BANKA E SHQIPËRISË MBAN TË PANDRYSHUAR NORMËN BAZË TË INTERESIT NË NIVELIN 0.5% - 1 korrik 2020 -

Ekonomia shqiptare ka qenë nën efektin e fortë të pandemisë gjatë tremujorit të dytë. Hapja progresive e ekonomisë, lehtësimi i masave të distancimit social, si dhe ambienti i qëndrueshëm monetar e financiar i vendit, krijojnë premisa për rikuperimin gradual të aktivitetit ekonomik në tremujorët në vazhdim. Miksi aktual i politikave fiskale, monetare dhe financiare, ofron stimulin e nevojshëm për mbështetjen e rritjes ekonomike dhe për kthimin e inflacionit në objektiv.

Të nderuar përfaqësues të medias,

Sot, në datën 1 korrik 2020, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim dhe miratoi Raportin e Ndërmjetëm të Politikës Monetare.


Analiza e informacionit të disponuar tregon se ekonomia shqiptare ka qenë nën efektin e fortë të pandemisë gjatë tremujorit të dytë. Këto pasojë vijojnë të jenë ende të pranishme. Reduktimi i kërkesës së brendshme e të huaj dhe kufizimi i aktiviteteve prodhuese e shërbyese në vend, kanë sjellë rënie të prodhimit, rritje të papunësisë, dhe vështirësi financiare për bizneset dhe familjet shqiptare. Megjithatë, sektori bankar i vendit mbetet i shëndetshëm dhe tregjet financiare shfaqen relativisht të qeta.

Këshilli Mbikëqyrës vlerëson se hapja progresive e ekonomisë, lehtësimi i masave të distancimit social, si dhe ambienti i qëndrueshëm monetar e financiar i vendit, krijojnë premisa për rikuperimin gradual të aktivitetit ekonomik në tremujorët në vazhdim. Megjithatë, balanca e rreziqeve vijon të mbetet e zhvendosur në kahun e poshtëm.

Në përfundim të diskutimeve, Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi se miksi aktual i politikave fiskale, monetare dhe financiare, ofron stimulin e nevojshëm për mbështetjen e rritjes ekonomike dhe për kthimin e inflacionit në objektiv.

Pandemia COVID-19 ka ushtruar goditje të gjithanshme mbi ekonominë shqiptare. Pasojat e saj kanë filluar të pasqyrohen tashmë dhe në informacionin e disponueshëm statistikor.

Sipas të dhënave të INSTAT-it, ekonomia shqiptare u tkurr me 2.5% në tremujorin e parë të këtij viti, duke pasqyruar rënien e eksportit dhe të investimeve. Po kështu, të dhënat e tregut të punës tregojnë se ekonomia shqiptare humbi rreth 17000 mijë vende pune në këtë periudhë, ndërsa norma e papunësisë u rrit në 11.4%.



Të dhënat indirekte të tremujorit të dytë sugjerojnë se goditja është forcur më tej. Eksportet e mallrave u tkurrën me 33% gjatë dy muajve të parë të këtij tremujori, në përgjigje të rënies së kërkesës së huaj dhe të pengesave në qarkullim. Po ashtu, importet u reduktuan me rreth 30%, duke sinjalizuar ngadalësimin e shpejtë të konsumit dhe të investimeve në vend, ndërsa të ardhurat buxhetore u tkurrën me rreth 30% në dy muajt e parë të tremujorit, duke pasqyruar rënien e përgjithshme të aktivitetit ekonomik.

Përkundrejt kësaj tabloje, inflacioni shënoi një rritje të lehtë në muajt prill dhe maj. Norma mesatare e tij kërcëu në nivelin 2%, kryesisht si pasojë e goditjeve të përkohshme të ofertës në këtë periudhë.

Banka e Shqipërisë vlerëson se ecuria e ardhshme e ekonomisë do të varet nga kohëzgjatja e pasojave të pandemisë dhe reagimi i agjentëve të brendshëm e të huaj ekonomikë ndaj tyre.

Skenari ynë bazë i zhvillimeve të pritura është ndërtuar mbi supozimin e shmangies së një vale të dytë të pandemisë dhe reduktimin gradual deri në zhdukje të plotë të pasojave të saj. Në këtë skenar, ekonomia shqiptare pritet të shënojë një rënie të ndjeshme për vitin 2020 dhe norma relativisht të shpejta dhe të qëndrueshme rritjeje në vijim. Aktiviteti ekonomik në vend pritet të shënojë pikun e ngadalësimit në tremujorin e dytë, të vijojë të mbetet në territor negativ në dy tremujorët në vijim, dhe t'i kthehet rritjes në vitin 2021.

Në përputhje me këtë skenar, inflacioni pritet të qëndrojë pranë niveleve aktuale në gjysmën e dytë të vitit. Më tej, ky tregues pritet të shënojë një rritje graduale gjatë vitit të ardhshëm dhe të kthehet në objektiv në tremujorin e fundit të tij.


Kjo ecuri ekonomike do të mbështetet nga një miks akomodues i politikave ekonomike.

Paketat fiskale të ndërmarra deri tani kanë ndihmuar në zbutjen e pasojave të krizës. Banka e Shqipërisë pret një rishikim të Buxhetit për pjesën e dytë të vitit, rishikim i cili pritet të rezultojë në një deficit më të lartë fiskal. Sikundër e kemi thënë, politika fiskale duhet të ketë një rol primar në adresimin e sfidës me të cilën po përballemi. Rritja e kujdesshme dhe e përkohshme e borxhit publik është një kompromis i pranueshëm për të zbutur efektin e goditjes në ekonomi dhe për të mbështetur stabilitetin monetar dhe financiar të vendit.

Paralelisht me të, Banka e Shqipërisë ka adoptuar politika lehtësuese monetare dhe financiare.

- Ulja e normës bazë të interesit në minimumin e saj historik, si dhe rritja e injektiveve të likuiditetit, kanë mundësuar kontrollin e primeve të rrezikut dhe kanë mbajtur në nivele të ulëta normat e interesit.
- Paralelisht me to, masat rregullatore që kemi ndërmarrë kanë inkurajuar shtyrjen e përkohshme të kësteve të kredisë për klientët në vështirësi, si dhe ristrukturimin e kredive për klientët të cilët shfaqin perspektiva solide biznesi, por vështirësi afatshkurtra dhe afatmesme financiare. Gjithashtu, këto masa kanë synuar rritjen e përdorimit të pagesave elektronike dhe kanë mundësuar furnizimin normal të ekonomisë me para fizike.

Grafik 13. Operacionet e tregut të hapur të BSH-së dhe ecuria e normave të interesit në tregun ndërbankar



Në përgjigje të tyre, tregjet financiare shfaqen relativisht të qeta. Kostoja e financimit të sektorit privat është pranë minimumit të saj historik, kursi i këmbimit është i qëndrueshëm, ndërsa sektori bankar vijon të shfaqë tregues të mirë likuiditeti dhe kapitalizimi. Në veçanti, raporti i kredive me probleme zbriti në nivelin 8.1% në muajin maj, duke shënuar një rënie të mëtejshme krahasuar me tremujorin paraardhës.

Këshilli Mbikëqyrës vlerëson se sektori bankar është duke ushtruar funksionin e tij të amortizuesit të goditjeve në ekonomi. Ky sektor ka vijuar të kreditojë sektorin privat të ekonomisë, e në veçanti atë të bizneseve. Kredia për sektorin privat vijoi të shënojë rritje në muajt prill e maj, rritje e cila ka qenë e pranishme kryesisht në sektorin e bizneseve, duke i mbështetur këta të fundit me likuiditetin e nevojshëm për përballimin e krizës. Po ashtu, sektori bankar ka marrë mbi vete një pjesë të koston financiare të goditjes, duke lehtësuar më tej barrën për sektorin publik dhe privat.

Duke inkurajuar vazhdimin e këtij roli, Këshilli Mbikëqyrës vëren se sektori bankar nuk mund dhe nuk duhet të përballojë i vetëm barrën financiare të goditjes. Në këtë kontekst, një rol primar ka dhe duhet të luajë sektori publik, nëpërmjet rritjes së stimulit fiskal, si dhe sektori privat, nëpërmjet rritjes së kujdesit financiar dhe eficiencës operationale.

Në mbyllje të diskutimeve, duke gjykuar dhe mbi projeksionet e skenarit bazë dhe balancën e rreziqeve rreth tij, Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi se

qëndrimi aktual i politikës monetare është i përshtatshëm. Për këtë arsye, ai vendosi:

- të lerë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 0.5%;
- të lerë të pandryshuara normat e interesit të depozitave dhe kredive njëditore, respektivisht në 0.1% dhe 0.9%.

Politika monetare do të vijojë të mbetet lehtësuese gjatë gjithë horizontit të parashikimit.

Gjithsesi, Këshilli Mbikëqyrës gjykon se balanca e rreziqeve vijon të mbetet në kahun e poshtëm. Në veçanti, rreziqe të kahut të poshtëm burojnë nga:

- rikthimi në formën e një vale të dytë të pandemisë;
- krijimi i problemeve në mekanizmin e transmetimit të politikës monetare, në formën e rritjes së normave të interesit dhe kostove të financimit të sektorit privat, në formën e përkeqësimit të ofertës së kredisë bankare, apo në formën e luhatjeve të forta të treguesve të tjerë të tregut financiar.

Këshilli Mbikëqyrës vëren se mundësia e materializimit të këtyre rreziqeve është zbutur, çka redukton nevojën për rritjen e stimullit monetar dhe përdorimin e instrumenteve jokonvencionale të politikës monetare. Megjithatë, materializimi i këtyre rreziqeve do të kërkonte lehtësimin e mëtejshëm të qëndrimit të politikës monetare dhe, potencialisht, edhe përdorimin e instrumenteve jokonvencionale, gjithnjë në përputhje me kuadrin ligjor, i cili konturon aktivitetin e Bankës së Shqipërisë.

“Politika monetare do të vijojë të mbetet lehtësuese gjatë gjithë horizontit të parashikimit.”

BANKA E SHQIPËRISË MBAN TË PANDRYSHUAR NORMËN BAZË TË INTERESIT NË NIVELIN 0.5% - 5 gusht 2020 -

Aktiviteti ekonomik pritet të shënojë pikun e ngadalësimit në tremujorin e dytë dhe të mbetet në territor negativ në dy tremujorët në vijim.

Aktiviteti ekonomik pritet t'i kthehet rritjes në vitin 2021 dhe inflacioni të kthehet në objektiv brenda vitit 2022.

Skenari bazë është i kushtëzuar nga zhvillimi i një sërë faktorëve, ndër më kryesorët ecuria e pandemisë në Shqipëri dhe në botë.

Të nderuar përfaqësues të medias,

Në datën 5 gusht 2020, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim dhe miratoi Raportin Tremujor të Politikës Monetare.

Informacioni i marrë në analizë sugjeron se aktiviteti ekonomik ka shfaqur një ngadalësim të fortë në gjysmën e parë të vitit, si pasojë e masave të marra për kontrollin e përhapjes së pandemisë. Relaksimi i masave të distancimit social gjatë fundit të tremujorit të dytë, si dhe stabiliteti monetar dhe financiar i vendit, kanë krijuar premisa për një rikuperim gradual të aktivitetit ekonomik në periudhën në vijim.

Në përfundim të diskutimit, Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi se qëndrimi aktual i politikës monetare mbetet i përshtatshëm. Kushtet aktuale monetare ofrojnë stimulim e nevojshëm për nxitjen e rritjes ekonomike dhe për kthimin e inflacionit në objektiv brenda vitit 2022. Megjithatë, përshkallëzimi i mëtejshëm i goditjes apo krijimi i vështirësive në mekanizmin e transmetimit të politikës monetare, do të kërkonin rritjen e stimullit monetar.

Pandemia ka sjellë një goditje të rëndë për ekonominë shqiptare, si në nivel makro ashtu dhe në nivel biznesesh e familjesh individuale.


Sipas të dhënave të INSTAfit, ekonomia shqiptare u kontraktua me 2.5% në tremujorin e parë të vitit. Ky kontraktim pasqyroi tkurrjen e investimeve, reduktimin e eksportit të mallrave dhe shërbimeve, si dhe ngadalësimin e

konsumit privat. Të dhënat indirekte të disponuara sugjerojnë se aktiviteti ekonomik do të pësojë një rënie dukshëm më të fortë në tremujorin e dytë.

Në terma makro, rënia e kërkesës për mallra e shërbime dhe mbyllja e përkohshme apo rritja e kostove për disa kategori aktivitetesh, është pasqyruar në një sërë treguesish ekonomikë.

- Inflacioni shënoi rritje të lehtë në tremujorin e dytë, duke regjistruar një nivel mesatar prej 1.9%. Kjo ecuri u diktua nga rritja e kostove të prodhimit e të transportit, efekte këto të cilat dominuan mbi ndikimin rënës në inflacion që sjell tkurrja e kërkesës agregate.
- Po ashtu, rënia e aktivitetit ekonomik pritet të shoqërohet me ulje të punësimit dhe rritje të papunësisë, me zgjerim të deficitit të llogarisë korrente dhe rritje të borxhit publik gjatë vitit 2020.

Grafik 14. Inflacioni total dhe objektiv



Burimi: INSTAT, baza e të dhënave Trading Economics dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Në terma mikroekonomikë, rënia e kërkesës dhe e shitjeve ka sjellë vështirësi financiare për shumë biznese e familje shqiptare, si pasojë e tkurrjes së të ardhurave dhe e humbjes së vendeve të punës. Këto vështirësi, si dhe pasiguria e perceptuar nga operatorët ekonomikë, tentojnë të zgjasin në kohë efektet e goditjes, nëpërmjet ngadalësimit të konsumit dhe investimeve private.

Këshilli Mbikëqyrës gjykon se efekti i pandemisë në ekonomi do të vijë progresivisht drejt reduktimit gjatë tremujorëve në vijim, ndonëse rikuperimi pritet të jetë i ngadalë dhe balanca e rreziqeve mbetet në

kahun e poshtëm. Në skenarin bazë, aktiviteti ekonomik në vend pritet të shënojë pikun e ngadalësimit në tremujorin e dytë, të vijojë të mbetet në territor negativ gjatë dy tremujorëve në vijim, dhe t'i kthehet rritjes në vitin 2021. Rritja e kërkesës agregate pritet të shoqërohet me rritje të punësimit dhe rritje të pagave e të kostove të prodhimit, duke krijuar premisa për kthimin e inflacionit në objektiv brenda vitit 2022.


Ky skenar është i kushtëzuar nga ecuria e mëtejshme e pandemisë, nga shpejtësia e përmirësimit të aktivitetit ekonomik në partnerët tanë tregtarë, nga ndikimi i pandemisë në sjelljen e ardhshme të biznesit dhe konsumatorit, si dhe nga efektiviteti në kohë i masave fiskale, monetare dhe financiare, të ndërmarra deri tani.

Këshilli Mbikëqyrës gjykon se stimuli i koordinuar fiskal, monetar dhe financiar, ka qenë një element vendimtar në zbutjen e pasojave negative të krizës.

Politika fiskale ka adoptuar një kah stimuluës, duke mundësuar:

- rritjen e shpenzimeve korrente, në interes të alokimit të fondeve për përballimin e pandemisë dhe për mbrojtjen e shtresave sociale në nevojë;
- krijimin e skemave të garancisë sovraane, në interes të rritjes së aksesit të biznesit në kredi; si dhe,
- rritjen e investimeve publike, në interes të rikuperimit të pasojave të tërmetit dhe të rritjes së kërkesës agregate.

Grafik 15. Orientimi i politikës fiskale*



*Orientimi i politikës fiskale është përafshuar me ndryshimin e raportit të deficitit primar kumulativ për një periudhë 12-mujore ndaj PBB-së, krahasuar me një vit më parë. Ndryshimet negative, pra vlerat e këtij treguesi nën zero tregojnë që pozicioni fiskal është përmirësuar, çka në mënyrë indirekte tregon për vlera negative të impulsit fiskal në ekonomi.

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, INSTAT dhe Illogaritje të stafit të Bankës së Shqipërisë.

Paralelisht me të, Banka e Shqipërisë ka rritur stimulin monetar, nëpërmjet uljes së normës bazë të interesit dhe rritjes së injektimeve të likuiditetit, duke synuar uljen e kostove të financimit dhe rritjen e masës monetare në ekonomi. Po ashtu, në bashkëpunim me industrinë bankare, Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë ndryshime të kuadrit rregullator, të cilat kanë lehtësuar shtyrjen e përkohshme të pagesës së kësteve dhe ristrukturimin e kredive bankare për klientët në vështirësi.

Në përgjigje të tyre, tregjet financiare shfaqen relativisht të qeta. Kostot e financimit të sektorit privat mbeten të ulëta, kursi i këmbimit është i qëndrueshëm, ndërsa sektori bankar vijon të shfaqë tregues të mirë likuiditeti dhe kapitalizimi.

Këshilli Mbikëqyrës vlerëson se sektori bankar ka dhënë një kontribut të qenësishëm në drejtim të amortizimit të goditjeve. Kredia për sektorin privat vijoi të shënojë rritje në tremujorin e dytë, duke kulmuar në nivelin 7% në muajin qershor dhe duke i mbështetur bizneset dhe familjet shqiptare me likuiditetin e nevojshëm për përballimin e krizës. Gjithashtu, ky sektor ka marrë mbi vete një pjesë të koston financiare të goditjes, duke lehtësuar më tej barrën për sektorin privat.

Këshilli Mbikëqyrës vëren se vijimi i kësaj përqaasjeje pozitive të sektorit bankar ndaj kredisë, e cila është favorizuar dhe nga instrumentet e garancisë sovrane, do të jetë një parakusht i nevojshëm për rikuperimin e ekonomisë në të ardhmen.

Në mbyllje të diskutimeve, duke gjykuar dhe mbi projeksionet e skenarit bazë dhe balancën e rreziqeve rreth tij, Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi se qëndrimi aktual i politikës monetare është i përshtatshëm.

Për këtë arsye, ai vendosi:

- të lerë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 0.5%;
- të lerë të pandryshuara normat e interesit të depozitave dhe kredive njëditore, respektivisht në 0.1% dhe 0.9%.

Politika monetare do të vijojë të mbetet lehtësuese gjatë gjithë horizontit të parashikimit.

Gjithsesi, Këshilli Mbikëqyrës gjykon se balanca e rreziqeve vijon të mbetet në kahun e poshtëm. Në veçanti, rreziqe të kahut të poshtëm burojnë nga:

- zgjatja e theksuar në kohë e pandemisë dhe rivendosja e masave të distancimit social për kontrollin e saj;
- lindja e problemeve në mekanizmin e transmetimit të politikës monetare, në formën e rritjes së normave të interesit dhe kostove të financimit të sektorit privat, në formën e përkeqësimit të ofertës së kredisë bankare, apo në formën e luhatjeve të forta të treguesve të tjerë të tregut financiar.

Këshilli Mbikëqyrës vëren se materializimi i këtyre rreziqeve do të kërkonte lehtësimin e mëtejshëm të qëndrimit të politikës monetare.

“Politika monetare do të vijojë të mbetet lehtësuese gjatë gjithë horizontit të parashikimit.”

BANKA E SHQIPËRISË MBAN TË PANDRYSHUAR NORMËN BAZË TË INTERESIT NË NIVELIN 0.5%

- 7 tetor 2020 -

Ndikimi i pandemisë në ekonomi ka qenë i plotë dhe serioz në tremujorin e dytë, por ka ardhur drejt reduktimit në muajt në vazhdim.

Qëndrimi aktual i politikës monetare mbetet i përshtatshëm.

Garantimi i rritjes ekonomike kërkon ruajtjen e një kahu stimulues të politikave makroekonomike.

Të nderuar përfaqësues të medias,

Në datën 7 tetor 2020, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim dhe miratoi Raportin e Ndërmjetëm të Politikës Monetare.


Në përputhje me pritjet tona, informacioni i disponuar sugjeron se ndikimi i pandemisë në ekonomi ka qenë i plotë dhe serioz në tremujorin e dytë, por ka ardhur drejt reduktimit në muajt në vazhdim. Stimuli i njëkohshëm fiskal, monetar dhe financiar, ka rezultuar efektiv në shmangien e pasojave më negative të goditjes. Lehtësimi i masave të distancimit social, stabiliteti i tregjeve financiare, si dhe shëndeti i bilanciit të sektorit bankar, përbëjnë premisa për një rikuperim gradual të aktivitetit ekonomik në të ardhmen.

Në përfundim të diskutimit, Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi se qëndrimi aktual i politikës monetare mbetet i përshtatshëm. Kushtet aktuale monetare ofrojnë stimulim e nevojshëm për nxitjen e rritjes ekonomike dhe për kthimin e inflacionit në objektiv brenda vitit 2022. Megjithatë, përshkallëzimi i mëtejshëm i goditjes apo krijimi i vështirësive në mekanizmin e transmetimit të politikës monetare, do të kërkonin rritjen e stimulit monetar.

Pandemia COVID-19 është sfida më serioze me të cilën është përballur ekonomia botërore gjatë dekadave të fundit. Aktiviteti ekonomik në shumicën e ekonomive ka shfaqur norma dyshifrore rënieje, papunësia është rritur, ndërsa gjendja financiare e sektorit privat është përkeqësuar. Masat e paprecedenta fiskale dhe monetare kanë lehtësuar impaktin e pandemisë, por nga perspektiva e rikuperimit mbetet ende e rrethuar nga pasiguri.

Inflacioni në vend shënoi një vlerë mesatare prej 1.3% gjatë muajve korrik e gusht, duke shënuar rënie krahasuar me tremujorin e dytë. Kjo rënie ka pasqyruar normat më të ulëta të inflacionit të artikujve ushqimorë dhe të disa kategorive të shërbimeve. Në terma makro, ngadalësimi i inflacionit pasqyroi shuarjen graduale të goditjeve të ofertës dhe shfaqti më të plotë efektin e rënies së kërkesës agregate, në vend dhe në botë.

Grafik 16. Produkti i brendshëm bruto nga ana e prodhimit dhe tregesis e besimit



Të dhënat janë gjysmë-përfundimtare. **Një vlerësim i parë.
 Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë. *

Sipas të dhënave të INSTAT-it, aktiviteti ekonomik në vend shënoi një rënie vjetore prej 10.2% në tremujorin e dytë. Kjo rënie pasqyroi kontributin negativ të pothuajse të gjithë sektorëve të ekonomisë dhe komponentëve të kërkesës agregate. Paralelisht me të, punësimi shënoi një rënie vjetore prej 3.6%, ndërkohë që norma e papunësisë u rrit në 11.9%. Të dhënat e tremujorit të tretë mbeten ende paraprake. Megjithatë, ecuria më e mirë e të ardhurave tatimore dhe eksporteve, si dhe përmirësimi i besimit të biznesit dhe konsumatorit, sugjerojnë se rënia ekonomike ka vijuar, por me ritme më të ngadalta se në tremujorin e dytë.

Këshilli Mbikëqyrës gjykon se efekti i pandemisë në ekonomi do të vijë drejt reduktimit gjatë tremujorëve në vijim. Në skenarin bazë, aktiviteti ekonomik në vend pritet të vijë në përmirësim, por të mbetet ende në territor negativ, gjatë gjysmës së dytë të vitit aktual dhe t'i kthehet rritjes në vitin e ardhshëm. Rritja e kërkesës agregate pritet të shoqërohet me rritje të punësimit dhe rritje të pagave e të kostove të prodhimit, duke ndihmuar në kthimin e inflacionit në objektiv brenda vitit 2022.


Jetësimi i skenarit bazë është i kushtëzuar nga ecuria e mëtejshme e pandemisë, nga ndikimi i saj në sjelljen e ardhshme të biznesit dhe konsumatorit, nga shpejtësia e përmirësimit të aktivitetit ekonomik në partnerët tanë tregtarë, si dhe nga reagimi i duhur në kohë i autoriteteve publike dhe sektorit privat.

Politikat e deritanishme lehtësuese fiskale, monetare dhe financiare, kanë pasur një rol të rëndësishëm në përballimin e goditjes. Më konkretisht:

- stimuli fiskal ka zbutur ndikimin e goditjes në financat e biznesit dhe të familjeve;
- stimuli monetar ka ulur kostot e financimit në ekonomi, ka garantuar furnizimin e sektorit bankar me likuiditetin e kërkuar, si dhe ka krijuar premisat e nevojshme për rritjen e kreditimit; ndërsa,
- lehtësimi i përkohshëm i kuadrit rregullator të sektorit bankar, ka ndihmuar shtyrjen në kohë të pagesave të kësteve të kredisë dhe ka inkurajuar ristikurimin e kredive, në përputhje me vullnetin dhe interesin e përbashkët të bankave dhe kredimarrësve.

Në pasqyrim të këtyre masave, tregjet financiare shqiptare kanë operuar të qeta. Normat e interesit vijojnë të mbeten pranë minimumeve historike, ndërsa kursi i këmbimit shfaqet i qëndrueshëm. Në veçanti, sektori bankar ka vijuar të furnizojë me likuiditet bizneset dhe familjet në nevojë. Kredia për sektorin privat njohu një rritje mesatare vjetore prej 6.4% në muajt korrik – gusht, duke pasqyruar një transmetim të mirë të stimullit të politikave ekonomike, shëndetin e bilanceve dhe gatishmërinë e sektorit bankar për të kontribuar në përballimin e goditjes.

Grafik 17. Ecuria e kredisë për sektorin privat



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Duke parë nga e ardhmja, Këshilli Mbikëqyrës vëren se garantimi i rritjes ekonomike kërkon ruajtjen e një kahu stimules të politikave makroekonomike. Po ashtu, Këshilli Mbikëqyrës vëren se stabiliteti monetar dhe financiar në vend përbën një premisë pozitive për rikuperimin e ekonomisë dhe një parakusht esencial për qëndrueshmërinë në kohë të saj.

Në këtë kontekst, ndërsa reduktimi i pritur i stimulit fiskal në të ardhmen dhe normalizimi makroprudencial do të ndihmojnë ruajtjen e ekuilibrave financiarë të vendit, politika monetare duhet të vijojë të ruajë qëndrimin e saj akomodues.

Në mbyllje të diskutimeve, duke gjykuar dhe mbi projeksionet e skenarit bazë dhe balancën e rreziqeve rreth tyre, Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi se qëndrimi aktual i politikës monetare mbetet i përshtatshëm. Për këtë arsye, ai vendosi:

- të lerë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 0.5%;
- të lerë të pandryshuara normat e interesit të depozitave dhe kredive njëditore, respektivisht në 0.1% dhe 0.9%.

Politika monetare do të vijojë të mbetet lehtësuese gjatë gjithë horizontit të parashikimit. Banka e Shqipërisë do të vijojë të ruajë formën aktuale të operacioneve të injektimit të likuiditetit, formë e cila garanton injektimin e pakufizuar në sasi të tij, deri në fund të tremujorit të parë të vitit të ardhshëm.

Gjithsesi, Këshilli Mbikëqyrës gjykon se balanca e rreziqeve vijon të mbetet në kahun e poshtëm. Në veçanti, rreziqe të kahut të poshtëm burojnë nga:

- zgjatja e theksuar në kohë e pandemisë dhe rivendosja e mundshme e masave të distancimit social për kontrollin e saj;
- lindja e problemeve në mekanizmin e transmetimit të politikës monetare, në formën e rritjes së normave të interesit dhe kostove të financimit të sektorit privat, në formën e përkeqësimit të ofertës së kredisë bankare, apo në formën e luhatjeve të paparashikuara të treguesve të tjerë të tregut financiar.

Këshilli Mbikëqyrës vëren se materializimi i këtyre rreziqeve do të kërkonte lehtësimin e mëtejshëm të qëndrimit të politikës monetare.

“Politika monetare do të vijojë të mbetet lehtësuese gjatë gjithë horizontit të parashikimit.”

BANKA E SHQIPËRISË MBAN TË PANDRYSHUAR NORMËN BAZË TË INTERESIT NË NIVELIN 0.5%

- 16 dhjetor 2020 -

Stabiliteti monetar dhe financiar i vendit kanë rezultuar të paprekur, ndërsa bizneset dhe familjet kanë vijuar të gjejnë mbështetje me kredi nga sektori bankar.

Qëndrimi aktual stimulues i politikës monetare mbetet i përshtatshëm, për të mbështetur si rritjen e ekonomisë, ashtu edhe kthimin e inflacionit në objektiv.

Masat lehtësuese të marra nga Banka e Shqipërisë kanë krijuar tregje financiare të qeta dhe kushte monetare stimuluese për nxitjen e aktivitetit ekonomik.

Të nderuar përfaqësues të medias,

mirë se keni ardhur në konferencën tonë të fundit të shtypit për këtë vit!

Viti 2020 ka qenë një vit i vështirë, si në aspektin shëndetësor dhe në atë ekonomik e social. Pandemia COVID-19 ka shkaktuar tkurrje të fortë të aktivitetit ekonomik, rritje të papunësisë, vështirësi financiare për sektorin publik dhe privat, si dhe presione të dobëta inflacioniste. Në këto rrethana, objektivi kryesor i politikave ekonomike ka qenë lehtësimi i barrës financiare për bizneset dhe familjet shqiptare, ruajtja e stabilitetit monetar dhe financiar në vend, si dhe krijimi i premisave për rimëkëmbjen e ekonomisë.

Banka e Shqipërisë ndërmori një paketë të plotë masash për adresimin e situatës.

- Ne lehtësuam politikën tonë monetare dhe rritëm injektimet e likuiditetit, duke synuar funksionimin normal të tregut financiar, lehtësimin e kostos së borxhit, rritjen e kreditimit dhe nxitjen e konsumit dhe investimeve.
- Po ashtu, ne lehtësuam në mënyrë të përkohshme rregulloret e funksionimit të sektorit bankar, duke nxitur shtyrjen në kohë të pagesës së kësteve të kredisë dhe ristrukturimin e saj. Nga kjo lëvizje u vendos në moratorium mbi 40% e portofolit të kredisë bankare, duke lehtësuar barrën financiare mbi bizneset dhe familjet në vështirësi të përkohshme. Gjithashtu, nga ristrukturimi

i kredisë kanë përfituar mbi 25 mijë klientë bankarë, duke rritur qëndrueshmërinë e plan-bizneseve të tyre afatgjata.

- Paralelisht me to, ne pezulluam shpërndarjen e dividendit të sektorit bankar gjatë vitit 2020, në interes të rritjes së kapitalit dhe qëndrueshmërisë së këtij sektori.
- Së fundi, ne eliminuam kostot e përdorimit të infrastrukturës së sistemeve elektronike të pagesave, duke synuar zgjerimin e përdorimit të këtyre instrumenteve.

Këshilli Mbikëqyrës vlerëson se këto masa kanë rezultuar të suksesshme. Stabiliteti monetar dhe financiar i vendit kanë rezultuar të paprekur, ndërsa bizneset dhe familjet kanë vijuar të gjejnë mbështetje me kredi nga sektori bankar, duke shmangur falimentimet në masë dhe duke zbutur rritjen e papunësisë. Më lejoni tani të paraqes mesazhet kryesore të Raportit të Ndërmjetëm të Politikës Monetare dhe vendimin e marrë nga Këshilli Mbikëqyrës në mbledhjen e sotme.

Informacioni i ri i marrë në analizë ka qenë pranë pritjeve tona. Lajmet e fundit mbi progresin e vaksinave japin shpresë për përfundimin e pandemisë dhe rikthimin e situatës në normalitet gjatë vitit 2021. Këto zhvillime rritin gjasat e rikuperimit gradual por të vazhdueshëm të aktivitetit ekonomik në horizontin afatmesëm, por situata epidemiologjike vijon të paraqesë sfida serioze për ecurinë e ekonomisë në afatin e shkurtër.

Në këto rrethana, Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi se qëndrimi aktual stimulues i politikës monetare mbetet i përshtatshëm, për të mbështetur si rritjen e ekonomisë, ashtu edhe kthimin e inflacionit në objektiv. Në vijim do të paraqes më në detaje konkluzionet e analizës, vendimin e politikës monetare dhe arsyet e tij.

Inflacioni i çmimeve të konsumit shënoi një vlerë mesatare prej 1.8% në muajt tetor e nëntor, duke ardhur në rritje kundrejt nivelit mesatar prej 1.4% të shënuar në tremujorin e tretë. Ecuria e inflacionit gjatë muajve të fundit është ndikuar më së shumti nga faktorë të ofertës, të cilët kanë diktuar dhe luhatjen e çmimeve të ushqimeve. Nga ana tjetër, presionet inflacioniste, të cilat burojnë nga kërkesa agregate dhe nga ambienti i huaj, vijojnë të mbeten të ulëta.

Ekonomia shqiptare ka shënuar një kthesë drejt rikuperimit në tremujorin e tretë. Megjithatë, aktiviteti ekonomik në vend vijon të mbetet poshtë nivelit potencial, ndërsa rikuperimi i tij pritet të jetë një proces gradual dhe i rrethuar me rreziqe.

Grafik 18. Inflacioni total dhe objektiv (majtas). Inflacioni në vendet e rajonit dhe në BE (djathtas)



Burimi: INSTAT, baza e të dhënave Trading Economics dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.


Treguesit e disponuar erdhën në përmirësim gjatë muajve të verës, duke pasqyruar frenimin e përhapjes së epidemisë, relaksim të distancimit social, si dhe efektin pozitiv të masave lehtësuese fiskale, monetare dhe financiare. Në përgjigje të tyre, ecuria e të ardhurave buxhetore dhe ajo e tregtisë me jashtë u përmirësua. Po ashtu, përmirësim shënoi dhe tregu i punës, sikurse ilustron nga rritja tremujore e punësimit dhe reduktimi në 11.6% i shkallës së papunësisë.

Të dhënat për tremujorin e katërt janë ende paraprake. Megjithatë, përkeqësimi i situatës epidemiologjike dhe rivendosja e pjeshme e kufizimeve gjatë tremujorit të katërt sugjerojnë një rikuperim më të ngadaltë të aktivitetit ekonomik në këtë periudhë. Ky vlerësim mbështetet nga rënia e besimit të bizneseve dhe ilustron brishtësinë e zhvillimeve ekonomike në afatin e shkurtër.

Masat lehtësuese të marra nga Banka e Shqipërisë kanë krijuar tregje financiare të qeta dhe kushte monetare stimuluese për nxitjen e aktivitetit ekonomik. Në veçanti, normat e interesit për familjet dhe bizneset kanë qëndruar në nivele të ulëta, kursi i këmbimit ka rezultuar i qëndrueshëm, ndërsa sektori bankar ka vijuar të kreditojë ekonominë. Kredia për sektorin privat shënoi një rritje mesatare vjetore prej 6.7% gjatë vitit 2020, e mbështetur kryesisht nga zgjerimi i kredisë për biznese dhe rritja e kredisë në lekë. Paralelisht me rritjen e portofolit të kredisë, ecuri pozitive ka pasur dhe struktura e këtij portofoli. Rritja në 50.2% e peshës së kredisë në lekë ndaj totalit, jep sinjale inkurajuese për rritjen e

efektivitetit të politikës monetare dhe rritjen e qëndrueshmërisë financiare të vendit.

Grafik 19. Kursi i këmbimit në tregun vendas



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Sektori bankar ka dhënë një kontribut pozitiv në përballimin e krizës. Rritja e kreditimit ka ndihmuar me likuiditet bizneset dhe familjet në vështirësi të përkohshme, si dhe ka mbështetur vijimin e investimeve. Po ashtu, shtyrja e pagimit të kësteve të kredisë për kategori të caktuara huamarrësish dhe ristrukturimi i kredive për kategori të tjera, ka zhvendosur një pjesë të barrës financiare të krizës në bilanci të këtij sektori.

Në skenarin bazë, Banka e Shqipërisë pret një rritje graduale të inflacionit drejt objektivit në horizontin afatmesëm. Ky parashikim faktorizon prritje për rritje progresive të aktivitetit ekonomik, në vend dhe botë. Rritja e kërkesës agregate do të shoqërohet me rritjen e punësimit, të pagave e të kostove të prodhimit. Paralelisht me rritjen e presioneve inflacioniste nga jashtë, inflacioni parashikohet të vijë në rritje dhe të kthehet në objektiv brenda vitit 2022.

Përbushja e këtij skenari zhvillimesh mbetet e kushtëzuar nga përfundimi i shpejtë i pandemisë, nga shpejtësia e rikuperimit të konsumit dhe investimeve, në vend dhe në botë, si dhe nga ruajtja e një ambienti të qetë e të përshtatshëm financiar. Gjithashtu, përbushja e këtij skenari kërkon mbështetje nga politika makroekonomike stimuluese.

Banka e Shqipërisë vëren se kombinimi aktual i politikave ekonomike mbetet i përshtatshëm. Ruajtja e kahut stimulues të politikës monetare

është i domosdoshëm për të nxitur kreditimin me kosto të ulët të ekonomisë. Në të njëjtën kohë, reduktimi gradual i stimulit fiskal – i parashikuar në Buxhetin e vitit 2021 dhe projektbuxhetet afatmesme – balancon nevojën e nxitjes së kërkesës agregate me atë të forcimit të qëndrueshmërisë së borxhit publik në afatin e mesëm dhe të gjatë.

Duke gjykuar mbi këto parashikime dhe konsiderata, Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi se qëndrimi aktual i politikës monetare është i përshtatshëm. Për këtë arsye, ai vendosi:

- të lerë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 0.5%;
- të lerë të pandryshuara normat e interesit të depozitave dhe kredive njëditore, respektivisht në nivelin 0.1% dhe 0.9%.

Politika monetare do të vijojë të mbetet lehtësuese gjatë gjithë horizontit të parashikimit për të siguruar kushte financimi të favorshme për rritjen e ekonomisë dhe për kthimin e inflacionit në objektiv.

Po ashtu, Banka e Shqipërisë do të vijojë të ruajë formën aktuale të operacioneve të injektimit të likuiditetit, formë e cila garanton injektimin e pakufizuar në sasi të tij, të paktën deri në fund të tremujorit të parë të vitit të ardhshëm.

Së fundi, Këshilli Mbikëqyrës vëren se zhvillimet e pritura makroekonomike janë të rrethuara nga pasiguri dhe të ekspozuara ndaj rreziqeve të kahut të poshtëm. Në veçanti, rreziqe të kahut të poshtëm burojnë nga:

- përkeqësimi i situatës epidemiologjike dhe thellimi i ndikimit të saj në ekonomi;
- shkalla e dëmtimit të kapaciteteve prodhuese dhe mundësia e një rikuperimi më të ngadaltë të kërkesës së brendshme dhe asaj të huaj;
- lindja e vështirësive në mekanizmin e transmetimit të politikës monetare, në formën e rritjes së normave të interesit dhe kostove të financimit të sektorit privat, në formën e rritjes së ngadaltë të kredisë bankare, apo në formën e luhatjeve të forta të treguesve të tjerë të tregut financiar.

Këshilli Mbikëqyrës vëren se materializimi i këtyre rreziqeve do të kërkonte lehtësimin e mëtejshëm të qëndrimit të politikës monetare.

“Politika monetare do të vijojë të mbetet lehtësuese gjatë gjithë horizontit të parashikimit për të siguruar kushte financimi të favorshme për rritjen e ekonomisë dhe për kthimin e inflacionit në objektiv.”



KAPITULLI III

KONFERENCA PËR SHTYP ME SHEFIN E MISIONIT TË FMN-SË DHE MINISTRIN E FINANCAVE DHE EKONOMISË

- *Fjala e Guvernatorit Sejko në konferencën e përbashkët për shtyp online me Shefen e Misionit të FMN-së dhe Ministren e Financave dhe Ekonomisë, 28 shtator 2020*

Konferencat për shtyp me Shefin e Misionit të FMN-së dhe Ministrin e Financave

Në kuadër të konsultimeve për Artikullin IV të neneve të marrëveshjes me FMN-në, misionet e Fondit vizitojnë Shqipërinë dhe kryejnë takime me përfaqësuesit e institucioneve kryesore të vendit për të diskutuar mbi ecurinë makroekonomike dhe zhvillimet më të fundit të Shqipërisë. Në përfundim të çdo vizite të misionit, organizohet një konferencë e përbashkët për shtyp e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, Shefit të Misionit të FMN-së dhe Ministrin të Financave.

MBI PËRFUNDIMIN E VIZITËS SË MISIONIT TË FMN-SË NË KUADËR TË MISIONIT TË PARË MONITORUES POST- PROGRAM PËR SHQIPËRINË - 28 shtator 2020 -

Gjatë dy javëve të fundit, nëpërmjet rrugëve të komunikimit elektronik, përfaqësues të Bankës së Shqipërisë kanë zhvilluar bisedime të shumta e të larmishme me Misionin e FMN-së, në kuadrin e Monitorimit Post-Programor që FMN i bën vendit tonë.

Këto bisedime kanë qenë të frytshme. Me Misionin e FMN-së kemi ndarë pikëpamje të ngjashme mbi stadin e zhvillimit të vendit, sfidat që kemi përpara dhe politikat e masat e nevojshme për adresimin e tyre. Në vijim, dëshiroj të ndaj me ju opinionin e Bankës së Shqipërisë mbi këto tre tema.

Kryefjala e diskutimeve në fushën e ekonomisë dhe financave ka qenë dhe mbetet ndikimi që pandemia COVID-19 ka pasur në Shqipëri.

Rënia e kërkesës, vështirësitë në qarkullimin e brendshëm e të jashtëm të mallrave dhe njerëzve, si dhe rritja e pasigurisë, janë shoqëruar me rënie të aktivitetit ekonomik dhe kanë sjellë vështirësi financiare për bizneset dhe familjet shqiptare.

Në planin makroekonomik, rënia e aktivitetit ekonomik është pasqyruar në presione të dobëta inflacioniste, në rritje të papunësisë dhe në zgjerim të borxhit të huaj e publik të vendit.

Në planin mikroekonomik, rënia e aktivitetit ka sjellë vështirësi financiare për bizneset dhe familjet shqiptare.

Përballimi i goditjes ka kërkuar një reagim të gjithanshëm të autoriteteve publike, në drejtim të rritjes së stimullit fiskal, monetar e financiar. Si një aktor kryesor në fushën e politikave ekonomike, Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë veprimet e mëposhtme:

- në fushën e politikës monetare, ne kemi ulur normën bazë të interesit dhe i kemi ofruar sektorit bankar sasi të pakufizuara likuiditeti, në interes të funksionimit normal të tregjeve të parasë dhe të uljes së koston së financimit për të gjithë agjentët ekonomikë;
- në fushën e mbikëqyrjes dhe rregullimit të sektorit bankar, ne:
 - kemi prezantuar stimuj rregullatorë, për të nxitur shtyrjen e pagesës së kësteve të kredisë për klientët në vështirësi të përkohshme dhe ristrukturimin e kredive për klientët në vështirësi më afatgjata,
 - kemi pezulluar shpërndarjen e dividendit për industrinë bankare gjatë vitit 2020, në interes të përmirësimit të qëndrueshmërisë së bilancit të sektorit bankar;
- në fushën e sistemeve të pagesave, Banka e Shqipërisë ka marrë masa për uljen e koston së pagesave elektronike;
- së fundi, Banka e Shqipërisë ka rritur kapacitetet e saj operacionale për garantimin e furnizimit të ekonomisë me para fizike (cash).

“Stimuli monetar dhe ai fiskal kanë pasur një objektiv të dyfishtë:

- ***të lehtësojnë koston financiare të goditjes për bizneset dhe familjet shqiptare, duke shmangur falimentimet masive dhe rritjen e fortë të papunësisë; dhe,***
- ***të ruajnë ekuilibrat monetarë dhe financiarë të vendit.”***

Së bashku me stimulin fiskal, këto masa kanë pasur një objektiv të dyfishtë:

- së pari, të lehtësojnë koston financiare të goditjes për bizneset dhe familjet shqiptare, duke shmangur falimentimet masive dhe rritjen e fortë të papunësisë; dhe,
- së dyti, të ruajnë ekuilibrat monetarë dhe financiarë të vendit.

Të dy këta objektiva mbeten parakushte të nevojshme për rritjen e qëndrueshme dhe afatgjatë ekonomike.

Në gjykimin tonë, masat e marra kanë rezultuar efektive. Duke gjykuar nga ecuria e depozitave në sistemin bankar, bilancet e biznesit dhe të familjeve kanë mbetur likuide. Po ashtu, tregjet e brendshme financiare shfaqen të qeta, të karakterizuara nga norma të ulëta interesi dhe kurs i qëndrueshëm këmbimi. Sektori bankar ka vijuar të kreditojë bizneset dhe familjet shqiptare. Ndonëse ky sektor ka përballuar një pjesë jo të vogël të koston së goditjes, ai vazhdon të ruajë tregues të shëndetshëm likuiditeti e kapitalizimi, si dhe të jetë i aftë të përmbushë funksionin e tij të ndërmjetësit financiar. Së fundi, sektori publik dhe ekonomia shqiptare kanë ruajtur besimin dhe aksesin në tregjet e brendshme dhe të jashtme financiare.

Këto janë premisa inkurajuese për rikuperimin e aktivitetit ekonomik në të ardhmen.

Në skenarin bazë, ekonomia shqiptare pritet të shënojë një rënie të fortë gjatë vitit 2020. Në pasqyrim të intensitetit të masave të distancimit social, rënia ekonomike pritet të kulmojë në tremujorin e dytë dhe të vijojë gradualisht drejt zbehjes gjatë dy tremujorëve në vijim. Më tej, në supozimin e një ecurie të favorshme epidemiologjike, ekonomia shqiptare pritet të shënojë rritje dhe të rikuperojë vëllimin e humbur të aktivitetit ekonomik gjatë dy viteve në vijim. Kjo ecuri do të mundësojë dhe rikthimin gradual të inflacionit në objektiv.

Përmbushja e këtij skenari nënkupton vijimin e politikës së akomodimit monetar edhe gjatë vitit në vazhdim, tërheqjen graduale të stimullit fiskal dhe rikthimin e fokusit rregullator në garantimin e shëndetit afatgjatë të sektorit bankar.

Nga ana tjetër, Banka e Shqipërisë vijon të theksojë se balanca e rreziqeve qëndron në kahun e poshtëm. Këto rreziqe burojnë nga një përkeqësim i mundshëm i situatës epidemiologjike, nga dobësimi i mëtejshëm i situatës ekonomike në partnerët tanë tregtarë, apo dhe nga rritja e pasigurisë në ambientin e brendshëm dhe të huaj.

Banka e Shqipërisë gjykon se materializimi i këtyre skenarëve do të kërkojë rritjen e stimullit makroekonomik. Formatimi i stimullit monetar duhet të synojë përdorimin e instrumenteve sa më efektive, të orientuara nga një analizë e plotë e kostove dhe përfitimeve të mundshme, në përputhje me zhvillimet e tregut financiar dhe kuadrin ligjor në fuqi.

Banka e Shqipërisë mbetet e angazhuar të vazhdojë dialogun me tregun financiar, si dhe të gjithë partnerët vendas dhe të huaj, në interes të përmbushjes së misionit dhe objektivave të saj.

“Banka e Shqipërisë mbetet e angazhuar të vazhdojë dialogun me tregun financiar, si dhe të gjithë partnerët vendas dhe të huaj, në interes të përmbushjes së misionit dhe objektivave të saj.”



BANKA E SHQIPËRIË
Shërbime Bankare dhe Financiare

Takim diskutimi me sistemin bankar dhe biznesin:
"Marrëdhëniet Biznes-Bankë: Sfidat e përbashkëta ekonomike në kushtet e pandemisë globale COVID-19"



KAPITULLI IV

FJALIME DHE PREZANTIME NË KONFERENCA

- *Fjala e Guvernatorit Sejko në takimin e organizuar nga Shoqata Shqiptare e Bankave, 12 shkurt 2020*
- *Fjala e Guvernatorit Sejko në takimin me sistemin bankar dhe biznesin me temë: “Marrëdhëniet Biznes-Bankë: Sfidat e përbashkëta ekonomike në kushtet e pandemisë globale COVID-19”, 13 maj 2020*
- *Fjala e Guvernatorit Sejko në takimin e 43-të të Klubit të Guvernatorëve të vendeve të Azisë Qendrore, Rajonit të Detit të Zi dhe Ballkanit, 2 qershor 2020*
- *Fjala e Guvernatorit Sejko në takimin e Ministrave të Financave dhe Guvernatorëve të Bankave Qendrore të vendeve të EQJL-së, me Drejtoreshen e Përgjithshme të FMN-së, zj. Kristalina Georgieva, 23 tetor 2020*
- *Fjala e Guvernatorit Sejko në Workshop-in XIV të Kërkimeve Ekonomike për Evropën Juglindore të organizuar nga Banka e Shqipërisë, 10 dhjetor 2020*

Konferenca dhe seminare

Banka e Shqipërisë organizon një sërë aktivitetesh publike, konferenca, seminare apo tryeza diskutimi për të trajtuar çështje të rëndësishme të bankingut qendror dhe të ekonomisë me rëndësi të veçantë për Bankën e Shqipërisë. Përveç këtyre, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë merr pjesë dhe në shumë aktivitete të tjera të organizuara nga institucionet kryesore në vend, institucionet ndërkombëtare financiare dhe bankat qendrore. Gjatë këtyre pjesëmarrjeve, Guvernatori prezanton vlerësime dhe analiza të detajuara të Bankës së Shqipërisë, si dhe opinionin e tij për zhvillimet ekonomiko-financiare dhe rolin e Bankës së Shqipërisë në këto zhvillime, eksperiencën e saj me politikën monetare dhe ruajtjen e stabilitetit financiar të vendit, si dhe sfidat e Bankës së Shqipërisë në çështje të ndryshme.

FJALA E GVERNATORIT SEJKO NË TAKIMIN E ORGANIZUAR NGA SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE - 12 shkurt 2020 -

Të nderuar,

Takimet dhe tryezat me përfaqësues të industrisë bankare janë jo vetëm kënaqësi, por dhe një mundësi e shkëlqyer për të diskutuar dhe harmonizuar përpjekjet tona në funksion të thellimit dhe zgjerimit të qëndrueshëm të tregut financiar, si një nga shtyllat bazë të ekonomisë dhe motor i zhvillimit e i rritjes së mirëqenies së publikut.

Do të dëshiroja që me pak fjalë të përcjell disa nga momentet kyç të vitit 2019, ku sistemi bankar e ai financiar në tërësi kanë dhënë kontributin e tyre, përfshirë dhe disa orientime kryesore për vitin 2020.

Më lejoni të ndalem fillimisht në situatën e përgjithshme ekonomike të vendit. Ngjarja me ndikimin më të lartë që shënjoji vitin 2019, në të gjithë sektorët ekonomikë dhe shoqërorë, ishte padyshim tërmeti shkatërrues i datës 26 nëntor. Një goditje e papritur që solli dëme ekonomike e psikologjike në zonat e goditura, por edhe më gjerë. Nga ana tjetër, ky ishte një test i fortë dhe i kaluar me sukses nga të gjitha bankat, përse i përket ruajtjes së vazhdimësisë së funksioneve kritike të tregut financiar.

Në një fatqësi të tillë, ishte shumë e rëndësishme që njerëzit të perceptonin sigurinë, të paktën nga ana financiare, për fondet e depozituara pranë bankave dhe të kishin akses të vazhdueshëm për të përmbushur nevojat bazë.

Më tej, të gjitha bankat jo vetëm kontribuuan bujarisht për përballimin e pasojave të tërmetit, por janë gjendur në krah të klientëve të tyre për të lehtësuar peshën e fatqësisë dhe për të ofruar zgjidhje të përshtatshme, duke siguruar vijimësinë e aktiviteteve dhe bizneseve të tyre.

“Ngjarja me ndikimin më të lartë që shënjoji vitin 2019, në të gjithë sektorët ekonomikë dhe shoqërorë, ishte padyshim tërmeti shkatërrues i datës 26 nëntor. Një goditje e papritur që solli dëme ekonomike e psikologjike në zonat e goditura, por edhe më gjerë.”


Përtej kësaj ngjarjeje, ecuria e përgjithshme e ekonomisë shqiptare, gjatë vitit 2019, duhet vlerësuar si pozitive. Ritmi i rritjes ka vijuar pozitiv, punësimi është rritur, ekuilibrat e brendshëm dhe të jashtëm të vendit janë forcuar, ndërkohë që treguesit kryesorë të shëndetit të sektorit bankar paraqiten në përmirësim.

Të gjitha këto sa rendita, janë arsye të mjaftueshme për të qenë optimist mbi perspektivën e rritjes ekonomike në periudhën afatmesme. Ndër të tjera, Shqipëria ndodhet edhe përpara një momenti madhor në rrugën e saj të zhvillimit e integritimit: çeljen e pritur të negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Këto negociata duhen parë domosdoshmërisht si një ankorë e rëndësishme zhvillimi dhe si një garanci shtesë për investitorët vendas e të huaj.

Siç u shpreha dhe më lart, viti 2019 konfirmoi qëndrueshmërinë e sektorit bankar shqiptar.

Të gjitha ndryshimet strukturore që u iniciuan gjatë vitit 2018, u finalizuan me sukses gjatë vitit 2019, duke sjellë konsolidimin e dëshiruar të sistemit bankar. Gjatë këtij viti, veprimtaria e sektorit shënoi rritje në terma të vëllimit të aktiveve, depozitave e letrave me vlerë. Ndërkohë, cilësia e portofolit të kredive ka një përmirësim me rreth 3 pikë përqindje gjatë vitit 2019 (nga 11.1% në 8.36%). Kjo ka ardhur si rezultat i veprimeve energjike të pjesës më të madhe të bankave në drejtim të trajtimit të portofolit të kredive me probleme, duke ofruar zgjidhje si brenda sistemit bankar (shlyerje, riposedim, ristrukturim, falje borxhi), ashtu edhe jashtë tij (shitje të portofoleve).

Grafik 20. Peshat e segmenteve të sistemit financiar ndaj totalit të aktiveve të sistemit, dhjetor 2019



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Infrastruktura financiare e sektorit bankar u fuqizua më tej gjatë vitit 2019. Banka e Shqipërisë dhe Komiteti Kombëtar i Sistemit të Pagesave kanë vënë në zbatim strategjinë kombëtare për fuqizimin e tregut të pagesave me vlerë të vogël dhe rritjen e shkallës së përfshirjes financiare të popullatës. Rezultatet e para janë premtuese dhe ato do të pasohen nga hapa të tjerë të Bankës së Shqipërisë dhe të sektorit për të mundësuar arritjen e objektivit sasior për dyfishimin e popullsisë që zotëron një llogari bankare, deri në vitin 2022.


Përfshirja financiare e popullatës përbën një nga prioritetet e rëndësishme të momentit. Gjatë vitit 2019, Banka e Shqipërisë dhe sektori bankar i kanë kushtuar një vëmendje të veçantë përfshirjes dhe edukimit financiar të popullatës. Tashmë është vërtetuar se rritja e përfshirjes financiare të popullatës ndikon në rritjen e mirëqenies së saj në mënyrë të harmonizuar. Për këtë qëllim, ndërmjet të tjerash kemi ideuar dhe vënë në zbatim një sërë projektesh edukuese të përshtatura për segmente të ndryshme të popullatës. Edukimi financiar, botimet specifike të natyrës informuese mbi produktet dhe shërbimet bankare, së bashku me zhvillimet në infrastrukturën dhe në shërbimet e pagesave, janë hapa konkretë për një mundësi më shumë për akses financiar nga çdo segment i popullatës.

Të nderuar përfaqësues të sektorit bankar,

Tek fatkeqësia natyrore nuk duhet të shohim vetëm disfatën, por edhe mundësitë për rimëkëmbje. Tashmë qeveria ka publikuar zonat ku do të rindërtohet pas tërmetit, dhe përveç fondeve të alokuara nga buxheti i shtetit për këtë qëllim, priten edhe burime të tjera nga konferenca e donatorëve. Në këtë mjedis ku shfaqen oportunitete financimi nga qeveria, donatorët, por edhe interes i lartë nga individët për të investuar në ristrukturimin e pronave të tyre dhe për t'i bërë ato më të sigurta, bankat nuk mund të qëndrojnë pasive, por duhet ta fuqizojnë rolin e tyre si ndërmjetës dhe ta dimensionojnë aktivitetin kredidhënës në një nivel të ri.

Më lejoni të prek disa çështje kryesore, të cilat meritojnë vëmendje, por edhe adresim të kujdesshëm, për të siguruar shtylla të qëndrueshme mbi të cilat të vijojë të ndërtohet një aktivitet bankar në tërësi, e në veçanti një aktivitet kreditues, i shëndetshëm, konkurrues dhe që siguron të ardhura të qëndrueshme.

Grafik 21. Raporti i kredive me probleme dhe mbulimi me provigjione



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Së pari, reduktimi i portofolit të kredive me probleme nuk na garanton se ato nuk do të shfaqen përsëri, nëse nuk pranojmë dhe adresojmë problemet dhe gabimet që u bënë gjatë krijimit të tyre. Dhe adresimi fillon nga përmirësimi i qeverisjes. Ngritja dhe fuqizimi i linjave të kontrollit, tërheqja dhe trajnimi i stafit të mjaftueshëm dhe të kualifikuar, por mbi të gjitha, mbikëqyrja efektive nga organet më të larta drejtuese, për të ruajtur balancën e duhur mes oreksit për rrezik dhe objektivave të biznesit janë vetëm disa nga hapat që duhen hedhur në këtë drejtim. Banka e Shqipërisë, në kuadër të përafrimit të legjislacionit me BE-në, ka shtuar kërkesat rregullore për të siguruar rritjen e nivelit cilësor të qeverisjes, por përtej përbushjes formale të kërkesave rregullore, është e domosdoshme që këto parime të përqafohen dhe të jenë pjesë e kulturës së të gjithë organizatës. Dhe ky është një investim afatgjatë, por që sjell rezultate të qëndrueshme pozitive.

Së dyti, duke adoptuar një qeverisje më të mirë, e njëjta pritshmëri duhet të transmetohet edhe tek klientët tuaj. Parimi për të mos pranuar të dhëna informale të biznesit në vlerësimin e aftësisë së tij paguese, ka dhënë padyshim rezultate pozitive në parandalimin e krijimit të kredive të reja me probleme, por çështja e informalitetit në ekonomi ende mbetet e prekshme. Më tepër mund të bëhet nga bankat edhe në këtë drejtim, duke ofruar për klientët tuaj dhe duke i nxitur ata të përdorin produkte ekzistuese apo të personalizuar që sigurojnë një qarkullim të lartë të fondeve brenda sistemit, rrisin ndërlidhjen mes bizneseve dhe klientëve,

si dhe lehtësojnë krijimin e një profili më të plotë financiar dhe një vlerësimi më të saktë të aftësisë paguese.

Së treti, me gjithë arritjet e deritanishme, ende ka një sasi relativisht të lartë të aktiveve “të palëvizshme” që zënë vend në bilancin e bankave. Në total, pronat e fituara nga proceset ligjore janë një potencial i lartë që pret të monetarizohet, por që mund ta humbë shumë shpejt vlerën e tij, duke u kthyer në një kosto të panevojshme, e cila dëmton reputacionin dhe konkurrueshmërinë e bankave. Për një treg relativisht të vogël si Shqipëria është provuar se kostot e klientëve me probleme i mban i gjithë sistemi dhe strategjitë individualiste nuk kanë rezultuar efektive. Për të ofruar ristrukturime efektive për klientët në vështirësi, është i domosdoshëm një bashkëpunim i ndershëm mes bankave, i cili siguron jo vetëm një vlerësim më të drejtë të aftësisë paguese të klientit, por optimizon edhe kohën dhe koston e vlerësimit për të dhe për bankën. Banka e Shqipërisë, ashtu si në të kaluarën, do të vijojë të mbështesë në mënyrë energjike projekte të tilla bashkëpunimi, duke garantuar paanësinë, por një vullnet i mirë nuk duhet të mungojë nga asnjë prej bankave.

“Parimi për të mos pranuar të dhëna informale të biznesit në vlerësimin e aftësisë së tij paguese, ka dhënë padyshim rezultate pozitive në parandalimin e krijimit të kredive të reja me probleme, por çështja e informalitetit në ekonomi ende mbetet e prekshme.”

Së fundi, në epokën e zhvillimeve të vrullshme teknologjike, mbijetesa e biznesit bankar do të ishte e pamundur pa investuar në drejtim të teknologjisë në kohën e duhur. Të gjitha bankat janë plotësisht të ndërgjegjësuar në këtë drejtim, por zhvillimet përkatëse në secilën prej tyre kanë ecur me ritme të ndryshme. Me shkëmbimet dhe lidhjet e forta me fqinjët tanë evropianë, por dhe aspiratën e palëkundur që të jemi pjesë e BE-së, shtyrja në kohë e investimeve të nevojshme në këtë drejtim vetëm do ta dëmtonte konkurrueshmërinë. Vetëm investimet në teknologji, pa mbështetjen në burime të brendshme njerëzore, mund t’i ekspozojnë bankat ndaj rreziqeve të larta operationale dhe pasojave të pariparueshme. Në kushtet kur Shqipëria po vuan largimin e të rinjve të arsimuar, ju ftoj t’i shikoni investimet në fushën e teknologjisë jo vetëm në funksion të automatizimit të proceseve, por edhe si një mundësi për të mos lejuar varfërimin e tregut të punës, duke krijuar kushtet për të mbajtur një forcë pune të kualifikuar në këtë treg, e cila është gjithashtu pjesë e klientelës elitare të tregut bankar.

Duke e mbyllur fjalën time, më lejoni t'ju garantoj se kemi vëmendjen dhe mbështetjen maksimale për të gjitha propozimet tuaja, jo vetëm si autoritet rregullator, por në radhë të parë si një partner luajal, mbështetës dhe serioz, në funksion të qëllimit të përbashkët, për një treg të zhvilluar që ofron mundësi tërheqëse për investitorët, për stabilitet financiar dhe një konkurrencë të drejtë që respekton të drejtat e konsumatorit.

Vendimmarrja jonë do të jetë transparente dhe të gjitha nismat tona do të udhëhiqen nga fryma e bashkëpunimit me sektorin, për të synuar eficiencë sa më të lartë.

Ju falënderoj për vëmendjen!

FJALA E GUVERNATORIT SEJKO NË TAKIMIN ME SISTEMIN BANKAR DHE BIZNESIN ME TEMË: “MARRËDHËNIET BIZNES-BANKË: SFIDAT E PËRBASHKËTA EKONOMIKE NË KUSHTET E PANDEMISË GLOBALE COVID-19”

- 13 maj 2020 -

*Të nderuar përfaqësues të biznesit,
Të nderuar përfaqësues të sektorit bankar,*

Së pari, dëshiroj t'ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj në këtë tryezë, të thirrur për të diskutuar mbi rrugën dhe instrumentet optimale për përballimin e sfidave të përbashkëta që kemi përpara.

Ky takim organizohet në rrethana jo të zakonata. Përhapja e pandemisë COVID-19 dhe masat e kujdesit të adoptuara për kontrollin e saj, kanë sjellë një rënie të shpejtë të kërkesës për mallra e shërbime, në tregun vendas dhe në atë të huaj, si dhe një tkurrje të ndjeshme të prodhimit.

Sfidat me të cilat përballemi, janë serioze, si në aspektin e madhësisë dhe në atë të kompleksitetit.

Ekonomia shqiptare pritet të pësojë një rënie të fortë të aktivitetit ekonomik gjatë vitit 2020, në përmasa të cilat nuk i kemi përjetuar gjatë dy dekadave të fundit. Ajo do të shoqërohet me rritje të papunësisë, rënie të të ardhurave dhe vështirësi financiare për bizneset e familjet. Në planin mikroekonomik, rënia e të ardhurave, pakësimi i likuiditetit dhe përkeqësimi i aftësisë paguese, do të testojnë qëndrueshmërinë financiare të bizneseve. Në planin makroekonomik, rritja e borxhit privat dhe publik do të testojë qëndrueshmërinë e ekuilibrave ekonomikë të vendit. Së fundi, goditja që ka pësuar sektori real nuk do të kalojë pa lënë gjurmë as në tregun financiar dhe as në treguesit e aktivitetit të sektorit bankar.

Përmasat dhe kompleksiteti i krizës kërkojnë një përgjigje koherente dhe gjithëpërfshirëse. Roli parësor në këtë drejtim i takon padyshim autoriteteve publike. Stimujt fiskalë, monetarë dhe financiarë, janë instrumente thelbësore për nxitjen e kërkesës agregate, për zbutjen e problemeve të likuiditetit dhe për shmangien e pasojave afatgjata të krizës.

Megjithatë, biznesi dhe sektori bankar nuk duhet ta konsiderojnë veten konsumatorë pasivë të politikave ekonomike, por aktorë të pazëvendësueshëm në përpjekjet tona për zgjidhjen e krizës. Stimujt e autoriteteve publike nuk janë efektivë dhe potencialisht as të mjaftueshëm, pa reagimin e duhur të biznesit dhe të industrisë bankare.

Të nderuar të ftuar,

Më lejoni, në vazhdim, të parashtroj shkurtimisht reagimin e autoriteteve publike dhe, më tej, të ndaj me ju vizionin tonë mbi sfidat dhe rolin që duhet të luajë biznesi dhe sektori bankar shqiptar.


1. REAGIMI I AUTORITETEVE PUBLIKE

Përballë emergjencës së paprecedentë shëndetësore, fokusi i politikave publike – në Shqipëri si dhe në mbarë botën – ka qenë marrja e masave të forta të distancimit social. Në mënyrë të natyrshme, këto masa kanë goditur aktivitetin ekonomik dhe kanë kërkuar një lehtësim të gjithanshëm të politikave fiskale, monetare dhe financiare.

Politika fiskale ka marrë – me të drejtë – një rol primar në përballimin e situatës. Kjo politikë mund të ofrojë një mbështetje direkte të kërkesës agregate, nëpërmjet transfertave fiskale, si dhe një përmirësim të menjëhershëm e të shënjestruar të likuiditetit për bizneset, nëpërmjet shtyrjes së pagesës së taksave e tatimeve dhe nëpërmjet programeve të garancisë sovrane. Dy paketat fiskale, të shpallura deri tani, ofrojnë një stimul potencial maksimal rreth nivelit 3% të PBB-së. Edhe pa marrë në konsideratë efektin negativ në të ardhurat publike, ky stimul transferon në bilanciçet e sektorit publik një pjesë të konsiderueshme të faturës financiare të krizës.

Nga ana e saj, Banka e Shqipërisë ka rritur dozën e stimulit monetar. Ky stimul ka marrë formën e uljes së normës bazë të interesit, tashmë në minimumin historik prej 0.5%, duke synuar nxitjen e kreditimit dhe uljen e kostos së shërbimit të kredive ekzistuese. Gjithashtu, ai ka marrë formën e heqjes së kufijve sasiorë të injektimit të likuiditetit në sistem, duke synuar furnizimin sa më të mirë të tregut bankar dhe të ekonomisë shqiptare. Vëllimi i likuiditetit që ne injektuamë çdo javë në sistemin financiar luhetet rreth nivelit 2% të PBB-së. Paralelisht me to, ne kemi marrë dhe masa operationale për garantimin e furnizimit të ekonomisë me para fizike, në përgjigje të kërkesave të shtuara të saj.

Grafik 22. Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parashë në periudhën 2016-2020 (me vlerë nominale).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Paralelisht me të, Banka e Shqipërisë – në dakordësi e mirëkuptim me industrinë bankare – ka kryer ndryshime rregullatore, të cilat lehtësojnë shtyrjen me një tremujor të pagesës së këstit të kredisë për bizneset e familjet në vështirësi të përkohshme financiare. Sipas raportimeve të deritanishme, nga kjo lehtësi kanë përfituar mbi 20,000 biznese, të cilat kanë kredi, pranë bankave, që llogariten mbi nivelin e dy miliardë eurove. Gjithashtu, ne kemi pezulluar përkohësisht shpërndarjen e dividendit nga sektori bankar, në interes të forcimit të treguesve të kapitalizimit të këtij sektori.

Të nderuar të ftuar,

Filozofia e reagimit të Bankës së Shqipërisë është zbutja e pasojave të krizës dhe krijimi i parakushteve për një rimëkëmbje sa më të shpejtë të ekonomisë me përfundimin e saj. Në zbërthim të kësaj filozofie, ne gjujkojmë se ruajtja e stabilitetit monetar dhe financiar, si dhe minimizimi i efekteve negative të pandemisë në kapacitetet tona prodhuese, janë dy parakushte kyçe për rimëkëmbje.

Për këtë arsye, objektivi i politikave tona është aplikimi i stimujve të duhur në kohën e duhur, por pa paragjykuar për asnjë moment stabilitetin monetar dhe financiar të vendit.


Jam i bindur se kjo filozofi ndahet dhe prej biznesit e sektorit bankar.

2. BIZNESI DHE SEKTORI BANKAR PËRBALLË COVID-19

Sikundër e theksova më parë, biznesi shqiptar përballët me një sfidë serioze ndaj së ardhmes së tij, sfidë e cila në segmente të caktuara ka përmasa thujtase ekzistenciale. Në të njëjtën kohë, shëndeti afatgjatë i sektorit bankar – dhe nëpërmjet tij, siguria e kursimeve të qytetarëve dhe stabiliteti financiar i vendit – është i lidhur ngushtë me shëndetin e biznesit.

Kredia e sektorit bankar për bizneset është pothuaj katërfishuar gjatë dy dekadave të fundit. Ajo përbën rreth 25% të bilancit të bankave dhe rreth 25% të PBB-së, ndërkohë që fluksi i marrëdhënieve bankë - biznes shtrihet edhe në fushën e produkteve të tjera financiare dhe të shërbimeve të pagesave.

Grafik 23. Kredia për biznese sipas madhësisë



Burimi: Banka e Shqipërisë, Illogaritje të stafit.

Për këtë arsye, reagimi juaj ndaj goditjes duhet të jetë i vendosur, kurajoz dhe largpamës, si dhe të mbështetet në frymën e bashkëpunimit dhe të interesave të përbashkëta afatgjata.

Më lejoni të jem më konkret në shtjellimin e vizionit të Bankës së Shqipërisë mbi sfidat që kemi përpara.

Sfida e parë është përballimi i emergjencës shëndetësore. Biznesi dhe sektori bankar duhet ta kenë të qartë se kapitali njerëzor është aset i çmuar i çdo kompanie. Për këtë arsye, çdo masë e nevojshme për garantimin e shëndetit të punonjësve nuk duhet parë si shpenzim, por si një investim strategjik në të ardhmen e biznesit.

Sfida e dytë është rishikimi i modelit të biznesit dhe rritja e fleksibilitetit operacional. Një nga mësimet e kësaj krize është se secili nga ne mund të bëjë më shumë për adoptimin e teknologjisë së informacionit, për zhvendosjen e një pjese të biznesit online, si dhe për rritjen e fleksibilitetit dhe të eficiencës operationale. Vënia në praktikë e këtyre mësimeve është veçanërisht e dobishme në rast të zgjatjes në kohë të pandemisë.

Sfida e tretë është ruajtja e likuiditetit dhe e aftësisë paguese të bizneseve. Goditja që pësuam e gjeti biznesin shqiptar me një nivel historikisht të lartë likuiditeti; depozitat e tij në sektorin bankar ishin pranë nivelit 12% të PBB-së në fund të tremujorit të parë. Paralelisht me to, aksesit i biznesit në fonde likuide bankare, në formën e overdraftit apo të linjave të kreditit, është në madhësi të krahasueshme me depozitat e vetë biznesit. Ky likuiditet përbën një barrierë të arsyeshme sigurie ndaj rrezikut. Megjithatë, përvoja historike tregon se krizat e likuiditetit janë shpesh pikënisje për kriza të plota financiare. Për këtë arsye, gjej me vend të theksoj se:

**“Sfidat që kemi përpara:
• përballimi i emergjencës shëndetësore;
• rishikimi i modelit të biznesit dhe rritja e fleksibilitetit operacional;
• ruajtja e likuiditetit dhe e aftësisë paguese të bizneseve;
• ruajtja e kapaciteteve prodhuese të ekonomisë.”**

- biznesi duhet të tregohet i kujdesshëm në administrimin operacional të likuiditetit, duke u bazuar në plane realiste dhe duke marrë masa për përballimin e nevojave kontingjente apo të paparashikuara;
- po ashtu, sektori bankar duhet të vazhdojë ta mbështesë ekonominë me fonde likuide, duke bërë një vlerësim objektiv e realist të situatës, por pa kompromentuar kriteret e rrezikut në kredidhënie.

Nga ana e saj, Banka e Shqipërisë ka marrë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme që sektori bankar të ketë të gjithë likuiditetin e mjaftueshëm për mbështetjen e ekonomisë shqiptare.

Sfida e katërt është ruajtja e kapaciteteve prodhuese të ekonomisë. Kjo sfidë nënkupton ruajtjen e shëndetit të bizneseve individuale, si dhe funksionimin e të gjithë zinxhirit të prodhimit e të tregimit. Për këtë arsye, Banka e Shqipërisë sugjeron:

- biznesi duhet të kujdeset për një ndarje sa më të drejtë të kostove të krizës, duke ofruar – aty ku është e mundur dhe në interes të dyanshëm – lehtësitë e nevojshme financiare për furnitorët apo klientët afatgjatë;

- sektori bankar duhet të bëjë një rivlerësim të qëndrueshmërisë së modelit të biznesit të kredimarrësve, në realitetin post-Covid. Klientët në vështirësi të përkohshme financiare, por me modele të qëndrueshme biznesi, duhet të mbështeten me likuiditet dhe lehtësi të përkohshme operationale. Klientët në vështirësi më serioze mund të ndihmohen nëpërmjet ristrukturimit të kredisë, në formën e një tjetër shtyrjeje të përkohshme të këstit apo në formën një ristrukturimi tërësor të saj, gjithnjë dhe për aq kohë sa perspektiva afatgjatë e biznesit mbetet solide.

Nga ana e saj, Banka e Shqipërisë do të inkurajojë një përqsaje proaktive të sektorit bankar ndaj këtij procesi, pa paragjykuar në asnjë moment stabilitetin e sektorit dhe transparencën e bilanceve të tij.

Së fundi, sfida e pestë është ruajtja e stabilitetit monetar e financiar të vendit. Duke përfutur nga rasti, gjej me vend të theksoj se:

- biznesi shqiptar duhet të tregohet transparent dhe luajal me sektorin bankar. Ky sektor duhet të ofrojë ndihmën e tij në përballimin e krizës, por ai nuk mund ta përballojë i vetëm faturën financiare të saj;
- po ashtu, sektori bankar duhet të gjejë një ekuilibër të drejtë midis mbështetjes së kredimarrësve në nevojë – në interes dhe përfitim afatgjatë të dyanshëm – dhe ruajtjes së shëndetit të bilanceve të tij.

“Sektori bankar duhet të gjejë një ekuilibër të drejtë midis mbështetjes së kredimarrësve në nevojë – në interes dhe përfitim afatgjatë të dyanshëm – dhe ruajtjes së shëndetit të bilanceve të tij.”

Sikundër e thashë, stabiliteti monetar dhe financiar është i panegociueshëm për Bankën e Shqipërisë. Në përputhje dhe me mandatin tonë ligjor, ai ka qenë dhe do të jetë guri i themelit të politikave tona.

Të dashur miq,

Dëshiroj ta mbyll këtë fjalë duke nënvizuar se, ndonëse sfidat që kemi përpara janë serioze, përballimi me sukses i tyre është brenda mundësive tona nëse secili prej nesh do të dijë të ngrihet në lartësinë e detyrës.

Për këtë arsye, ju ftoj të zhvillojmë një diskutim frytdhënës dhe të hapur, duke synuar të identifikojmë një program të përbashkët pune për periudhën në vijim.

Ju faleminderit!

FJALA E GUVERNATORIT SEJKO NË TAKIMIN E 43-TË TË KLUBIT TË GUVERNATORËVE TË VENDEVE TË AZISË QENDRORE, RAJONIT TË DETIT TË ZI DHE BALLKANIT - 2 qershor 2020 -

Të nderuar Guvernatorë,

Po jetojmë në një kohë të ndikuar thellësisht prej pandemisë COVID-19. Përveç se është një nga krizat shëndetësore më të rënda që kemi kaluar, ajo është kthyer gjithashtu në një nga sfidat më serioze ekonomike të historisë bashkëkohore. Përhapja e pandemisë, kombinuar me masat e forta të ndërmarra për të parandaluar infektimin e mëtejshëm, zvogëluar në mënyrë të paprecedentë lëvizjen e njerëzve, të mallrave dhe të shërbimeve. Rënia e njëkohshme e kërkesës dhe e ofertës ka shkaktuar një rënie të shpejtë të prodhimit, shtim të menjëhershëm të papunësisë, vështirësi të mëdha për familjet dhe bizneset, dhe ka parashtruar sfida të ndërlikuara për politikëbërjen publike.

Shqipëria nuk bën përjashtim nga kjo tablo e zhvillimeve ndërkombëtare. Ne po përballemi me një kontraktim ekonomik, ndër më të fortët në dy dekadat e fundit.

Paketa tërësore e politikave ekonomike stimuluese për të minimizuar efektet negative është implementuar në kohë optimale dhe ka ndikim gjithëpërfshirës. Objektivi i saj ka qenë i trefishtë: (i) ofrimi i financimit të nevojshëm për të përballuar emergjencën shëndetësore; (ii) mbrojtja e familjeve dhe e bizneseve të prekura nga kriza, me qëllim minimizimin e humbjeve në kapacitetet prodhuese; dhe (iii) ruajtja e stabilitetit monetar dhe financiar.

“Paketa tërësore e politikave ekonomike stimuluese për të minimizuar efektet negative është implementuar në kohë optimale dhe ka ndikim gjithëpërfshirës.”

Për shkak të dinamikës së shpejtë dhe të madhësisë së emergjencës, politika fiskale luan rol parësor në përballimin e situatës, duke kompensuar pjesërisht humbjet e të ardhurave për familjet dhe duke ofruar mbështetje

me likuiditet për bizneset e prekura nga situata. Madhësia e paketës së stimullit fiskal në Shqipëri vlerësohet në rreth 3% të PBB-së, dhe përfshin stimuj në formën e transfertave fiskale për individët, shtyrjes së pagesës së taksave dhe të tatimeve, dhe garancive sovraane për të lehtësuar marrjen e kredisë bankare. Sipas këndvështrimit tonë, rritja e borxhit publik është një kosto e pranueshme kur krahasohet me impaktin e saj në lehtësimin e ndikimit social të krizës, në shmangien e falimentit në shkallë të gjerë të bizneseve dhe në mënjanimin e impaktit të thellë negativ që këto falimente do të kishin mbi stabilitetin financiar të vendit.

Ndërhyrja e Bankës së Shqipërisë ishte e shpejtë. Veprimet tona patën për qëllim arritjen e tre objektivave: (i) sigurimin e ofrimit normal të shërbimeve financiare gjatë kohës së mbylljes së aktivitetit ekonomik; (ii) reduktimin e kostove të shërbimit të borxhit të agjentëve ekonomikë; dhe (iii) ruajtjen e stabilitetit monetar e financiar, si një parakusht i domosdoshëm për një rimëkëmbje të shpejtë të ekonomisë.

Në lidhje me këtë:

- Banka e Shqipërisë shtoi stimulin monetar me anë të uljes së normës bazë të interesit, në një minimum të ri historik prej 0.5%, si dhe me anë të rritjes së injektimeve të likuiditetit në treg;
- për më shumë, ne udhëzuam bankat të ofrojnë lehtësi likuiditeti për biznese të ndryshme që hasin vështirësi të përkohshme, si për shtyrjen e pagesave për një periudhë afatshkurtër ashtu edhe në formën e ristrukturimit të kredive, aty ku është e nevojshme. Ne e lehtësuam këtë proces nëpërmjet ndryshimeve specifike, por të përkohshme të kuadrit rregullator që i udhëheq këto aktivitete;
- vendosëm heqjen përkohësisht të komisioneve mbi përdorimin e platformave të pagesave elektronike, si dhe nxorëm udhëzime të detajuara për bankat me qëllim që të lehtësojmë vazhdimësinë e veprimtarisë së tyre.

“... skenari ynë bazë – dhe njëkohësisht rasti më i mirë i ecurisë së ekonomisë në të ardhmen - parashikon një rimëkëmbje në formë V-je, duke nisur nga tremujori i tretë i vitit 2020.”

Duke parë nga e ardhmja, pasiguritë përreth dëmit ekonomik të shkaktuar nga pandemia janë jashtëzakonisht të mëdha. Megjithatë çdo projeksion pikësor mbi ecurinë e ekonomisë është ende për t'u vlerësuar, skenari ynë bazë – dhe njëkohësisht rasti më i mirë i ecurisë së ekonomisë në të ardhmen - parashikon një rimëkëmbje në formë V-je, duke nisur nga tremujori i tretë i vitit 2020.

Deri më sot, sistemi bankar shqiptar mbetet solid, me aftësi paguese të qëndrueshme dhe likuid. Për më shumë, tregjet tona të brendshme financiare janë të qeta dhe kushtet financiare mbeten mbështetëse ndaj rritjes së kredisë.

Gjithashtu, Banka e Shqipërisë ka njoftuar planet e saj për të aktivizuar instrumente jokonvencionale të politikës monetare, në rast se kriza thellohet dhe përdorimi i tyre do të ishte i nevojshëm dhe i pashmangshëm. Implementimi i këtyre instrumenteve do të jetë gjithnjë në përputhje me kuadrin tonë ligjor, dhe në varësi të realiteteve të tregut tonë të brendshëm ekonomik dhe financiar. Për më shumë, çdo stim financiar dhe monetar i ofruar nga Banka e Shqipërisë do të ndërmerret pa dëmtonur as stabilitetin financiar dhe as shëndetin e sektorit bankar në vend.

Ne besojmë në një ndarje të drejtë të kostove ndërmjet sektorit publik, privat dhe atij financiar. Megjithatë, çdo përpjekje për të vendosur një shumë joproporcionale të kostove në bilanci të sektorit bankar do të rezultonte kundërproduktive dhe në dëm të rikuperimit të ekonomisë në një fazë të dytë.

Së fundmi, më lejoni të them se, një rimëkëmbje e plotë nga pandemia ka nevojë për një shkallë të gjerë bashkëpunimi ndërkombëtar. Rajoni i Evropës Juglindore dhe Lindore përfshin vende me ekonomi të vogla dhe të hapura, të cilat mbështeten në tregti dhe në financim për t'u zhvilluar ekonomikisht e për të konverguar me standardet e Bashkimit Evropian. Çdo kthim pas në procesin e integritimit rajonal dhe evropian do të na dëmtonte thellësisht.

“... një rimëkëmbje e plotë nga pandemia ka nevojë për një shkallë të gjerë bashkëpunimi ndërkombëtar.”

Këto janë sfidat tona për të ardhmen, ndërkohë që lëmë pas pandeminë. Sigurisht nuk është një rrugë e shtruar, por jam i sigurt se ne do t'ia dalim me sukses!

Faleminderit për vëmendjen tuaj!

FJALA E GUVERNATORIT SEJKO NË TAKIMIN E MINISTRAVE TË FINANCAVE DHE GUVERNATORËVE TË BANKAVE QENDRORE TË VENDEVE TË EQJL-SË, ME DREJTOREN E PËRGJITHSHME TË FMN- SË, ZJ. KRISTALINA GEORGIEVA

- 23 tetor 2020 -

*E nderuar zonja Georgieva,
I nderuar zoti Kryetar,
Të nderuar Ministra,
Të nderuar Guvernatorë,*

Pas stresit të rëndë ekonomik dhe social të shkaktuar nga pandemia COVID-19, perspektiva globale duket se po vjen drejt përmirësimit. Përgjigjja e vendosur e ndërmarrë nga politikëbërësit në fushën e ekonomisë, ndërthurur me përpjekjet për të kufizuar përhapjen e pandemisë, kanë mbrojtur ekonomitë dhe shoqëritë nga e keqja më e madhe e krizës dhe kanë shtruar rrugën drejt një rigjallërimi të ekonomisë në të ardhmen.

Megjithatë, sfidat që shtrihen para nesh janë të shumëfishta dhe komplekse. Së pari, rigjallërimi i ekonomisë mbetet i rrethuar nga rreziqe të kahut të poshtëm, ndërsa hapësira për veprim e politikave po zvogëlohet gjithnjë e më shumë. Së dyti, goditja e rëndë mund të ulë potencialin e rritjes ekonomike në të gjithë globin. Së treti, një përmbysje potenciale e integritimit të zinxhirit të prodhimit dhe tregtisë globale mund të çojë në fragmentim të politikave ekonomike dhe të rrisë më tej vështirësitë për ekonomitë në zhvillim.


Në Bankën e Shqipërisë, ne besojmë se një zgjidhje e suksesshme e politikës monetare kërkon kurajë dhe fleksibilitet në nivel kombëtar, si dhe koordinim e bashkëpunim në nivel rajonal e ndërkombëtar. Do të përpiqem t'i shtjelloj shkurtimisht këto pika, duke i ilustruar ato me perspektivën rajonale dhe atë shqiptare.

“Në Bankën e Shqipërisë, ne besojmë se një zgjidhje e suksesshme e politikës monetare kërkon kurajë dhe fleksibilitet në nivel kombëtar, si dhe koordinim e bashkëpunim në nivel rajonal e ndërkombëtar.”

Përhapja e pandemisë i vendosi vendet e Ballkanit Perëndimor në një recesion të thellë. Prodhimi dhe të ardhurat ranë në mënyrë drastike, papunësia u rrit, bilancet e sektorit privat dhe atij publik u përkeqësuan, ndërsa shoqëritë në shkallë të gjerë u ndodhën në stres. Vlerësimet për rënien e PBB-së në rajon gjatë vitit 2020, variojnë nga -3.1% (sipas Bankës Botërore) në -5.2% (sipas FMN-së). Për t'i përballuar ato:

- bankat qendrore përdorën si instrumentet konvencionale të politikës monetare (ulje të normës së interesit) dhe ato jokonvencionale (nga operacionet e lehtësimit sasior deri tek injektimet afatgjata të likuiditetit dhe skemat e mbështetjes me kredi). Për më shumë, ato siguruan lehtësira të përkohshme makroprudenciale për të nxitur shtyrjen e pagesave të kredisë dhe ristrukturimin e tyre;
- në të njëjtën kohë, politika fiskale u lehtësua. Shumë prej qeverive zbatuan paketa stimuluese të konsiderueshme, duke përfshirë: rritje të shpenzimeve për sektorin e shëndetësisë; lehtësim të taksave; rritje të transfertave të drejtpërdrejta; si dhe skema të garantimit të kredive. Si rezultat, raportet e borxhit ndaj PBB-së pritet të rriten mesatarisht me 10 pikë përqindje.

Grafik 24. Borxhi i sektorit publik dhe privat i dezagreguar (% ndaj PBB-së nominale)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shqipëria ka një përvojë të ngjashme. Në fillim të goditjes së dyfishtë, shkaktuar nga tërmeti i fundnëntorit 2019 dhe pandemisë, PBB-ja pritet të pësojë një rënie rreth mesatares rajonale.

Masat e politikës monetare të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë patën për qëllim të siguronin fluks të pandërprerë të kreditimit dhe të shërbimeve

financiare, si dhe të ruanin stabilitetin monetar dhe financiar. Në mënyrë më specifike, Banka e Shqipërisë:

- rriti stimulin monetar, duke ulur normën bazë të interesit në 0.5% në mars 2020, dhe duke kaluar në operacione injektimi të likuiditetit me çmim të fiksuar e duke rritur masën e këtyre injektimeve;
- udhëzoi bankat të ofrojnë lehtësi likuiditeti për biznese të ndryshme që hasin vështirësi të përkohshme, në formën e një moratoriumi afatshkurtër për pagesat e kësteve të kredisë si dhe në formën e ristrukturimit të kredisë. Procesi u mbështet me lehtësi rregulatore të shënjestruara dhe të përkohshme;
- pezulloi shpërndarjen e dividendit në të gjithë sektorin bankar, me qëllim që të rritej më tej kapitali i tij;
- së fundi, shfuqizoi tarifatat mbi kostot e transaksioneve ndërbankare për pagesat në sistemet e pagesave të operuara nga Banka e Shqipërisë.

Këto politika janë koordinuar dhe mbështetur në shkallë të gjerë nga stimuli fiskal. Duke lehtësuar bilancet e sektorit publik, politika fiskale kompensoi humbjet e të ardhurave të individëve, ofroi mbështetje me likuiditet për bizneset e prekura nga kriza në formën e shtyrjes së pagesave të taksave dhe të aksesit të përmirësuar në financë nëpërmjet skemave të garancisë sovrane për kreditë.

Lidhur me këtë, gjej me vend të evidentoj rolin e Instrumentit të Financimit të Shpejtë (RFI), akorduar Shqipërisë nga FMN-ja në fillimet e pandemisë. Ky instrument mbështeti stimulin tonë fiskal, lehtësoi ndikimin e tij në tregjet e brendshme financiare dhe sinjalizoi aftësinë e vendit tonë për të aksesuar burime të ndryshme financimi.

Rezultatet e para të politikave tona kanë qenë inkurajuese. Sistemi bankar shqiptar mbetet solid, i aftë për të paguar dhe likuid. Tregjet tona financiare janë të qeta, ndërkohë që normat e interesit dhe kursi i këmbimit janë të qëndrueshëm. Për më shumë, fluksi pozitiv i kreditimit të ekonomisë ka qenë thelbësor në zbutjen dhe përballimin e nevojave financiare të biznesit. Së fundi, si sektori publik dhe ai privat kanë ruajtur aksesin në tregjet financiare ndërkombëtare.

“Instrumenti i Financimit të Shpejtë (RFI), akorduar Shqipërisë nga FMN-ja në fillimet e pandemisë, mbështeti stimulin tonë fiskal, lehtësoi ndikimin e tij në tregjet e brendshme financiare dhe sinjalizoi aftësinë e vendit tonë për të aksesuar burime të ndryshme financimi.”

Duke ardhur në fund të prezantimit tim, do të ofroj një përmbledhje të shkurtër të disa prej mësimëve që kemi nxjerrë nga kjo përvojë.

- Së pari, goditje të paprecedenta të kësaj madhësie kërkojnë marrjen në kohë të masave të jashtëzakonshme, masa të cilat në mënyrë kritike vënë në pikëpyetje edhe konsensusin ekzistues të politikës ekonomike.
- Së dyti, kompleksiteti i krizës kërkon koordinim të kujdesshëm të politikave ekonomike, me qëllim ofrimin e ndihmës për të gjithë sektorët kryesorë të ekonomisë.
- Së treti, bashkëpunimi ndërkombëtar – në formën e asistencës financiare dhe të koordinimit të politikave – është thelbësor për të lehtësuar kostot e ekonomive në zhvillim dhe për të shmangur përhapjen negative në shkallë rajonale dhe globale.
- Së katërti, fondamentet e shëndosha monetare dhe financiare janë siguria dhe investimi më i mirë që politikat ekonomike mund të ofrojnë për një rritje të qëndrueshme dhe afatgjatë. Këto fundamente mund të ndërtohen në mënyrë më efektive nëpërmjet masave të kujdesshme dhe reformave strukturore gjatë periudhave "të mira kohore". Për këtë arsye, në adresimin e çdo sfide afatshkurtër, politikëbërësit duhet të ruajnë një sens perspektive mbi ndikimin që ato kanë në qëndrueshmërinë monetare dhe financiare të vendit.

Të nderuar kolegë,

Shkalla e sfidave të ardhshme potencialisht është më e madhe krahasuar me atë çfarë ne kemi hasur deri më sot. Përveç mbështetjes së rigjallërimit ciklik të ekonomive tona, ne duhet të jemi të vëmendshëm ndaj ndryshimeve strukturore që kjo krizë mund të na sjellë.

Besoj se ne do të mund të ngrihemi në lartësinë e kësaj detyre vetëm nëse vendosim në vëmendje mësimet e nxjerra deri më sot dhe veprojmë me frymën e koordinimit dhe solidaritetit të përbashkët.

Faleminderit!

FJALA E GUVERNATORIT SEJKO NË WORKSHOP-IN XIV TË KËRKIMEVE EKONOMIKE PËR EVROPËN JUGLINDORE TË ORGANIZUAR NGA BANKA E SHQIPËRISË - 10 dhjetor 2020 -

*Të nderuar profesorë dhe studiues nga akademija,
Të nderuar kolegë dhe studiues të bankave qendrore,
Të nderuar pjesëmarrës,*


Është kënaqësi të hap punimet e Seminarit XIV të Kërkimeve Ekonomike për Evropën Juglindore. Për shkak të vështirësive dhe kufizimeve me të cilat po përballemi të gjithë ne, shkaktuar nga pandemia COVID-19, seminari i këtij viti organizohet virtualisht. Me kënaqësi shoh se jeni të gjithë mirë, dhe uroj që ju dhe familjet tuaja të jeni të sigurt dhe të gëzoni shëndet gjatë kësaj kohe të vështirë! Më vjen keq që nuk mundëm t'ju mirëpresim në Tiranë këtë dhjetor, e në të njëjtën kohë, ndihem mirë që - pavarësisht këtij ndryshimi të detyruar të formatit dhe në prani të shumë vështirësive me të cilat pandemia ka sfiduar secilin prej nesh - shoh sot një pjesëmarrje të gjerë nga bota akademike dhe bankat qendrore. E vlerësojmë interesin tuaj, duke e konsideruar atë si certifikatë të cilësisë dhe reputacionit të këtij aktiviteti. Kërkuesit tanë presin me këshëri të dëgjojnë studimet tuaja dhe të diskutojnë me ju kërkimet që janë bërë në Bankën e Shqipërisë gjatë vitit 2020.

***“... pavarësisht këtij ndryshimi të detyruar të formatit dhe në prani të shumë vështirësive me të cilat pandemia ka sfiduar secilin prej nesh, shoh sot një pjesëmarrje të gjerë nga bota akademike dhe bankat qendrore në këtë workshop.*”**

Ndihem mirë të shoh se pothuajse të gjitha materialet studimore të përzgjedhura, përfshirë dhe ato nga akademija, përqendrohen në tema praktike, të cilat janë të rëndësishme për formulimin dhe vendimmarrjen e politikave në bankën qendrore. Këto studime shërbejnë si themeli i të kuptuarit të fenomeneve ekonomike dhe financiare, dhe të ndërveprimit të politikave tona monetare, makro dhe mikroprudenciale me ekonominë. Falë kësaj kuptueshmërie dhe njohjeje të përmirësuar, Banka e Shqipërisë harton politikat që ajo ndjek, dhe zgjedh instrumentet e politikës për t'iu përgjigjur goditjeve të konsiderueshme negative që kanë ndodhur ndaj ekonomisë sonë.

Të dhënat e fundit sugjerojnë se pandemia ka goditur fort ekonominë shqiptare, e cila, si pasojë, përjetoi ngushtimin më të fortë të prodhimit të brendshëm bruto, në dy dekadat e fundit, në -10.2%, gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020. Të dhënat makro nga tregjet e punës tregojnë se, krahasuar me fundin e vitit 2019, ekonomia shqiptare humbi rreth 50 mijë vende pune, e barasvlershme me një rënie vjetore të punësimit prej 3.6%. Si rrjedhim, norma e papunësisë u rrit në 11.9%. Në përgjigje të këtyre zhvillimeve, inflacioni, në tremujorin e tretë, ra në 1.4% nga 1.9% në tremujorin e kaluar. Pavarësisht këtyre goditjeve negative, masat e marra nga Banka e Shqipërisë ofruan stimulin monetar të nevojshëm për të mbështetur funksionimin normal të tregjeve financiare dhe për të siguruar fluksin e kredisë në ekonomi. Normat e interesit për individët dhe bizneset janë në nivele të ulëta, presionet për likuiditet janë nën kontroll, ndërsa kursi i këmbimit është i qëndrueshëm.

Grafik 25. Pozicioni ciklik i ekonomisë u përmirësua në tremujorin e tretë 2020, por mbetet në territor negativ




Shënime: Hendeku i prodhimit është mesatare e disa matjeve, mbi të cilën aplikohet metoda e mesatares lëvizëse. Hendeku i normës së shfrytëzimit të kapaciteteve është llogaritur si devijim i vlerës aktuale nga mesatarja historike, dhe më pas është zbatuar metoda e mesatares lëvizëse. Hendeku i shkallës së papunësisë vlerësohet si mesatare e hendeqeve të papunësisë sipas 3 metodave, të cilat vlerësojnë normën ekuilibër të papunësisë. Ai shprehet si diferencë e shkallës ekuilibër të papunësisë me atë faktike dhe më pas zbatohet metoda e mesatares lëvizëse.

Burimi: INSTAT dhe vlerësimet e Bankës së Shqipërisë.

Sistemi bankar shqiptar mbetet i shëndetshëm, pavarësisht sfidave me të cilat po e përball pandemia. Masat operacionale të menjëhershme të ndërmarra nga bankat, si dhe masat mikro dhe makroprudenciale të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë, siguruan jo vetëm vazhdimësinë e kryerjes së funksioneve kritike të bankave, por gjithashtu ndërmjetësim financiar të kënaqshëm, pavarësisht goditjes së rëndë që pësoi ekonomia. Kredia për ekonominë po rritet (ajo u rrit me 6.3% në tremujorin e tretë të vitit 2020), kapitali është i mjaftueshëm dhe bilancet e bankave mbeten të shëndetshme, duke sinjalizuar aftësinë e tyre për t'i përballuar goditjet e raundit të parë. Ne jemi optimistë se aktiviteti ekonomik pritet të

rigjallërohet në dy vitet e ardhshme. Megjithatë, parashikimi ekonomik për të ardhmen shoqërohet nga një nivel i lartë pasigurie dhe rreziqe të kahut të poshtëm. Në periudhën afatshkurtër, këto rreziqe lidhen më së shumti me pasigurinë e vetë pandemisë, ashpërsinë e saj, kohëzgjatjen dhe rikthimin e mundshëm të masave kufizuese. Në periudhën afatgjatë, rreziqet lidhen me dëmtimin afatgjatë mbështetur nga kapacitetet prodhuese dhe kërkesa e brendshme, si dhe nga ndryshimi i mundshëm strukturor në ekonomi, si rezultat i sjelljes së ndryshuar të agjentëve ekonomikë. Ne jemi të sigurt se evidencat, analizat dhe parashikimet e bazuara në punën kërkimore do të ofrojnë informacionin e saktë dhe në kohë për orientimin dhe koordinimin e politikës.

Grafik 26. Pritjet për kthim në situatë normale



Burimi: Vrojimi i besimit të bizneseve, Banka e Shqipërisë.

Puna kërkimore në fushat e politikës monetare, stabilitetit financiar dhe mbikëqyrjes bankare, gjithmonë ka dominuar në temat e këtij seminari. Këtë vit, COVID-19 hyri me forcë në agjendë. Goditja dhe efektet negative që shkaktoi në ekonomi dhe në politikat e bankës qendrore kanë qenë përtej të kuptuarit. Autoritetet hasin vështirësi në kryerjen e detyrës së tyre në kufirin e poshtëm zero ose shumë pranë tij. Në lidhje me këtë, bankat qendrore kanë humbur instrumentet tradicionale të politikës monetare dhe po i rikthehen pasasë si instrument i politikës monetare. Ky kalim ka qenë i konsiderueshëm, jo vetëm në madhësi, por edhe në koncept. Bankat qendrore, udhëheqëse në ekonomitë e zhvilluara, ato të cilat përcaktojnë tendencat, janë në proces rishikimi të objektivave të tyre dhe të politikës monetare. Duke u mbështetur në analizat dhe përfundimet e kërkimeve, ato po rishkruajnë ekonomiksin monetar, duke u dhënë bankave qendrore

një instrument të ri në formën e përdorimit të përhershëm të bilancit të bankës qendrore, si mjet zgjerimi monetar. Megjithatë, ndërsa zbatimi i strategjive të bilancit është i lehtë për t'u ndjekur dhe për t'u trajtuar nga bankat qendrore të vendeve të zhvilluara, disa politika mund të mos jenë lehtësisht të përvetësueshme dhe të zbatueshme në ekonomitë në zhvillim. Tregjet e ngushta dhe jo të zhvilluara të kapitalit, problemet me përfshirjen financiare dhe edukimin financiar, bilance dhe histori të sektorit privat, publik dhe bilance fiskale të stresuara, na kujtojnë për rreziqet e ndryshme potenciale që këto politika mund të mbartin për ekonomitë e dollarizuara apo të euroizuara të Evropës Juglindore. Ende në prani të pengesave aktuale të hasura nga politika monetare, ne na duhet të reagojmë dhe të gjejmë rrugë të reja për të mbështetur ekonominë. I takon kërkimit të udhëheqë rishikimet dhe modelet e politikës për politika ekonomike të qëndrueshme që mund të nxisin rritjen ekonomike në prani të stabilitetit të çmimeve dhe të sistemit financiar.

Lajmet për zbulimet e suksesshme të vaksinave kundër COVID-19, duke shpresuar që dhe të tjera do të jenë të suksesshme në të ardhmen e afërt, sjellin lehtësimin e shumëpritur. Megjithatë, siç e përmenda më lart, pasiguria mbetet, jo vetëm sa i përket prodhimit, shpërndarjes dhe suksesit të fushatës së vaksinimit në botën reale, por gjithashtu sa i përket formës dhe shpejtësisë së rimëkëmbjes ekonomike dhe financiare, pasi të jetë mposhtur COVID-19. Ende rreziqe të tjera si ai që lidhet me ndryshimin e klimës, së bashku me shkatërrimet natyrore, humbja e habitateve dhe e ndryshimeve të përdorimit të tokës së punueshme, rreziqet demografike dhe pandemike përbëjnë sfida të konsiderueshme afatgjata për ekonominë globale. Gjithashtu, ato përbëjnë rreziqe të mëdha për ekonomitë tona të vendeve të Evropës Juglindore. Ne do mund të na duhet t'i kushtojmë më shumë burime kërkimore studimit të këtyre fenomeneve dhe ndikimeve të tyre në ekonomi, në çmime dhe në stabilitetin financiar në vendet tona. Jam i sigurt se ato do të bëhen tema të rëndësishme të këtij seminari në të ardhmen.

“... puna kërkimore e bazuar në vrojtime dhe në të dhëna mikro ka ofruar informacion të rëndësishëm për situatën financiare të familjeve dhe të bizneseve, për burimet e tyre të financimit, për instrumentet e pagesave, kursimet dhe sjelljen ekonomike e financiare.”

Gjatë viteve të fundit, kemi parë se puna kërkimore e bazuar në vrojtime dhe në të dhëna mikro ka ofruar informacion të rëndësishëm për situatën financiare të familjeve dhe të bizneseve, për burimet e tyre të financimit, për instrumentet e pagesave, kursimet dhe sjelljen ekonomike e financiare. Dëshiroj të sjell në vëmendjen tuaj se i njëjti informacion është i nevojshëm për të kuptuar

përfshirjen financiare dhe kulturën financiare në një vend. Ato janë dy aspekte të ndryshme për mirëqenien e familjeve dhe bizneseve dhe për stabilitetin e ekonomisë sonë. Ne mund ta përdorim në mënyrë të dobishme këtë informacion si pikënisje për hartimin dhe zbatimin e një strategjie kombëtare për edukimin dhe përfshirjen financiare. Këta janë dy objektiva të rëndësishëm për bankën qendrore. Këta objektiva janë pozicionuar të marrin vëmendje qendrore pas kalimit të situatës së emergjencës dhe të ndjekin tendencë rritëse drejt digjitalizimit, prezantimit të instrumenteve financiare digjitale dhe prezantimit të mundshëm të monedhës digjitale të bankës qendrore. Rekomandimi im më i rëndësishëm është që kërkimi i kryer në bankën qendrore, të qëndrojë pranë interesit të bankës qendrore dhe të ketë vlerë praktike për politikëbërjen dhe vendimmarrjen për të arritur objektivat e tyre. Kjo duhet të vijë në mënyrë të natyrshme në hartimin e politikës dhe të ofrojë themele solide për politikën monetare dhe stabilitetin financiar.

“Rekomandimi im më i rëndësishëm është që kërkimi i kryer në bankën qendrore, të qëndrojë pranë interesit të bankës qendrore dhe të ketë vlerë praktike për politikëbërjen dhe vendimmarrjen për të arritur objektivat e tyre.”

E fundit, më vjen mirë të shoh se stafi ynë i kërkimeve ka përparuar në përvetësimin e teknikave më të sofistikuar të punës kërkimore. Gjithashtu, jam i kënaqur që përvetësimi i metodave kërkimore ka kaluar kufirin e Departamentit të Kërkimeve, dhe po përhapet mjaft mirë në departamentet e tjera. Ekonomistët tanë po bëjnë punë kërkimore të pavarur, në mbështetje të veprimtarisë së tyre të përditshme. Ky është rezultat i përpjekjeve tona të vazhdueshme për të rritur ndikimin e kërkimit në politikëbërje. Megjithatë, pa dyshim që është edhe rezultat i veprimtarive të tilla si ky seminar, të cilët i ofrojnë stafit tonë mundësinë të njohë punën e bërë nga akademikët dhe bankat e tjera qendrore.

Edhe nëse vini nga bota akademike apo nga bankat qendrore, jemi mirënjohës për interesin tuaj të vazhdueshëm dhe ju falënderojmë për pjesëmarrjen. Urojmë që ju e kolegët tuaj do të vazhdoni ta ndiqni seminarin tonë në të ardhmen, dhe me shpresë të plotë, në një botë pa COVID. E kështu, ne do të mund t’i rikthehemi mënyrës sonë tradicionale të organizimit të këtij aktiviteti dhe t’ju ofrojmë mundësinë të prezantoni punimet tuaja në Bankën e Shqipërisë, të angazhoheni me kërkimet tona këtu dhe t’ju prezantojmë Tiranën tonë të bukur.

Edhe një herë uroj më të mirën për të gjithë ju dhe punime të suksesshme seminarit!

MONITOR

E PERJAVSHME VITI I XX I BOTIMIT NR. 17 (930) - 11/MAJ/2020 Çmimi 300 lekë • 3 EURO

BIZNES • EKONOMI • TREG

 www.monitor.al

sjellja konsumatore
Ndryshimi pas Covid-19

Faqe 22

qendrat tregtare
Mbijetesa do varet nga markat

Faqe 31

ëndrra e diktatorëve
Pandemia, si mjet për rrëmbimin e pushterit

Faqe 45

TESTI I COVID-19

INTERVISTË E POSAÇME E GOVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, GENT SEJKO

KAPITULLI V

INTERVISTA

- *Intervistë e Guvernatorit Sejko për ABCNews, 12 mars 2020*
- *Intervistë e Guvernatorit Sejko për Top-Channel, 12 mars 2020*
- *Intervistë e Guvernatorit Sejko për televizionin News24, 12 mars 2020*
- *Intervistë e Guvernatorit Sejko për televizionin Euronews, 12 mars 2020*
- *Intervistë e Guvernatorit Sejko për emisionin "Opinion" në televizionin Klan, 12 mars 2020*
- *Intervistë e Guvernatorit Sejko për emisionin "Real Story" në televizionin News 24, 19 mars 2020*
- *Intervista e Guvernatorit Sejko për televizionin Klan, 26 mars 2020*
- *Intervistë e Guvernatorit Sejko për televizionin Vizion Plus, 31 mars 2020*
- *Intervistë e Guvernatorit Sejko për televizionin A2CNN, 1 prill 2020*
- *Intervistë e Guvernatorit Sejko për emisionin "Open" në Top Channel, 2 prill 2020*
- *Intervistë e Guvernatorit Sejko për emisionin "Ekopolitikë" në Ora News, 11 prill 2020*
- *Intervistë e Guvernatorit Sejko për emisionin "Opinion" në televizionin Klan, 7 maj 2020*
- *Intervistë e Guvernatorit Sejko për revistën Monitor, 11 maj 2020*
- *Intervistë e Guvernatorit Sejko për televizionin Ora News, 11 maj 2020*
- *Intervistë e Guvernatorit Sejko për televizionin Abc News, 20 maj 2020*
- *Intervistë e Guvernatorit Sejko për televizionin News24, 29 maj 2020*
- *Intervistë e Guvernatorit Sejko për emisionin "Përballë" në televizionin RTSH, 7 korrik 2020*

INTERVISTË E GUVERNATORIT SEJKO PËR ABC NEWS

- 12 mars 2020 -

Pyetje: Është marrë një vendim sot, të cilin do ta konsideroja mjaft të rëndësishëm si për bizneset ashtu edhe për individët, duke marrë parasysh situatën e krijuar nga COVID-19. Është vendosur një pezullim i kredive për 3 muaj. A mund të na shpjegoni përse u mor një vendim i tillë dhe çfarë synoni të arrini me të?

Guvernatori: Duke filluar nga java e kaluar, Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë një sërë masash, në përputhje me situatën e jashtëzakonshme që po kalojmë nga pandemia COVID-19, siç është shpallur dje nga Organizata Botërore e Shëndetësisë. Këto masa i kanë orientuar bankat tregtare të operojnë me klientët e tyre në kushte sa më optimale, në mënyrë që nga njëra anë të mos pengohen operacionet bankare dhe financiare dhe nga ana tjetër të ruhet shëndeti i punonjësve dhe klientëve të bankave.

“... masat e Bankës së Shqipërisë kanë orientuar bankat tregtare të operojnë me klientët e tyre në kushte sa më optimale në mënyrë që nga njëra anë të mos pengohen operacionet bankare dhe financiare dhe nga ana tjetër të ruhet shëndeti i punonjësve dhe klientëve të bankave.”

Përpara se të shpjegoj vendimin, dua të përfitoj nga rasti për t’u dhënë një mesazh të gjithë klientëve të bankave, individë dhe biznese: masat që kemi marrë dhe udhëzimet që kemi dhënë të mos perceptohen si vështirësi financiare apo mangësi në likuiditet nga ana e bankave. Bankat kanë likuiditet të mjaftueshëm; situata e tyre financiare është shumë e mirë; janë në gjendje të përballojnë gjithë aktivitetin normal. Masat e marra kanë lidhje me ruajtjen e shëndetit të klientëve dhe punonjësve të bankave. Për këtë arsye, bankat janë të detyruara të ruajnë distancat, të bëjnë dezinfektime dhe të zbatojnë të gjitha masat e nevojshme për t’u ruajtur nga virusi SARS-CoV-2. Masat janë shpërndarë në formën e një udhëzimi për bankat tregtare. Megjithatë, ndodh që për shkak të tyre të krijohen radhë dhe padashur edhe panik te klientët.

Sot, Këshilli Mbikëqyrës ka marrë një vendim, i cili prek gjithë individët dhe bizneset kredimarrëse në shlyerjen e kësteve të kredisë. Nëpërmjet një moratoriumi, kemi bërë një pezullim të shlyerjes së kësteve të kredisë. Kjo nuk do të thotë se këstet falen, por ato shtyhen për një periudhë tremujore. Ata klientë që kanë vështirësi në bizneset e tyre, janë prekur nga virusi apo kanë probleme të tjera si rrjedhojë e gjendjes së pandemisë, nuk do të jenë të detyruar t'i paguajnë këstet e kredisë gjatë kësaj periudhe. Gjithashtu, dua të theksoj se klientët që dëshirojnë të vijojnë normalisht me shlyerjen e kësteve të kredisë, mund ta bëjnë këtë lirisht.

Ne jemi duke e monitoruar situatën vazhdimisht me bankat tregtare. Edhe ne si Banka e Shqipërisë kemi marrë masa, duke punuar me staf të reduktuar, në përmbushje të direktivave të parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave. Gjithashtu, edhe bankat tregtare po punojnë me staf të reduktuar, me kapacitetet e domosdoshme për të siguruar operacionet normale financiare ditore në shërbim të klientëve. Kemi marrë masa që pagesat online dhe *cash* të jenë funksionale dhe të mos bëhen pengesë për funksionimin normal dhe mbarëvajtjen e jetës së qytetarëve.

Pyetje: A do të vijojnë të funksionojnë sportelet e bankave tregtare? Ju e përmendët që ka një reduktim të personelit. A do të vijojnë këto sportele të jenë të hapura apo kjo do të varet nga situata?

Guvernatori: Sigurisht që kjo do të vendoset duke monitoruar në mënyrë të kujdesshme situatën në vijim, por bankat do të vazhdojnë të jenë të hapura. Është vendosur që aktiviteti të ndërpritet për tre ditë, dhe në vijim të vendimit të Këshillit të Ministrave për masat e emergjencës, ato do të respektohen edhe nga sistemi bankar. Kjo do të thotë që ditën e nesërme bankat dhe Banka e Shqipërisë do të jenë të mbyllura, ashtu si institucionet e tjera shtetërore. Megjithatë, janë marrë masa që sistemi i pagesave të funksionojë normalisht, online dhe *cash*. Bankat do të sigurojnë *cash*-in e nevojshëm për qytetarët, për të kryer pagesa të ndryshme. Gjithashtu, pagesat mund të kryhen edhe nëpërmjet kartave bankare të debitit ose kreditit. Kartat e debitit nuk shoqërohen me komisione dhe pjesa më e madhe e qytetarëve shqiptarë disponojnë një kartë të tillë. Nuk parashikojmë të përballemi me ndonjë anomali në veprimtarinë financiare të kryerjes së pagesave. E rëndësishme është t'i minimizojmë sa më shumë kontaktet me njëri-tjetrin, pasi jemi ende në fillimin e një situatë të jashtëzakonshme sa i përket shëndetit publik, përfundimi i të cilës është ende i panjohur. Institucionet e shëndetit

publik janë duke punuar në mënyrë intensive për të identifikuar rastet. Megjithëse po përballemi me një situatë jashtë të zakonshmes, mbetet e rëndësishme të ruhemi nga paniku. Duhet të jemi të organizuar dhe praktikë; të vazhdojmë jetën normalisht duke zbatuar me përpikëri masat mbrojtëse.

Pyetje: Sa do të ndikojë kjo situatë në ecurinë ekonomike? A do të kemi një rishikim në ulje të rritjes ekonomike për këtë vit?

Guvernatori: Patjetër që situata që po kalojmë do të ketë një efekt negativ në rritjen ekonomike të vendit dhe jo vetëm. Sot shohim që ekonominë e mëdha kanë pësuar miliona dhe miliarda euro, paundë dhe dollarë humbje; bursat dhe tregjet ndërkombëtare janë ndikuar thellë. Shifrat janë alarmante. Ekonomia shqiptare është një ekonomi e vogël, por e hapur. Ekonomia jonë do të ketë efektet e saj - goditje të jashtme dhe të brendshme - por nuk mund të themi ende se sa do të jetë ndikimi në rritjen ekonomike. Ne si Banka e Shqipërisë po bëjmë analizat dhe skenarët tanë, të cilët do të prezantohen në mbledhjen e radhës të Këshillit Mbikëqyrës, e cila do të mbahet pas disa ditësh, ku do të merret vendimi i duhur për politikën monetare. Ajo që mund të theksoj, është se politika jonë monetare do të vijojë të jetë lehtësuese dhe stimuluese për konsumin, kreditimin dhe investimet. Ne po marrim masa makroprudenciale për të ruajtur stabilitetin e çmimeve dhe atë financiar, në funksion të detyrimeve tona ligjore.

Një avantazh që vlen të theksohet është fakti që bankat janë me tepriçë likuiditeti, në gjendje të mirë financiare, me tepriçë kapitali mbi nivelin e mjaftueshëm të kërkuar. Pra, ne nuk parashikojmë probleme e aq më pak një krizë në sistemin financiar, por një rënie të ritmit të rritjes ekonomike. Se sa do të jetë kjo rënie, do të varet nga analiza. Këto parashikime i përkasin gjashtëmujorit të parë të vitit. Parashikojmë që efektet e kësaj epidemie do të adresohen në këtë gjashtëmujor. Në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës do të kemi dhe shifra më të sakta dhe do të marrim vendimet e duhura, të cilat do të bëhen publike si zakonisht nëpërmjet deklaratës për shtyp të politikës monetare. Nuk parashikojmë që ekonomia jonë të bjerë në recesion, por mund të kemi një rënie të ritmit të rritjes ekonomike.

“Një avantazh që vlen të theksohet është fakti që bankat janë me tepriçë likuiditeti, në gjendje të mirë financiare, me tepriçë kapitali mbi nivelin e mjaftueshëm të kërkuar. Pra, ne nuk parashikojmë probleme dhe aq më pak një krizë në sistemin financiar, por një rënie të ritmit të rritjes ekonomike.”


Pyetje: A mund të kemi një rishikim tjetër të normës së interesit?

Guvernatori: Natyrisht që dhe kjo është një mundësi. Lehtësimi i politikës sonë monetare ka vazhduar dhe aktualisht kemi normën bazë të interesit më të ulët historike, në nivelin 1%. Transmetimi i politikës sonë monetare kufizohet dhe nga elemente të tjera siç është shkalla e lartë e euroizimit në ekonomi. Megjithatë, politika jonë monetare ka pasur një transmetim të mirë në të gjitha segmentet e tregut financiar. Ka ende hapësirë, megjithëse të kufizuar, për të vazhduar me lehtësimin e politikës monetare. Nuk mund të them se çfarë qëndrimi do të mbajmë, pasi ky është një vendim që i përket Këshillit Mbikëqyrës. Ne jemi ende duke analizuar skenarët, të cilët po evoluojnë shumë shpejt dhe ditë pas dite kemi rezultate të reja për treguesit makroekonomikë. Në rast se do të jemi të detyruar të bëjmë një lehtësim të mëtejshëm të politikës monetare, natyrisht që do ta ndërmarrim dhe këtë hap. Megjithatë, është ende herët për të dalë në konkluzione. E rëndësishme është të ruajmë stabilitetin e çmimeve, pasi ky është dhe objektivi kryesor ligjor i Bankës së Shqipërisë. Duhet të ruajmë parametrat kryesorë makroekonomikë; të ruajmë stabilitetin financiar në vend. Siç e theksova, gjendja financiare e vendit është e qëndrueshme dhe likuide. Banka e Shqipërisë do të marrë të gjitha masat, nëpërmjet politikës monetare dhe jo vetëm, për ruajtjen e stabilitetit financiar të vendit, në mënyrë që kjo periudhë të ketë efekte sa më minimale tek qytetarët shqiptarë.

Pyetje: Çfarë ndikimi mund të ketë tek konsumi e gjithë kjo situatë?

Guvernatori: Ne jemi të ndërgjegjshëm se masat për mbrojtjen e popullatës do ta ndikojnë domosdoshmërisht konsumin; konsumi preket i pari. Në rast se do të mbyllen dyqanet, aktivitetet tregtare, bizneset – mbyllje e pashmangshme kjo pasi jeta e qytetarit është gjithnjë në plan të parë - sigurisht që dhe konsumi do të ndikohet. Konsumi ndikon prodhimin, pasi këto janë elemente zinxhir. Kjo situatë krize do të godasë shumë dhe turizmin, i cili lidhet gjithashtu me konsumin. Jemi para sezonit turistik dhe nuk e dimë se sa do të zgjasë kjo situatë. Të gjitha janë parashikime, por përsëris se do të kemi një rënie të ritmit të rritjes ekonomike dhe ne si bankë qendrore do të reagojmë në varësi të rezultateve të analizave tona.

Grafik 27. Ecuria e konsumit privat




Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Pyetje: Do të jetë ndikimi i vetë krizës që do të krijojë në Shqipëri apo duke pasur parasysh që kjo mund të jetë dhe një krizë globale a do t'i mbivendoset kriza e tregjeve dhe kostove tona reale?

Guvernatori: Në analizat tona, ne gjithmonë marrim parasysh skenarët e rrezikut, të cilët përfshijnë faktorë të brendshëm dhe të jashtëm. Faktorët e brendshëm mund të jenë rënia e konsumit, rënia e turizmit dhe faktorë të tjerë që ndikohen nga kjo situatë. Faktorët e jashtëm mund të jenë situata e vështirë në Eurozonë dhe në veçanti në Itali, e cila është një nga partnerët tanë kryesorë. Të rëndësishme gjithashtu janë prurjet nga remitancat dhe ne do të vëzhgojmë me kujdes se si do të ndikohen ato nga pandemia. Mund të kemi dhe një rënie të tyre, pasi situata do të jetë e vështirë dhe për emigrantët shqiptarë; do të thosha se ekonomia shqiptare do të ketë skenarë rreziku, duke marrë parasysh situatën në vendet partnere, sidomos në Eurozonë. Të gjitha këto do të merren në konsideratë në analizën që Banka e Shqipërisë po bën dhe do të ndikojnë në vendimmarrjen e politikës monetare, për një ulje të mëtejshme të normës bazë të interesit - ndoshta për të shtuar likuiditetin në treg - ose masa të tjera konvencionale ose jokonvencionale që bankat qendrore i përdorin në këto raste.

Grafik 28. Dërgesat e emigrantëve (flukse neto, në milionë euro)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

E rëndësishme është të shmangim panikun. Duhet të jemi të organizuar mirë dhe të respektojmë masat e mbrojtjes së shëndetit publik.

Pyetje: Sot biznesi shqiptar - më saktë kreu i Dhomës së Tregtisë - ka kërkuar nga qeveria lehtësira për biznesin. Çfarë mendimi keni për këtë?

Guvernatori: Kërkesa kryesore që unë kam parë nga biznesi është ajo për të cilën ne kemi reaguar në mënyrë të menjëhershme, pra për një shtyrje të shlyerjes së kredive në një afat tremujor. Në dijeninë time, nuk ka pasur kërkesa të tjera për tregun monetar, e sidomos për Bankën e Shqipërisë. Ndërsa sa i përket kërkesave të tjera, ato janë në juridiksionin e Ministrisë së Financave dhe besoj se ky institucion ka reaguar dhe i ka adresuar ato. Gjatë kësaj periudhe, ne kemi qenë të fokusuar tek detyrimet tona ligjore dhe masat që janë brenda fushës sonë të veprimit, në koordinim dhe me Qeverinë Shqiptare. Sot kam komunikuar me Ministren e Financave dhe ajo më informoi se janë duke punuar që t'i përgjigjen sa më mirë kërkesave të biznesit.

INTERVISTA E GUVERNATORIT SEJKO PËR TELEVISIONIN TOP CHANNEL

- 12 mars 2020 -

Pyetje: Për të gjithë qytetarët që këto ditë duhet të shkojnë t'i paguajnë këstet e kredive, ndërkohë që e gjithë jeta e tyre ekonomike dhe sociale është paralizuar, çfarë duhet të bëjnë?

Gubernuratori: Banka e Shqipërisë ka marrë të gjitha masat e nevojshme që të kemi vazhdimësi normale të pagesave online dhe *cash*, si dhe të mos ketë probleme për qytetarët për tërheqjet e parasë *cash* nga ATM-të. Gjithashtu, kemi udhëzuar bankat se si duhet të veprojnë lidhur me operacionet e tyre ditore që të mos krijojnë vështirësi për klientët, që t'i orientojnë ata të përdorin sa më shumë kartat bankare, pasi kjo jo vetëm që i lehtëson pagesat, por përbën gjithashtu dhe një masë mbrojtëse kundër infeksioneve.

Sot, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë ka marrë një vendim për të gjithë klientët kredimarrës, biznese dhe individë. Nëpërmjet një forme moratoriumi, ka bërë një pezullim për shlyerjen e kësteve të kredisë për një afat tremujor. Kjo do të thotë që klientët, gjatë këtij afati, mund të zgjedhin t'i paguajnë ose jo këstet e kredisë. Ata që nuk do të jenë në gjendje, për arsye shëndetësore ose vështirësi biznesi, mund të mos paraqiten pranë bankës dhe kësti i tyre do të shtyhet me tre muaj, pa i rënduar me interesa vonesash. Ndërkohë, dua të bëj të qartë që klientët e tjerë të cilët dëshirojnë të vijojnë të kryejnë normalisht pagesat e tyre, janë të lirë ta bëjnë këtë. Ky vendim hyn në fuqi duke filluar nga dita e nesërme.

“Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë ka marrë një vendim për të gjithë klientët kredimarrës, biznese dhe individë. Nëpërmjet një forme moratoriumi ka bërë pezullim për shlyerjen e kësteve të kredisë me një afat tremujor.”

Banka e Shqipërisë po e monitoron ngushtë situatën e sistemit bankar dhe atij financiar në vend. Nga dita e djeshme, kemi udhëzuar në mënyrë të detajuar bankat se si duhet të veprojnë në këtë situatë, në mënyrë që të marrin masat e duhura për të ruajtur shëndetin e punonjësve dhe të klientëve, por nga ana tjetër të vazhdojnë punën e tyre operacionale pa krijuar turbulenca.

Duke përfituar nga rasti, do të doja të theksoja që sistemi bankar vazhdon të ketë gjendje shumë të mirë likuiditeti. Ai është i mirëkapitalizuar dhe plotësisht në gjendje t'iu shërbejë nevojave të klientëve. Këto janë situata që duhen menaxhuar me durim, pa panik, me organizim të mirë, me praktikitet dhe devotshmëri. Ne jemi në koordinim të vazhdueshëm me bankat e nivelit të dytë, dhe nuk kemi vënë re probleme të mundshme.

Do të doja të theksoja gjithashtu që klientët e bankave nuk duhet të bien pre e panikut. Duhet të dimë se nëse bankat u shërbejnë klientëve një nga një në ambientet e tyre, kjo nuk bëhet për shkaqe vështirësish financiare, por për arsye të ruajtjes së shëndetit të klientëve. Pra, në qoftë se ruajtja e distancave dhe zbatimi i masave mbrojtëse krijojnë radhë në sportele, kjo nuk do të thotë që banka ka vështirësi për kryerjen e pagesave, por se po merren masa për të ruajtur shëndetin e punonjësve dhe atë të klientëve.

Pyetje: Zoti Guvernator, koronavirusi mendohet që do të ketë efekte shumë të rënda mbi ekonominë botërore. A ka një parashikim se çfarë mund të ndodhë me Shqipërinë?

Guvernatori: Kjo është një pyetje me vend. Ne jemi duke marrë në analizë të gjithë skenarët e mundshëm të ndikimit të pandemisë në ekonomi. Në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë që do të zhvillohet pas pak ditësh, do të paraqesim rezultatet e analizave tona dhe do të marrim vendime në përputhje me to. Jemi përgatitur me instrumentet e nevojshme që na jep Ligji "Për Bankën e Shqipërisë", për të ruajtur stabilitetin e çmimeve dhe stabilitetin financiar të vendit. Politika jonë monetare do të vazhdojë të mbetet lehtësuese në drejtim të stimulimit të konsumit dhe investimeve. Gjithashtu, me masa makro dhe mikroprudenciale, do të menaxhojmë situatën në sistemin bankar. Natyrisht, mund të kemi përkeqësime të disa treguesve, si në rastin e kredive me probleme ashtu edhe në tendencat e kreditimit. Këto janë situata të jashtëzakonshme, të cilat patjetër do të ndikojnë negativisht në ekonomi. Shohim që ekonominë botërore kanë miliardat dhe trilionët euro humbje dhe kjo do të ndikojë domosdoshmërisht edhe në ekonominë shqiptare. Megjithatë, nuk duhet të krijojmë panik; duhet të jemi të qetë, të organizuar dhe të reagojmë me instrumentet e duhura.

"... Jemi përgatitur me instrumentet e nevojshme që na jep ligji "Për Bankën e Shqipërisë" për të ruajtur stabilitetin e çmimeve dhe stabilitetin financiar të vendit."

Në këtë moment, nuk kemi shifra të sakta të ndikimit të krizës së shkaktuar nga pandemia në ekonominë shqiptare, pasi jemi ende duke analizuar, por mund t'ju them se efekti do të jetë negativ, sikundër ka qenë në të gjitha ekonomitë botërore. Nuk parashikojmë të biem në recesion, por mund të kemi ulje të ritmit të rritjes ekonomike. Ky parashikim është për gjashtëmuorin e parë të vitit, sepse mendojmë që pandemia do të ndikojë vetëm këtë periudhë. Sot, analizat dhe skenarët janë të papërfunduar dhe nuk mund të themi me saktësi se ku jemi, por në mbledhjen e radhës të Këshillit Mbikëqyrës do të marrim vendime, të cilat do t'i bëjmë publike.

INTERVISTË E GUVERNATORIT SEJKO PËR TELEVISIONIN NEWS24

- 12 mars 2020 -

Pyetje: Përse u detyruat të merrnit një vendim të tillë dhe cilat janë detajet shoqëruese të tij?

Guvernatori: Ne jemi të gjithë të ndërgjegjshëm për situatën e jashtëzakonshme, në të cilën gjendemi. Banka e Shqipërisë e ka analizuar vazhdimisht situatën që në fillimet e epidemisë. Që nga fillimi i kësaj jave, kemi shpërndarë udhëzime në bankat e nivelit të dytë, për t'i orientuar në marrjen e masave të duhura, në mënyrë që aktiviteti operacional të vazhdojë pa krijuar problem, pra pa ndërprerje, gjithnjë duke ruajtur shëndetin e punonjësve dhe të klientëve të bankave të nivelit të dytë.

Në këtë kontekst, dua të theksoj që këto masa që kanë të bëjnë me ruajtjen e distancës, higjienizimin për shmangien e rrezikut të virusit, ndoshta do të krijojnë radhë klientësh përpara ambienteve të bankave dhe kjo mund të krijojë ide të gabuara ose pasiguri te klientët sa i përket gjendjes financiare të bankave. Unë dëshiroj t'ju siguroj se bankat janë në gjendje shumë të mirë likuiditeti.

Kriza me të cilën përballemi sot është shëndetësore dhe jo financiare, por sigurisht që pasojat në ekonomi do të maten në vijim. Për momentin, ne kemi marrë masa që sistemi bankar të vazhdojë funksionimin e tij, me kufizimet e duhura, duke respektuar me rigorozitet masat për ruajtjen e shëndetit, dhe duke mbetur operacionalë. Janë marrë masa për sigurimin e pagesave cash dhe atyre online, në mënyrë që tregu të funksionojë normalisht, dhe çka është më e rëndësishmja, sot Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë ka vendosur të bëjë një shtyrje apo një riskedulum të kësteve të kredive për tre muaj, duke shpresuar që gjendja e pandemisë - siç u shpall dje nga OBSH-ja - në tre muaj kohë do të ketë kaluar.

“Kjo periudhë tremujore nuk do të krijojë probleme për bankat dhe Këshilli Mbikëqyrës e mori këtë vendim pikërisht që ato të mos rëndohen me provigjione ose me kufizime sipas rregulloreve.”

Pyetje: Kjo periudhë tremujore nuk do të krijojë problem për bankat? A e keni studiuar situatën?

Gubernatori: Jo, nuk do të krijojë probleme për bankat dhe Këshilli Mbikëqyrës e mori këtë vendim pikërisht që ato të mos rëndohen me provigjione ose me kufizime sipas rregulloreve. Pra i kemi çliruar bankat nga kufizimet tona rregullative, në mënyrë që ato t'ia krijojnë këtë fleksibilitet klientëve - individë apo biznese - për pagesat e kësteve të kredive. Kjo nuk krijon asnjë problem për bankat, por është bërë për të ndihmuar klientët, për të mos e rënduar gjendjen e tyre financiare, në këtë moment të vështirë për shëndetin publik. Ne synojmë t'u ofrojmë atyre lehtësi, në rast se do ta kenë të pamundur të bëjnë pagesat e kësteve në këta tre muaj.

Pavarësisht kësaj, ata klientë që janë në një gjendje të mirë financiare dhe kanë mundësi pagese, mund të vazhdojnë t'i paguajnë këstet sipas skedulit të tyre.

Dua të theksoj dhe se ky vendim nuk i fal këstet, por thjesht i risedulon ato; është një shtyrje dhe një falje e interesvonesave dhe jo falje e kësteve të kredisë.

Pyetje: Zakonisht ndodh që kur dikujt i kalon paga mujore, automatikisht i merren paratë për kredinë. A do të vazhdojë të ndodhë normalisht kjo, pavarësisht këtij vendimi që ju keni marrë?

“Bankat do të jenë të gatshme për t’i shtyrë pagesat për ata klientë, individë apo biznese, që mund të kenë vështirësi financiare këto tre muaj.”

Gubernatori: Patjetër, edhe vetë klientët janë të interesuar të ndjekin skedulin e pagesave, pra kjo do të vazhdojë normalisht. Kjo masë është marrë kryesisht për ata klientë që kanë vështirësi dhe e kanë të pamundur të shkojnë në sportelet e bankës, për arsye shëndetësore ose për arsye financiare. Gjithashtu, edhe kjo masë është marrë në morinë e masave mbrojtëse për mospërhapjen e virusit, për të zvogëluar sa më shumë të jetë e mundur kontaktet midis njerëzve. Pra, kjo jo vetëm që krijon një lehtësi tek individët dhe bizneset, por në njëfarë mënyre, do të ulë dhe numrin e klientëve në sportelet e bankave të nivelit të dytë.

Ne po përpiqemi të marrim masa që aktiviteti bankar të vijojë, por nga ana tjetër të ketë sa më pak kontakte midis njerëzve. Shpresojmë që

pandemia të mos avancojë në ato përmasa sa të detyrohemi të marrim masa edhe më kufizuese.

Pyetje: Nëse situata përkeqësohet, a mund të shkohet deri në mbylljen e bankave?

Guvernatori: Kjo varet nga vendimet që do të marrë Komiteti i Emergjencës i Qeverisë Shqiptare. Nuk mendoj se do të arrijmë deri në mbylljen e bankave, megjithatë kjo nuk mund të thuhet me siguri. Të gjithë ne duhet të përiqemi të shmangim panikun dhe të marrim masa parandaluese, në mënyrë që ta izolojmë sa më shumë virusin, të mbrojmë sa më shumë njerëzit, pa ndalur plotësisht aktivitetin e përditshëm.

Pyetje: Ju thatë pak më parë se punonjësit e bankave gjithsesi po kujdesen për të mos e përhapur virusin. Po kujdesen për veten si dhe për të tjerët, duke marrë masat mbrojtëse të shpallura nga Ministria e Shëndetësisë dhe jo vetëm. A keni ju informacion nëse ka nëpunës bankash të prekur me COVID-19 apo në vetëkarantinim?

Guvernatori: Deri tani nuk kemi asnjë punonjës të prekur nga COVID-19 në Bankën e Shqipërisë. Ndërsa informacioni lidhur me punonjësit e bankave të nivelit të dytë më mungon. Nëse do të kishte raste të tilla, këtë informacion do ta kishit dhe ju, pasi rastet janë të gjitha të identifikuara. Megjithatë, nuk dimë nëse do të vijojë të jetë kështu edhe në ditët në vijim. Vlen të theksojmë rëndësinë e respektimit rigoroz të masave parandaluese për të shmangur përhapjen e virusit, të cilat nuk është e nevojshme t'i përsëris pasi janë vazhdimisht në ekranet e televizionit – dhe gjëj rastin t'i falënderoj mediat për këtë shërbim që po i bëjnë publikut.

Pyetje: Të gjithë bashkë, siç thotë dhe Kryeministri, jemi duke luftuar armikun e padukshëm për të mbrojtur shëndetin e popullatës. 23 njerëz gjithsesi janë prekur deri tani nga COVID-19 dhe mund të ketë edhe prekje në një numër më të madh.

E kuptoj që nuk është momenti për të bërë këtë lloj analize, por për hir të së vërtetës ne e kemi bërë këtë përpara se virusi të mbërrinte në vendin tonë, pasi kemi parë historitë e vendeve fqinje, ku është thënë se ky problem që godet shëndetin e popullatës, herët a vonë reflektohet në ekonominë e vendit dhe gati-gati e gjunjëzon atë.

Ju u shprehët se nuk është momenti, por gjithsesi ju do ta bëni këtë lloj analize. Unë jam e bindur që ju, në njëfarë forme, e keni bërë

këtë. A mund të më tregoni se sa goditet ekonomia shqiptare nga pandemia COVID-19?

Guvernatori: Është e vërtetë që ne kemi filluar të analizojmë. Detyra jonë është të analizojmë ndikimin e kësaj situatë në ekonominë shqiptare, ndikim i cili natyrisht do të jetë negativ.

Po shohim që ekonomi të tjera, bursat dhe tregjet ndërkombëtare, kanë pësuar humbje në miliarda dhe trilionë euro, pra është e qartë se edhe ekonomia jonë do të preket nga efektet e kësaj situatë. Kjo është një gjendje e jashtëzakonshme që do të ndikojë konsumin, dhe nëse kjo ndodh, edhe prodhimi do të ketë ndikimet e veta.

Shohim që ndërmarrjet fasone po hasin vështirësi serioze, si pasojë e kontratave të porosive. Gjithashtu, presim një ndikim negativ në sezonin turistik, e kështu me radhë. Natyrisht që efektet janë ciklike. Ekonomia do të ketë pasoja, megjithatë nuk parashikojmë që të bjerë në recesion, por të kemi rënie të ritmit të rritjes ekonomike. Për momentin nuk kam shifra të sakta, pasi po analizojmë skenarët.

Në ditët e ardhshme do të zhvillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit Mbikëqyrës në të cilën do të merren dhe vendimet reaguese nga Banka e Shqipërisë, në funksion të detyrimeve tona ligjore.

“Nëpërmjet politikës tonë monetare lehtësuese, ne do të vazhdojmë të stimulojmë konsumin, investimet, kreditimin. Do ta gjykojmë nëse do të kemi nevojë për të vazhduar lehtësimin e politikës monetare, në varësi të analizave dhe rezultateve.”

Detyrimi jonë kryesor është stabiliteti i çmimeve. Nëpërmjet politikës sonë monetare lehtësuese, ne do të vazhdojmë të stimulojmë konsumin, investimet, kreditimin. Do ta gjykojmë nëse do të kemi nevojë për të vazhduar lehtësimin e politikës monetare, në varësi të analizave dhe rezultateve.

Nga krahu tjetër, lajmi i mirë dhe pozitiv është që sistemi bankar dhe sistemi financiar është me tepricë likuiditeti, me gjendje mjaft të shëndetshme, me kapital të mjaftueshëm. Pra,

nuk kemi probleme likuiditeti dhe kapitalesh.

Në këtë situatë, do të shikojmë ndikimin që do të ketë në ritmin e rritjes ekonomike, në konsum, në turizëm. Natyrisht që do të marrim masat e duhura - masat kundërciklike - për ta neutralizuar sa më shumë që të jetë e mundur këtë ndikim.

Duhet të jemi të përgatitur për një rënie të ritmit të rritjes ekonomike; sa do të jetë rënia, nuk mund ta them tani, por gjithsesi nuk parashikojmë recesion. Disa vende, si p.sh. Italia – pasojat e pandemisë në ekonominë e të cilës po i shohim të gjithë – do të përjetojnë recesion.

Në këtë fazë të hershme, parësore për ne mbetet parandalimi i përhapjes së virusit. Pas analizave natyrisht që do të ndërmarrim edhe reagimet e duhura, por sa më rigorozë të jemi në respektimin e masave parandaluese, aq më të vogla do të jenë dhe efektet në ekonomi në të ardhmen. Kjo është gjithçka që mund të themi për momentin.

Pyetje: Ju thoni se ekonomia shqiptare nuk do të shkojë në recesion. Megjithatë, nëse marrim skenarin më të keq dhe ne shkojmë në recesion, pasi askush nuk e di se sa do të zgjasë situata me COVID-19, a i kemi ne mekanizmat për t’u rimëkëmbur?

Guvernatori: Sigurisht që po, por nuk kemi ende shifra të sakta. Kjo lidhet me parashikimet konkrete të institucioneve të shëndetit publik për përhapjen e virusit. Megjithatë, nuk parashikojmë që të arrijmë në nivele ku mund të kishim nevojë për mekanizma të tjerë. Mekanizmat që ne kemi, janë të mjaftueshëm për të ndikuar në masat kundërciklike për stimulimin e rritjes ekonomike dhe për ruajtjen e stabilitetit financiar në vend.

“Mekanizmat që ne kemi, janë të mjaftueshëm për të ndikuar në masat kundërciklike për stimulimin e rritjes ekonomike dhe për ruajtjen e stabilitetit financiar në vend.”

Dëshiroj të theksoj që ne i kemi këta mekanizma, pra të mos krijojmë panik. Është shumë e rëndësishme që të kemi një situatë të qetë, të mos krijojmë panik dhe të tregohemi të kujdesshëm që të veprojmë në mënyrë të organizuar.

Për momentin, ne kemi marrë parasysh dhe po studiojmë disa skenarë pozitivë dhe negativë. Sipas analizave tona dhe skenarëve negativë, ne disponojmë të gjitha instrumentet e duhura për të reaguar në rast përkeqësimi ekonomik, megjithëse skenarët negativë kanë pak gjasa të kthehen në realitet.

Pyetje: Punonjësit e bankave të nivelit të dytë u thonë klientëve të tyre se bankat shumë shpejt do të mbyllën, madje disa thonë se do të mbyllën dhe që nesër.

Guvernatori: Sipas një vendimi të Këshillit të Ministrave për të mbyllur

gjithë institucionet e administratës publike, edhe bankat do të mbyllen ditën e nesërme. Siç e dimë, jemi në momentin e përhapjes së një pandemie, dhe ne si bankë qendrore kemi marrë masa që pagesat e *cash-it* dhe ato online të jenë funksionale. Pra, mbyllja e bankave nuk do të sjellë probleme. Ato po mbyllen për të shmangur kontaktet midis njerëzve dhe pagesat nëpërmjet kartave dhe *cash-it* të tërhequr nga ATM-të do të vijojnë pa asnjë lloj problemi. Ditën e martë, aktiviteti bankar do të vijojë dhe sigurisht që bankat do të jenë funksionale.

Situata nuk duhet të keqkuptohet, pra masat po merren për çështje që lidhen me shëndetin publik.

Pyetje: Ju jeni takuar me Presidentin e Republikës, a mund të më thoni se çfarë është diskutuar midis jush?

Guvernatori: Po, sot në mëngjes pata një takim me Presidentin e Republikës, me kërkesë të tij. E kam informuar Presidentin lidhur me analizat që po bëhen nga Banka e Shqipërisë mbi ndikimet që do të ketë situata e pandemisë COVID-19, në ekonomi dhe në sistemin financiar.

“Situata është nën kontroll, Banka e Shqipërisë disponon instrumentet e nevojshme, sistemi bankar është likuid dhe i mirëkapitalizuar. Po merren të gjitha masat për të parandaluar çdo lloj problematike.”

Kam theksuar të njëjtat gjëra që po theksoj dhe në këtë intervistë. Pra që: situata është nën kontroll; Banka e Shqipërisë disponon instrumentet e nevojshme; sistemi bankar është likuid dhe i mirëkapitalizuar; po merren të gjitha masat për të parandaluar çdo lloj problematike.

Presidenti vlerësoi punën e Bankës së Shqipërisë. Ishte një bisedë informative dhe raportuese, për të cilën dhe vetë Presidenca ka bërë një deklaratë për shtyp, duke bërë

publike konkluzionet e takimit.

INTERVISTË E GUVERNATORIT SEJKO PËR TELEVISIONIN EURONEWS ALBANIA

- 12 mars 2020 -

Pyetje: Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë ka vendosur sot që të ketë një pezullim të pagesës së kredive për të gjithë debitorët. Vendimi është marrë në kuadër të masave të vendosura nga qeveria për të parandaluar përhapjen e COVID-19. Banka e Shqipërisë njofton gjithashtu se anulon dhe disa aktivitete edukative të Javës së Parasë të parashikuara për t'u organizuar në datat 23-29 mars. Çfarë nënkupton ky vendim për të pezulluar tre muaj pagesat e kredive për ata shtetas apo biznese që kanë kredi. Pse arritët në këtë vendim dhe cilat janë kategoritë që preken nga ky pezullim?

Gubernur: Ky vendim u mor sot nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, në kuadër të masave të ndërmarra për të përballuar situatën aktuale. Ndërsa dje ne kemi shpërndarë udhëzime të qarta për të gjitha bankat e nivelit të dytë, sa i përket mënyrës së operimit në kushtet e kësaj situatë të jashtëzakonshme. Udhëzimet tona parashikojnë që bankat të punojnë me një numër të kufizuar punonjësish, duke marrë masat e duhura parandaluese për mbrojtjen e punonjësve dhe klientëve, por pa ndërprerë operacionet bankare.

“Udhëzimet tona parashikojnë që bankat të punojnë me një numër të kufizuar punonjësish, duke marrë masat e duhura parandaluese për mbrojtjen e punonjësve dhe klientëve, por pa ndërprerë operacionet bankare.”

Në lidhje me pyetjen tuaj konkrete, sot Këshilli Mbikëqyrës mori një vendim për riskedulimin e kësteve të kredisë, pra për një shtyrje të këtyre kësteve për të gjitha kategoritë e klientëve, si individë ashtu edhe biznese, për një afat tremujor. Ne jemi të ndërgjegjshëm që, në këtë situatë, shumë biznese janë mbyllur – kjo vlen veçanërisht për bizneset e vogla, barkafetë, restorantet, por pa përjashtuar bizneset e mëdha - dhe në këtë situatë të vështirë të krijuar nga masat shtrënguese, synojmë të lehtësojmë “frymëmarrjen” e biznesit. Kjo bëhet njëkohësisht dhe për të ulur numrin e kontakteve në sportelet e bankave të nivelit të dytë. Në këtë aspekt, dua të theksoj që nuk ka falje të kësteve të kredisë, por thjesht një shtyrje apo një riskedulim me tre muaj të pagesave të kredive. Njëkohësisht, dëshiroj të sqaroj se klientët që duan të kryejnë pagesat

e kredive si zakonisht, mund të vazhdojnë ta bëjnë këtë; bankat janë të hapura dhe të disponueshme për të vazhduar marrëdhëniet normale. Ne si Bankë e Shqipërisë kemi lehtësuar kriteret tona rregullative për rastet e vonesave - pra kemi bërë një moratorium – duke mos i rënduar kredimarrësit me interesvonesa për pagesat e kësteve të kredisë.

Pyetje: Çfarë ndodh mbas këtyre tre muajve? Fillon pagesa e tre muajve që kanë mbetur apo e tre muajve bashkë? Çfarë do të ndodhë kur të kalojë kjo periudhë?

Gubernatori: Pas kësaj periudhe tremujore, rifillon pagesa e kredisë sipas skedulit normal. Pra, afati i maturimit dhe skeduli i pagesave shtyhet me tre muaj. Janë po të njëjtat këste dhe po e njëjta sasi kredie për t'u paguar, thjesht skeduli i pagesave shtyhet me tre muaj.

Pyetje: Po ndërkohë, a duhet të ketë lehtësi?

Gubernatori: Bankat nuk rëndohen me provigjione. Lehtësia është që nuk do të rëndohen me interesvonesa.

Pyetje: A duhet të ketë lehtësi dhe për detyrime të tjera që ata kanë? Qira, tarifa për ujin, për energjinë gjatë këtyre tre muajve apo dhe më shumë?

Gubernatori: Gjykoj se duhet të ketë, por kjo është pjesë e punës së Qeverisë Shqiptare dhe jo e Bankës së Shqipërisë ose bankave të nivelit të dytë. Jam i sigurt që qeveria po shqyrton masat për të krijuar lehtësi për individët dhe për bizneset, por lidhur me këtë nuk mund t'ju jap një përgjigje konkrete. Iu përgjigja konkretisht pyetjes tuaj lidhur me një vendimmarrje të sotme që ka të bëjë me bankat e nivelit të dytë dhe me klientët kredimarrës, të cilët nuk janë pak.

Pyetje: Z. Gubernator, Kryetari i Partisë Demokratike, z. Basha, i ka bërë thirrje bankave që të japin kredi me interesa të ulëta. A vlen të trajtohet kjo ide?

Gubernatori: Nuk kisha dijeni mbi këtë deklaratë, por mund të them se bankat kanë planet e tyre të biznesit. Ato janë institucione private dhe njësoj si gjithë institucionet e tjera, do të marrin në konsideratë çdo lloj mundësie, sigurisht pa prekur përfitimet ose të ardhurat e tyre. Nuk e di konkretisht se çfarë është thënë apo kërkuar, por di që dje Kryetari i Partisë Demokratike e ka ngritur këtë shqetësim, sikurse e kanë ngritur

edhe shoqatat e biznesit. Vetë Shoqata Shqiptare e Bankave e ka diskutuar më parë me mua çështjen e një shtyrjeje tremujore, por lidhur me uljen e normave të interesit apo lehtësira të tjera nuk është diskutuar ende. Ajo që mund të them është se politika jonë monetare lehtësuese i ka ulur në maksimumin e mundshëm normat e interesit. Kemi një transmetim të politikës monetare në të gjitha segmentet e tregut financiar, në interesat e kredive, depozitave ashtu dhe të bonove të thesarit. Në këtë kontekst, duke pasur parasysh situatën e krijuar nga pandemia dhe pasojat që ajo mund të ketë në ekonomi - për të cilat ne jemi duke bërë analizat tona dhe duke parashikuar skenarët - ne si bankë qendrore patjetër që do të vazhdojmë me politikën tonë monetare lehtësuese. Mund të kemi dhe një lehtësim të mëtejshëm të politikës monetare që do të thotë se do të ketë dhe ulje të normës së interesit, në rast se ne do të shohim që rezultatet e analizave na e imponojnë marrjen e një vendimi të tillë. Sidoqoftë, ky është një vendim që i përket Këshillit Mbikëqyrës.

“Mund të kemi dhe një lehtësim të mëtejshëm të politikës monetare që do të thotë se do të ketë dhe ulje të normës së interesit, në rast se ne do të shohim që rezultatet e analizave na imponojnë marrjen e një vendimi të tillë.”

Politika monetare lehtësuese synon uljen e normave të interesit, lehtësimin e kushteve të kreditimit, për të stimuluar kreditimin, konsumin dhe investimet. Vetë bankat kanë ulur normat e interesit, si pasojë e reflektimit të politikës monetare lehtësuese të Bankës së Shqipërisë. Ndërkohë edhe Banka Qendrore Evropiane ka pasur një politikë monetare lehtësuese që i ka ulur normat e interesit të kredive në Euro. Pra, gjatë viteve të fundit, interesat janë ulur në mënyrë graduale si në Lek ashtu dhe në Euro.

Pyetje: Z. Guvernator, a mund të kemi ulje të konsumit dhe rënie ekonomike në këtë periudhë? Me parashikimet që ju po bëni, prisni që të kenë ulje të konsumit dhe rënie ekonomike? Cili është parashikimi juaj më i përafërt për humbjen që do të ketë ekonomia?

Guvernatori: Nuk kemi shifra; nuk mund ta them me saktësi se sa është parashikimi, pasi situata ndryshon ditë pas dite. Një gjë është e sigurt, që do të kemi ulje të konsumit dhe të ritmit të rritjes ekonomike. Parashikimi ynë për rritjen ekonomike që do të ishte 3%, besojmë se do të jetë më i ulët. Këtë po e marrim në analizë këto ditë dhe, pas mbledhjes së Këshillit Mbikëqyrës, do ta bëjmë publike përmes deklaratës sonë të politikës monetare. Aty do të bëhet publik dhe qëndrimi që do të mbajë Banka e Shqipërisë me instrumentet që ligji i ka vënë në dispozicion.

Për momentin, nuk mund të them se sa do të jetë ulja, por mund të them që ne nuk do të biem në recesion, sikurse u ka ndodhur shumë shteteve. Pasojat në ekonominë botërore janë shumë të rënda dhe ne do të kemi patjetër ndikime si një ekonomi e vogël dhe e hapur, e ndërthurur kryesisht me vendet e Bashkimit Evropian. Siç e dini, Italia është një nga partnerët tanë kryesorë tregtarë, si në drejtim të shkëmbimeve tregtare ashtu dhe të investimeve të huaja direkte. Këta i konsiderojmë faktorë të jashtëm rreziku që kanë ndikimin e tyre në ekonominë shqiptare; po e analizojmë me kujdes situatën. Nuk besoj se do të biem në recesion - analizat tona nuk e parashikojnë këtë – por mund të ulet ritmi i rritjes ekonomike. Lidhur me këtë do të jemi në një video-konferencë me misionin e FMN-së ditën e nesërme.

Pyetje: A kanë likuiditet bankat dhe a mund të presim ndonjë ulje apo rritje të Euros?

Guvernatori: Këto janë pyetje me vend. E para, bankat kanë tepriçë likuiditeti. Madje problemi ynë ka qenë si ta përkthejmë këtë likuiditet në kredi për ekonominë. Kredia vitin e fundit është rritur pozitivisht, me shifra shumë të mira, deri në nivelin 8%. Fatkeqësisht, ne patëm goditje nga tërmeti dhe tani kemi goditje nga gjendja e pandemisë, e cila do t'i ndikojë ritmet e kreditimit dhe rritjen e kredive me probleme. Megjithatë, situata e likuiditetit të bankave është e shëndetshme dhe nuk parashikojmë të kemi krizë likuiditeti.

Në këtë pikë, dua të theksoj se ne i kemi udhëzuar bankat që të marrin masa parandaluese për COVID-19 - duhet të ruhen distancat dhe të

“Këto ditë ne kemi marrë dhe masa të tjera për të krijuar lehtësira në sistemet e pagesave online ose në menaxhimin e cash-it, në mënyrë që klientët të kenë mundësi të tërheqin cash nga ATM-të.”

merren masa higjienizimi. Kjo mund të bëjë që të krijohen radhë dhe mund të krijohet ideja e gabuar se bankat kanë probleme financiare. Kjo nuk është e vërtetë, pasi gjithçka bëhet për të ruajtur shëndetin publik. Këto ditë ne kemi marrë dhe masa të tjera për të krijuar lehtësira në sistemet e pagesave online ose në menaxhimin e cash-it, në mënyrë që klientët të kenë mundësi të tërheqin cash nga ATM-të.

E dyta, lidhur me pyetjen tuaj për kursin e këmbimit, mbetet për t'u parë se si do të ndikohet ai. Ne kemi pasur Lek të mbiçmuar, si pasojë e faktorëve që i kemi përmendur. Në vitin 2018, kemi ndërhyrë në treg për të tërhequr tepriçën dhe për të stabilizuar kursin e këmbimit. Euroja

e nënçmuar dhe Leku i mbiçmuar kanë ndikuar negativisht dhe në nivelin e inflacionit të synuar, por sigurisht që kanë ndikuar dhe në ekonominë shqiptare, kryesisht në drejtim të eksporteve. Tani mund të kemi një sjellje kryesisht në kahun e kundërt, por kjo mbetet për t'u parë. Ekonomia është shumë komplekse dhe pasojat e implikimet që do të ketë pandemia në Eurozonë dhe në ekonominë shqiptare mbeten për t'u parë në vijim. Për momentin, kursi i këmbimit është stabilizuar dhe kështu parashikojmë të mbetet edhe në të ardhmen.

Pyetje: A duhet të jenë shqiptarët po kaq të qetë sa dukeni ju sot, sa i takon aspektit ekonomik, megjithëse janë të karantinuar?

Guvernatori: Shqiptarët duhet të ruajnë qetësinë. Është tepër e rëndësishme të shmangim panikun, pasi kjo do të krijonte probleme më të mëdha në të gjitha aspektet e jetës, jo vetëm në ekonomi. Institucionet duhet të veprojnë të koordinuara, pasi jemi në gjendje pandemie dhe të gjithë duhet të jemi rigorozë në respektimin e masave parandaluese. Qytetarët shqiptarë duhet të izoloohen, të pakësojnë kontaktet sa më shumë të jetë e mundur, të respektojnë masat e vendosura nga institucionet e shëndetit publik. Unë dëshiroj të siguroj publikun që nga ana jonë do të bëhen të gjitha analizat dhe do të merren të gjitha masat e nevojshme. Megjithëse veprimet në një situatë që mbart pasiguri, ne nuk parashikojmë të përballemi me recesion, por natyrisht që do të kemi rënie të ritmit të rritjes ekonomike dhe efekte negative në ekonomi. Vijoj të theksoj se parësor, në këtë moment, është shëndeti i popullatës, ndërsa ecuria ekonomike do të shihet në vijim.

INTERVISTË E GUVERNATORIT SEJKO PËR EMISIONIN “OPINION” NË TELEVISIONIN KLAN

- 12 mars 2020 -

Pyetje: Z. Sejko, ju keni marrë një masë për shtyrjen e pagesave të kredive për 3 muaj. Çfarë do të thotë kjo? A mund ta shpjegoni konkretisht për qytetarët?

Guvernatori: Ne në fakt kemi marrë një sërë masash dhe kjo është vetëm njëra prej tyre. Duke filluar nga kjo javë, kemi dërguar disa udhëzime për bankat e nivelit të dytë për të siguruar kryerjen e aktivitetit të tyre operacional në mënyrë sa më optimale, paralelisht me respektimin e masave për ruajtjen e shëndetit të punonjësve dhe klientëve bankarë.

Pyetje: A do të punojnë bankat?

Guvernatori: Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave për mbylljen e institucioneve publike, edhe ne kemi marrë vendim që bankat të mos punojnë ditën e nesërme, por të sigurojnë të gjitha pagesat online dhe nëpërmjet *cash*-it. Kjo bëhet për të kufizuar sa të jetë e mundur kontaktet, në mënyrë që të parandalohet përhapja e virusit. Siç e thashë, janë marrë të gjitha masat për kryerjen e pagesave online dhe atyre me *cash* nëpërmjet tërheqjeve nga ATM-të, ndërkohë që do të jenë dhe 2-3 ditë pushim. Javën e ardhshme parashikojmë që aktiviteti të vazhdojë normalisht.

“... dua të theksoj që të gjithë qytetarët që kanë marrëdhënie me bankat e nivelit të dytë duhet të kuptojnë se, në rast se do të krijohen radhë, kjo nuk vjen nga gjendja financiare e bankave, por nga implementimi i masave të distancimit social.”

Pyetje: Cilat janë masat e sigurisë që do të zbatojnë punonjësit e bankave të nivelit të dytë dhe të zyrave të këmbimit valutor?

Guvernatori: Sa i përket masave mbrojtëse dhe parandaluese, ne kemi dërguar një udhëzim të qartë dhe të plotë në të gjitha bankat e nivelit të dytë. Po ashtu kemi instruktuar të gjithë punonjësit e bankave për

të marrë masat e duhura lidhur me higjienizimin, ruajtjen e distancës dhe zbatimin e masave të shpallura nga autoritetet e shëndetit publik. Pra, në banka duhet ruajtur distanca, duhet të ketë numër të kufizuar punonjësish etj. Në këtë kontekst, dua të theksoj që të gjithë qytetarët që kanë marrëdhënie me bankat e nivelit të dytë duhet të kuptojnë se, në rast se do të krijohen radhë, kjo nuk vjen nga gjendja financiare e bankave, por nga implementimi i këtyre masave të distancimit social. Udhëzimet janë të qarta, të sakta dhe përputhen me ato të institucioneve të shëndetësisë për ruajtjen e shëndetit të punonjësve të bankave dhe të klientëve. Udhëzimi ynë është shpërndarë dhe bankat e kanë implementuar atë.

Pyetje: Thuhet se *cash-i* përbën një nga mjetet kryesore që mund të shpërndajë virusin. Kina e dezinfektoi gjithë *cash-in*. Çfarë do të ndodhë me të në vendin tonë?

“Cash-i nuk është mbartës ose përhapës i sëmundjes më shumë se sa sipërfaqet e tjera, si tavolinat, dorezat etj. Pra, cash-i nuk është një element i cili kërkon një vëmendje të veçantë.”

Gubernatori: Ne kemi marrë dje një konfirmim nga Organizata Ndërkombëtare e Kartëmonedhës, e cila ia ka bërë të ditur Organizatës Botërore të Shëndetësisë që *cash-i* trajtohet njëllëj si të gjitha sipërfaqet e tjera. Pra, *cash-i* nuk është mbartës ose përhapës i sëmundjes më shumë se sa sipërfaqet e tjera, si tavolinat, dorezat etj. *Cash-i* nuk është një element që kërkon një vëmendje të veçantë; nuk ka nevojë për dezinfektim *cash-i*. Ne kemi marrë masa që

punonjësit të jenë të dezinfektuar në të gjitha zyrat e institucionit edhe në qendrën tonë të përpunimit të *cash-it*.

Pyetje: Thatë që keni shtyrë me 3 muaj pagesën e kredive të bankave të nivelit të dytë, por ka disa institucione financiare më të vogla që mund të quhen të nivelit të tretë. Po pagesat e këtyre kredive më të vogla, a do të shtyhen?

Gubernatori: Lidhur me kreditë, unë e kam bërë publike shtyrjen. Në radhë të parë dua të theksoj që nuk bëhet fjalë për një falje të kësteve të kredive, por për një riskedulim, një shtyrje me një afat 3-mujor për ata klientë të cilët nuk kanë mundësi të paguajnë këstin, si pasojë e rrethanave të krijuara. Skeduli i pagesave të kredisë do shtyhet me tre muaj dhe nuk do të rëndohen me interespagesa, nëse nuk do të paguajnë këta 3 muaj. Kjo vlen dhe për institucionet financiare jobanka.

Pyetje: Pyetja e fundit ka të bëjë me *cash*-in në automate. Ka qytetarë që pretendojnë që sot lejohet të tërhiqen vetëm deri në 20.000 lekë nga automati. A ka një urdhër lidhur me këtë apo është limitim i vetë bankës?

Guvernatori: Jo, nuk ka asnjë urdhër për kufizim tërheqjeje *cash*-i, por bankat kanë limitet e tyre për tërheqjen nga automati. Ne jemi fleksibël dhe mund të ndryshojmë të gjitha rregulloret lidhur me tërheqjen e *cash*-it nga automati, por nuk parashikojmë të përballemi me situata ku kjo të jetë e nevojshme. Shuma limit është çështje e politikave të bankave dhe përgjithësisht ajo është e mjaftueshme për t'i shërbyer qytetarit.


E rëndësishme është që ne si bankë qendrore kemi marrë masa që edhe këto ditë që do të jenë pushim të kemi Departamentin e Emisionit në gjendje pune, për të furnizuar rregullisht me *cash* bankat e nivelit të dytë. Ne u kemi kërkuar bankave që të furnizojnë ATM-të me *cash* dhe t'iu shërbejnë qytetarëve rregullisht, për tërheqjen e *cash*-it të nevojshëm për kryerjen e pagesave normale ditore. Nëse një ATM nuk punon, qytetarët nuk duhet të shqetësohen, por të shkojnë me qetësi në një ATM tjetër për të bërë tërheqjen.

INTERVISTË E GUVERNATORIT SEJKO PËR EMISIONIN "REAL STORY" NË TELEVISIONIN NEWS 24

- 19 mars 2020 -

Pyetje: Përpara se të fillojmë bisedën, do doja të shikonim tabelat që tregojnë numrin e të infektuarve me COVID-19 në Shqipëri. Tashmë kemi arritur në 59, prej të cilave 42 raste janë në Tiranë, 5 janë në Durrës, 2 në Lushnjë, 2 në Elbasan, 6 në Fier, 2 në Rrogozhinë. Sot kemi një lajm të mirë dhe një të keq. Lajmi i keq është padyshim humbja e jetës së një 66-vjeçari nga Lushnja, i cili ishte i shtruar në sanatorium, por e mori virusin, pra i cili e shpejtoi ndarjen e tij nga jeta. Lajm i mirë është që një nga të sëmurët, pacienti 1 dhe pacienti 0, kanë rezultuar negativë nga testimi i dytë. Çka do të thotë që ai është shumë pranë të konsideruarit zyrtarisht i shëruar. Pasi siç e dimë shifra e shërimit është ende 0, dhe në momentin që fillojnë shërohen, në momentin që numri i të shëruarve do të jetë më i lartë se numri i të infektuarve do të flasim që kurba po shkon drejt stabilizimit. Ndërkohë shikojmë dhe grafikun tjetër, pra kjo është kurba blu, pra të gjithë ne tentojmë kurbën blu. Pra, që numri i të sëmurëve të rritet në mënyrë graduale dhe jo në mënyrë të shpejtë. Por, ndërkohë po shikojmë dhe një grafik tjetër që tregon shtimin e numrit të rasteve nga dita në ditë, që nga dita e parë kur u regjistruan dy rastet e para, ju lutem regjia na e mundësoni dhe grafikun. Rastet e testuara dhe të konfirmuara. Me të verdhë është Italia që është skenari të cilit i frikësohemi më shumë nga data 9 mars dhe datën 18 mars shikojmë Shqipërinë. Shqipëria ka një kurbë në rritje por është një kurbë stabël nuk është një kurbë e rrezikshme. Sigurisht do të presim fundin e kësaj jave dhe me gjasa dhe të javës tjetër nëse kjo kurbë do të thellohet. Por sigurisht ka një kurbë tjetër e cila ka filluar të na shqetësojë që është kurba e zhvillimit ekonomik në vend. Një zhvillim ekonomik i cili mori goditje të rënda në vitin 2019, për shkak të krizës politike edhe për shkak të tërmetit. Natyrisht është ndjerë dhe efekti i COVID-19, shikoni shifrat e shkëmbimeve tregtare krahasuar me marsin e vitit 2019. 1-14 mars 2019, shkëmbimet tregtare kanë qenë në shifrën 34.708.722.150 lekë; ndërkohë 1-14 mars 2020, kjo shifër ka rënë në 33.087.898.154 lekë. Pra është një rënie e vogël, por a mendoni që ky është vetëm fillimi, z. Sejko?

Grafik 29. Ecuria e tregtisë në mallra



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Guvernatori: Po, me sa duket, ky është fillimi. Por, se sa do të zgjasë kjo situatë mbetet për t'u parë, pasi ka kaluar vetëm një javë që nga shpallja e gjendjes së pandemisë COVID-19.

Pyetje: Dhe sot jemi në luftë me të...

Guvernatori: Po, sot jemi në luftë me të. Jemi shumë afër me Italinë, e cila është epiqendra e luftës me virusin, dhe natyrisht që ai do të mbërrinte dhe te ne. Numri i njerëzve që hyjnë e dalin në Shqipëri nga Italia dhe në të kundërt është shumë i madh, për këtë arsye është bërë dhe anulimi i fluturimeve dhe izolimi me Italinë dhe më gjerë, dhe ne jemi në situatën që jemi. Të shpresojmë që numri i rasteve nuk do të rritet ose rritja do të jetë e kontrolluar dhe shërimi i rasteve aktuale do të jetë i shpejtë.

Pyetje: I cili le të themi akoma zyrtarisht nuk është konsideruar i tillë pas testit të dytë, por sigurisht në vetvete është një lajm i mirë se i bie që brenda 10 ditëve të para nga rasti 0 kemi shërimin e një rasti. Kjo është dhe harta e cila nuk ka ndryshuar nga java e kaluar, pra harta e shpërndarjes është e njëjtë. Pra nuk kemi qarqe të reja ku janë shfaqur të infektuar. Shumica e rasteve janë të lidhura me njëra-tjetrën, pra janë të identifikuar, sidomos rastet e Tiranës shumica janë të tilla, edhe rastet e Durrësit, edhe rastet e Fierit. Në Tiranë kemi numër akoma më të madh për shkak se popullata është më e

madhe, por ndërkohë kemi dhe një numër mjekësh dhe infermierësh, të cilët janë infektuar dhe janë në izolim. Ju vetë si qytetar dhe si familjar, a e ndjeni rrezikun e këtij virusi z. Guvernator?

Guvernatori: Natyrisht! Duke pasur parasysh informacionin që vjen nga mjekët, jemi më shumë të shqetësuar për prindërit, pasi si moshë e tretë, janë më të rrezikuar nga ky virus, por sigurisht dhe për fëmijët dhe për veten.

Pyetje: A po punon BSH-ja me staf të reduktuar si shumë institucione të tjera?

Guvernatori: Patjetër që po, por gjithnjë duke siguruar një funksionim operacional normal.

Pyetje: Z. Sejko, le të flasim pak lidhur me masat: Banka e Shqipërisë dhe Qeveria Shqiptare së bashku, në mënyrë të koordinuar, morën masat e para që dje, mos gaboj. Mund të na thoni diçka më shumë?

Guvernatori: Unë do të doja të flisja diçka më shumë për masat që kemi marrë ne si Bankë Shqipërie. Ndërkohë që Kryeministri ka njoftuar që nesër do të shpallë planin e masave të Qeverisë Shqiptare. Natyrisht që përcaktimi i masave kërkon kohë, për shkak se ato duhet të mbështeten në analiza të thelluara. Fillimisht, ne si Bankë e Shqipërisë kemi marrë disa masa udhëzuese e parandaluese, në drejtim të ruajtjes së shëndetit të punonjësve të bankave të nivelit të dytë, të Bankës së Shqipërisë, si dhe të klientëve të bankave. Më pas jemi përqendruar tek marrja e disa masave për funksionimin operacional, i domosdoshëm për jetën e gjithë vendit. Ne si bankë qendrore jemi përgjegjës për sistemin e pagesave dhe për menaxhimin e *cash*-it në Republikën e Shqipërisë. Pra i gjithë *cash*-i në monedhë kombëtare qarkullon nëpërmjet thesarit të bankës qendrore. Kjo vlen edhe për të gjitha pagesat në monedhë kombëtare, jo në monedhë të huaj, të cilat kalojnë në një server në bankën qendrore. Duke pasur parasysh situatën e vështirë, ne jemi organizuar sipas një plani kontigjence, për të shmangur ndërprerjet, qoftë edhe momentale, të funksionimit të pagesave dhe të furnizimit me *cash* në Republikën e Shqipërisë. Deri tani gjithçka ka vijuar normalisht. Duke qenë se Austrian Airlines njoftoi ndërprerjen e fluturimeve, sot kemi marrë dhe një masë lidhur me *cash*-in që ka të bëjë me tepricat ose mungesat e tij që do të kenë bankat e nivelit të dytë në ditët në vijim. Menaxhimi i *cash*-it do të bëhet në ambientet e Bankës së Shqipërisë dhe për këtë jemi koordinuar dhe me Policinë e Shtetit.

Pyetje: Ju i referoheni faktit që përmes linjave ajrore, ndër to dhe Austrian Airlines, kishte dalje të valutës jashtë nga bankat e nivelit të dytë?

Gubernatori: Jo vetëm dërgesa të *cash-it*, por edhe prurje.

Pyetje: Kjo masë që keni marrë është për shkak të një shqetësimi se ndoshta nuk ka valutë sa duhet në treg?

Gubernatori: Valutë ka; kjo që thoni nuk qëndron. Kjo masë është për tepricat e valutës, pra që përveç menaxhimit të *cash-it* në Lek, nga Banka e Shqipërisë të bëhet edhe menaxhimi i *cash-it* në valutë.

Pyetje: Valuta dhe *cash-i* do të futen tani në ambientet e Bankës së Shqipërisë?

Gubernatori: Po.

Pyetje: Në një farë mënyre ktheheni në funksionin bazë të një banke, të ruajë paranë...

Gubernatori: Patjetër.

Pyetje: Z. Sejko, dje u interpretua si shqetësim te qytetarët prania e shumë e tyre në banka. Në fakt ka pasur shumë faktorë: pas një fundjave të zgjatur, e premtja u shpall ditë pushimi, dita e hënë ishte ditë pushimi për shkak të festës zyrtare së Ditës së Verës; pra ishin gati katër ditë pushim. Bankat punojnë me staf të reduktuar, respektojnë rregullat e reja të higjienës dhe të distancimit social, pra a ka vend për panik?

Gubernatori: Jo nuk ka vend për panik. Të gjitha këto arsye, që ju dhatë z. Balla, qëndrojnë, por kjo ka ndodhur më shumë për arsye se për personat fizikë dhe bizneset, dje ka qenë dita e pagesës së detyrimit tatimor. Kjo dhe puna me numër të kufizuar punonjësish kanë sjellë radhë në banka. Unë pata një komunikim me publikun ditën e enjte të javës së kaluar, pikërisht për të shmangur ndonjë keqkuptim mbi gjendjen e likuiditetit në banka. E gjitha ndodh pasi tashmë bankat nuk i fusin të gjithë klientët në ambientet e tyre si zakonisht, por i fusin me radhë për të ruajtur distancën. Për fat të keq, ndodhi që këta klientë të cilët duhet të ruanin distancën brenda bankave, qëndronin të padistancuar jashtë tyre, duke rrezikuar të preken nga virusi.

Pyetje: Për arsye personale kam qenë në një bankë të nivelit të dytë dhe aty dëgjova që flitej midis drejtuesve të bankës për reduktim të mëtejshëm të stafit, për shkak se nuk kishte numër të lartë klientësh.

Guvernatori: Natyrisht që masat për kufizimin e qarkullimit të qytetarëve do të ndikojnë dhe tek numri i klientëve të bankave. Është një situatë e jashtëzakonshme dhe gjërat ndryshojnë nga dita në ditë. Pavarësisht kësaj, dua ta siguroj publikun që funksionimi i sektorit bankar është normal dhe operacional. Bankat janë nga të paktat institucione në gjendje pune, duke i shërbyer klientelës me sportele dhe me ATM të furnizuara me cash. Pra, funksionimi i sektorit bankar për klientët nuk është problem, megjithëse krijohen radhë dhe kjo krijon një stres momental. Mund të them se dhe kam komunikuar me disa drejtorë bankash të nivelit të dytë për të shtuar numrin e degëve të hapura dhe sot më shumë degë bankash kanë qenë të hapura. Pavarësisht kësaj, nesër hyjmë në një fazë tjetër.

“Bankat janë nga të paktat institucione në gjendje pune, duke i shërbyer klientelës me sportele dhe me ATM të furnizuara me cash.”

Pyetje: Nesër kemi vetëm gjashtë orë liri qarkullimi në qytetet tona. Në fakt, Kryeministri ka thënë me pak ironi dhe humor se bankat shqetësohen se që nga nesër nuk do të kenë klientë në sportele. Ta kuptojnë dhe bankierët se jemi në luftë dhe t’i hapin sportelet nga ora 6:00 deri në 10:00 dhe nga 16:00 në 18:00 në pasdite. A ndërhyjnë dot Banka e Shqipërisë në përcaktimin e një orari të tillë për bankat?

Guvernatori: Këto janë masa emergjence, “masa lufte” në një farë mënyre, dhe sigurisht që do të respektohen. Duhet kuptuar që jemi në një situatë jonormale dhe natyrisht që në një situatë të tillë, jeta dhe shëndeti i njerëzve zë peshën më të madhe. Për sa kohë që kemi pasiguri se sa do të jetë numri i rasteve, do të jemi të detyruar të marrim masa shtrënguese, ashtu siç po vepron Qeveria Shqiptare. Shohim që masat janë të ngjashme në të gjitha vendet, jo vetëm në vendet fqinje.

Pyetje: Disa nga masat dhe shtetet me më shumë probleme se ne, i kanë marrë ose i marrin pasi i kemi marrë ne. Ky është fakt...

Guvernatori: Po, masat që po merren janë të ngjashme, por natyrisht vendosja e kufizimeve krijon konfuzion dhe e ndikon shumë jetën e përditshme. Dikush do të paguajë faturën e ujit të apo të energjisë elektrike, këstin e kredisë e me radhë, dhe kufizimet krijojnë përshtjellime dhe frikë.

Pyetje: Lidhur me vendimin që ju keni marrë dje z. Sejko, një shikues më kërkon t'ju pyes nëse mësuesve dhe mjekëve që i marrin rrogat në një bankë të nivelit të dytë do t'u shtyhet me tre muaj pagesa e kështu të kredisë? Kjo do të ishte një ndihmë e jashtëzakonshme për ta. Kjo është dhe një nga paqartësitë që ka hapur debate sa i përket urdhrin që ju keni lëshuar së bashku me Kryeministrin.

Guvernatori: Mësuesit dhe mjekët i marrin pagat në llogaritë e tyre në mënyrë automatike. Ato mund t'i tërheqin *cash* nga ATM-ja nëpërmjet kartës së debitit. Tërheqja e pagës nuk është problem nga ana operacionale. Problemi qëndron tek kreditë. Një pjesë e mirë e punonjësve të administratës publike kanë kredi nga bankat. Shumica ka kredi konsumatore, por ka dhe nga ata që kanë kredi hipotekare.

Pyetje: Ka dhe nga ata që punojnë në privat...

Guvernatori: Edhe ata që punojnë në kompani private, si mësuesit dhe mjekët, dhe administrata publike kanë trajtim shumë të ngjashëm, në varësi të pagës dhe të ardhurave të tyre. Bankat e nivelit të dytë aplikojnë kredi të caktuara, si kreditë konsumatore, të cilat janë më të vogla, por edhe kredi hipotekare, pra për pasuri të patundshme.

Normalisht, një pjesë e mirë e punonjësve, si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik, mund të kenë probleme të caktuara financiare, por nuk kanë probleme thelbësore të diktuar nga kjo lloj sëmundjeje. Mirë do të ishte që të kishte një shtyrje për ta, por megjithatë nuk janë të ekspozuar dhe të riskuar drejtpërdrejt, për sa kohë që vazhdon t'u kreditohet rroga në llogarinë e tyre.

Pyetje: Kjo nuk vlen për rastin që përmendëm?

Guvernatori: Jo, nuk vlen për këto raste.

Pyetje: Nuk ndryshon asgjë financiarisht për ta, pasi paga do të vazhdojë megjithëse janë në shtëpi. Për këtë arsye edhe kredia do vazhdojë të paguhet si më parë...

Guvernatori: Po, ata do të vijojnë të paguajnë dhe natyrisht do të vijojnë të shlyejnë edhe këstet e kredisë. Një pjesë e mirë e tyre nuk duan të kenë shtyrje. Pra, ka raste nga më të ndryshmet, si tek individët ashtu dhe tek bizneset.

Pyetje: Por mos harrojmë që mund të ketë raste që në një familje dikush e merr rrogën në shtet, dikush e merr në privat. Ai që është në privat sot është i detyruar të rrijë në shtëpi dhe të mos paguhet. Ndërkohë, pavarësisht se partneri paguhet rregullisht, ekonomia e shtëpisë ka pësuar një goditje. Ndoshta nuk do të ishte mirë që dhe për ta....

Guvernatori: Këto janë raste komplekse dhe rastet ndryshojnë nga njëra-tjetra. Në vija të përgjithshme, unë do theksoja që vendimi i marrë nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë dhe i rakorduar më pas dhe me Kryeministrin, ka të bëjë vetëm me atë kategori klientësh, të cilët do jenë të prekur nga kriza financiare që vjen si pasojë e pandemisë. Këta klientë do të duhet të kontaktojnë me bankat për të argumentuar problemin e tyre.

“Vendimi i marrë nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë dhe i rakorduar në pas dhe me Kryeministrin, ka të bëjë vetëm me atë kategori klientësh të cilët do jenë të prekur nga kriza financiare që vjen si pasojë e pandemisë.”

Pyetje: Pra nuk është automatike?

Guvernatori: Jo, nuk është automatike.

Pyetje: Kush është i interesuar ta bëjë këtë mund ta bëjë...

Guvernatori: Jo, unë e theksova këtë që ditën e parë, por me sa duket klientët ishin të paqartë, dhe prandaj dolëm me një njoftim të dytë. Për ta përshpejtuar procesin e identifikimit të klientëve që u shtyhet pagesa, ne caktuam një afat tregtar që nga momenti që klienti kontakton me bankën. Pra, banka duhet t'i kthejë një përgjigje klientit për tre ditë, nëse ai është i kualifikuar për të përfituar nga kjo shtyrje.

Pyetje: Këtu bëhet fjalë për shtyrjen e kështit të kredisë për tre muaj apo bëhet fjalë për anulim të interesave?

Guvernatori: Bëhet fjalë për shtyrjen për tre muaj të kësteve dhe të interesave për të, pa aplikuar penalitete apo gjoba mbi interesat. Pra, kjo vlen për klientët me vështirësi financiare.

Pyetje: Është një fazë e ngrirë tremujore?

Guvernatori: Po, është një fazë ngrirjeje tremujore; këto këste nuk do të falen.

Pyetje: Nëse ti e kërkon ama...

Guvernatori: Vetëm nëse klienti e kërkon, duke kontaktuar bankën.

Pyetje: Miratimi i fundit merret nga banka?

Guvernatori: Po, pra nuk është një urdhër automatik që të gjithë klientëve u shtyhet kredia. Ne si Bankë e Shqipërisë kemi kuadrin tonë ligjor dhe kemi bërë ndryshime rregullative për të mos i rënduar bankat me provigjione dhe për t’iu krijuar atyre mundësinë që ta bëjnë këtë shtyrje. Ne i kemi këshilluar që të procedojnë sa më shpejt, por sigurisht që situata evoluon nga dita në ditë dhe gjithmonë ka paqartësi dhe pakënaqësi. Në rast se do të merrej një vendim nga Qeveria Shqiptare, përmes një ndryshimi ligjor, për të bërë një ngrije totale të të gjitha kësteve të kredisë, kjo do të krijonte një problem për stabilitetin financiar; do të krijonte një problem për bankat. Janë mbi treqind milion euro, në vijë të përgjithshme, që do të rëndonin vetëm për këste dhe interesa të këtyre kredive.

Pyetje: 340 milionë mos gaboj; kjo shifër është referuar në media për kredinë.

“Ne si bankë qendrore jemi përgjegjës me ligj për stabilitetin e çmimeve në radhë të parë, kontrollin e inflacionit, por dhe për stabilitetin financiar.”

Guvernatori: Rreth 300 milionë euro. Ligji na bën ne si bankë qendrore përgjegjës, në radhë të parë, për stabilitetin e çmimeve, për kontrollin e inflacionit, por dhe për stabilitetin financiar. Masa u mor me urgjencë, pikërisht për t’i ardhur në ndihmë klientëve, por dhe bankave të nivelit të dytë, pasi nëse klientët nuk do të ishin në gjendje ta paguanin kredinë dhe bankat do të viheshin në

vështirësi financiare. Kjo nuk do të thotë që ne do merrnim një vendim që do t’i rëndonte më shumë bankat, pasi ne nuk e dimë kohëzgjatjen e kësaj krize. Kjo është një situatë e paprecedentë, shumë e veçantë dhe tepër e vështirë, por po përpiqemi të organizohemi dhe të marrim të gjitha masat parandaluese. Këtu flas për ne si bankë qendrore, sa i përket sektorit financiar, pasi qeveria dhe institucionet e tjera po marrin masat e tyre. Natyrisht që stabiliteti financiar është tepër i rëndësishëm, pra stabiliteti financiar i bankave, me klientët e tyre kredimarrës dhe depozitues. Duhet të kuptojmë se pjesa dërrmuese e kredive që jepen nga bankat vijnë nga depozitat e qytetarëve dhe një pjesë shumë e vogël nga kapitalet e aksionerëve. Bankat janë ndërmjetës financiarë.


Këtu nuk bëhet fjalë për të bërë avokatin e bankave, por për të qenë prudent dhe korrekt, duke trajtuar me shumë kujdes gjendjen e stabilitetit financiar, që ka të bëjë drejtpërdrejt me depozitat e qytetarëve.

Pyetje: Z. Guvernator ka një pyetje tjetër nga një teleshikues, i cili interesohet nëse janë të sigurta depozitat dhe obligacionet që qytetarët kanë në bankat e nivelit të dytë, pasi ato i fusin në bursa dhe këto të fundit po pësojnë rënie?

Guvernatori: Jo, bankat nuk i kanë futur depozitat në bursë. Kjo pyetje kërkon një përgjigje teknike, dhe nuk dëshiroj ta lodh teleshikuesin me teknikalitete. E thënë thjesht, analizat tona dëshmojnë se bankat kanë një siguri optimale për investimet e tyre. Ekzistojnë kritere të caktuara për kategoritë e investimeve, të vëna nga bankat qendrore të vendeve ku bankat tona kanë bankat mëma, por dhe nga ne si Bankë e Shqipërisë. Sigurisht që bursat kanë norma të larta fitimi dhe shkallë të lartë risku, por ka kufizime të caktuara për investime të caktuara. Bankat pjesën kryesore të depozitave e japin kredi në tregun shqiptar dhe pjesën tjetër e kanë vendosur në banka të tjera, pasi natyrisht që likuiditeti do të vendoset diku. Nuk ka investime të këtij rreziku, por dhe në qoftë se ka në kompleksin e portofoleve të bankave, përmes mbikëqyrjes sonë konstatojmë dhe vërtetojmë që ka siguri të mjaftueshme për depozitat.

Pra, aktualisht bankat janë në një gjendje shumë të mirë dhe të shëndetshme financiare. Ka mjaftueshmëri kapitali më të lartë se sa minimumi i kërkuar sipas kërkesave tona. Mesatarja e mjaftueshmërisë së kapitalit, që është treguesi kryesor i shëndetit të bankave, është mbi 18%, ndërkohë që kërkesa është 12% dhe për disa banka 14-15%. Pra, gjendja e likuiditetit të bankave është e mirë, por kjo nuk do të thotë që në një situatë krize dhe pasigurie për zhvillimet në të ardhmen, t'i rëndojmë bankat duke iu dhënë një goditje kaq të fortë që në fillim. Duhet të jemi të kujdesshëm pasi kur të vijë goditjet e radhës, bankat mund të përballen me vështirësi ende të panjohura për ne. Kjo krizë do kujdes dhe trajtim rast pas rasti; në situatën ku ndodhemi, jemi të detyruar të veprojmë në këtë mënyrë.

Grafik 30. Ecuria e treguesve të mjaftueshmërisë së kapitalit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pyetje: Z. Sejko këtu ka dy kurba që ecin paralel. Kurba e shqetësimit apo frikës për shkak të virusit dhe një kurbë në rritje e shqetësimit në rritje për shkak të ekonomisë. Ndërkohë që qeveria i është përgjigjur me masa drastike kurbës së parë, ajo, por dhe ju si Banka e Shqipërisë, është vënë në ditët e fundit nën tehun e kritikave të biznesit dhe të opozitës - në fakt, i pari që ngriti alarmin ishte Presidenti i Republikës me deklaratën e tij - se po tregoheni shumë më të matur apo të kujdesshëm për të marrë masa të tilla. Këtë e bëni sepse nuk doni të trembni tregun apo sepse vërtet nuk keni një vlerësim real të situatës dhe prisni zhvillimet në ditët në vijim?

Guvernatori: Ne mund të marrim masa vetëm brenda kuadrit tonë ligjor. Duhet theksuar që masat që kemi marrë dhe do të ndërmarrim në ditët në vijim kanë të bëjnë me stabilitetin e çmimeve, stabilitetin financiar. Qëndron fakti që përmendët se ne ende nuk i kemi përfunduar analizat tona për vijimësinë e situatës ekonomike. Në varësi të kësaj analize, ne si bankë qendrore përshtatim dhe politikën monetare. Jemi duke parashikuar skenarët e ndryshëm të ndikimit të krizës së shkaktuar nga pandemia në ekonomi. Në funksion të këtyre rezultateve dhe analizave, pas pak ditësh, në mbledhjen e radhës, Këshilli Mbikëqyrës do të marrë dhe vendimin e politikës monetare. Pra, thjesht po dalim në konkluzione.

Pyetje: Për çështjen e normës së interesit?

Guvernatori: Po, për çështjen e normës së interesit dhe për lehtësi të tjera, nëse do ta shikojmë të nevojshme.

Pyetje: Ju thoni se nuk e keni akoma, ndërkohë p.sh. Banka Federale e çoi pothuajse në 0 nivelin e interesit - nga 2% e çoi 0%. Pra, bëri një ulje shumë të fortë, ulje drastike.

Guvernatori: Po, bëri një ulje drastike, e cila krijoi pështjellime në tregje...

Pyetje: Ndoshta jeni të kujdesshëm që mos krijohet panik në treg, qoftë dhe pa arsye?

Guvernatori: Patjetër! Ka ndryshim shumë të madh midis tregut amerikan dhe tregut shqiptar, jo vetëm në përmasa, por dhe në shkallën e sofistikimit. Ndryshimi i normës së interesit nga banka qendrore e SHBA-së ka efekt të menjëhershëm në indeksat e tregjeve dhe bursave. Ndërkohë, ne e dimë që në Shqipëri tregjet e kapitalit janë të pazhvilluara dhe transmetimi i politikës monetare ka kufizimet e veta. Nuk ka një efekt të menjëhershëm në bursë, por ka një efekt gradual dhe të shpejtë në normat e interesit.


“Në Shqipëri, transmetimi i politikës monetare ka kufizimet e veta dhe nuk ka një efekt të menjëhershëm në bursë, por ka një efekt gradual dhe të menjëhershëm në normat e interesit, por më gradual.”

Pyetje: Ne jemi më shumë të varur nga euribori apo jo?

Guvernatori: Ne jemi të varur nga euribori për pjesën e Euros, e cila përcaktohet nga Banka Qendrore Evropiane, pra 50% - po flas me shifra të përafërta - e bilanceve të sistemit të pagesave në aktive, në depozita dhe kredi, janë në Euro. Kjo do të thotë se politika monetare që ndërmerr Banka e Shqipërisë aplikohet mbi 50% të kredive dhe depozitave, ndërsa pjesa tjetër ndikohet nga Banka Qendrore Evropiane. Për këtë arsye, ne këmbëngulim për një politikë deeuroizimi, pra për të rritur efektin e politikës monetare mbi tregun shqiptar, mbi sistemin financiar shqiptar.

Por çfarë do të thotë kjo? Kjo do të thotë që transmetimi i kësaj politike monetare, që bëhet në funksion të ekonomisë shqiptare, të jetë më i plotë.

Grafik 31. Treguesit kryesorë për monitorimin e nivelit të përdorimit të valutës në sektorin bankar shqiptar



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Pyetje: Në Shqipëri, siç thatë vetë, do pak shpjegim ulja e normave të interesit, pasi nuk ka të njëjtën natyrë si në SHBA.

Guvernatori: Natyrisht! Megjithatë ne kemi pasur një transmetim shumë të mirë të politikës monetare, duke pasur gjithnjë parasysh kufizimet si pasojë e shkallës së lartë të euroizimit. Është rritur kredia në Lek, është rritur konsumi dhe janë rritur investimet. Pra politika monetare ndikon në nxitjen e kreditimit, konsumit dhe investimeve në ekonomi. Ka një ndikim të mirë nga transmetimi i politikës monetare të Bankës së Shqipërisë. Nga analizat e bëra vitet e kaluara dhe nga matjet tona, siç është raportuar dhe në Kuvendin e Shqipërisë, 0.5% e rritjes ekonomike prej 3% vjen vetëm si pasojë e ndikimit të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë. Është fakt që politika monetare ka qenë lehtësuese në mënyrë të vazhdueshme dhe norma bazë e interesit është në minimumin e saj historik. Megjithëse e kufizuar, kemi ende hapësirë për lehtësim të mëtejshëm, por kjo është një vendimarrje që i takon Këshillit Mbikëqyrës.

Pyetje: Dhe do ta merrni shumë shpejt këtë vendim apo jo?

Guvernatori: Po, vendimi do të merret këto ditë.

Grafik 32. Kredia për sektorin privat ndaj PBB-së dhe sipas monedhës



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pyetje: Z. Sejko në mbyllje të kësaj pjese të parë, do t'ju bëj një pyetje të drejtpërdrejtë. Steven Mnuchin, Sekretari i Thesarit të Amerikës, në një memo që doli në shtypin amerikan, flet që skenari më negativ mund të jetë që papunësia në Shtetet e Bashkuara mund të shkojë në 20%. Ndërkohë, shqetësim për ekonominë kanë dhe vende të tjera. Megjithëse kanë një numër të vogël të infektuarish, një sërë vendesh kanë futur shuma të mëdha parash në ekonomi, si p.sh: Emiratet e Bashkuara Arabe, afërsisht 27-28 miliardë; 13 miliardë, Arabia Saudite; 25 miliardë, Italia, sistemi shëndetësor i të cilës është në krizë të plotë; Gjermania ka futur 500 miliardë. A do jetë dhe Shqipëria në krizë ekonomike për shkak të COVID-19?

Guvernatori: Patjetër që edhe Shqipëria do të ketë efekte negative në ekonomi, për shkak të pandemisë, si çdo shtet tjetër i prekur. Kjo vetëkuptohet.

Pyetje: Rrezikojmë një rritje negative, pra rrezikojmë recesion?

Guvernatori: Nuk mund ta them tani nëse do të rrezikojmë recesion. Varet nga definicioni i recesionit, pra është një rritje negative; mund të ketë një tremujor recesionit.

Pyetje: Pra nga 2.9% që është sot, rritja mund të shkojë në 0% ose poshtë 0?

Guvernatori: Në skenarët tanë, ne e kemi parashikuar këtë.

Pyetje: Kjo do të ketë ndikim te kreditë, te vlerat e tyre, te vlera e banesave, te gjithçka...

Guvernatori: Patjetër, pasi gjithçka shkon zinxhir.

Pyetje: Pra, rrezikojmë të jemi në skenarin e recesionit?

Guvernatori: Me skenarët që ne kemi deri tani, mund të rrezikojmë recesion për një tremujor, por jo për vitin. Për momentin, nuk mund të jap një mesazh për ju dhe teleshikuesit tuaj nëse rrezikojmë më shumë apo jo. Me këtë do të njiheni pas pak ditësh, në deklaratën e politikës monetare, kur llogaritjet të përfundojnë. Ajo që mund të them me dy fjalë është që në skenarin pozitiv, ne parashikojmë një rënie të rritjes ekonomike me 0.5% dhe në skenarin më negativ 2 deri 2.5%. Megjithatë, kjo nuk duhet marrë si e mirëqenë, pasi analizat nuk kanë përfunduar. Ato do të prezantohen në Këshillin Mbikëqyrës dhe do të komunikohen për publikun me deklaratën e politikës monetare të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, në pak ditë.

Pyetje: Z. Sejko, muaji mars është një periudhë mbylljeje për pagesën e detyrimeve tatimore të biznesit, çka e shpjegonte dhe popullimin e bankave dje. Megjithatë, opozita, e cila ka bërë ofertat e saj konkrete për ekonominë, ngre pyetjen se ku do t'i gjejë biznesi paratë për të paguar TVSH-në?

Guvernatori: Z. Balla, kjo në fakt është një pyetje për t'u sqaruar nga Ministria e Financave.

Pyetje: Dhe nga qeveria patjetër...

Guvernatori: Po. Banka e Shqipërisë bashkëpunon vazhdimisht me Ministrinë e Financave.

Pyetje: Dhe i bëni sugjerime? A mund t'i detyroni? Se kjo mund të ngrihet si pyetje...

Guvernatori: Jo, ne nuk i detyrojmë. Mënyra e bashkëpunimit ndërinstitucional është e përcaktuar me ligj. Ne kemi komitete të përbashkëta për menaxhimin e llogarive të qeverisë dhe për elemente të tjera. Megjithatë, në rastin konkret, vendimmarrja lidhur me fiskun është natyrisht atribut i Qeverisë Shqiptare.

Pyetje: A mendoni që p.sh. duhet të pezullohen pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për një periudhë tremujore. Megjithëse njerëzit do të jenë në shtëpi, biznesi detyrohet të paguajë sigurime shoqërore dhe shëndetësore.

Guvernatori: Natyrisht, unë jua theksova që e mira do të ishte që gjatë një krize të pezulloheshin të gjithë pagesat. Por sa është e mundur kjo?

Pyetje: Pagesat e energjisë dhe shërbimit të konsumatorit?

Guvernatori: Besoj se është e pamundur. Është e lehtë të kritikosh dhe të parashtrosh kërkesa, por analiza bëhet me shifra dhe me mundësi konkrete të buxheteve. Ne bëjmë analizën tonë si bankë qendrore për mundësitë që ne kemi në raport me tagrin tonë ligjor. Ndërkohë që Ministria e Financave dhe Qeveria Shqiptare bëjnë analizat e tyre.

Pyetje: Prandaj po ju pyes si Guvernator. Në rast nevojë, kur biznesi shfaq pamundësi financiare, pagat e punonjësve të paguhen nga buxheti i shtetit, për një periudhë dymujore, sipas kriterëve të mirëpërcaktuara për të shmangur abuzimin. Përfashtimi nga tatimfitimi për 6-mujorin e parë të vitit...

Guvernatori: Këto mund të jenë në planin e masave.

Pyetje: Çfarë fitimi do të tatohet në momentin që biznesi nuk ka pasur punë. Punë kanë vetëm farmacitë, firmat që bëjnë import-eksport mallrash farmaceutike dhe supermarketet.

Guvernatori: Në planin e masave të marra nga Qeveria Shqiptare, që do të komunikohet nga Kryeministri, jam i sigurt që do të ketë lehtësira për këto kategori, por le të presim e ta shikojmë. Për pagat, prioriteti vjen sipas shtresave të caktuara të popullsisë.


Pyetje: A do të kemi pagën në fund të muajit? SHBA-ja po paguan 1000 dollarë për çdo qytetar, pra është masë konkrete.

Guvernatori: Po, SHBA-ja po paguan 1000 dollarë për çdo qytetar dhe kjo është një masë konkrete që vjen nga buxheti.

Pyetje: A e bëjnë këtë për të mos ulur nivelin e konsumit? Pasi konsumi e mban ekonominë gjallë...

Guvernatori: Po, kjo ka të bëjë me nivelin e konsumit. Këto janë masa për të ndihmuar qytetarët në një kohë krize dhe Presidenti Trump ka premtuar një shumë të caktuar ndihme për çdo qytetar, përmes një projektbuxheti në mënyrë që ...

Grafik 33. Ecuria e konsumit privat



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Pyetje: Që shkon në trilionë dollarë.

Guvernatori: Është e vërtetë që fatura shkon në trilionë dollarë, por duhet kuptuar që buxheti i SHBA-së e përballon këtë. Ne po flasim për buxhetin e Republikës së Shqipërisë, dhe kjo vjen sipas një analize, e cila besoj është duke u bërë nga instancat përkatëse. Në funksion të kësaj, në radhë të parë, do të ndihmohen shtresat në nevojë dhe rrogëtarët - sipas Kryeministrit pagat do të paguhen - dhe më pas kategoritë e caktuara, bizneset e kështu me radhë.

Sigurisht që bizneset duhen mbështetur dhe kjo mbështetje do të vijë sipas një plani të caktuar; këtë do ta dëgjojmë nesër. Ajo që ne mund të bëjmë si Banka e Shqipërisë është masa që tashmë e kemi marrë, për një shtyrje të pagesave të këstit të kredisë, pavarësisht faktit që kjo nuk është automatike. Ne po punojmë shumë ngushtë me bankat e nivelit të dytë, përmes një *task force*, në mënyrë që bankat të krijojnë lehtësi. Kjo është çka ne mund të bënim për biznesin,

“Një ndër funksionet tona si bankë qendrore është furnizimi i tregut bankar me likuiditet në funksion të vazhdimin të kreditimit të ekonomisë.”

brenda kuadrit tonë ligjor. Gjithashtu, një ndër funksionet tona si bankë qendrore është furnizimi i tregut bankar me likuiditet në funksion të vazhdimit të kreditimit të ekonomisë.

Pyetje: Pra ju do të fusni likuiditet në treg?

Gubernatori: Ne e bëjmë këtë rregullisht.

Pyetje: Por a do të ketë shtesë?

Gubernatori: Ka pasur dhe do të ketë shtesë.


Pyetje: A keni një shifër për këtë?

Gubernatori: Ne bëjmë operacione të furnizimit të sistemit bankar me likuiditet çdo ditë. Në varësi të nevojës, do të rrisim likuiditetin dhe njëkohësisht do të marrim masa të tjera lehtësuese për sistemin bankar për të relaksuar raporte të caktuara kufizuese, në mënyrë që bankat të jenë më proaktive në kreditim. Pra, paralelisht me lehtësimin e politikës monetare që do të vendoset nga Këshilli Mbikëqyrës këto ditë, në ditët në vijim, ne do të marrim dhe masa lehtësuese për bankat, për të qenë me proaktive në kreditim, për të plotësuar nevojat që do të ketë biznesi.

Pra që të jem i qartë, bizneset në vështirësi do të përfitojnë nga një shtyrje tremujore e kësteve të kredisë. Gjithashtu, ato do të përfitojnë në vazhdimësi kredi dhe overdrafte nga bankat, për të vazhduar aktivitetin e tyre deri në përfundim të kësaj krize. Por, e theksoj dhe njëherë, duhet të jemi shumë të kujdesshëm me bankat, pasi ky aktivitet bëhet me depozitat e qytetareve.

Ne duhet ta mirëkuptojmë situatën financiare, duhet të dëgjojmë ekspertët dhe të shikojmë bilanci e bankave. Unë e kuptoj që disa biznese janë në kushte stresi dhe kërkojnë maksimumin, por dhe bankat kanë një bilanc për të menaxhuar dhe ky bilanc është i lidhur me depozitat e individëve. Ne duam që bankat të kontribuojnë në ekonomi, të kreditojnë, të menaxhojnë, të ndihmojnë, por njëkohësisht të jenë të shëndetshme.

Grafik 34. Operacionet e tregut të hapur të BSH dhe ecuria e normave të interesit në tregun ndërbankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pyetje: Vetëm se ka një nonsens që del nga kjo logjikë. Nga njëra anë nuk duhet që gjithë barrën t’ua vendosim bankave, por nga ana tjetër, sipas një lajmi të fundit, data 20 mars është shpallur ditë pushimi dhe këtë fundjavë do të aplikohet një mbyllje totale e vendit. Sigurisht, të parat që do ta pësojnë do të jenë bizneset, por ndërkohë ato do të duhet të jenë në rregull me pagesat e kredive.

Gubernuratori: Z. Balla, ne vendosëm për një shtyrje tremujore për bizneset që kanë vështirësi, duke parë që kjo është një krizë që evoluon përditë. Në varësi të situatës do të shohim dhe mundësinë e lehtësirave të tjera, por nuk mund të themi ende se çfarë do të ndodhë. Kjo është një krizë e veçantë, e paprecedentë. E ardhmja është e panjohur edhe për vendet e mëdha dhe bankat e tyre qendrore. Ne shpresojmë që e gjitha të përfundojë sa më shpejt dhe efektet të jenë sa më të vogla, por në qoftë se zgjat, duhet të kuptojmë që çdo ndihmesë do të bëhet brenda kapaciteteve që kanë si bankat ashtu dhe buxheti i shtetit. Asgjë nuk mund të kërkohet jashtë kapaciteteve.

Pyetje: Pra ne duhet të përgatitemi për falimente të bizneseve private apo jo?

Gubernuratori: Këtë nuk mund ta themi, por natyrisht që nëse një biznes nuk punon për një periudhë të zgjatur, do të ketë faliment.

Pyetje: Mos do ketë dhe falimente të qëllimshme, pra një biznes nuk pret të goditet plotësisht nga kriza, por e shpall falimentin përpara; këtu mund të hyjnë spekulimet me sistemin?

Guvernatori: Potencialisht çdo gjë ndodh, po nuk është ky thelbi. Thelbi është që, në vija të përgjithshme, duhet të jemi të kujdesshëm dhe të marrim masa që të mos kemi falimente në shumicën e bizneseve. Kjo lloj krize do e ketë një faturë financiare për buxhetin e shtetit, për sistemin financiar, për bizneset dhe individët. E rëndësishme është që të menaxhohet sa më mirë situata që në radhë të parë të ruhet shëndeti dhe më pas të koordinohet puna që ka filluar për të menaxhuar anën financiare që fatura të jetë sa më e ulët.

“E rëndësishme është që të menaxhohet sa më mirë situata që në radhë të parë të ruhet shëndeti dhe më pas të koordinohet puna që ka filluar për të menaxhuar anën financiare që fatura të jetë sa më e ulët.”

Pyetje: Z. Guvernator, në momentin që flasim, me një vendim të Këshillit të Ministrave, z. Arben Ahmetaj, ministri për Rindërtimin, ka marrë kompetenca edhe për menaxhimin e krizës nga pandemia. Ai do të menaxhojë situatën për koordinimin e institucioneve pikërisht për të hartuar masat për t’u përballur me një krizë të mundshme financiare. Këtu kam një pyetje që lidhet dhe me skemën e tërmetit. Për tërmetin u përdor një skemë shumë efikase, mendoj unë, që ishte në nivelin e suksesit të konferencës së donatorëve. Pra, atyre iu paraqit një plan i detajuar, i hartuar dhe në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe institucione të tjera, ku u llogarit edhe fitimi i munguar. A është e mundur që të ndiqni një skemë të tillë dhe për faturën e pandemisë?

Guvernatori: Mund të ndiqet një skemë e tillë, por kjo do të shihet. Edhe në rastin e tërmetit, ditët e para të goditjes ishin ditë proaktive për të shpëtuar jetë njerëzish. Pas kësaj u mendua për pjesën e faturës financiare dhe për menaxhimin e rimëkëmbjes. E njëjta gjë do të ndodhë dhe në këtë rast. Problemi është se ne jemi ende në fazën e parë dhe akoma nuk dimë se sa jetë njerëzore mund të humbasim dhe as shpejtësinë e përhapjes së virusit. Çështja është ta parandalojmë shpërndarjen e mëtejshme dhe të shërohen ata që janë të prekur. Informacioni nga institucionet e shëndetit publik është shumë i rëndësishëm, ashtu siç është edhe respektimi i rregullave. Në rast se do ta dinim kohëzgjatjen e kësaj situatë, atëherë do të dinim dhe sa do të ishte dëmi dhe do të ishim në gjendje të bënim llogaritjet. Por për fat të keq, nuk e dimë këtë.

Pyetje: Megjithatë z. Guvernator, kuptojmë se biznesit i bien lehtë alarmet. Le të themi se ekonomia jonë kishte një farë stabiliteti; një makrostabilitet. Pavarësisht krizës shumë të rëndë politike, dy goditjeve nga tërmeti, ekonomia gjithsesi e ruajti trendin e saj rritës, ndërkohë që ishte një trend të themi delikat. Nga ana tjetër, ka një shtim shumë të madh të presionit politik - kryesisht nga opozita, por dhe nga Presidenti i Republikës, i cili ishte i pari që e ngriti këtë alarm - që masat duhet të jenë po aq të shpejta sa masat drastike dhe shtrënguese. A mendoni se i bën mirë ky lloj presioni, klimës ekonomike në vend?

Guvernatori: Ne jemi në demokraci, kemi pozitë dhe opozitë, dhe natyrisht që opozita si detyrë të saj ka presionin korrektues. Në fakt, në situata krizash, do ishte mirë që të kishte bashkëpunim dhe komunikim. Ajo që do të sugjeroja është që komunikimi dhe bashkëpunimi të ishte më i mirë në këtë situatë. Kjo natyrisht që nuk varet nga unë, por çdo lloj sugjerimi, çdo lloj pikëpamje e ngritur shërben. Megjithatë, marrja në konsideratë e tyre është funksion i institucioneve dhe qeverisë, pasi ajo është përgjegjëse dhe ka informacionin dhe mundësitë konkrete për të gjykuar dhe për të vlerësuar çka është më e dobishme.

Pyetje: E shoh që jeni i kujdesshëm. Kam një pyetje për ju nga një drejtuese në një bankë të nivelit të dytë: shtyrja e kësteve për tre muaj do të konsiderohet modifikim i kredisë, a do të ndikojë apo ndryshojë statusin e klientit në regjistrin e Bankës së Shqipërisë? E thënë ndryshe, a do të dëmtohet historia e kredisë nga kjo shtyrje?

Guvernatori: Jo, ne do ta modifikojmë të gjithë statusin.

Pyetje: Çfarë masash do të merrni ju për këtë?

“... klientët e bankave do të kenë një riskedulum të pagesave të kësteve dhe interesave pa interesvonesë, dhe për të gjithë këta klientë nuk do të ketë ndryshim në status në Regjistrin e Kredive.”

Guvernatori: Në radhë të parë, klientët e bankave do të kenë një riskedulum të pagesave të kësteve dhe interesave pa interesvonesë. Për të gjithë këta klientë nuk do të ketë ndryshim statusi në Regjistrin e Kredive. Ato do të konsiderohen si kredi normale. Ne kemi komunikim me bankat dhe i kemi instruktuar ato ditë pas dite, pasi dhe vendimmarrja brenda dy-tre ditëve është e shpejtë, dhe sqarimi apo informacioni do një koordinim të mirë nga lart-poshtë. Këtë desha të sqaroja, jo vetëm për bankieren që ngre pyetjen,

por edhe për individët, klientët dhe bizneset, të cilët e kanë këtë problem.

Pyetje: Statusi i tyre?

Guvernatori: Statusi i tyre nuk do të preket. Absolutisht jo.

Pyetje: Z. Guvernator, në reagimet e dy-tre ditëve të fundit, kam parë grupet e interesit - bizneset, Dhoma e Tregtisë, Konfindustria, pedagogë të rëndësishëm të ekonomisë - të cilët e vlerësojnë ndërhyrjen e Bankës së Shqipërisë, por shprehen se nuk është e mjaftueshme.

Guvernatori: Për çfarë arsyeje nuk është e mjaftueshme?

Pyetje: Thonë se ka nevojë për ndërhyrje më të thella...

Guvernatori: Në çfarë kuptimi më të thella?

Pyetje: Këto janë rekomandimet e Dhomës Amerikane të Tregtisë:

1. Kërkesë për shtyrje afati ligjor për depozitimin e pasqyrave financiare. Bëhet fjalë për marrësin që e përmendët më herët, formularin për deklarimin dhe pagesën e tatimit mbi fitimin, njoftimin vjetor për transaksionet e kontrolluara.
Pra, këto të gjitha të shtyhen;
2. Eliminimin e detyrimeve fiskale për të paktën tre muaj, ndërsa për bizneset dhe sektorin e turizmit gjashtë muaj - me sa kujtoj, kjo është kërkuar dhe nga opozita;
3. Krijimin e një fondi të emergjencës që do të mundësojë akses në kapital, me anë të kredive të buta si dhe granteve, në mënyrë që bizneset të përballojnë efektin negativ të kësaj periudhe.


Guvernatori: Tani të gjitha këto janë kërkesa të logjishme. Do të duhet që qeveria të reagojë, sipas mundësive, për plotësimin pjesor ose të plotë të tyre. Një nga kërkesat e bëra nga Dhoma Shqiptare e Tregtisë apo nga grupi i dhomave të tregtisë, i drejtohej bankës qendrore, dhe konkretisht që kjo shtyrje e kësteve të kredisë për klientët që kanë vështirësi të jetë deri në një vit, pasi ka shtete që e kanë bërë me këtë afat.

Është e vështirë që shtyrja të bëhet deri në një vit, pasi do të kishte pasoja të mëdha financiare për bankat. Shtyrja u bë 3-mujore për të parë evoluimin e krizës. Duhet të shohim nëse bizneset do të rifillojnë veprimtaritë e tyre; sa më e shkurtër të jetë periudha e mbylljes, aq më e vogël do të jetë humbja.

Pyetje: Kjo është një arsye më tepër për të respektuar kufizimet, në mënyrë që kjo situatë të shkurtohet në kohë.

Guvernatori: Kjo është e vërtetë, por doja ta theksoja që kërkesa për shtyrje për një vit do të kishte efekt të thellë financiar. Shtyrja e kësteve të kredive për një periudhë njëvjeçare do të thotë ta godasësh sistemin bankar, pavarësisht nga situata e mirë e likuiditetit. Duhet të jemi realistë... Është praktikisht e pamundur, pasi duhet ruajtur stabiliteti financiar dhe ai i bankave, të cilat jo vetëm na duhen për të ndihmuar ekonominë me kredi, por në radhë të parë mbajnë depozitat dhe kursimet e qytetarëve. Ruajtja e shëndetit të tyre është shumë e rëndësishme.

Grafik 35. Ecuria e treguesve monetarë




Pyetje: Megjithatë, z. Guvernator do doja t’ju pyesja dhe për efektet e menjëhershme që ka kjo krizë tek industria ajrore private në Shqipëri, e cila është e brishtë. Pra, industria ajrore është goditur; ndërtimi është i goditur, sepse duket sikur kishte marrë një farë rritjeje në 6 muajt e fundit, pavarësisht krizës politike dhe tërmetit. Ajo që unë shikoj tani te tregu i banesave është se ka një stepje, një tkurrje të menjëhershme. Gjithashtu edhe turizmi, sipas Shoqatës së Turizmit, është goditur pasi ka anulime të shumta, sidomos nga jashtë.

Guvernatori: Po e filloj nga turizmi - të gjitha këto që përmendët janë industri shumë të rëndësishme, por po e filloj nga më e rëndësishmja – që është një nga shtyllat kryesore të ekonomisë shqiptare, e cila fatkeqësisht do të preket. Pra pas tërmetit, po merr dhe goditjen nga

pandemia. Turizmi është burim hyrjesh dhe të ardhurash të mëdha në ekonominë tonë. Ai ka qenë nga elementet kryesore që ka ndikuar dhe në forcimin e Lekut dhe në dobësimin e Euros, përveç të hyrave të tjera nga investimet e huaja direkte dhe remitancat...

Grafik 36. Zërat kryesorë në llogarinë e shërbimeve (flukse neto në milionë euro)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pyetje: Dhe remitancat besoj do të pësojnë goditje të fortë...

Guvernatori: Edhe ato mund të pësojnë goditje, pasi pandemia ka prekur një nga shtetet kryesore nga vijën remitancat, Italinë.


Pyetje: Greqia gjithashtu, Britania e Madhe, Shtetet e Bashkuara të Amerikës...

Guvernatori: Dhe ato po preken ekonomikisht, por jemi ende të paqartë për të ardhmen. Në këto ditë, remitancat nuk janë prekur. Unë kam kontaktuar me institucionet kryesore financiare që janë ndërmjetës për sjelljen e remitancave në Shqipëri, dhe shprehen se ato vazhdojnë normalisht. Megjithatë, do të shohim se si do të shkojnë në ditët në vijim. Turizmi sigurisht që do të preket dhe lidhur me këtë duhet menduar seriozisht. Ne do të konsultohemi dhe do të bashkëpunojmë me qeverinë për të vlerësuar se cilat mund të jenë iniciativat për këtë industri kaq të rëndësishme të ekonomisë shqiptare. Sigurisht, ndërtimi gjithashtu është një sektor shumë i rëndësishëm, i cili dhe ai mund të ketë ndikim; të gjithë sektorët do të kenë ndikim.

Pyetje: Sipas jush, cilët do të jenë sektorët që do të goditen më shumë?

Guvernatori: Sektorët kryesorë që do të goditen janë turizmi dhe eksportet shqiptare, fasonet. Në radhë është turizmi, pasi besoj që kjo krizë ka sjellë anulim rezervimesh dhe ne nuk do të kemi këtë vit prurjet e vizitorëve si normalisht. E përsëris, nuk e dimë sa do të zgjasë mbyllja. Nëse zgjat deri në korrik, goditja do të jetë shumë e madhe, por le të shpresojmë që kriza të mos zgjasë dhe përfundimi do të jetë më i menaxhueshëm. Ndoshta me ndryshimin e stinëve ne do të kemi dhe një zbutje të virusit. Të shpresojmë!

Grafik 37. Ecuria e tregtisë në mallra



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pyetje: Shpresojmë, pasi në hemisferën jugore ku është verë, numri i të prekurve nuk ka arritur as 3000. A mund të jetë ky një indikator që, me afrimin e verës, gjërat do të ndryshojnë?

Guvernatori: Unë nuk jam mjek, por epidemitë e virozave, përgjithësisht kanë një cikël të caktuar, pra janë sezonale. Të shpresojmë se edhe ky grip, sado specifik, të ketë ciklin e tij.

Pyetje: Te ky detaj ka një debat për krizën ekonomike që po jep shenjat që do të fillojë. A do të jetë si kriza e vitit 2008 apo ajo e pas 11 shtatorit 2001. Ajo që thotë Steven Mnuchin, Sekretari i Thesarit të SHBA-së, që papunësia mund të shkojë deri në 20%, sigurisht flet për një skenar shumë negativ apo jo?

Guvernatori: Kriza, përveç papunësisë, mund të sjellë dhe deformime të tjera të parametrave makroekonomikë, pra përkeqësime, por papunësia është një element i rëndësishëm. Ajo mund të ketë ndikime në sektorin financiar, mund të ketë ndikime në monedha të caktuara, mund të ketë papunësi dhe falimentime, pra janë të gjitha elementet që sigurojnë një krizë. Për ne si bankë qendrore, e rëndësishme është që kjo krizë të mos të cenojë stabilitetin financiar; të mos preken bankat dhe depozitat e klientëve, pavarësisht nga humbjet që duhen menaxhuar. Ne do të bëjmë maksimumin për të ruajtur stabilitetin e çmimeve. Norma e interesit është një instrument në funksion të kësaj.

Pyetje: Ju po paralajmëroni sonte që do ta ulni normën?

Guvernatori: Në funksion të rezultateve, këtë do ta vendosë Këshilli Mbikëqyrës me votë.

Pyetje: Ju si do të votoni?

Guvernatori: Unë do të votoj për ulje të normës. Po e deklaroj votën time, por megjithatë do të informohem dhe do të vendos në varësi të rezultateve të analizave të ekspertëve. Informacioni që kam është paraprak. Ne do të shikojmë analizat dhe do të marrim një vendim si Këshill.

Pyetje: Besoj do të prisni dhe daljen e paketës nga ana e Qeverisë Shqiptare, për ta pasur pak më të qartë dhe vendimmarrjen e Këshillit Mbikëqyrës?

Guvernatori: Po dhe kjo ndikon në vendimmarrje.

Pyetje: Nga qeveria u tha se tërmeti do të kthehet në një moment të artë, për shkak të donacioneve dhe granteve, edhe për rritjen e mëtejshme të ekonomisë së vendit. Kjo besoj është pak e pamundur të pohohet sot apo jo? Unë e dyshoj që këto grante, kredi të buta apo donacione, të jenë përsëri në të njëjtin nivel që na u premtua; e dyshoj me thënë të vërtetën.

Guvernatori: Për tërmetin e keni fjalën?

Pyetje: Janë 1 miliard e 140 milionë që duhet të futeshin. Mendoni se do të ndodhë?

Guvernatori: Kreditë janë të dedikuara për Shqipërinë dhe duke abstrguar nga kriza e momentit, ato do të aplikoheshin në varësi të kapaciteteve thithëse që ne do të kishim, pra do të menaxhoheshin nga Qeveria Shqiptare në varësi të projekteve. Edhe grantet janë sipas projekteve. Kreditë do të duhet të tërhiqeshin me një kontroll të rreptë siç është thënë deri tani qoftë nga Kryeministri qoftë nga Qeveria Shqiptare. Për shembull, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, institucionet ndërkombëtare, Banka Botërore etj., e kontrollojnë shumë mirë destinacionin e fondeve të tyre; nuk mund t'i kalosh fondet nga bujqësia në turizëm.

Pyetje: Ose mund të blesh makina për administratë?

Guvernatori: Nuk mund të ndërrohet destinacioni. Për këtë ka projekte konkrete.

Pyetje: Pra, këto fonde nuk mund t'ua kthejmë? Pyes pasi në këtë krizë çdo vend ka shqetësimet e veta.

Guvernatori: Jo, nuk besoj. Qeveritë janë korrekte; ato qeveri të cilat kanë alokuar fonde për menaxhimin e krizës së tërmetit, nuk do tërhiqeshin. Sfida kryesore është procesimi me eficiencë, në mënyrë që ne t'i tërheqim këto fonde. Nga një vlerësim i përgjithshëm, ne kemi parashikuar që vetëm 70% e fondeve do të tërhiqeshin. Do të ishte shumë mirë nëse ne do të ishim në gjendje të administronim 70% të këtyre fondeve, pra 700 – 800 milion; do të jepnin një impakt shumë të mirë, jo vetëm për lehtësimin e jetës së qytetarëve të dëmtuar, por edhe për ekonominë.

Pyetje: Në momentin që niveli i importeve do të bjerë për shkak të masave kufizuese, edhe të BE-së, nuk do të kemi prurje të mallrave të konsumit. Kjo nuk do të thotë që në Shqipëri nuk ka prodhim të produkteve të konsumit. Pra, dhe nga pijet alkoolike - për shembull sektori i birrës që është sektor i rëndësishëm dhe i zhvilluar - por dhe bujqësia e produktet vendase, a mund të kthehet ky në një moment që artë për biznesin vendas, pasi kriza shëndetësore të kalojë?

Guvernatori: Për momentin është moment i artë për supermarketet dhe farmacitë. Pavarësisht se për disa është një moment i keq, natyrisht që mund të jetë një moment i artë për disa biznese të tjera si prodhuesit vendas, të cilët mund të furnizojnë tregun vendas. Megjithatë, është pak e vështirë që të kthehet në një moment të artë për të gjithë ekonominë shqiptare.

Pyetje: Flas për sektorin e prodhimit.

Guvernatori: Edhe për sektorin e prodhimit. Natyrisht që do të ketë riorientime; do të ketë ndryshime.

Pyetje: A mund të stimulohet kjo gjë? Se ndonjëherë, siç është në PR, ajo që është pika më e dobët mund të kthehet në pikën më të fortë.

Guvernatori: Natyrisht që mund të stimulohet. Ka politika proteksioniste për prodhimet vendase dhe mund të stimulohet prodhimi vendas.

Pyetje: Tani politika proteksioniste është në fuqi, pasi të gjitha vendet i kanë mbyllur kufijtë.

Guvernatori: Sigurisht që për shkak të nevojave, për shembull bujqësia, këto ditë, mund të ketë dhe rritje – megjithëse edhe kjo mbetet për t'u parë nga shifrat që do të vijnë – kjo edhe sepse fshati nuk është prekur nga COVID-19.

Pyetje: Për momentin harta tregon që nuk kemi një shtrirje.

Guvernatori: Po, dhe fshati po vazhdon aktivitetin për prodhimin bujqësor. Kërkesa për produkte bujqësore, për sa kohë që s'ka import, do të plotësohet nga prodhimin vendas. Kjo është diçka shumë e mirë për prodhuesit vendas, që kanë pasur problemin e pikave të grumbullimit ...

Pyetje: Edhe për sektorin prodhues, që ndeshet me çmime shumë konkurruese nga produktet e importit.

Guvernatori: Po, dhe sektorë të tjerë, por bujqësia është një sektor shumë i rëndësishëm që mund të përfitonte. Megjithatë, e përsëris, se të gjitha këto janë për t'u parë në vijim.

Pyetje: Kjo mund të vlejë edhe për turizmin e brendshëm. Në vend të Turqisë apo Greqisë, pushuesi shqiptar mund t'i kalojë pushimet në Vlorë, në Durrës...

Guvernatori: Pasi të tejkalohet kriza, pushuesit shqiptarë do të shkonin përsëri në Turqi dhe Greqi. Kjo gjendje do të harrohej shpejt...

Pyetje: Do harrohej gjithçka thoni ju?

Guvernatori: Pastaj do të ngelej fatura financiare, por sigurisht jeta vazhdon. Njerëzit do të vazhdojnë jetën e tyre dhe është krejt normale. Shpresojmë që

“Një parashikim i përgjithshëm, me të dhënat e mëparshme është që rënia ekonomike e këtij viti do të kompensohet konsiderueshëm vitin që vjen.”

gjithçka të mbarojë sa më shpejt. Mund të ketë një riorientim të ekonomive prodhuese, të brendshme, por në rang ekonomie do të ketë pasoja negative - këtë duhet ta pranojmë - dhe se sa do të jetë kjo goditje mbetet për t'u parë. Ne duhet të menaxhojmë situatën në mënyrë që goditja të jetë sa më e ulët, por në vija të përgjithshme, do të kemi një rënie të ritmeve ekonomike. Nuk vlerësojmë se do të kemi recesion ose të paktën jo në nivel viti; për këtë tremujor mund të kemi recesion, por ai do të kompensohet. Një parashikim i përgjithshëm, me të dhënat e mëparshme, është që rënia ekonomike e këtij viti do të kompensohet konsiderueshëm vitin që vjen. Ne si bankë qendrore kishim bërë një korrektim të rritjes ekonomike, pas ndikimit të tërmetit, i cili ishte 3% këtë vit dhe 4% vitin tjetër. Në këtë rast mund të kemi një rritje më të ulët këtë vit, e cila mund të shkojë afër zeros, por kjo do të kompensohet nga një rritje shumë më e lartë vitin që vjen; një rritje e menjëhershme që mund të shkonte në 5.9%. Këto natyrisht janë parashikime që duhet t'i përfundojmë. Ato do t'i komunikojmë për publikun në Deklaratën e Politikës Monetare, shoqëruar dhe me vendimmarrjen e politikës monetare. E rëndësishme është të menaxhojmë krizën dhe të ulim numrin e të prekurve. Sa më shpejt që të ulët numri i të infektuarve dhe të menaxhohet kriza, aq më e ulët do të jetë fatua financiare.

Pyetje: Z. Guvernator, faleminderit që ishit me mua sonte!

Guvernatori: Faleminderit juve!

INTERVISTA E GUVERNATORIT GENT SEJKO PËR TELEVISIONIN KLAN

- 26 mars 2020 -

Pyetje: Ju falënderoj për intervistën! Ndodhemi në një situatë të vështirë, ndërkohë që një ditë më parë, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë ka marrë një vendim për të lehtësuar fort politikën monetare. Çfarë synon kjo politikë monetare lehtësuese kaq e rrallë?

Guvernatori: Faleminderit! Ulja e normës së interesit synon uljen e koston së huamarrjes për gjithë operatorët ekonomikë në treg, në mënyrë që të lejojë një lehtësi shtesë në drejtim të riaktivizimit dhe rigjallërimit të aktivitetit ekonomik. Kjo ulje me 0.5% ka qenë më e fortë se herët e tjera kur ne kemi ulur normën e interesit me 0.25%. Pikërisht, për shkak të situatës ekonomike që është në një ngërç më të fortë se sa ato që ne kemi parë historikisht, ne jemi përpjekur maksimalisht që ta marrim këtë masë. Natyrisht që duhet të jemi të qartë se ulja e normës së interesit nuk është “shkop magjik” për zgjidhjen e situatës ekonomike, por është vetëm një masë që ndikon në stimulimin e kreditimit në ekonomi, dhe që patjetër duhet të jetë e ndërthurur me masat të tjera që ka ndërmarrë Qeveria Shqiptare.


“Ulja e normës së interesit synon uljen e koston së huamarrjes për gjithë operatorët ekonomikë në treg, në mënyrë që të lejojë një lehtësi shtesë në drejtim të riaktivizimit dhe rigjallërimit të aktivitetit ekonomik.”

Pyetje: Ditët e fundit kemi parë një dobësim të monedhës kombëtare, pra një nënçmim të Lekut, ndërkohë që ulja e normës së interesit të Lekut mund të sillte një dobësim të mëtejshëm. Çfarë është duke ndodhur me tregun e këmbimit valutor?

Guvernatori: Në Republikën e Shqipërisë ne zbatojmë regjimin e lirë të kursit të këmbimit - pra ne nuk ndërhyjmë në qoftë se parametrat tanë për ndërhyrje nuk arrihen - dhe sipas një regjimi të lirë, kursi i këmbimit natyrisht që përcaktohet nga tregu, sipas kërkesës dhe ofertës. Kjo krizë i ka bllokuar të gjitha këto kanale - kryesisht turizmi është i bllokuar, investimet e huaja dhe biznesi - remitancat kanë vazhduar, por dhe ato do të kenë një efekt. Këto të gjitha janë një kufizim i prurjeve të Euros

në ekonominë shqiptare. Ne ndërhyjmë kur objektivi jonë kryesor, pra inflacioni, është i rrezikuar, por në këtë situatë, ne do të vazhdojmë të ndjekim një regjim të lirë të kursit të këmbimit.

Grafik 38. Kursi i këmbimit në tregun vendas dhe treguesi i anshmërisë për mbicim/nënçim*



*Treguesi i anshmërisë për mbicim/nënçim illogaritet si raport i numrit të ditëve kur kursi është mbicuar kundrejt numrit të ditëve kur kursi është nënçuar, në një horizont kohor rrethqitës që mund të variojë, p.sh., nga 22 ditë (një muaj kalendarik) deri në 250 ditë (një vit kalendarik). Vlera 1 e këtij treguesi përfaqëson vlerën ekuilibër ku numri i ditëve që kursi është mbicuar është i barabartë me numrin e ditëve kur kursi është nënçuar, dhe tregon se në treg nuk ka pasur anshmëri për mbicim apo nënçim. Nëse vlera e këtij treguesi është mbi 1 (nën 1), atëherë në treg ka sinjale për pritshmëri të njëanshme për mbicim (nënçim) të kursit.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pyetje: A është e gatshme Banka e Shqipërisë që të aktivizojë operacione shtesë për një skenar shumë të errët për ekonominë shqiptare?

Guvernatori: Së pari, shpresojmë të mos kemi një skenar shumë të errët. Natyrisht, ekonomia jonë ashtu si të gjitha ekonomitë botërore do të pësojë goditje dhe ndikim negativ. Ritmet e rritjes ekonomike apo rënia ekonomike është për t’u parë dhe për t’u matur; ne kemi likuiditet dhe kartëmonedhë të mjaftueshme për të mbështetur sistemin financiar dhe nëpërmjet tij të gjithë tregun. Kjo është një nga masat që ne përdorim dhe natyrisht që do të përdoret dhe në këtë rast. Përtej normës së interesit, në rast se do të jetë e nevojshme dhe do të plotësohen kriteret ligjore, ekonomike dhe makroekonomike, ne mendojmë se mund të përdorim edhe lehtësimin sasior. Një shembull lehtësimi sasior mund të ishte blerja e bonove të thesarit dhe letrave me vlerë të Qeverisë Shqiptare, nëpërmjet sistemit bankar ose në mënyrë direkte.

Pyetje: Disa ditë më parë ju dhe Kryeministri keni firmosur një urdhër ku i kërkohet bankave të nivelit të dytë që të shtyhet shlyerja e kësteve të kredisë, për personat dhe bizneset afësia paguese e të cilëve është prekur nga pandemia. Si po zbatohet ky urdhër nga bankat e nivelit të dytë?

Guvernatori: Banka e Shqipërisë ka bërë ndryshimet e duhura rregullative për t'i lehtësuar bankat që të ndihmojnë klientët e tyre me një shtyrje tremujore të kësteve të kredisë dhe të interesave, pra të këstit principal dhe interes. Nëse do të duhet të bëjmë një lehtësim të mëtejshëm, këtë do ta shikojmë në bashkëpunim me sistemin bankar, por për momentin kemi parë një gatishmëri dhe një reagim shumë të mirë të të gjithë sistemit.

Pyetje: Për sa i përket fondit të garancisë sovrane, i cili do të shkojë në ndihmë të bizneseve të mëdha, për t'i kredituar ato që janë në pamundësi për të dhënë pagat e punëtorëve. A keni biseduar me bankat për të hartuar rregulloret se si do të zbatohet kjo lloj procedure?

Guvernatori: Po bashkëpunohet me bankat dhe kjo është duke u elaboruar më tej. Duhet kuptuar që duhet të tregohemi të duruar, pasi çdo masë e marrë - si në rastin e shtyrjes së këstit të kredive ashtu dhe në rastin e lëshimit të garancisë nga ana e Qeverisë Shqiptare – ka nevojë për disa ditë kohë për t'u implementuar, pasi duhet të koordinohen veprimet në mënyrë që këto instrumente të bëhen funksionale. Pra duhet pak durim, natyrisht që dhe ky instrument do të bëhet funksional.

“... pak durim, pasi çdo masë e marrë - si në rastin e shtyrjes së këstit të kredive ashtu dhe në rastin e lëshimit të garancisë nga ana e Qeverisë Shqiptare – ka nevojë për disa ditë kohë për t'u implementuar, pasi duhet të koordinohen veprimet në mënyrë që këto instrumente të bëhen funksionale.”

Pyetje: A ka pasur ndryshim të skenarëve të pritshmërive të inflacionit?

Guvernatori: Ne nuk kemi hasur ndonjëherë në një krizë si kjo që po kalojmë - jo vetëm ne si Bankë Shqiptare, por edhe të gjitha bankat qendrore apo ekonomitë e mëdha ose të vogla, të zhvilluara ose të pazhvilluara të globit. Në këtë kuptim, është e natyreshme që do të kërkojë një analizë më të gjatë. Sigurisht që do të kemi një ndryshim në ecurinë e inflacionit, pasi efektet dhe goditjet e krizës do të ndikojnë në ecurinë e tij.

Pyetje: Qeveria parashikon një rritje ekonomike në nivelin 2% nga 4.1% që kishte projektuar në fillim të vitit 2020, në buxhetin e shtetit. A jeni dakord me këtë lloj parashikimi apo ju duhen ende analiza dhe matje të tjera?

Guvernator: Do të isha shumë i lumtur - që të jem i sinqertë me ju - në rast se do të kishim një rritje 2% këtë vit. Këtë vit, rritja mund të jetë dhe më e ulët se atë, megjithatë kjo është për t'u parë dhe analizuar në vijim.

Gazetarja: Ju falënderoj!

Guvernatori: Faleminderit juve!

INTERVISTË E GUVERNATORIT SEJKO PËR TELEVISIONIN VIZION PLUS

- 31 mars 2020 -

Kronika: Efektet që do të pësojë ekonomia nga izolimi i pandemisë do të jenë të dyfishta, si nga ana e kërkesës, ku konsumi dhe investimet do të bien, ashtu dhe nga oferta, ku prodhimi dhe volumet tregtare do të tkurren. Por askush deri më tani nuk llogarit dot kostot, për aq kohë sa nuk dihet kohëzgjatja e pandemisë. Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, në një intervistë për Vizion Plus, thotë se me mirëmenaxhim, situata mund të përballohet edhe për 3 muaj me radhë.

Guvernatori Sejko: Masat e Bankës së Shqipërisë janë në njërin kah, në kahun e ofertës; sigurisht që ka shumë masa të tjera të ndërrmarra nga Qeveria Shqiptare, të cilat janë bërë tashmë publike, që kanë të bëjnë me politikën dhe lehtësirat fiskale. Duke i parë në kompleks të gjitha masat e marra, unë mendoj që, të paktën për një tremujor, ne jemi të përgatitur ta kalojmë këtë situatë. Situata është vërtet dinamike dhe nuk kemi ende shifra të sakta, por me burimet dhe rezervat që kemi, besoj se e përballojmë me sukses këtë situatë për një tremujor.

Kronika: Sipas Guvernatorit, aktualisht jemi ende larg skenarit për të prekur rezervën valutore. Kjo pasi fillimisht banka mund të përdorë mekanizmin që njihet si lehtësimi sasior, që parashikon blerjen e bonove të thesarit të qeverisë.

Guvernatori Sejko: Po injektojmë dhe po furnizojmë tregun me likuiditetin e nevojshëm. Për këtë, gjatë kësaj periudhe, kemi organizuar ankande pa limit. Në rast se sistemi bankar ose qeveria do të kenë nevoja të mëtejshme për likuiditet - në raste përkeqësimi të situatës, nga izolimi dhe bllokimi - atëherë sigurisht që ne do të përdorim lehtësimin sasior, pra nëpërmjet sistemit bankar do të blejmë bono thesari të Qeverisë Shqiptare. Rezerva valutore

“Rezerva valutore është instrumenti/elementi i fundit që mund të përdoret, jo për arsye se është tabu, por për përdorimin e saj ka kritere ligjore dhe ekonomike të përcaktuara.”

është instrumenti/elementi i fundit që mund të përdoret, jo për arsye se është tabu, por për përdorimin e saj ka kriterë ligjore dhe ekonomike të përcaktuara. Unë besoj që me instrumentet që përmenda, ne nuk do të shkojmë tek prekja e rezervës valutore, pasi ne kemi mallra dhe materiale importi të nevojshme për vazhdimin normal të jetës. Ekonomia, pavarësisht kufizimeve, po vazhdon të funksionojë.

Kronika: Por izolimi nga pandemia ka sjellë edhe një nënçmim të monedhës kombëtare, duke bërë që kursi i këmbimit të pësojë luhatje. Që nga koha e karantinës, Euroja është forcuar me rreth 9 lekë, duke u këmbyer me 131 lekë në tregun valutor.

Guvernatori Sejko: Situata aktuale ka bërë që një sërë kanalesh, si turizmi apo investimet dhe të hyrat e tjera, të ndërpriten, si pasojë e masave izoluese për mbrojtjen e shëndetit të popullatës. Kjo natyrisht që do të ketë një ndikim në kursin e këmbimit, pasi ai është në radhë të parë rezultat i kërkesës dhe ofertës për euro në treg. Megjithatë, do të thosha që sot ne vumë re një stabilizim, pra një ngushtim të *spread*-eve në kursin e këmbimit. Shpresojmë të mos kemi një mbiçmim të vazhdueshëm, shumë më të lartë.

Kronika: Ajo çka pritet më tej është një rritje e çmimeve të produkteve dhe shërbimeve, por Banka e Shqipërisë thotë se për shkak të rezervave që ka tregu, rritja nuk pritet të jetë e ndjeshme.

Guvernatori Sejko: Ashtu si kursi i këmbimit edhe çmimet përcaktohen nga kërkesa dhe oferta në treg, por një lajm i mirë është që ne kemi rezerva të mjaftueshme ushqimore dhe të mallrave kryesore për të cilat ka nevojë tregu, jo vetëm për një tremujor. Kjo do të garantojë që të mos kemi një rritje të ndjeshme të çmimeve. Do të ketë sigurisht luhatje në disa produkte të caktuara, në disa mallra të shportës, për të cilat mund të ketë një kërkesë më të madhe nga tregu. Besoj që rritja e çmimeve nuk do të jetë me përmasa galopante.

INTERVISTË E GUVERNATORIT SEJKO PËR TELEVISIONIN A2CNN

- 1 prill 2020 -

Pyetje: Z. Guvernator, pyetja e parë ka të bëjë me takimin e sotëm, me konferencën online me Kryeministrin. Çfarë u diskutua saktësisht?

Guvernatori: Mirëmbërëma! Sot, siç e keni parë dhe ju, kemi organizuar një takim nëpërmjet video-konferencës me Qeverinë Shqiptare, Kryeministrin dhe ministrin Ahmetaj, dhe me drejtorët e bankave të nivelit të dytë. Takimi ishte koordinativ, këshillimor, pra nuk pati vendimmarrje, por shkëmbim informacioni, në funksion të veprimeve që po ndërmerim kohët e fundit. Kjo ishte mjaft e nevojshme për të rakorduar veprimet midis bankave të nivelit të dytë, qeverisë, tregut dhe bankës qendrore. Konkretisht, ne diskutuam në radhë të parë lidhur me iniciativën dhe vendimin për shtyrjen tremujore të kësteve të kredive të klientëve bankarë, dhe pamë që bankat e nivelit të dytë, praktikisht, e kanë adresuar seriozisht dhe në mënyrë proaktive problemin. Ato po veprojnë ditë pas dite me gjithë klientët, si biznese dhe individë; nuk shikojmë ndonjë problem në këtë aspekt. Na u kërkua që të fillojmë të mendojmë në vazhdimësi nëse do të ketë probleme me biznesin edhe pas një tremujori, për të parë lehtësirat e mundshme që mund të krijojmë nga ana rregullative.

“... pati një shkëmbim informacioni në funksion të veprimeve që po ndërmerim kohët e fundit dhe kjo ishte mjaft e nevojshme për të rakorduar veprimet midis bankave të nivelit të dytë, qeverisë, tregut dhe bankës qendrore.”

Pyetje: Është një çështje shumë interesante kjo e kredive për një periudhë tremujore, duke pasur parasysh që ka qenë një kërkesë e vazhdueshme e komunitetit të biznesit, por pa dyshim e mirëpritur dhe nga qytetarët e thjeshtë. Megjithatë shpeshherë është shoqëruar me një paqartësi, në rast se bëhet fjalë për pranimin e të gjitha kërkesave që do të vijnë nga individët dhe bizneset apo vetëm për ato biznese apo qytetarë të cilët do t'i vërtetojnë bankës që ndodhen në vështirësi. Në përfundim, do të jetë banka ajo që do të vendosë apo bëhet fjalë për një urdhër dhe sistemi bankar është i detyruar që të aprovojë shtyrjen për çdo rast që paraqitet? Kjo është çështje që vlen të sqarohet.

Guvernatori: Vendimi ynë i jep bankave të drejtën për të gjykuar rastet, pra jo të gjithë klientëve do t'u shtyhet kësti i kredisë në mënyrë automatike. Kjo mund të bëhet vetëm nëpërmjet një ligji, me një garanci të caktuar dhe duhet të kishte formën e një moratoriumi të prerë. Ne nuk e gjykuam këtë si mënyrën e duhur, pasi mund të krijonte vështirësi financiare për disa nga bankat e nivelit të dytë dhe siç dihet, stabiliteti financiar për ne ka rëndësi parësore. Pavarësisht nga kjo, filozofia, përqasja dhe ndërmarrja e veprimeve nga ana e bankave është shumë proaktive dhe pothuajse të gjitha kërkesat janë duke u trajtuar si të ishte një mënyrë automatike; bankat e nivelit të dytë po e aplikojnë shtyrjen në mënyrë të menjëhershme pas marrjes së kërkesës, madje disa prej tyre e kanë aplikuar pothuajse për të gjithë klientët. Sigurisht që ka raste përjashtimore që nuk janë të prekur nga kriza, p.sh. kur burimi i të ardhurave nuk është prekur nga kriza, dhe në këto raste nuk ka kuptim që të ketë miratim për shtyrje të këstit të kredisë. Këta klientë mund të jenë të pakët, por gjithsesi ekzistojnë. Nga diskutimi i sotëm nuk vëmë re që ka problematika. Qeveria nga ana e saj ishte e interesuar që të shikonte reagimin e bankave, njëkohësisht dhe ne nga këndvështrimi ynë në mbrojtje të stabilitetit financiar, donim të shikonim si po ecte procesi. Problemet do t'i shikojmë ndoshta pas një tremujori, dhe do të ndërmarrim veprime të mëtejshme, në rast se do të vazhdojë të ketë vështirësi.

Pyetje: Në fakt, z. Guvernator, në këtë situatë sistemi bankar është shumë i rëndësishëm, pasi jo vetëm që është financuesi kryesor i ekonomisë, por është një aktor kryesor në zbatimin e planit A të emergjencës ku përfshihen: garancia sovrane 100 milionë dollarë që do të vihet në dispozicion në mbështetje të të gjitha bizneseve të mesme dhe të mëdha të cilat do të kenë vështirësi në dhënien e pagave dhe mund t'i drejtohen sistemit bankar për marrjen e një kredie për mbulimin e kësaj nevoje; si dhe hapja e llogarive për kalimin e pagës së luftës. Duke pasur parasysh se edhe bankat në vetvete janë biznes, cila ka qenë qasja e sistemit bankar apo rekomandimet dhe kërkesat e tyre, në mënyrë që dhe ato të jenë në një situatë optimale në këtë periudhë të vështirë për të gjithë?

Guvernatori: Këto që sapo përmendët ishin dy nga çështjet që u diskutuan në takimin e sotëm. Pra: si do të operohej me fondin e garancisë prej 100 milionësh, akorduar nga qeveria për pagat e punonjësve të sektorit privat; dhe hapja e llogarive bankare nga ana e bankave të nivelit të dytë, të cilave iu kërkua nga qeveria të kenë një qasje fleksibël dhe mundësisht me kosto sa më të ulëta.

Unë dua t'i falënderoj të gjithë drejtuesit e bankave të nivelit të dytë për qasjen e tyre proaktive deri në këtë moment, pavarësisht nga disa problematika të vogla. Në përgjithësi, duhet të jemi të ndërgjegjshëm se ndodhemi në një situatë emergjence dhe të gjitha bankat kanë treguar gatishmërinë e duhur, kanë qenë bashkëpunuese dhe kanë kryer aktivitetin në mënyrë të përkryer. Normalisht, fondi i garancisë i lëshuar nga qeveria do të përdoret nga bankat e nivelit të dytë, pra ato e kanë marrë këtë detyrë me seriozitet; ky ishte konfirmimi që ne morëm nga drejtorët e bankave të nivelit të dytë. Gjithsesi, ecuria e procesit do shihet në vijim. Gjithashtu, nga drejtuesit e bankave të nivelit të dytë na u premtua se hapja e llogarive bankare do të procesohet shpejt. Në këtë kontekst, ata kishin një shqetësim në lidhje me orarin e punës, pasi masat kufizuese të lëvizjes së popullatës krijojnë problematikë në funksionimin operacional të bankave të nivelit të dytë. Duhet të jemi të qartë që një klient banke shpenzon më shumë kohë se një klient që shkon në supermarket pasi vetë procesi kërkon një farë kohe dhe kjo krijon radhë. Bankave iu premtua se mund të vazhdojnë punën operationale deri në ora 13:00. Me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë është rakorduar që nëse punonjësit e bankave do të jenë në lëvizje pas orës 13:00, duke treguar kartën e bankës si punonjës banke, ata nuk do të ndalohen.

Takimi i sotëm ishte një takim informues dhe koordinues, për të matur se sa është kuptuar nga sistemi bankar paketa e masave të marra, si dhe ndryshime të caktuara rregullative që janë bërë dhe do të bëhen në vijim, si nga ana e qeverisë ashtu edhe nga ana e bankës qendrore. Pati disa kërkesa nga drejtuesit e bankave për ne si bankë qendrore, për të marrë në shqyrtim lehtësira të tjera në vazhdimësi, sa i përket trajtimit me provigjione ose kërkesave për kapital. Këto do të elaborohen në ditët në vijim, por sigurisht që gjithçka do të varet nga kohëzgjatja e krizës. Për momentin, unë do të thosha që gjendja e stabilitetit financiar dhe e sistemit bankar vazhdon të mbetet e shëndetshme, me tepricë likuiditeti, me një normë të lartë mjaftueshmërie, një personel të mirëtrajnuar e të gatshëm për të shërbyer. Bankat do të jenë në funksionim dhe fatmirësisht sistemi bankar është një nga shtyllat kryesore që do të ndihmojë në kalimin e kësaj situatë të vështirë, në mënyrë sa më të mirëmenaxhuar dhe me më pak vështirësi.

“Takimi i sotëm ishte një takim informues dhe koordinues, për të matur se sa është kuptuar nga sistemi bankar paketa e masave të marra, si dhe ndryshime të caktuara rregullative që janë bërë dhe do të bëhen në vijim, si nga ana e qeverisë ashtu edhe nga ana e bankës qendrore.”

Pyetje: Z. Guvernator, padyshim që është një lajm i mirë që sistemi bankar është likuid dhe i mirëkapitalizuar, duke pasur parasysh se duhet të jetë dhe në përgjigje të një prej veprimeve që ka marrë së fundmi Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, nënkuptoj këtu uljen e kostos së Lekut, normës bazë të interesit, që tashmë ka zbritur në minimumin historik prej 0.5 për qind. A e shikoni ju si një mekanizëm që do të ndihmojë në rimëkëmbjen e ekonomisë në një periudhë të dytë, pasi faza e emergjencës shëndetësore të ketë kaluar, dhe a do të ketë ndonjë përgjigje nga ana e bankave, nëpërmjet një reagimi të uljes së interesave të kredive të reja në Lek?

Guvernatori: Nëse shikon planin e masave të të gjitha bankave qendrore të prekura nga kjo situatë - të rajonit, të Eurozonës, por dhe më gjerë – has pothuajse në të njëjtat masa. Duke qenë se bankat qendrore kanë si objektivi kryesor stabilitetin e çmimeve, masa e parë është ulja e normës së interesit - me përjashtim të bankës qendrore evropiane, e cila ishte në një normë negative interesi, të gjitha bankat e tjera qendrore, FED-i e etj. që kanë pasur hapësirën e nevojshme, kanë bërë një ulje të normës së interesit. Ulja e kësaj norme shërben për të ulur koston e huamarrjes dhe koston e shërbimit të borxhit, pra politika monetare lehtësuese aplikohet me uljen e normës së interesit, për të nxitur kreditimin, konsumin dhe investimet. Sigurisht që dhe pas kësaj situatë krize, kjo ulje e normës së interesit do të ndihmojë publikun, të gjithë agjentët ekonomikë dhe sistemin bankar, për të pasur një kosto sa më të ulët të kredisë, por në funksion të nxitjes së konsumit dhe investimeve. Ky është instrumenti

“Ulja e normës së interesit shërben për të ulur koston e huamarrjes dhe koston e shërbimit të borxhit, si dhe për të nxitur për kreditimin, konsumin dhe investimet.”

bazë i bankave qendrore që dhe ne aplikojmë, duke qenë në nivelin 1%, kishim ende pak hapësirë. Përtej kësaj, sikurse kemi theksuar edhe në komunikime të mëparshme, kemi planifikuar masa të tjera me instrumente jokonvencionale, të cilat mund t'i përdorim, në rast se situata do të përkeqësohet. Fatmirësisht, kemi një gjendje të mirë likuiditeti dhe këtë gjendje likuiditeti ne do ta përdorim, gjithmonë në përputhje me kriteret dhe kufizimet ligjore.

Pyetje: Tashmë është pranuar nga të gjithë - nga Christine Lagarde e FMN-së, nga BQE-ja, OECD-ja - që pandemia COVID-19 do të shoqërohet me një krizë ekonomike, dhe pritet që të gjithë të biem në një recesion të thellë nga i cili edhe Shqipëria nuk mund shpëtojë. Duket sikur shenjat e para të kësaj krize kanë trokitur, duke pasur parasysh edhe pushime nga puna në disa industri, të diktuar edhe

nga situata. Në një letër drejtuar sot Kryeministrit nga industria fason kërkohej mbështetje për biznesin e madh. Në kuadër të të gjithë dinamikës, sa e thellë pritet të jetë kriza dhe cilat janë masat që ju do të rekomandonit, në mënyrë që edhe rimëkëmbja pas pandemisë të jetë sa më e shpejtë?

Guvernatori: Kjo që thoni është e vërtetë dhe çështja është shumë komplekse. Ekzistojnë një set masash, që ne do të rekomandonim. Në fakt, kjo është një krizë e rrallë, me të cilën globi nuk është përballur prej gati 100 vitesh, që nga koha e gripit spanjoll 1917-1918. Për këtë arsye bota është gjendur e papërgatitur. Në këtë situatë, të gjitha institucionet financiare ndërkombëtare si FMN-ja dhe BB-ja, por dhe bankat qendrore të shteteve të mëdha e të vogla, kanë filluar të bëjnë analizat dhe prognozatat e tyre, në funksion të ecurisë së krizës dhe të zhvillimeve ekonomike dhe makroekonomike. Sigurisht që situata ndryshon çdo ditë dhe çdo lloj prognoze është shumë e paqartë, pasi varet nga kohëzgjatja e krizës shëndetësore. Për sa kohë që kjo situatë do të vazhdojë, natyrisht që do të ketë dhe masa izoluese, të cilat godasin direkt ekonominë në dy drejtime, si në drejtim të prodhimit ashtu dhe të konsumit. Kjo është realisht një goditje e fortë, e cila po të zgjatet ka pasoja edhe në sistemet financiare. Nëse do t'i referohesha disa shifrave, megjithëse këto analiza nuk janë zyrtare, Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë parashikuar një recesion mbi 5% gjatë këtij viti, ndërsa Kina një recesion afër 4% , pra kemi të bëjmë me shifra të thella recesioni. Ekonomia shqiptare, pavarësisht se është një ekonomi e vogël, është e hapur ndaj tregjeve dhe partnerët tanë kryesorë janë në Eurozonë. Vende si Italia janë prekur rëndë nga pandemia dhe do të kenë problemet e tyre ekonomike, të cilat do t'i sjellin goditje të tyre në ekonominë shqiptare. Siç e thashë, gjithçka do të varet nga kohëzgjatja e pandemisë. Sa më e gjatë të jetë pandemia, aq më e vështirë do të jetë rimëkëmbja dhe aq më i thellë do të jetë dëmi financiar dhe ekonomik. Një parashikim i përafërt i ekspertëve të shëndetit është se në fund të muajit prill, do të kemi një rënie të shifrave të të prekurve dhe stina e verës shpresojmë të na kthejë në një situatë ku mund të fillojmë rimëkëmbjen. Rritja ekonomike pas kësaj situatë do të vijë e shpejtë, por gjithçka është e lidhur me dëmin e bërë gjatë kësaj periudhe.

“Sa më e gjatë të jetë pandemia, aq më e vështirë do të jetë rimëkëmbja dhe aq më i thellë do të jetë dëmi financiar dhe ekonomik.”

Faleminderit!

INTERVISTË E GUVERNATORIT SEJKO PËR EMISIONIN “OPEN” NË TELEVIZIONIN TOP CHANNEL

- 2 prill 2020 -

Pyetje: Së pari, a është normale që Kryeministri i Shqipërisë të nënshkruajë me Guvernatorin një marrëveshje kur institucionet duhet të jenë të pavarura? Do të doja të dija a ka ndodhur më parë kjo gjë?

Guvernatori: Kjo është krejtësisht normale, pasi ne jemi në një situatë krize dhe në një situatë të tillë çdo veprim në funksion të lehtësirave për sistemin financiar, për klientët dhe për qytetarët shqiptarë, natyrisht që është normale. Kjo bëhet ekskluzivisht brenda kufijve dhe kriterëve ligjore; e rëndësishme është që, nëpërmjet ndryshimeve rregullative që kemi bërë si bankë qendrore dhe urdhrit të përbashkët me Kryeministrin e Republikës së Shqipërisë, bankat e nivelit të dytë po e adresojnë seriozisht këtë problem dhe në mënyrë proaktive po shtojnë kështu e kreditë për të gjithë klientët me vështirësi financiare.

Pyetje: A po i shtojnë vërtet? Ne kemi folur me disa bankierë dhe në mënyrë konfidenciale ata thonë që urdhri është i papabuzuar në ligj. Gjithsesi ata e zbatojnë në mënyrë vullnetare këtë gjë për shkak se e shohin situatën. A po zbatohet realisht në 90% të bankave?

Guvernatori: Ne dje kemi pasur një audio-konferencë me të gjithë drejtuesit e bankave dhe unë jam në kontakt me ta në mënyrë të vazhdueshme. Ky veprim i ndihmon dhe vetë bankat në aktivitetin e tyre financiar, pasi në rast se klientët nuk do të jenë në gjendje të kthejnë kështu e kreditë, kjo do të krijonte vështirësi financiare dhe për portofolin e bankës; është një veprim që ndihmon jo vetëm klientët, por edhe bankat e nivelit të dytë. Në këtë kontekst dhe drejtuesit e bankave të nivelit të dytë janë “mirënjohës”, sepse ne po bashkëpunojmë në drejtim të ndryshimeve rregullative për të lehtësuar ngarkesën me fondin rezervë për

“Unë dëshiroj të përfitoj nga rasti për t’i falënderuar të gjithë drejtuesit dhe punonjësit e bankave të nivelit të dytë për proaktivitetin e treguar, jo vetëm në drejtim të shtyrjes së kësteve të kreditë, por edhe në drejtim të gjithë performancës së tyre operacionale në shërbim të klientëve.”

të mbuluar humbjet nga kreditë për bankat e nivelit të dytë lidhur me këtë veprim.

Unë dëshiroj të përfitoj nga rasti për t'i falënderuar të gjithë drejtuesit dhe punonjësit e bankave të nivelit të dytë për proaktivitetin e treguar, jo vetëm në drejtim të shtyrjes së kësteve të kredisë, por edhe në drejtim të gjithë performancës së tyre operacionale në shërbim të klientëve. Siç e dimë të gjithë, këto ditë kanë qenë të ngarkuara edhe psikologjikisht, dhe këta punonjës janë në mënyrë të vazhdueshme në shërbim të klientëve brenda orareve të lejuara.

Pyetje: Gjithsesi janë të njëjtët që thonë që kjo është e pabazuar në ligj. Pra ata kanë një kontratë mes privatësh dhe ky urdhër nuk është i mbështetur në një bazë ligjore. Jam e interesuar të di se cila është baza ligjore...

Gubernurori: Unë e kam shpjeguar që nuk është çështje e një baze ligjore. Banka e Shqipërisë ka ndryshuar rregulloren e riskut të kredisë që i lehtëson bankat nga ngarkesa me provigjione, pra është një çështje teknike, por gjithsesi ndryshimi rregullativ ia ka lehtësuar bankave shtyrjen e kësteve të kredisë. Kjo mund të bëhej dhe me një ligj të veçantë për të bërë një moratorium standard lidhur me shtyrjen e kësteve të kredive për të gjithë klientët, por rezultoi i panevojshëm pasi bankat u treguan proaktive në trajtimin e klientëve.

Pyetje: Çfarë do të bëhet me ato banka që e kanë problem shtyrjen e kështit?


Gubernurori: Në dijeninë time dhe nga kontaktet që unë kam, të gjitha bankat po i shtyjnë këstet e kredive për klientët që kanë aplikuar për këtë.

Pyetje: Të gjitha i kanë shtyrë, pra nuk ka oponencë ndaj kësaj? Kjo është e rëndësishme...

Gubernurori: Oponenca e vetme - ju keni të drejtë – vjen nga institucionet financiare jobanka, të cilat e kanë situatën e likuiditetit të varur shumë nga këstet e kredive, pasi nuk pranojnë depozita. Bankat janë më të shëndetshme nga ana e likuiditetit pasi kanë depozita. Këto institucione, në qoftë se nuk kanë shlyerjen e kësteve të kredive, e kanë shumë të vështirë të likuidojnë detyrimet e tyre, por këto lloj institucionesh kanë një peshë të vogël në tregun financiar. Klientët e tyre ankohen me të drejtë,

pasi kjo vendimmarrje e jona i përfshin edhe këto institucione, por ato nuk po tregohen aq proaktive sa bankat. Bankat që përbëjnë mbi 90% të tregut financiar, e kanë aplikuar me seriozitet këtë masë.

Grafik 39. Shpërndarja e burimeve të financimit të SFJB-ve për dhjetor 2019



Burimi: Departamenti i Statistikave dhe përpunime të stafit të Departamentit të Mbikëqyrjes.

INTERVISTË E GUVERNATORIT SEJKO PËR EMISIONIN “EKOPOLITIKË” NË TELEVISIONIN ORA NEWS

- 11 prill 2020 -

Pyetje: Mirëmbrëma, uroj të jeni mirë! Në diskutimin që kemi bashkë do të mundohemi të sqarojmë sa më shumë situatën nga këndvështrimi juaj institucional. Ta fillojmë me parashikimin e rritjes ekonomike. Si do të preket ekonomia shqiptare dhe si kanë ndryshuar një tërësi parametrash në këndvështrimin tuaj për këtë vit dhe për vitet e ardhshme?

Guvernatori: Ne jemi duke bërë analiza dhe nuk mund të themi qartësisht dhe saktësisht një shifër se sa do të jetë rritja ekonomike, pasi ekonomia shqiptare mori goditje nga tërmeti në tremujorin e fundit të vitit të kaluar. Ndërkohë që ne po përgatiteshim për të filluar planin e rikuperimit të dëmeve nga tërmeti, globin e preku pandemia COVID-19, e cila ka efekte edhe më të mëdha. Efekti i rritjes në prodhimin e përgjithshëm bruto të ekonomisë shqiptare ishte negativ edhe në tremujorin e vitit të kaluar, pasi të dhënat e fundit nga INSTAT-i treguan një rritje negative me -0.1 të PBB-së. Eurozona, SHBA-ja, të gjitha shtetet e mëdha, por dhe rajoni ynë, kanë parashikuar rënie ekonomike. Ne jemi duke punuar kryesisht me FMN-në, por dhe BB-në, për të pasur disa parashikimeve të sakta, por ato janë shumë të varura nga kohëzgjatja e pandemisë. Një gjë është e sigurt, që goditja do të jetë e fortë dhe ne mund të kemi një rritje negative këtë vit. Megjithatë, e rëndësishme është që të jemi të organizuar, në mënyrë që ta kalojmë periudhën e goditjes me sukses dhe të fillojmë sa më shpejt ringritjen. Kjo është ajo që mund të them për momentin, ndërsa nivelin e rritjes asnjë nga bankat qendrore, të rajonit apo gjere, nuk mund ta thotë me saktësi.

Tabela 5. Ndikimi në importe, punësim dhe shkallën e papunësisë

	Ndikimi në PBB (%)	Ndikimi në importe (%)	Ndikimi në punësim (%)	Ndikimi në papunësi (p.p.)	Shkalla e papunësisë (%)
Konsum	-4.0	-7.4	-5.5	+4.9	16.1
Investime	-1.1	-2.5	-0.9	+0.8	11.9
Eksport	-1.8	-3.6	-1.9	+1.7	12.9
Total	-6.9	-13.5	-8.3	+7.4	18.6

Burimi: INSTAT dhe vlerësime të autorëve.

Pyetje: Kjo është me rëndësi për t'u theksuar sepse edhe Kryeministri i vendit të njëjtën përgjigje ka dhënë, pra që është e vështirë të parashikohet. Megjithatë, ju mendoni se do të jetë në territor negativ, pra do të jetë me minus të paktën për këtë vit?

Guvernatori: Po, me sa duket do të jetë në territor negativ. Parashikimi i FMN-së për disa shtete të mëdha si SHBA-ja, Italia dhe Kina, është me shifra të thella negative. Natyrisht, kur shtete kaq të mëdha do të kenë një rritje negative, edhe për ne mund të themi të njëjtën gjë. Në rast se do të jemi në gjendje të rikthehemi sa më shpejt në kushte normale, atëherë dhe rritja dhe frenimi i rritjes negative do të jetë më i shpejtë. Ky nuk është "fundi i botës", pasi rikthimi mund të jetë më i shpejtë dhe i vrullshëm pas kalimit të pandemisë.

Pyetje: Normalisht këto lloj krizash vijnë një herë në 10 vjet, por kjo që po ndodh dy herë me Shqipërinë - pati dy goditje, tërmetin dhe pandeminë - mendoj se e ka vënë jashtëzakonisht në vështirësi biznesin edhe sa i përket shlyerjes së kredive. Ndërkohë që të dhënat tregojnë, të paktën për tremujorin e parë, që kreditë me probleme janë ulur. A ka kontradiktë këtu, apo ndoshta dhe ndërmarrjet kanë qenë aq efikase sa bizneset t'i shlyejnë në kohë? A mendon se do t'i shlyejnë në kohë të gjitha kreditë që kanë?

Guvernatori: Jo, të dhënat e tremujorit të parë nuk reflektojnë efektet e pandemisë. Në fakt, treguesi i kredive me probleme ka evoluar shumë pozitivisht edhe në vazhdim të tremujorit të parë, përfshirë dhe efektet e tërmetit. Kjo dëshmon një punë shumë të mirë të bërë nga ana e bankave të nivelit të dytë, por po ashtu edhe performancë të lartë të bizneseve dhe klientëve në funksion të kredidhënies; tregon që tregu është ndërgjegjësuar në raport me biznesin e tij dhe në raport me marrëdhëniet me bankat e nivelit të dytë. Treguesi i kredive me probleme ka ardhur në rënie nga një shifër shumë e lartë si ajo e para disa viteve, dhe ne po vilnim frytet e një pune shumëvjeçare të bërë si në treguesit e kredive me probleme ashtu edhe në treguesit e tjerë të shëndetit bankar, kryesisht në kredidhënie. Për herë të parë, kohët e fundit kemi pasur një rritje të mirë të kredidhënies në ekonomi, pra rritja e kredisë si për bizneset ashtu edhe për individët ka qenë në nivelet afërsisht 8%, por fatkeqësisht ne hasëm në këtë situatë e cila do të ndikojë edhe në treguesin e kredive me probleme. Ky tregues nuk përfshin dhe nuk i reflekton efektet e krizës që ne po përjetojmë, pasi shifra do kohë për t'u përcaktuar. Natyrisht që ne do të shikojmë një përqendrim të shifrës të treguesit për kreditë me probleme për muajt e ardhshëm, po ashtu do të kemi dhe një ndikim në rritjen e kreditimit,

por niveli i tij mbetet për t'u parë në vijim. Në bashkëpunim me sistemin bankar, ne kemi marrë masa për ta menaxhuar këtë efekt. Bankat janë të ndërgjegjshme lidhur me këtë çështje dhe ne si rregullatorë jemi duke e menaxhuar situatën, por sigurisht që nuk mendojmë se do të kemi një rënie të vazhdueshme të treguesit të kredive me probleme, pasi është e qartë që klientët po hasin vështirësi dhe nuk do të jenë në gjendje të shlyejnë detyrimet e tyre. Bizneset janë të mbyllura, ekonomia është e bllokuar – kjo është tabloja që na paraqitet.

Pyetje: Guvernator, në vendimin e marrë për uljen e normës bazë të interesit, ju jeni shprehur se: Shqipëria gëzon një shëndet të mirë ekonomik dhe financiar; parametrat e funksionimit të sektorit të ekonomisë dhe atij bankar janë të shëndetshëm; rezervat e likuiditetit të kapitalit të sektorit bankar janë të larta. Këto janë arsyet që ne nuk duhet të shqetësohemi. Pavarësisht rënies ekonomike në këtë vit, qytetarët nuk duhet të kenë shqetësim në tërësi për ekonominë shqiptare?

Guvernatori: Ashtu si gjithë bota edhe ne duhet të jemi deri diku të shqetësuar. Ne kemi ndërmarrë disa masa sigurie për të ulur efektet negative të krizës, me të cilën do të përballemi domosdoshmërisht. Shqipëria gëzon shëndet të mirë ekonomik dhe financiar, që do të thotë se ne kemi pasur një rritje të mirë ekonomike. Shëndet të mirë financiar do të thotë që kemi pasur një sistem bankar e financiar të mirëkapitalizuar dhe me likuiditet të mjaftueshëm. Këto

“Një lajm i mirë është që jo më larg se dje kemi firmosur një marrëveshje për një instrument të veçantë për kohë krizash me vlerë 175 milionë euro që do të jepen nga FMN-ja për Qeverinë Shqiptare në formën e një huaje.”

elemente na japin një siguri të mjaftueshme që periudhën e goditjeve të krizës ne do të arrijmë ta menaxhojmë dhe ta kalojmë me sa më pak dhimbje. Por kjo nuk do të thotë që ne do të jemi në gjendje ta frenojmë rënien ekonomike ose të mos të kemi efekte. Situata financiare në sistemin bankar është një nga shtyllat kryesore që do të ndikojë pozitivisht në kapërcimin e kësaj situatë. Pavarësisht kësaj, nuk duhet të keqkuptohemi, sistemi bankar nuk është e vetmja “varkë shpëtimi”. Nga ana e Qeverisë Shqiptare do të ketë paketa masash të tjera që ne po i shikojmë, por e rëndësishme është që sistemi financiar është në gjendje të sigurojë likuiditetin e mjaftueshëm për të gjithë agjentët ekonomikë në treg dhe ne si bankë qendrore kemi likuiditet të mjaftueshëm për të furnizuar sistemin bankar dhe nëpërmjet tij të gjithë agjentët ekonomikë. Ne kemi marrë disa masa dhe kemi funksionuar normalisht dhe gjatë këtyre ditëve, pavarësisht nga goditja. Kemi bërë operacione repo

me bankat e nivelit të dytë, duke furnizuar pa kufi likuiditeti. Tregu ka qenë në gjendje të tërheqë të gjithë likuiditetin e nevojshëm për monedhën vendase. Gjithashtu, Qeveria Shqiptare ka tërhequr dhe një sasi likuiditeti nëpërmjet eurobondit nga sistemi bankar. Një lajm i mirë është që FMN-ja ditët e fundit ka komunikuar ngushtë me Ministrinë e Financave dhe me ne, dhe jo më larg se dje kemi firmosur një marrëveshje për një instrument të veçantë për kohë krizash. Pra, 175 milionë euro do të jepen nga FMN-ja për Qeverinë Shqiptare në formën e një huaje dhe likuiditeti i nevojshëm në monedhë të huaj, pra në valutë Euro, është siguruar si nga sistemi bankar ashtu edhe nga FMN-ja. Duhet të jemi të qartë se disa parametra apo kritere të cilat ishin të parashikuara për një situatë normale, siç ishin niveli i borxhit ose niveli i deficitit buxhetor, nuk do të respektohen, pasi tashmë jemi në një situatë të jashtëzakonshme. Sigurisht që ne jemi duke bashkëpunuar me FMN-në dhe me institucionet e tjera ndërkombëtare, dhe orientimi i tyre është që ne do të na duhet të dalim përkohësisht nga disa objektiva si konsolidimi fiskal dhe ulja e nivelit të borxhit. Pra, do të jemi të detyruar të kemi një rritje të përkohshme të nivelit të borxhit dhe, me kapërcimin e krizës, do t'i kthehemi përsëri konsolidimit fiskal. Jemi duke punuar me parashikimet; mendohet që viti 2020 do të ketë një rritje të nivelit të borxhit, një rritje të deficitit fiskal, dhe kjo rritje do të zbutet dhe do të vijë në rënie në vitet e ardhshme. Kjo nuk vlen vetëm për Shqipërinë, pasi kjo që jetojmë është një situatë e jashtëzakonshme për të gjithë.

Pyetje: Ky është një lajm i mirë, pra 170 milionë dollarë janë të aksesueshme brenda pak muajsh për Qeverinë Shqiptare?

Gubernatori: 175 milionë euro do të jenë të aksesueshme që nga java që vjen.

Pyetje: Ato janë të destinuar detyrimisht për një objektiv të caktuar apo është thjesht një ndihmë ose një mbështetje për financat shtetërore?

Gubernatori: Fondet janë në funksion të buxhetit të shtetit për të menaxhuar situatën e krizës dhe për t'i ardhur në ndihmë ekonomisë shqiptare në plotësimin e nevojave për likuiditet të buxhetit të shtetit në valutë të huaj. Gjithashtu, ne si bankë qendrore kemi furnizuar sistemin bankar me likuiditetin e nevojshëm për të gjithë agjentët ekonomikë. I rëndësishëm ka qenë menaxhimi i fillimit të kësaj situatë, pasi tashmë kemi 4-5 javë në këto kushte dhe gjatë kësaj kohe ne e kemi testuar situatën e përgjithshme. Qytetarët kanë qenë shumë mirëkuptues dhe kanë treguar një nivel të

lartë qytetarie në respektimin e rregullave kufizuese për të ruajtur shëndetin e tyre. Ne kemi parë që, pavarësisht vështirësive që imponon situata, publiku ka vepruar në mënyrë të matur dhe nuk ka rënë preh e panikut. Gjithashtu, rrjeti i bankave është furnizuar normalisht me *cash* dhe me gjithë radhët e krijuara si pasojë e masave kufizuese, ato kanë qenë në gjendje t'i ofrojnë shërbimet e tyre dhe qytetarët kanë tërhequr *cash*-in e nevojshëm. Pra, ne kemi qenë në gjendje që ta menaxhojmë goditjen më të madhe, si për tërheqjen e *cash*-it të nevojshëm dhe për kryerjen e transaksioneve financiare. Paralelisht, kemi marrë dhe disa masa për t'i lehtësuar veprimet, siç ka qenë p.sh. heqja e komisioneve për transfertat elektronike, e cila ka lehtësuar transfertat *jo-cash*, në mënyrë që klientët të mos ishin të detyruar të shkonin patjetër pranë bankave të nivelit të dytë, por transaksionet të kryheshin pa prezencën e tyre. Një tjetër masë e marrë dje nga Këshilli Mbikëqyrës ka qenë ulja e nivelit të komisioneve. Pra, pavarësisht faktit që java e parë e pandemisë ka qenë pak stresante, sistemi bankar e përballoi pa probleme situatën dhe veprimtaria ka ecur normalisht, natyrisht brenda kufizimeve.

Pyetje: Një tjetër lajm i mirë është dhe vendimi që asnjë prej bankave nuk do të mund të ndajë dividendin për të paktën 6 muajt e parë të vitit 2020...

Guvernatori: Po, ky ishte një vendim tjetër që ne morën në mbledhjen e djeshme të Këshillit Mbikëqyrës; vendosëm që për një tremujor të pezullojmë shpërndarjen e dividendit nga ana e bankave të nivelit të dytë. Ato kanë një normë të lartë të mjaftueshmërisë së kapitalit - në nivelin 18% nga 12% i kërkuar nga banka qendrore - dhe në një farë mënyre, ky **vendim** nuk ishte i domosdoshëm, por kjo është një masë prudence, e cila në situatën e krijuar dhe duke pasur parasysh dhe rekomandimet e BQE-së dhe të Autoritetit Bankar Evropian, u mor për të ofruar më shumë siguri. Ne do të shohim ecurinë e sistemit financiar dhe të ekonomisë në vijim dhe do ta shqyrtojmë sërish atë deri në fund të vitit. Bankat e nivelit të dytë janë treguar tepër bashkëpunuese dhe kanë dhënë maksimumin e tyre për menaxhimin e situatës; kemi pasur mirëkuptim të plotë në të gjitha masat e marra, për të cilat natyrisht jemi konsultuar paraprakisht me bankat dhe me Shoqatën Shqiptare të Bankave.

“Në fakt, bankat e nivelit të dytë kanë një normë të lartë të mjaftueshmërisë së kapitalit, në nivelin 18% nga niveli 12% i kërkuar nga ne si bankë qendrore.”

Pyetje: Z. Guvernator, disa biznese ose qytetarë fillimisht kanë qenë të çorientuar nëse do të ishte automatike shtyrja me tre muajt e

pagesës së kësteve të kredive. Ndërkohë, para pak ditësh, ju keni vendosur dhe në faqen tuaj zyrtare një link ku njerëzit mund të bëjnë pyetje apo të kërkojnë informacione shtesë mbi shtyrjen. Në publik ka ekzistuar konfuzion nëse shtyrja është automatike apo është individuale për çdo rast.

Guvernatori: Unë e kam sqaruar që shtyrja e kësteve të kredisë nuk është automatike. Jo të gjithë kredimarrësve të të gjitha bankave u shtyhet shlyerja e këstit të kredisë për një afat tremujor. Kjo vlen vetëm për ata klientë që do të hasin vështirësi financiare si pasojë e gjendjes që vjen nga pandemia. Numri i këtyre klientëve, si biznese dhe individë, natyrisht që mund të jetë shumë i lartë, por gjithsesi ata do të duhet të kontaktojnë bankën dhe ta informojnë atë për gjendjen e tyre, për të përfituar nga kjo masë. Ne kemi bërë ndryshimet e nevojshme rregullative për të mos i ngarkuar bankat me provigjione me fonde rezervë për mbulimin e huave, pra për t'u krijuar atyre mundësinë që ta bënin këtë shtyrje. Disa banka të veçanta e kanë aplikuar këtë masë, disa banka të tjera janë duke e

“Ne kemi bërë ndryshimet e nevojshme për të mos i ngarkuar bankat me provigjione me fonde rezervë për mbulimin e huave...”

elaboruar pasi nuk janë në një nivel likuiditeti të mjaftueshëm sa për të përballuar shtyrjen për të gjithë ata që kanë aplikuar. Dua të theksoj se bankat janë shumë proaktive për aplikimin e kësaj mase dhe në të gjitha rastet kur klienti ka vështirësi financiare, kredia do të shtyhet për tre muaj. Megjithatë, duhet kuptuar që portofoli dhe numri i klientëve është shumë i madh, dhe procesimi i kërkesave të tyre merr kohë, pasi përveç kufizimeve të orarit të qarkullimit, shtyrja e afateve të kredive kërkon firmosjen e një marrëveshjeje të re kreditimi. Për këtë arsye, ne i kemi njoftuar të gjithë klientët që mund t'i drejtohen bankës qendrore për të ndihmuar në bashkëpunimin mes klientit dhe bankës.

Pyetje: Ju jeni këshillimor në këtë rast, pra thjesht ndihmoni klientët në procedurat me bankat e nivelit të dytë?

Guvernatori: Ne si autoritet mbikëqyrës kemi të drejtë të gjykojmë dhe të vlerësojmë bankat e nivelit të dytë, të shikojmë të gjithë procesin. Natyrisht që marrëveshja e kredisë është një marrëveshje ndërmjet palëve, midis klientit dhe bankës, dhe në fund të fundit është banka ajo që vendos, por ne kemi një dakordësi me të gjitha bankat për të shtyrë këstet dhe ne do të shikojmë sa proaktiv është funksionimi i procesit të shtyrjes së kredive. E vërteta është që ankesat kryesore nuk

vijnë nga klientët e bankave, por nga ata të institucioneve financiare jobanka. Këto të fundit, në ndryshim nga bankat, kanë probleme me likuiditetin, pasi të ardhurat nga këstet, dhe jo depozitat, janë burimi i tyre i likuiditeteve. Institucionet financiare jobanka funksionojnë me një skemë financiare të ndryshme dhe nuk kanë të njëjtën qasje si bankat e nivelit të dytë, por sigurisht që ndryshimet rregullative dhe urdhri i përfshin ato dhe ne do të ndihmojmë të gjithë klientët për ta zgjidhur sa më shpejt këtë situatë.

Pyetje: Kjo është një vendimmarrje që s’e keni bërë më parë, duke hyrë gjithmonë e më shumë në territore të reja. Në pjesën e dytë të emisionit do të doja të diskutonim për këto masa të paprecedenta ndoshta dhe për sa i përket ideimit të lehtësimit sasior. Po të përqendrohemi te kjo pjesë në fillim, thamë që tremujorin e parë kreditë me probleme nuk janë të larta, kjo është gjë e mirë, por çfarë parashikohet që të ndodhë gjatë vitit? Ju thatë që bankat janë të mirëkapitalizuara dhe mund t’i përballojnë ndoshta dhe kreditë me probleme, por në tërësi, si parashikohet, me kaq informacion sa kemi, të paktën në këtë muaj të vështirë?

Guvernatori: Siç e thashë, parashikimet në këtë situatë janë të vështira. Ne shpresojmë që kohëzgjatja e situatës së pandemisë dhe e masave shtrënguese të jetë sa më e shkurtër, për të filluar sa më shpejt rimëkëmbjen e ekonomisë. Kjo vlen veçanërisht në këto kohë, duke qenë se jemi para sezonit turistik dhe turizmi është një nga shtyllat kryesore të ekonomisë shqiptare. Shpresojmë që qershori të jetë një muaj pozitiv; megjithëse fluturimet janë pezulluar për një afat të gjatë, presim që turizmi i brendshëm të ketë ndikimin e vet pozitiv. Ky efekt pozitiv do të varet nga kohëzgjatja e pandemisë, duke pasur parasysh që shumë pritshmëri janë të pasigurta. E rëndësishme është që sistemin financiar, kjo gjendje e gjeti të shëndetshëm. Kjo në fakt nuk vlen vetëm për Shqipërinë, por edhe për shumë shtete të tjera, pasi fatmirësisht kriteret e shtrënguara të riskut pas krizës së 2008-ës, e forcuan sistemin financiar kundrejt një krize tjetër financiare. Ne kemi diskutuar dhe kemi pritur kritika për tepicën e likuiditetit, për moskthimin e likuiditetit në ekonomi, dhe bankat kanë qenë gjithmonë nën “kritika” nga agjentë të ndryshëm ekonomikë për moskreditimi të mjaftueshëm, por sigurisht që ato kanë kriteret e tyre të riskut. Bankat do të donin të rritej kreditimi në mënyrë të shëndetshme, pa përsëritur kreditë me probleme apo shkeljen e kriteve të rrezikut

“... stabiliteti financiar është një prioritet të cilin nuk do ta cenonim pavarësisht nga kriza.”

që ndodhi para vitit 2008, por kjo pandemi i gjeti bankat në një gjendje shumë të mirë likuiditeti dhe kjo i shërben përballimit të situatës. Gjithashtu, masat e marra nga ne si rregullatorë për mjaftueshmërinë e kapitalit, duke kërkuar një normë më të lartë mjaftueshmërie kapitali, pra duke i detyruar bankat të mbanin rezerva më të mëdha, shkojnë gjithashtu në favor të kësaj situatë. Pra, pavarësisht nga situata me kthimet e kredisë - dhe ne jemi të ndërgjegjshëm që bizneset që kanë vështirësi do të kenë shtyrje këstesh dhe kemi bërë lehtësimin rregullativ që dhe bankat të mos i rëndojmë me provigjione ose fonde rezervë për humbje, në mënyrë që raportet e tyre të jenë të pranueshme - sigurisht që do të ketë një rritje të kredive me probleme. Se sa do të jetë kjo rritje, ende nuk mund ta themi, por e rëndësishme është që mjaftueshmëria e kapitalit të bankave, gjendja e likuiditetit dhe raportet kryesore të shëndetit financiar të sistemit bankar të ruhen. Stabiliteti financiar është një prioritet, një parakusht, të cilin nuk do ta cenonim, pavarësisht nga kriza. Bankat do të përdorin të gjithë kapacitetin e tyre për të ndihmuar. Ato po bashkëpunojnë me një profesionalizëm të lartë dhe ne do ta kalojmë krizën duke u mirëkoordinuar dhe duke marrë masa, por natyrisht që nuk do të lejojmë që të cenohet stabiliteti financiar.

Pyetje: Pra kryesore është që ekonomia shqiptare dhe pas krizës të mbetet në këmbë, me një sistem financiar të shëndetshëm, dhe ky është objektivi që ju konfirmoni?


Guvernatori: Ekzakt...

Pyetje: Nëse mundemi të kalojmë tek disa pyetje që vijnë nga qytetarët. Nuk do ja u bëj pyetje direkte, por ndoshta janë tematika që duhen trajtuar. Jemi rikthyer në pjesën e dytë të emisionit me Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, pra po përqipemi të marrim vesh se sa të shëndetshme janë bankat e Shqipërisë, bankat e nivelit të dytë dhe Guvernatori po jep të gjithë mbështetjen institucionale por gjithashtu edhe analizën institucionale që janë të mirëkapitalizuara, që do të thotë që çfarëdo të ndodhë ndoshta dhe me ekonominë ato janë të gatshme dhe nuk do të cenohet pavarësisht masave që janë marrë nuk do të cenohen asnjëherë për të qenë të shëndetshme deri në fund të kësaj periudhe të vështirë. Z. Guvernator, javën e kaluar, qytetarët u çorientuan për sa i përket luhatjes së kursit të këmbimit, kryesisht me Euron. Kjo ishte për arsye institucionale spekulative të përkohshme? A duhet të shqetësohemi?

Guvernatori: Ne kemi një regjim të lirë të kursit të këmbimit. E kemi theksuar që kursi i këmbimit caktohet nga oferta dhe kërkesa në treg për monedhë kombëtare dhe valutë të huaj. Kemi vënë re që gjatë këtyre viteve, ne kemi pasur një mbiçmim të kursit të këmbimit, pra kemi pasur një mbiçmim të monedhës kombëtare dhe një nënçmim të monedhës Euro. Për këtë kemi pasur dhe shumë kritika nga bizneset, kryesisht nga eksportuesit, dhe ne kemi ndërhyrë sipas parametrave që kemi si bankë qendrore. Ne ndërhyjmë në treg kur ka çrregullim apo spekulim, si dhe kur goditet rëndë objektivi ynë i inflacionit, por këto janë raste shumë të rralla dhe regjimi i lirë i kursit të këmbimit në një ekonomi të hapur siç është Shqipëria është ai që funksionon dhe i tillë do të mbetet. Ne do të vazhdojmë të kemi një regjim të lirë të kursit të këmbimit. Sikurse kemi theksuar, kursi i këmbimit është bazuar kryesisht tek fundamentet.

Në të kaluarën, ne kemi pasur një mbiçmim dhe kemi thënë se ai bazohet tek fundamentet, të ardhurat nga investimet e huaja direkte në ekonomi, në nivele të larta gjatë viteve të kaluara - afërsisht 900 milionë apo 1 miliardë euro në vit, sipas shifrave zyrtare të raportuara nga institucionet publike, institucionet e statistikave ose të Bankës së Shqipërisë. Në vitet e fundit, kemi pasur rreth 2 miliardë euro të ardhura nga turizmi. Po ashtu, remitancat kanë vijuar të mbeten të konsiderueshme, rreth 1 miliardë euro. Pra vetëm nga këto tre kanale që unë përmenda janë disa miliardë euro hyrje në ekonominë shqiptare. Natyrisht që për një ekonomi të vogël, këto të hyra janë të mjaftueshme për të mbiçmuar kursin e këmbimit. Në këtë situatë, me bllokimin e përgjithshëm të të gjitha kanaleve, natyrisht që do të ketë një efekt në kurs dhe ai është tregues shumë sensitiv. Në radhë të parë, ne kishim dhe një mungesë të caktuar eurosh *cash* javën e kaluar, të ardhur nga bllokimi i fluturimeve. Pa dashur të hyj në detaje teknike mbi mënyrën e klerimit të eurove, thjesht do të thosha që ne kishim një situatë ngërçi dhe kjo ndikoi. Pra, përveç faktorëve fundamentalë, të cilët janë faktorë thelbësorë të ekonomisë dhe përcaktojnë kursin e lirë të këmbimit në një nivel të caktuar, kishim të bënim dhe me një faktor të caktuar për një javë të caktuar. Më pas, sasia e caktuar e eurove është rakorduar dhe është dakorduar, në mënyrë që të mos kemi më probleme me furnizimin me Euro të sistemit bankar dhe të tregut. Megjithatë, për sa kohë që do të vazhdojë regjimi i lirë i kursit të këmbimit, kursi do të përcaktohet nga kërkesa dhe oferta në treg. Ne nuk do të ndërhyjmë dhe kursi do të jetë ai që kërkon tregun.

Grafik 40. Kursi i këmbimit në tregun vendas



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Unë nuk mund të them se sa do të jetë kursi, pasi ne, si çdo bankë qendrore me kurs të lirë të këmbimit, nuk e kontrollojmë dot atë. Ndryshe ndodh kur vendos një kurs fiks. Në këtë rast kursi kontrollohet, por kjo ka pasoja dhe efekte të tjera në ekonomi. Në rast se ne mbajmë një regjim të lirë të kursit të këmbimit, ashtu si shumë shtete të tjera, natyrisht që nuk e parashikojmë dhe nuk e kontrollojmë dot kursin, por përipiqemi të kontrollojmë e të shmangim spekulimet me të.

Ditët e fundit, ne kemi vënë re që kursi është stabilizuar përsëri - *spread* et janë ngushtuar dhe sjellja e bankave është më e normalizuar në drejtim të kursit të këmbimit – megjithatë, se sa do të jetë kursi i këmbimit nuk mund të parashikohet. Nga pozicioni që mbaj në krye të bankës qendrore, kolegë dhe miq të shumtë më pyesin si do të shkojë kursi, dhe e them me sinqeritet që këtë nuk e parashikon dot askush. Unë ju shpjegova përse kanë ndodhur mbiçmimet apo nënçmimet, bazuar në disa faktorë fundamentalë. Në rast se ekonomia jonë do t'i kthehet shpejt gjendjes normale dhe ne do të kemi një turizëm të zhvilluar, si një nga shtyllat kryesore të ekonomisë shqiptare, do të vazhdojmë të kemi remitanca dhe investime të huaja, natyrisht që këto vijnë në monedhën Euro.

Një nga arsyet që ne kemi ndjekur një strategji deeuroizimi është që të shmangim pasojat nga situata si kjo që po ndodh dhe mund të përsëritet edhe në të ardhmen. Pra, ne synojmë shmangien e rrezikut të kursit të këmbimit për një transmetim më të mirë të politikës monetare dhe për

të zvogëluar ndikimin negativ në stabilitetin financiar të vendit. Kemi kërkuar një politikë deeuroizimi për të pasur një nivel sa më të ulët euroizimi, por kjo është një betejë që nuk i përket këtij momenti.

Pyetje: Deeuroizimi është një betejë e së shkuarës, por i përket edhe kësaj krize. Instrumentet që ju keni në dorë do të kishin efikasitet për të ndihmuar të gjithë qytetarët shqiptarë, por ju po thoni që kjo është lotari apo një bast. Kushdo që mund ta kuptojë kursin e këmbimit, mund t'i konvertojë paratë që ka në Euro, në Lekë, dhe pastaj t'i rikthejë përsëri. Këto gjëra ju nuk i rekomandoni, pra bizneset apo qytetarët të mos luajnë me këtë gjë?

Guvernatori: Kjo që thaatë është shumë e saktë. Në parim, në momente krize, çdo sjellje apo transaksion për të këmbyer një monedhë me një tjetër, përgjithësisht është provuar që shkakton humbje në bilancet e bizneseve apo qytetarëve. Qetësia, maturia dhe vëzhgimi i tregut duhet të mbizotërojnë. Transaksionet financiare rekomandohet të bëhen në bazë të nevojave që kanë bizneset për aktivitetet dhe në një situatë të qetë financiare dhe ekonomike. Përgjithësisht, në një situatë paniku, transaksionet financiare të këmbimit kanë rezultuar me humbje pasi situata ndryshon. Për momentin, kursi i këmbimit në treg nuk ka luhatje, por në vijim do të shohim efektin e krizës në ekonomi dhe efektet e ekonomisë në kursin e këmbimit.

Pyetje: Z. Guvernator, nuk e di nëse shikoni Netflix. Në filmin serial "Casa de Papel", shqiptarët kanë parë që printohen para dhe pastaj ato mund të përdoren lirisht. Edhe në Shqipëri gjithnjë e më shumë po ngrihet pyetja përse nuk printohen para që t'i jepen direkt qytetarëve. A e keni menduar këtë? Dhe pse nuk bëhet, nëse nuk e bëni?

Guvernatori: Kjo është një teori që ka lindur në periudha krizash; kriza e vitit 2008 e ka elaboruar disi më shumë, por nuk është aplikuar. Përgjithësisht, bankat, nëpërmjet instrumenteve të tyre, kanë aplikuar lehtësime sasiore. BQE-ja, FED-i, Banka e Japonisë dhe Banka e Anglisë janë shembujt për ndjekjen e politikave të lehtësimit monetar dhe të lehtësimit sasior. Lehtësimi monetar është ulja e normës së interesit për të stimuluar kreditimin, konsumin dhe investimet; ndërsa lehtësimi sasior është

"Lehtësimi monetar është ulja e normës së interesit për të stimuluar kreditimin, konsumin dhe investimet, pra për të pasur një normë më të ulët; ndërsa lehtësimi sasior është ndërhyrja me likuiditet në treg duke blerë borxhin e qeverisë."

ndërhyrja me likuiditet në treg, duke blerë borxhin e qeverisë, letra me vlerë apo bono thesari të qeverisë, nëpërmjet sistemit bankar ose vetë. Këto vende kanë injektuar likuiditet në treg, kryesisht nëpërmjet sistemit bankar, dhe i kanë dhënë një frymëmarrje ekonomisë. Në këto kohëra të vështira krizash, ku tregu ka pasur nevojë për likuiditet, ka qenë dhe teoria e "helikopterit monetar", pra që banka qendrore të printojë para dhe t'i shpërndajë direkt tek qytetarët. Kjo ka mbetur vetëm një teori, por natyrisht situata e krizës i ka rigjallëruar përsëri këto teori dhe i ka përhapur në opinionin publik. Kjo është një teori e pa aplikuar.

Vendi ynë ka edhe specifikën e një niveli të lartë euroizimi dhe ne do të kishim një inflacion edhe më të përshpejtuar, në rast se, në mënyrë hipotetike, do të mendonim të bënim një gjë të tillë. Kjo nuk është në strategjinë tonë, pasi siç e shpjegova, sistemi ynë ka likuiditetin e nevojshëm në euro dhe në monedhë kombëtare. Nëpërmjet sistemit bankar, ne kemi furnizuar në mënyrë të vazhdueshme tregun me likuiditet, madje gjatë kësaj periudhe kemi hequr dhe limitet repo. Pra, është e panevojshme që të përdoret "helikopteri monetar" - të printojmë para pa kriter dhe t'ua japim qytetarëve - për arsye të thjeshtë se do të kishim zhvlerësim të parash dhe rritje të jashtëzakonshme çmimesh.

Në mënyrë hipotetike, në rast se do të hidheshin para pa kriter në treg, natyrisht që çmimet do të kuotoheshin në valutë të huaj dhe këto para nuk do të kishin asnjë vlerë. Po t'i kthehemi si shembull vitit '97, kriza ekonomike dhe financiare bëri që të kishte një dollarizim të ekonomisë - kudo që shkoje, përveç dyqanit të bukës, të gjitha mallrat ishin të kuotura në dollarë - kështu Leku nuk kishte asnjë vlerë. E njëjta gjë ndodhi dhe në Turqi dhe Banka Qendrore e Turqisë, në atë periudhë, u detyrua që të shtonte tre dhe gjashtë 0 në kartëmonedhë. Ekonomia turke ishte e dollarizuar dhe çmimet ishin të kuotura në monedhë të huaj USD.

Kështu do të ndodhte edhe nëse ne do të printonim para pa masë. Pra, në radhë të parë, kjo nuk është e nevojshme, dhe në radhë të dytë do të kishte efekte negative në ekonomi, efekte të padëshiruara në makroekonomi. Ne jemi në një periudhë krize dhe në periudha të tilla natyrisht që të gjitha palët do të kenë humbje të caktuara. Në rast se mbyllet aktiviteti dhe deri diku mbyllet "jeta", sigurisht që do të ketë humbje, por kjo humbje duhet pranuar, menaxhuar dhe kapërcyer sa më shpejt përmes masave të duhura. Më pas, ne do të na duhet të ndërmarrim reforma strukturore, për të shpejtuar rritjen ekonomike, por duhet të jemi të ndërgjegjshëm që do të kemi humbje, të cilat do të na

duhet t'i menaxhojmë gjatë periudhës së pandemisë. Banka qendrore nuk ka asnjë strategji për të përdorur "helikopterin monetar", pra për të printuar më shumë para. Ne e kemi sasinë e nevojshme të likuiditetit në monedhën vendase dhe do të funksionojmë me të, ndërsa burimet e monedhës së huaj, i shpjegova më parë.

Pyetje: Pra, ju po thoni që dhe nëse qytetarëve do u japësh 200 mijë lekë para shtesë, fuqia e saj blerëse nuk do të jetë 200 mijë lekë, por më pak, dhe do të ndryshojë krejtësisht sjelljen e të gjithë informacionit ekonomik në shoqëri? Më shumë do të sjellë kaos sesa përfitim...

Guvernatori: Po, do të ishte naive nga ana jonë printimi i parave pa kriter, pasi kështu prishen fundamentet dhe do të kishim inflacion, pra thjesht do të rriteshin çmimet dhe asgjë më shumë. Ne pritojmë para në vijimësi dhe masa monetare në qarkullim është rritur në mënyrë të kontrolluar edhe para pandemisë, si pasojë e nevojave të ekonomisë për kartëmonedhë, por këtë e bëjmë duke pasur parasysh gjithmonë mbajtjen në kontroll të inflacionit dhe të parametrave makromonetarë.

Pyetje: Nuk e di nëse jam i saktë, por në publik ka qarkulluar lajmi se ju keni thënë që keni një plan të mundshëm për lehtësim sasior. Ku dallon kjo nga "paraja helikopter"?

Guvernatori: Lehtësimi sasior është blerja e letrave me vlerë. Në rast se kriza do të thellohet, brenda kriteve dhe përcaktimeve ligjore, ne do të financojmë deficitin, siç është e parashikuar dhe e përcaktuar, duke blerë letrat me vlerë të Qeverisë Shqiptare, nëpërmjet sistemit bankar - ky është lehtësimi sasior. Sigurisht që buxheti i shtetit është ai që do të menaxhojë krizën në raport me qytetarët dhe jo bankat qendrore. Ato ruajnë parametrat makroekonomikë dhe financiarë të sistemit bankar dhe stabilitetit të çmimeve, si dhe bashkëpunojnë me qeverinë për të furnizuar me likuiditetin e duhur dhe për të pasur nivele të kontrolluara të borxhit. Ky është roli i bankave qendrore. Është buxheti i shtetit - dhe kjo po ndodh edhe në Shqipëri - ai që shpërndan apo jep ndihma sociale dhe paga në kohë krize. Teoria e "helikopterin monetar" nënkupton që bankat qendrore të shkojnë direkt te qytetarët, duke printuar para.

Praktikisht, me lehtësimin sasior, banka qendrore rrit financimin e qeverisë, nëpërmjet blerjes së bonove të thesarit. Këtë kemi planifikuar të bëjmë në rast se do të përkeqësoheshin parametrat makroekonomikë; të gjitha bankat qendrore, në rajon dhe më gjerë, këtë plan kanë aplikuar. Teoria e "helikopterin monetar", deri më sot, nuk është aplikuar nga asnjë bankë

qendrore. Ndërhyrjet e bankave qendrore, si edhe ndërhyrja e fortë e Bankës së Anglisë, janë mënyra funksionale për të ruajtur parametrat që tregu të funksionojë normalisht.

Duhet të jemi të qartë që këto janë masa për të mbajtur tregun me injektim për të ruajtur parametrat, por kjo nuk do të thotë që të shmangen të gjitha efektet e krizës. E rëndësishme është që të menaxhojmë sa më mirë humbjet dhe të fillojmë sa më shpejt ringritjen e ekonomisë. Ne si bankë qendrore këtë rol kemi, pra të marrim masa që të mitigojmë humbjen, ta menaxhojmë sa më mirë këtë periudhë dhe të mbajmë parametrat makroekonomikë që tregu të funksionojë normalisht. Fatmirësisht, kështu ka ndodhur, megjithëse kemi përjetuar javë të vështira.

Shqetësimi lidhur me shëndetin, mbyllja e aktivitetit normal dhe kufizimi i qarkullimit, janë elemente që ndikojnë në psikologjinë dhe ekonominë e njerëzve, gjë që ndikon në konsum. Deri tani, falë ndërjegjësimit dhe mirëkuptimit, reagimi i publikut ka qenë qytetar dhe i vetëpërmbytur. Fatmirësisht, këto ditë po shikojmë një ulje të numrit të rasteve, nga profesionistët e mjekësisë po diskutohet se piku mund të ketë kaluar në fund të muajit mars, dhe mendohet se nga fundi i majit do fillojnë lehtësimin e masave dhe rihapjen e aktivitetit.

Pyetje: Nëse mund të bëj një përmbledhje për teleshikuesit: ju po thoni që Shteti Shqiptar ka gjetur financim të paktën për muajt e ardhshëm në vlerën 175 milionë euro nga FMN-ja dhe eurobondin në ankandin përpara një jave me 100 milionë euro. Pra, deri diku, financimi nuk mungon dhe nuk është e nevojshme që ju të ndërhyni për të financuar deficitin.

Guvernatori: Këto janë sa i përket të ardhurave në valutë. Për pjesën e të ardhurave në Lek, Qeveria Shqiptare në këto momente nuk është në një situatë që ka nevojë për të emetuar bono thesari; nuk është ende koha.

Pyetje: Gjithashtu, ju thoni se lidhur me kursin e këmbimit publiku nuk duhet të shqetësohet, por të jetë i vëmendshëm e të mos spekulojë, pasi ai është i paparashikueshëm. Nga publiku vijjnë pyetje në lidhje me ristrukturimin e kredisë - pra rikthehemi te shqetësimi kryesor i qytetarëve - disa prej tyre kanë aplikuar, por disa institucione financiare jobanka kërkojnë që këstet të paguhen dhe në rast të kundërt do paguhet dhe kamatëvonesa.

Guvernatori: E kam thënë dhe në një intervistë tjetër se janë institucionet financiare jobanka ato që janë më të vështira në negociim në këto raste. Kjo pasi ato nuk mbahen me depozita dhe kanë vështirësi likuiditeti. Institucionet financiare jobanka reagueshan dhe nuk ishin aq bashkëpunuese sa bankat, në raport me ne si bankë qendrore, kur morëm masën për shtyrjen e kësteve mujore. Duhet të kuptojmë se shtyrja e kësteve tremujore atyre iu "heq oksigjenin", sepse modeli i tyre i biznesit funksionon me këstet e kredive. Megjithatë, ne kemi diskutuar dhe me ata, si dhe me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). BERZH-i është treguar i gatshëm dhe ka vënë në dispozicion një linjë kredie, por kjo do kohë për shkak të procedurave burokratike. Është e kuptueshme që klienti do të donte ta zgjidhte menjëherë këtë problem me institucionin financiar jobankë. Publiku duhet të dijë se institucionet financiare jobanka zënë 5-6% të tregut, ndërsa pjesa dërmuese e tij prej 95% i përket bankave.

Pyetje: Këto janë dhe shtresat më të varfra që preken kryesisht...

Guvernatori: Patjetër, jam dakord me ju. Unë do t'u sugjeroja qytetarëve që kanë këtë lloj shqetësimi, të dërgojnë një ankesë me shkrim në faqen e Bankës së Shqipërisë dhe ne patjetër që do ta adresojmë çështjen në bashkëpunim me institucionin financiar.

Pyetje: Adresa e e-mailit është publike tek bankofalbania.org?

Guvernatori: Po.

Pyetje: Z. Guvernator, ju uroj suksese në menaxhimin e kësaj krize të paprecedentë për ekonominë shqiptare dhe për të gjithë botën.

Guvernatori: Faleminderit!

INTERVISTË E GUVERNATORIT SEJKO PËR EMISIONIN “OPINION” NË TELEVIZIONIN KLAN

- 7 maj 2020 -

Pyetje: Z. Guvernator, kam 4-5 pyetje të thjeshta, ndërkohë janë dhe 2-3 pyetje që në fakt konsistojnë në të njëjtën pikë. E para - sa është zyrtarizuar dhe a vlen për të gjithë sistemin bankar shtyrja e kredive?

Guvernatori: Z. Fevziu, shtyrja e kredive për tremujorin aktual natyrisht që është zyrtarizuar dhe ky është një fakt i njohur për publikun. Është një shumë e konsiderueshme kredish të shtyra për një tremujor prej afërsisht dy miliardë euro, dhe ndërkohë po shqyrtohen dhe disa raste të tjera.

“Është një shumë e konsiderueshme kredish të shtyra për një tremujor prej afërsisht dy miliardë euro.”

Pyetje: Për të gjithë sistemin bankar z. Sejko, përfshirë dhe institucionet e financimit mikro?

Guvernatori: Po, për sistemin bankar dhe institucionet financiare jobanka, të cilat operojnë kryesisht në fushën e mikrokredisë. Këto institucione kanë bërë një shtyrje të kredive për tre muaj për ata klientë që kanë hasur vështirësi financiare. Pra, jo për të gjithë kredimarrësit, por vetëm për ata që kanë aplikuar.

Pyetje: Pikërisht kjo është pyetja. Pra, a shtyhet kësti i kredisë automatikisht apo rast pas rasti?

Guvernatori: Jo, shtyrja nuk është automatike, por shqyrtohet rast pas rasti dhe miratohet vetëm për ata klientë që, në gjykimin e bankës, kanë vështirësi financiare. Dua të theksoj që në këtë proces bankat kanë qenë proaktive, dhe i kanë relaksuar mjaftueshëm kriteret. Pra mund të them se për 99% të klientëve që kanë aplikuar, bankat kanë bërë shtyrje, pasi realisht klientët kanë pasur vështirësi të mëdha financiare.

Pyetje: Besoj se në këtë kohë pothuajse të gjithë kanë vështirësi financiare, për arsye të situatës së krijuar, ndërkohë që ka shumë klientë të cilët pretendojnë që bankat kanë qenë hermetikë me ta. A kenë ju ankesa, ose a bëni ju verifikim në këtë drejtim?

Guvernatori: Në rastin konkret, ju flisni për shtyrjen e kredive apo për pagesat që kanë lidhje me garancinë?

Pyetje: Jo, për shtyrjet e kredive.

Guvernatori: Për shtyrjet e kredive, bankat janë treguar proaktive në terma të përgjithshëm. Mund të ketë ndonjë përjashtim që lidhet me ndonjë problematikë të veçantë, por vetë fakti që deri tani është miratuar shtyrja për 21 000 kredi, përfshirë biznese të mëdha e të vogla, në një vlerë të barabartë me 2 miliardë euro, e dëshmon këtë.

Pyetje: Ndërkohë a është kjo shtyrje pa asnjë penalitet? Ka shumë qytetarë që pretendojnë se kredidhënësit u kanë thënë që do t'i shtynjë këstet për tre muaj, por më pas do t'i paguajnë të tre muajt bashkë ose do të paguajnë një kosto ekstra.

Guvernatori: Z. Fevziu, në ndryshimin rregullativ që kemi bërë, i rekomanduam bankat që kjo shtyrje të bëhet pa penalitet. Dhe ato, në përgjithësi, kështu kanë vepruar, pra është bërë një shtyrje tremujore në kohë, jo për t'u paguar njëherazi, dhe pa asnjë penalitet. Pra është e njëjta formë pagese me principalin.

Pyetje: Ndërkohë që ka pretendime se bankat u kanë mbajtur klientëve një përqindje jo të vogël nga paga e luftës. Pra, ata nuk e kanë marrë neto pagën e luftës që u ka dhënë qeveria.

“... ne kemi hequr komisionet për hapjen e llogarive në vlera të vogla, pikërisht për “pagën e luftës”, dhe shumica e bankave i ka hapur llogaritë pa komisione për ata që nuk kanë pasur një të tillë.”

Guvernatori: Në këtë rast, mund të ketë ndonjë bankë që mban komisione për veprimet dhe llogaritë bankare. Banka të ndryshme kanë komisione të ndryshme. Ne kemi hequr komisionet për hapjen e llogarive në vlera të vogla, pikërisht për marrjen e pagës së luftës, dhe shumica e bankave i ka hapur llogaritë pa komisione për ata që nuk kanë pasur një të tillë. Mund të ketë ndonjë rast të veçantë, por kjo është e përgjithshme.

Pyetje: Një nga gazetarët e ekonomisë që foli pak më parë u shpreh se në daljen tuaj keni folur për garancinë e parë sovraane, por nuk jeni shprehur për garancinë e dytë, pra për kredinë që jepet për të mbështetur biznesin. Çfarë ndodh me garancinë e dytë sovraane? A e kanë pranuar bankat dhe a kanë rënë dakord që të nisë?

Guvernatori: Z. Fevziu, ministri Ahmetaj më parë e shpjegoi garancinë e dytë sovrane. Me sa dëgjuam, ajo është miratuar në qeveri, por nuk është shpallur ende. Në këtë periudhë është operuar vetëm me garancinë e parë, prandaj dhe unë dje, pas mbledhjes së Këshillit Mbikëqyrës, kam dhënë informacione dhe të dhëna vetëm për garancinë e parë sovrane.

Pyetje: Vetëm për të parën?

Guvernatori: Garancia e dytë do të shihet në operim. Ndryshe nga garancia e parë që ishte për pagat, garancia e dytë i dedikohet bizneseve, për të mbështetur aktivitetin - sikurse u prezantua nga ministri Ahmetaj - për mjete xhiroje dhe asete fikse. Termat konkretë janë negociuar me bankat drejtpërdrejt nga qeveria.

Pyetje: Dhe kur bëhet aktive?

Guvernatori: Shumë shpejt besoj, duke qenë se ka kaluar dje në qeveri. Një gjë shumë e rëndësishme që ndoshta ju do ta ngrini në emisione të tjera, do të jetë elaborimi i kësaj garancie në raport me bizneset dhe bankat. Megjithëse kjo mbetet për t'u parë, unë gjykoj dhe besoj që bankat nuk do të bënin lëvrimin e kësaj garancie në mënyrë automatike, pasi ato kanë disa kritere risku dhe klasifikime klientësh. Për shembull, për klientët që kanë pasur gjithmonë performancë të keqe, lëvrimi i garancisë mund të mos jetë i menjëhershëm. Bankat bëjnë një analizë rast pas rasti, pasi ky është gjithmonë një transferim risku tek bankat.

Pyetje: Nëse e kuptoj mirë, e thënë më thjesht, ju po thoni që ata që janë mësuar të mos paguajnë ose t'i shtyjnë kreditë do ta kenë të vështirë të marrin kredi të re?

Guvernatori: Nuk dua të hyj në detaje teknike, por kritere të ndryshme patjetër që do të vlerësohen, për sa kohë që, siç e shpjegoi dhe ministri Ahmetaj, garancia mbulon vetëm 60% të riskut, ndërsa pjesën tjetër e kanë bankat.

Pyetje: Bankat do të jenë më të kujdesshme?

Guvernatori: Po, bankat do të jenë më të kujdesshme për sa kohë kanë 40% të riskut; do të marrin dhe një përqindje të riskut që ka klienti dhe ky risk është i klasifikuar.

Pyetje: Ndërkohë, ministri Ahmetaj tha që ju keni biseduar dje me Kryeministrin për një shtyrje tjetër të kredive. A mund të na thoni dot ndonjë detaj më tepër?

Guvernatori: Aktualisht, për të gjitha efektet ekonomike dhe makroekonomike që ka kriza, normalisht ka diskutime të vazhdueshme midis nesh dhe Ministrisë së Financave, midis meje dhe ministrit Ahmetaj. Gjithashtu, sot kemi pasur një takim me Kryeministrin dhe ministrin Ahmetaj, ku kemi diskutuar implikimet makroekonomike që mund të ketë kriza dhe masat që mund të ndërmerim, si qeveria ashtu dhe banka

“...ne jemi duke vlerësuar gjendjen e situatën e sistemit bankar nga pikëpamja e likuiditetit dhe e treguesve të tjerë të parametrave të tjerë të shëndetit të sistemit bankar.”

qendrore. Në këtë kontekst është diskutuar edhe problematika që kanë klientët, individë dhe biznese, si dhe mbështetjen që mund të japë sistemi bankar. Edhe në mbledhjen e djeshme të Këshillit Mbikëqyrës është diskutuar mundësia e një shtyrjeje ose restrukturimi tjetër. Ne jemi duke vlerësuar gjendjen e sistemit bankar nga pikëpamja e likuiditetit dhe e treguesve të tjerë të parametrave të shëndetit të sistemit bankar, siç është mjaftueshmëria e kapitalit, për të parë se sa i aftë është ai për të mbështetur biznesin.

Nga ana tjetër, duhet të jemi të ndërgjegjshëm se biznesi duhet të mbështetet patjetër, pasi në rast se këputen zinxhirët e prodhimit, në rast se do të kemi rënie të biznesit ose falimentime, do të jetë e pamundur që ato të shlyejnë kreditë. Nëse kjo ndodh, do të reflektohet automatikisht në përmasën e bankave. Sistemi bankar dhe bankat janë të ndërgjegjshme për këtë, pasi ato bëjnë analizat e tyre të riskut. Ne po bëjmë një analizë të shifrave dhe, pas një konsultimi me banka dhe me grupet e biznesit, për të parë kërkesat dhe aftësinë e të tyre financiare, do të dalim në një përfundim para mbarimit të afatit tremujor. E përsëris që është tepër e rëndësishme që ne të mos këpusim zinxhirët e prodhimit, të ruhem nga falimentet, por mbi të gjitha të ruajmë stabilitetin e sistemit financiar; të mos godasim bankat.

Pyetje: Z. Sejko, sa e fortë është goditja që kemi marrë?

“Ky vit do të mbyllet me rënie ekonomike, në Shqipëri dhe në të gjithë botën.”

Guvernatori: Forcën e goditjes që kemi marrë, për momentin, nuk e matim dot, pasi shifrat dalin me një kohë vonesë - jo vetëm në Shqipëri, por në të gjithë botën. Siç e deklarua dhe dje në Deklaratën e Politikës Monetare, sipas skenarit pozitiv, goditja më e fortë do të jetë në tremujorin

e dytë deri në fund të këtij tremujori, dhe pastaj gjatë verës do të fillojë rimëkëmbja, por deri në fund të vitit ne do të jemi në recesion. Ky vit do të mbyllet me rënie ekonomike, në Shqipëri dhe në të gjithë botën. Dëgjuam dhe vlerësimet e institucioneve ndërkombëtare. Bashkimi Evropian ka parashikuar një recesion të thellë për Eurozonën prej 7.7%, dhe pa diskutim që dhe Shqipëria do të ketë recesion. Ne jemi vend i vogël, z. Fevziu, dhe në rast se operojmë me politika të zgjuara, në rast se manovrojmë me zgjuarsia, ne...

Pyetje: Zgjuarsia nuk na ka karakterizuar aq shumë në fakt gjatë historisë...

Guvernatori: Duhet të përpiqemi. Kjo krizë është një test. Gjatë historisë ndoshta nuk ka qenë kështu, por në këtë rast duhet të tregohemi të zgjuar, pasi kështu mund ta kapërcejmë krizën me më pak dhimbje, me më pak dëme. Sigurisht që do të kemi një rënie ekonomike, e cila do të alokohet në të gjitha grupet e interesit - biznesi, bankat, individët dhe qeveria - por e rëndësishme është sa shpejt do të vijë rimëkëmbja.

Pyetje: Një teleshikues pretendon që nuk e ka marrë të plotë pagën e luftës, pra nga 26 mijë lekë, ka marrë 20 mijë lekë. Si mund të shpjegohet kjo? Mbase kërkon një përgjigje nga z. Ahmetaj...

Guvernatori: Z. Fevziu, në këtë rast mund të kemi të bëjmë me ndonjë gabim njerëzor ose personi në fjalë mund të ketë ndonjë detyrim ndaj bankës, që i është mbajtur në momentin e disbursimit të pagës së luftës.

Pyetje: Një pyetje tjetër nga publiku është nëse mund të ketë një shtyrje tjetër, pasi institucionet financiare të kredive kërkojnë që në qershor klientët të paguajnë të gjitha këstet e akumuluarra së bashku për shmangien e penaliteteve, ndërkohë që paga e luftës nuk është shpërndarë ende.

Guvernatori: Është e vërtetë që ekziston një problem sa i përket institucioneve financiare jobanka, të cilat, në ndryshim nga bankat, kanë një situatë më të vështirë financiare. Bankat operojnë me depozita, pra kanë situatë shumë më të mirë likuiditeti, ndërkohë që institucionet financiare marrin kredi ose kanë donatorë të ndryshëm, dhe në rast se nuk i arkëtojnë normalisht këstet e kredive, ato nuk arrijnë të shlyejnë detyrimet tek donatorët ose bankat që i kanë kredituar. Pra, bankat kanë mundësi të manovrojnë, ndërsa institucionet financiare e kanë më të vështirë. Pikërisht për këtë arsye ne po shqyrtojmë mundësitë se si të

operojmë në mënyrë që nga kjo të përfitojnë njëlloj të gjithë klientët, si ata bankarë ashtu edhe ata të institucioneve financiare jobanka, pa diferencime. Nga ana tjetër, duhet të marrim në konsideratë edhe gjendjen financiare të institucioneve financiare jobanka, kur të marrim vendimin nëse do të kemi një ristrukturim ose shtyrje në fazën e dytë, megjithëse institucionet financiare jobanka zënë një pjesë fare të vogël të tregut financiar.

Tabelë 6. Totali i aktiveve të SFJB-ve për periudhën dhjetor 2018 - dhjetor 2019 (në miliardë lekë)

	Dhjetor'17	Dhjetor'18	Dhjetor'19
Totali i aktiveve të SFJB*	38.15	46.33	58.1

Burimi: Banka e Shqipërisë.

* Në totalin e aktiveve të SFJB-ve nuk përfshihen të dhënat për Postën Shqiptare, pasi në bilancin e saj paraqiten të dhëna edhe për veprimtaritë e tjera jofinanciare të saj.

Pyetje: Sa për qind?

Guvernatori: Rreth 6-7% të tregut financiar, ndoshta më pak. Megjithatë edhe këto institucione kanë shumë rëndësi, pasi operojnë kryesisht në zonat rurale. Përgjithësisht mbështesin bujqësinë, e cila ka shumë nevojë për mbështetje. Pra, punojnë me klientë të vegjël, por janë shumë eficientë.

Pyetje: Një telespektator tjetër shprehet se ka marrë një kredi prej më shumë se një viti të cilën e shlyen rregullisht; ka bërë kërkesë për shtyrje kredie dhe punonjësi i bankës i ka thënë se kështu duhet t'i paguajë në fund, por bashkë me interesin e bankës, d.m.th. anulohet penaliteti dhe shtohet interesi. A është normale kjo?

Guvernatori: Mund të ketë raste dhe pretendime të ndryshme. Unë do t'i këshilloja qytetarët të ankohen përmes postës elektronike pranë Bankës së Shqipërisë dhe ne do t'i trajtojmë ankesat e tyre.

Blendi Fevziu: Atëherë z. Guvernator faleminderit!

Guvernatori: Faleminderit juve z. Fevziu!

INTERVISTË E GUVERNATORIT SEJKO PËR REVISTËN MONITOR

- 11 maj 2020 -

Pyetje: Cili është roli kryesor i Bankës Qendrore?

Guvernatori: Banka e Shqipërisë është ngritur dhe operon në bazë të praktikave më të mira të bankingut qendror.

Kushtetuta e Republikës të Shqipërisë dhe Ligji “Për Bankën e Shqipërisë” i ofrojnë asaj një mandat të qartë: atë të ruajtjes së stabilitetit të çmimeve, një listë detyrash të cilat mbështesin realizimin e objektivit kryesor, ku më e rëndësishmja është mbikëqyrja dhe rregullimi i sektorit bankar, si dhe pavarësi institucionale, operacionale dhe financiare për përmbushjen e tyre.

Përcaktimi i stabilitetit të çmimeve si objektiv kryesor i Bankës së Shqipërisë bazohet në teorinë dhe eksperiencën botërore të akumuluar prej shumë vitesh. Konsensusi i filozofisë së rregullimit ekonomik konvergjon në faktin se stabiliteti i çmimeve është një parakusht esencial për rritjen afatgjatë ekonomike të vendit, për mirëqenien e shoqërisë dhe barazinë sociale, si dhe për stabilitetin financiar. Në Shqipëri, përmbushja e këtij objektiv realizohet nëpërmjet hartimit e zbatimit të një politike monetare të pavarur, të mbështetur në parime dhe instrumente moderne, dhe të operacionalizuar në përputhje të plotë me parimet e tregut të lirë. Në thelb të kësaj politike, qëndron përcaktimi i një niveli normash interesi, i cili mban ekonominë pranë nivelit të saj potencial, çka nxit punësim të plotë, inkurajon një rritje të pagave reale në linjë me produktivitetin, ruan gjendje të qëndrueshme financiare të bizneseve dhe krijon premisa për një rritje çmimesh në linjë me objektivin tonë të inflacionit.

“Përcaktimi i stabilitetit të çmimeve si objektiv kryesor i Bankës së Shqipërisë bazohet në teorinë dhe eksperiencën botërore të akumuluar prej shumë vitesh.”

Paralelisht me objektivin e saj kryesor, Banka e Shqipërisë ka një listë të gjatë detyrash, pjesa më e madhe e të cilave janë ekskluzive të saj dhe kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin afatgjatë të vendit.

- Së pari, Banka e Shqipërisë kujdeset dhe për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e sektorit bankar, duke pasur si objektiv të punës

së saj krijimin e institucioneve bankare të besueshme për ruajtjen e kursimeve të publikut dhe të afta për kreditimin e biznesit dhe familjeve.

- Së dyti, Banka e Shqipërisë kujdeset për shtypjen dhe emetimin e monedhës e kartëmonedhës, duke i ofruar ekonomisë dhe publikut shqiptar një instrument fizik pagese të sigurt dhe në nivelin e kërkesës së tij. Po ashtu, Banka e Shqipërisë kujdeset për rregullimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të pagesave elektronike në vend, duke i ofruar ekonomisë dhe publikut shqiptar platforma dhe instrumente të besueshme e me kosto të ulët.

Stabiliteti i çmimeve, licencimi, mbikëqyrja dhe rregullimi i sektorit bankar, si dhe mirëmbajtja e parasë fizike dhe e sistemeve të pagesave elektronike, janë elemente të rëndësishme në arkitekturën e stabilitetit financiar. Përtej tyre, Banka e Shqipërisë kontribuon në këtë drejtim nëpërmjet: ngritjes dhe monitorimit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave; ngritjes dhe mirëmbajtjes së kuadrit ligjor e rregullator për ndërhyrjen e jashtëzakonshme; si dhe dialogut të vazhdueshëm me partnerët kombëtarë edhe ndërkombëtarë.

- Së treti, Banka e Shqipërisë kujdeset për administrimin e rezervave valutore të vendit, në përputhje me praktikat më të mira të fushës.
- Së katërti, Banka e Shqipërisë ka një rol të rëndësishëm këshillimi për sektorin publik dhe privat të vendit, nëpërmjet dhënies së opinionëve mbi situatën dhe zhvillimet e pritura ekonomike, nëpërmjet dhënies së opinionëve mbi gjendjen e stabilitetit financiar, si dhe nëpërmjet dhënies së opinionëve mbi akte të rëndësishme ekonomike, si Buxheti i Shtetit apo projektligje të cilat prekin aktivitetin e sistemit financiar të vendit. Gjithashtu, ne kemi adoptuar edukimin financiar të publikut si një drejtim prioritar të punës sonë, duke synuar rrënjosjen e kulturës së administrimit të financave personale, si një aspekt esencial i kulturës së përgjithshme në një ekonomi tregu.
- Së pesti, Banka e Shqipërisë ka një rol të rëndësishëm në integrimin e vendit. Ky rol nuk është thjesht dhe vetëm në procesin e integritimit evropian, ku ne kemi detyrat tona në fushën e integritimit të tregjeve dhe sistemeve financiare, por dhe më gjerë. Ai nënkupton punën e vazhdueshme për tërheqjen e investitorëve të huaj, si dhe integrimin me platformat ndërkombëtare të tregtimit financiar.

Paralelisht me to, ne kemi një kontribut të qenësishëm në zhvillimin e statistikave të vendit, në debatin akademik dhe profesional mbi strategjitë e zhvillimit etj.

Të gjitha këto mund t'i përmblihdja duke thënë: një bankë qendrore me mandat të qartë ligjor, e pavarur, profesionale dhe transparente, është një parakusht i domosdoshëm për zhvillimin e sektorit financiar dhe rritjen e qëndrueshme dhe afatgjatë të vendit. Jam i bindur se Banka e Shqipërisë i plotëson të gjitha këto premisa.

“... një bankë qendrore me mandat të qartë ligjor, e pavarur, profesionale dhe transparente, është një parakusht i domosdoshëm për zhvillimin e sektorit financiar dhe rritjen e qëndrueshme dhe afatgjatë të vendit.”

Pyetje: Çfarë instrumentesh përdor Banka e Shqipërisë në funksion të objektivave të saj kryesorë?

Guvernatori: Politika monetare bazohet në një kuadër modern instrumentesh, të bazuar në parimet e tregut të lirë. Me fjalë të tjera, Banka e Shqipërisë kujdeset për krijimin e kushteve të përshtatshme monetare – dhe këtu i referohem normave të interesit dhe sasisë së likuiditetit – por ajo ka vetëm një ndikim indirekt në normat e interesit me të cilat bankat operojnë me klientët e tyre. Gjithashtu, më lejoni të theksoj se në bazë të ligjit, partnerë ekskluzivë të Bankës së Shqipërisë në zbatimin e politikës monetare janë bankat tregtare që operojnë në vend. Ne nuk mund të kryejmë operacione me entitete të tjera komerciale, biznese, familje apo operatorë të tjerë të tregut financiar.

Më konkretisht, instrumenti ynë kryesor janë marrëveshjet e riblerjes dhe ato të anasjella të riblerjes me afat njëjavor, të cilat – në thelb – janë hua afatshkurtra, të cilat Banka e Shqipërisë ua vë në dispozicion bankave tregtare për të përmbushur nevojat e tyre. Norma e interesit të këtyre operacioneve, e cila njihet dhe si norma bazë e interesit, përfaqëson normën më të rëndësishme të interesit në sistemin financiar dhe pikënisjen e përcaktimit të të gjitha normave të instrumenteve të tjera financiare, si depozita, kredi apo instrumente borxhi të sektorit publik dhe privat.

Paralelisht me instrumentin e marrëveshjeve të riblerjes dhe në mbështetje të tij, Banka e Shqipërisë mban dhe operon instrumentet e depozitës dhe të kredisë njëditore, të cilat së bashku kufizojnë nivelin e luhatjeve të normave të interesit në tregun ndërbankar, rezervën e detyrueshme mbi depozitat në Lek dhe në valutë, si dhe orientimin e tregut mbi të ardhmen e politikës monetare.

Pjesë e arsenalit të instrumenteve të politikës monetare janë dhe injektimet afatgjata të likuiditetit me afat deri në tre muaj dhe, në raste ekstreme, edhe ndërhyrjet në tregun valutor. Nga ana tjetër, Banka e Shqipërisë mund të kryejë dhe operacione tërheqjeje apo injektimi të përhershëm të likuiditetit në sektorin bankar, nëpërmjet shitjes apo blerjes me të drejta të plota të letrave me vlerë të qeverisë në to. Këto operacione tashmë njihen gjerësisht si operacione të lehtësimit monetar dhe bëjnë pjesë në arsenalin e instrumenteve jokonvencionale të politikës monetare.

“Në fushën e mbikëqyrjes dhe rregullimit bankar, Banka e Shqipërisë përcakton kriteret dhe rregullat e operimit të sektorit bankar, duke vendosur kushtëzime për nivelin e kapitalit dhe likuiditetit të sektorit bankar.”

Në fushën e mbikëqyrjes dhe rregullimit bankar, Banka e Shqipërisë përcakton kriteret dhe rregullat e operimit të sektorit bankar, duke vendosur kushtëzime për nivelin e kapitalit dhe likuiditetit të sektorit bankar, duke vendosur kufizime mbi aktivitetet e lejuara prej bankave dhe shkallën e rrezikut që ato mund të marrin përsipër, si dhe duke u kujdesur që bankat të kenë struktura të qëndrueshme dhe eficiente të administrimi dhe të monitorimit të rrezikut.

Pyetje: Sa është rezerva valutore e Bankës së Shqipërisë dhe në çfarë rastesh përdoret ajo?

“...rezervat valutore janë një ankorë e rëndësishme e stabilitetit monetar e financiar të vendit, si dhe element i rëndësishëm i kredibilitetit të tij në investitorët e huaj.”

Gubernatori: Së pari, më lejoni të theksoj se rezervat valutore janë një ankorë e rëndësishme e stabilitetit monetar e financiar të vendit, si dhe element i rëndësishëm i kredibilitetit të tij në investitorët e huaj.

- Në këndvështrimin e stabilitetit financiar, rezervat valutore mundësojnë aftësinë e Bankës së Shqipërisë për t’iu përgjigjur në kohë nevojave të bankave për likuiditet në valutë, duke garantuar edhe në prani të problemeve të paparashikuara - funksionimin normal të tyre. Në këtë mënyrë, një nivel i mjaftueshëm i rezervave valutore ul primet e rrezikut të industrisë bankare dhe financiare në Shqipëri, duke nxitur dhe interesin e investitorëve vendas dhe të huaj për të operuar në të.
- Në këndvështrimin e stabilitetit monetar, rezervat valutore i mundësojnë Bankës së Shqipërisë të ndërhyjë në tregjet valutore vendase, në rast problemesh serioze të funksionimit të tyre, apo në

- rast luhatjesh të forta e të dëmshme të kursit të këmbimit. Në këtë këndvështrim, ato ofrojnë një instrument shtesë të kontrollit monetar.
- Në këndvështrimin e kredibilitetit, rezervat valutore garantojnë investitorët e huaj në rast krizash të forta valutore të vendit, të cilat cenojnë – në afatin e shkurtër – aftësinë paguese të sektorit publik dhe privat të vendit. Në këtë rast, rezerva valutore shërben si një instrument garancie për kreditorët e huaj, që ekonomia shqiptare ka valutën e nevojshme për respektimin e detyrimeve të saj. Për këtë arsye, një nivel i përshtatshëm rezervash valutore është esencial për të ulur kostot e huamarrjes të sektorit publik dhe privat në tregjet ndërkombëtare të kapitalit.

Nisur nga roli i rezervës valutore, përdorimi i saj bëhet vetëm në raste mjaft të veçanta. Duke analizuar rrethanat ekonomike dhe financiare të vendit, gjykoj se jemi ende mjaft larg plotësimit të premisave të përdorimit të rezervës valutore. Stabiliteti monetar dhe financiar i vendit mbetet solid, sektori bankar nuk shfaq probleme të mungesës së likuiditetit në valutë, vendi është larg kërcënimit të aftësisë paguese të borxhit të huaj dhe qeveria po procedon me emetimin e një Eurobondi në tregjet ndërkombëtare, për plotësimin e nevojave të saj. Po ashtu – dhe, në gjykimin tonë, po aq e rëndësishme - fondet e nevojshme për adresimin e pasojave të goditjes me të cilën po përballemi mund të sigurohen në tregun lokal dhe në monedhën tonë kombëtare Lek. Banka e Shqipërisë ka instrumente të bollshme për plotësimin e nevojave për fonde të ekonomisë në Lek, instrumente të cilat në analizë të fundit shfaqin kosto më të ulët se përdorimi i rezervës,

“Duke analizuar rrethanat ekonomike dhe financiare të vendit, gjykoj se jemi ende mjaft larg plotësimit të premisave të përdorimit të rezervës valutore.”

pasi Banka e Shqipërisë ka një kontroll të plotë mbi to. Së fundi, gjej me vend të theksoj se rasti i fundit kur është përdorur rezerva valutore, jo në funksion të stabilitetit monetar e financiar të vendit, por për të zbutur pasojat e një krize ekonomike, është fundi i viteve '80. Në periudhën menjëherë pas ndryshimit të sistemit politik të vendit dhe fundit të regjimit komunist, në prani të turbullirave të forta ekonomike dhe sociale, Shqipëria u detyrua ta përdorte rezervën valutore për të paguar faturat e importeve të mallrave jetike për vendin. Besoj se Shqipëria është mjaft larg një situatë të ngjashme.

Aktualisht, rezerva valutore e Bankës së Shqipërisë është rreth nivelit 3.2-3.3 miliardë euro. Përtej nivelit nominal, kjo rezervë është në përputhje me kriteret tona të vlerësimit të mjaftueshmërisë së saj. Ajo shërben për

të mbuluar mbi 6 muaj importi mallrash e shërbimesh dhe mbi 150% të borxhit të jashtëm afatshkurtër të vendit.

Pyetje: Cilat janë mekanizmat që ka në dorë Banka e Shqipërisë për të ndërhyrë në raste krizash si kjo që po kalon ekonomia, si rrjedhojë e pandemisë COVID-19?

Guvernatori: Mekanizmat tanë për adresimin e krizave varen nga origjina dhe pasojat e saj.

Goditjet mbi sektorin real të ekonomisë, qofshin ato që prekin nivelin e aktivitetit ekonomik apo që prekin nivelin e çmimeve, si rregull, adresohen nëpërmjet përdorimit të instrumenteve të politikës monetare. Qëndrimi i politikës monetare lehtësohet nëse goditja ka pasoja negative në ekonomi dhe efekt rënës në inflacion, dhe anasjelltas.

Në të kundërt, krizat që kanë origjinë sektorin financiar, duhen adresuar nëpërmjet një kombinimi të instrumenteve të politikës makroprudenciale – me synim garantimin e stabilitetit financiar – dhe të politikës monetare, për adresimin e pasojave negative që kriza financiare mund të ketë në ekonomi.

Goditja me të cilën po përballemi kërkon një përgjigje gjithëpërfshirëse nga autoritetet publike. Ajo kërkon përdorimin e stimulit fiskal si instrumenti parësor për të dhënë stimuj të targetuar në bizneset dhe familjet shqiptare. Për bizneset, lehtësimi i përkohshëm i barrës tatimore dhe garancitë publike të rrezikut të kredisë, ndihmojnë në rritjen e likuiditetit të tyre. Për familjet, kompensimi i një pjese të të ardhurave të munguara ndihmon ruajtjen e fuqisë blerëse dhe pakëson pasojat sociale të goditjes.

Nga ana e saj, Banka e Shqipërisë ka vënë në përdorim instrumentet e saj të politikës monetare, ka kryer ndryshime të kuadrit rregullator të sektorit bankar, si dhe ka marrë masa të ndryshme rregullatore dhe operacionale që garantojnë mbarëvajtjen e aktivitetit të sektorit bankar dhe sistemit të pagesave.

“Në çdo rast, filozofia jonë ka qenë të ofrojmë gjithë stimulin e nevojshëm për tejkalimin e situatës, por pa paragjykuar stabilitetin monetar e financiar të vendit dhe pa dëmtuar bilancet e sektorit bankar.”

Në çdo rast, filozofia jonë ka qenë të ofrojmë gjithë stimulin e nevojshëm për tejkalimin e situatës, por pa paragjykuar stabilitetin monetar e financiar të vendit dhe pa dëmtuar bilancet e sektorit bankar. Në vizionin tonë, ruajtja e stabilitetit monetar dhe financiar

është një parakusht i domosdoshëm për rikuperimin e ekonomisë me përfundimin e pandemisë. Goditja e këtij stabiliteti, vendosja e sektorit bankar dhe financiar në kushte pamundësie për të kryer funksionin e tij të ndërmjetësimit të fondeve në ekonomi, do ta shndërronin këtë goditje në një krizë të tejzgjatur për ekonominë e vendit.

Pyetje: Konkretisht, si i ka përdorur këta mekanizma dhe si e mat efikasitetin e tyre?

Guvernatori: Sikundër mund ta dini, ne kemi ulur normën bazë të interesit, për të ulur çmimin e kredive të reja dhe koston e shërbimit të borxhit ekzistues, si dhe kemi rritur furnizimin me likuiditet të sektorit bankar.

Në fushën e rregullimit bankar, ne kemi lehtësuar kërkesat rregullatore mbi ristrukturimin e kredisë dhe kemi inkurajuar bankat të ofrojnë shtyrje të pagesës së kështit të kredisë për bizneset dhe familjet në vështirësi të përkohshme. Po ashtu, ne kemi pezulluar përkohësisht shpërndarjen e dividendëve në industrinë bankare, duke synuar ruajtjen e nivelit të kapitalizimit të sektorit bankar dhe të aftësisë së tij për kreditim.

Paralelisht me to, kemi marrë dhe një sërë masash të tjera për të garantuar mbarëvajtjen e aktivitetit të sektorit bankar, për të garantuar funksionimin normal të sistemit të pagesave, si dhe për të siguruar furnizimin e ekonomisë me para fizike, monedha dhe kartëmonedha.

Në opinionin tim, Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë deri tani masat e duhura, në kohën e duhur. Dëshiroj ta përsëris që ne kemi qenë dhe do të vijojmë të jemi mjaft të kujdesshëm ndaj stabilitetit monetar dhe financiar të vendit.

“Në opinionin tim, Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë deri tani masat e duhura, në kohën e duhur.”

Vlerësimi i plotë i efektivitetit të tyre do të kërkojë kohën e vet. Megjithatë, ajo që mund të them është se këto masa i kanë përmbushur objektivat minimalë operacionalë. Së pari, aktiviteti i tregut financiar mbetet nën kontroll. Likuiditeti lëviz lirish në treg, pa ngërçe apo bllokime, ndërsa treguesit e luhatshmërisë mbeten në nivele të pranueshme - ndonëse të rritur, ato nuk janë në nivele të tilla sa të frenojnë tregtimin. Së dyti, sektori bankar ka reaguar pozitivisht ndaj masave tona rregullatore, duke proceduar me shtyrjen e pagesës së kësteve të kredisë – çka dëshiroj të theksoj se shkon në dëm të rezultatit financiar të këtij sektori në afatin e

shkurtër – dhe duke vazhduar mbështetjen e tij me fonde për bizneset dhe sektorët në vështirësi.

Mendoj se – në një plan më të gjatë kohor – suksesi i punës sonë do të matet nga shkalla e kufizimit të dëmeve në ekonomi, nga ruajtja e stabilitetit ekonomik dhe financiar të vendit. si dhe nga shpejtësia e ringritjes së ekonomisë pas përfundimit të goditjes.

Pyetje: Si e realizon BSH-ja politikën e lehtësimit sasior dhe a ka në plan që ta përdorë konkretisht së shpejti?

Guvernatori: Instrumenti i lehtësimit sasior është pjesë e kuadrit jokonvencional të masave të politikës monetare.

Qëllimi i përdorimit të këtij instrumenti është rritja e vëllimit të likuiditetit në ekonomi, në momentet kur konstatohen mungesa të tij ose në momentet kur normat e interesit në tregun financiar rriten, duke dëmtuar transmetimin e politikës monetare dhe duke vështirësuar aksesin në kredi të sektorit privat. Në terma operacionalë, përdorimi i këtij instrumenti nënkupton blerjen nga banka qendrore të letrave me vlerë të qeverisë në tregun dytësor. Me fjalë të tjera, në bilancet e bankave tregtare do të ketë më pak letra me vlerë të qeverisë dhe më shumë likuiditet të disponueshëm për financimin e sektorit privat.

Sikundër e thashë, ky është një instrument jokonvencional i politikës monetare, pasi ai përfaqëson një injektim të përhershëm likuiditeti në sistem. Për këtë arsye, përdorimi i tij bëhet vetëm në raste specifike, të cilat unë i parashtrova më sipër, dhe për periudha të kufizuara kohore. Pa dashur të paragjykoj vendimmarrjen e ardhshme të Bankës së Shqipërisë, mund të them se përdorimi i këtyre instrumenteve është pjesë e planit tonë të kontingjencës, por aktivizimi i tij do të kryhet vetëm në rast se konstatohet nevoja për përdorimin e tij.

Sa më sipër, gjej me vend të theksoj se – në mënyrë indirekte – opsioni i përdorimit të instrumenteve të lehtësimit sasior bën dhe më të largët nevojën e përdorimit të rezervës valutore.

Pyetje: Paraja në qarkullim ka pasur rritje të shpejtë gjatë javëve të fundit. Çfarë tregon kjo për politikën tuaja? Gjithashtu, Banka e Shqipërisë pritet të hedhë në treg prerje të reja 1.000 dhe 10.000 Lekë. Pse ky veprim?

Guvernatori: Më lejoni të sqaroj publikun se rritja e parasë fizike në qarkullim nuk është rezultat i politikave të Bankës së Shqipërisë, por i kërkesës së tregut për të. Ka dy momente të rëndësishme për të kuptuar këtë.

“... rritja e parasë fizike në qarkullim nuk është rezultat i politikave të Bankës së Shqipërisë, por i kërkesës së tregut për të.”

- Paraja fizike përfaqëson vetëm një pjesë të mjeteve të pagesës në ekonomi. Pjesa tjetër e këtyre mjeteve përbëhet nga depozitat dhe llogaritë rrjedhëse, kartat e kreditit, apo instrumente të tjera të parasë elektronike. Paraja fizike mund të konvertohet lirisht në format e tjera të parasë elektronike, dhe anasjelltas.
- Është zgjedhje e individëve dhe bizneseve nëse mjetet e tyre të pagesës do t’i mbajnë në formë të parasë fizike, apo në formë llogarish rrjedhëse, depozitash pa afat, letrash me vlerë të qeverisë, apo diçka tjetër.

Detyra jonë si Bankë Shqipërie është t’i përgjigjemi ndryshimit në kohë dhe në strukturë të preferencës së ekonomisë për formën e mjeteve monetare. Kjo do të thotë se nëse operatorët e ekonomisë duan të përdorin më shumë para fizike në transaksionet e tyre, atëherë ne do të furnizojmë më shumë *cash*, dhe anasjelltas. Ky është një element esencial i kontratës që kemi me publikun, në mënyrë që ai të ruajë besimin të monedha jonë kombëtare – por kjo nuk përfaqëson apo lidhet direkt me politikat tona monetare apo financiare.

Banka e Shqipërisë ka marrë të gjitha vendimet e nevojshme dhe ka angazhuar strukturat e saj në plotësimin e kërkesave të tregut me para fizike. Për ta ilustruar këtë, sjell në vëmendje disa tregues:

- Në katër muajt e parë të këtij viti, paraja në qarkullim është rritur me 9.9 miliardë lekë kundrejt pakësimit me -1.3 miliardë lekë në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.
- Vetëm gjatë muajit prill, sasia e parasë në qarkullim është rritur me 6.7 miliardë lekë, kundrejt pakësimit me 0.7 miliardë lekë në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Rritja e parasë në qarkullim është mbështetur nëpërmjet sigurimit të stokut të mjaftueshëm të parasë në Bankën e Shqipërisë, e cila jep siguri jo vetëm për të tashmen, por edhe për të ardhmen.

Në këtë kontekst, gjej me vend të theksoj se Banka e Shqipërisë ka nisur qysh në vitin 2019 procedurat për shtypjen e kartëmonedhave të serisë së re me vlerë 1000 dhe 10 000 Lekë, me synim hedhjen e tyre në qarkullim brenda tremujorit të katërt të këtij viti. Shtypja e kartëmonedhave të reja 1000 dhe 10 000 Lekë është pjesë e vijimësisë së punës së Bankës së Shqipërisë për të garantuar në çdo moment furnizimin e ekonomisë me para të gatshme. Për këtë arsye dëshiroj t'i garantoj të gjithë se tregu nuk ka dhe nuk do të ketë mungesa të parasë fizike.

Në një këndvështrim afatgjatë, ne jemi të ndërgjegjshëm se ekonomia shqiptare ka një përdorim të lartë të parasë fizike. Ky përdorim pasqyron shkallën e kulturës financiare, shkallën e informalitetit, por dhe zhvillimin e sofistikimit të sistemit financiar. Në këtë kontekst, Banka e Shqipërisë ka marrë një sërë aksionesh për të rritur ndërgjegjësimin e publikut, për të zhvilluar sistemin e pagesave, si dhe për të inkurajuar formalizmin e ekonomisë.

Pyetje: Si e shihni opsionin e *“helicopter money”*? Cilat janë avantazhet dhe dezavantazhet dhe a do të ishte zgjidhje në këtë situatë?

Guvernatori: Banka e Shqipërisë, si çdo bankë qendrore, nuk “dhuron” para. Në çdo rast, operacionet tona të injektimit të likuiditetit kanë formën e kredisë, e cila jepet gjithnjë kundrejt kolateralit, apo kanë formën e blerjes së asetëve financiare, të cilat janë likuide dhe me rrezik të ulët. Ky moment është mjaft i rëndësishëm. Ai nënkupton që vëllimi i likuiditetit që ne hedhim në treg i korrespondon nevojave reale të ekonomisë – çka është një parakusht për stabilitetin e çmimeve. Po ashtu, ai nënkupton se bilanci i Bankës së Shqipërisë është solid dhe pozicioni i saj i kapitalit është i qëndrueshëm, duke mos cenuar qëndrueshmërinë e financave publike.

“... përdorimi i operacioneve të tipit “helicopter money” nga bankat qendrore të ekonomive të zhvilluara dhe në zhvillim, deri më sot, mbetet një opsion teorik, i pa zbatuar në praktikë.”

Për këtë arsye, përdorimi i operacioneve të tipit *“helicopter money”* nga bankat qendrore të ekonomive të zhvilluara dhe në zhvillim, deri më sot, mbetet një opsion teorik, i pa zbatuar në praktikë.

Prerja e parave, në kuptimin që ka marrë së fundi, i referohet shpesh operacioneve të “dhurimit” të parave nga autoritetet publike për bizneset apo familjet në nevojë. Duke

iu referuar këtij interpretimi të pyetjes, dëshiroj të theksoj se kryerja e operacioneve të ngjashme nga Banka e Shqipërisë është i pamundur. Së pari, sepse nëse realizohet nga banka qendrore, ai bie ndesh me objektivin tonë kryesor, stabilitetin e çmimeve, dhe për këtë arsye nuk është i lejuar nga kuadri ligjor që rregullon punën e institucionit tonë. Së dyti, pasi operacione të ngjashme do të ngarkonin me humbje bilancin e Bankës së Shqipërisë, humbje e cila do të duhej të transferohej në buxhetin e shtetit. Me fjalë të tjera, këto operacione nënkuptojnë një përkeqësim të borxhit publik të vendit dhe si të tilla, mund dhe duhet të kryhen vetëm nga autoritetet fiskale.

Pyetje: FMN-ja dhe Banka Botërore parashikojnë se në skenarin bazë, ekonomia do të tkurret me 5% këtë vit. Po Banka e Shqipërisë si e vlerëson efektin që COVID-19 do të shkaktojë në ekonomi?

Guvernatori: Pandemia COVID-19 dhe masat e distancimit social të marra për adresimin e saj kanë dhënë një goditje komplekse mbi aktivitetin ekonomik në vend. Nga njëra anë, masat e distancimit social dhe rritja e pasigurisë kanë sjellë rënie të konsumit, të investimeve dhe të eksporteve shqiptare. Nga ana tjetër, masat e distancimit social kanë nënkuptuar dhe ndërprerje të detyruar të prodhimit në segmente apo sektorë të caktuar të ekonomisë shqiptare.

“Pandemia COVID-19 dhe masat e distancimit social të marra për adresimin e saj kanë dhënë një goditje komplekse mbi aktivitetin ekonomik në vend.”

Në deklaratën e fundit për shtyp të lëshuar nga Këshilli Mbikëqyrës, në përfundim të analizës së Raportit Tremujor të Politikës Monetare, ne jemi shprehur qartë se Banka e Shqipërisë pret një rënie të aktivitetit ekonomik në vitin 2020. Po ashtu, ne jemi shprehur se ky recesion do të shoqërohet me rënie të punësimit dhe rritje të papunësisë, me vështirësi financiare për mjaft biznese dhe familje, të cilat përballen më rënie të fortë të të ardhurave, me rritje të borxhit të huaj dhe rritje të borxhit publik, si dhe rënie të të ardhurave në sistemin financiar.

Skenari ynë bazë i parashikimeve, i cili është bazuar në supozimin se pandemia kulmon në tremujorin e dytë dhe masat e distancimit social do të vijnë drejt normalizimit pas kësaj periudhe, ofron projeksione të krahasueshme të rënies ekonomike me ato që ju cituat. Ndërkohë, skenarë të tjerë, të cilët faktorizojnë një zgjatje të mëtejshme të pandemisë, ofrojnë projeksione dhe më të thella të rënies ekonomike.

“Pasiguria mbi zhvillimin e pandemisë dhe dëmin që ajo do të lërë pas, e vështirëson përtej normales punën e parashikimit të zhvillimeve ekonomike në të ardhmen.”

Në çdo rast, është e qartë që goditja është e paprecedentë dhe mjaft komplekse.

Politikat tona kundërciklike – monetare, fiskale dhe financiare – nuk mund ta shmangin të gjithë efektin negativ të goditjes, por ato mund dhe duhet të synojnë të shmangin pasojat afatgjata që kjo goditje mund të ketë në ritmin e rritjes së ardhshme

ekonomike. Këtu kam parasysh ruajtjen e bizneseve dhe kapaciteteve prodhuese të vendit, mbrojtjen e familjeve dhe shtresave në nevojë, si dhe ruajtjen e stabilitetit monetar dhe financiar të vendit.

Pyetje: Sa të shpejtë e prisni rimëkëmbjen dhe rikthimin në normalitet?

Guvernatori: Pasiguria mbi zhvillimin e pandemisë dhe dëmin që ajo do të lërë pas, e vështirëson përtej normales punën e parashikimit të zhvillimeve ekonomike në të ardhmen.

Në skenarin tonë bazë, pandemia do të sjellë një tkurrje të aktivitetit ekonomik gjatë vitit 2020. Më tej, me zbutjen graduale të masave të kontrollit, rikuperimi i ekonomisë pritet të jetë relativisht i shpejtë. Rritja ekonomike pritet të kalojë në territor pozitiv në vitin 2021 dhe të ndjekë një trajektore rritëse në vijim. Rritja e kërkesës dhe e punësimit do të ushtrojnë presione për rritjen e pagave, të kostove të brendshme dhe të inflacionit.

Në një skenar pesimist, zgjatja në kohë e kufizimeve do të vononte dhe ngadalësonte rikuperimin e ekonomisë.

“Stimujt fiskalë, monetarë e financiarë që kemi ndërmarrë, i kanë dhënë një mbështetje jetike ekonomisë, e veçanërisht sektorëve dhe familjeve të prekura.”

Stimujt fiskalë, monetarë e financiarë që kemi ndërmarrë, i kanë dhënë një mbështetje jetike ekonomisë, e veçanërisht sektorëve dhe familjeve të prekura. Natyrisht, në rast se kriza zgjatet dhe perspektiva ekonomike bëhet dhe më sfiduese, autoritetet publike do të duhet të marrin në konsideratë një rritje të mëtejshme të stimullit ekonomik, por kjo është diçka për të cilën ne jemi të ndërgjegjshëm dhe të

vëmendshëm. Në mbyllje, dëshiroj të them se, ndonëse goditja që po kalojmë është mjaft e fortë, përgjigjja e koordinuar e politikave makroekonomike krijon premisa për rikuperimin e shpejtë të aktivitetit ekonomik pas përfundimit të saj. Shqipëria i ka të gjitha potencialet për ta kaluar me sukses këtë test.

INTERVISTË E GUVERNATORIT SEJKO PËR TELEZIONIN ORA NEWS

- 11 maj 2020 -

Pyetje: Ju vazhdimisht e keni përsëritur që nëse kriza do të vazhdojë, efektet do të jenë negative në ekonomi. Shoqëria, pak nga pak, po i kthehet normalitetit. Me kaq sa keni parë këto 9-10 javë, çfarë po ndodh me ekonominë shqiptare? Çfarë pasojash kemi?

Guvernatori: Ju bëtë një përmbledhje në hyrje të prezantimit që është pak a shumë mesazhi i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për ekonominë shqiptare. Ekonomia shqiptare, ashtu si ato të rajonit e me gjerë në të gjithë botën, është goditur nga COVID-19. Kjo është një goditje që ka ardhur si në kërkesë ashtu dhe në ofertë; është ndërprerë zinxhiri i prodhimit, si pasojë e masave të distancimit social. Qytetarët kanë qenë të detyruar të vetizolohen dhe patjetër që kjo ka pasur efektet e saj në ekonomi. Ne si Këshill Mbikëqyrës bëmë analizën tonë dhe parashikojmë që goditja më e fortë në ekonominë shqiptare do të jetë në tremujorin e dytë - kjo në fakt është sipas skenarit pozitiv që ne kemi parashikuar - dhe në tremujorin e tretë dhe atë të katërt të vitit 2020 do të vazhdojmë të kemi rënie ekonomike, megjithëse jo kaq të fortë sa ky tremujor. Kështu, ringritja parashikohet të ndodhë në vitin 2021 - kjo gjithmonë nëse nuk do të ketë një kthim të situatës së virusit dhe nuk do të kemi përsëritje të masave izoluese. Shpresojmë që periudha e verës të ketë një relaksim të menaxhuar dhe të kujdesshëm të masave, të ndjekur nga një rihapje dhe një ringritje e domosdoshme e aktivitetit ekonomik.

“Ne shpresojmë që ringritja të jetë e shpejtë, pavarësisht se efektet do të vazhdojnë edhe në dy tremujorët në vijim.”

Pyetje: Shpresojmë se do të kemi një ringritje së paku nga turizmi...

Guvernatori: Patjetër, siç e kemi theksuar në dalje të tjera televizive, turizmi është një nga shtyllat e ekonomisë së Shqipërisë. Vendi ynë ka bregdet dhe agroturizëm. Presim që në muajin qershor të ketë një hapje të menaxhuar dhe turizmi të ketë efektin e tij në ekonomi, por përtej

turizmit edhe industri të tjera gradualisht do të fillojnë të hapen. Presim që shifrat e të prekurve të vijnë në rënie dhe pastaj mbetet të shohim se sa e shpejtë do të jetë ringritja ekonomike. Ne shpresojmë që ajo të jetë e shpejtë, pavarësisht se efektet do të vazhdojnë edhe në dy tremujorët në vijim. Ashtu siç e kanë parashikuar dhe institucionet ndërkombëtare, për Shqipërinë dhe Eurozonën, ringritja do të jetë shumë e fortë në vitin 2021. Ky është parashikim, por natyrisht që ne mund të përballemi me një skenar më pozitiv ose më negativ.

Pyetje: Zoti Sejko, ndërkohë, në raportin e fundit të Bankës së Shqipërisë, rezulton se ulja e depozitave ka ardhur në pesëdhjetë milion euro, ka pasur gjithashtu një rritje të kredive të këqija për muajin mars. Çfarë po ndodh me depozitat e shqiptarëve? Pasi kemi krizën COVID-19, por gjithashtu kemi edhe një krizë të shkaktuar nga tërmeti i nëntorit. Pra janë disa valë goditjesh...

Guvernatori: Faktikisht, duhet thënë që këtyre goditjeve kaq të forta e të paparashikueshme sistemi financiar shqiptar u ka rezistuar më së miri.

“Në fillimet e krizës, parashikimet ishin më të frikshme, më të zymta, por ky test vërtetoi edhe njëherë që sistemi ynë financiar është i mirëkapitalizuar dhe me likuiditet të mjaftueshëm për të përballuar situata të vështira krize”.

Në fillimet e krizës, parashikimet ishin më të zymta, por ky test vërtetoi edhe njëherë që sistemi ynë financiar është i mirëkapitalizuar dhe me likuiditet të mjaftueshëm për të përballuar situata kaq të vështira krize. Në fakt nuk është se ka një rënie esenciale depozitash. Depozitat totale janë rreth 8 miliardë, por pavarësisht nga shifra, duke pasur parasysh këtë, rënia me 50 milion euro nuk është e papërfillshme, pasi kemi pasur një bllokim të aktivitetit ekonomik dhe sigurisht që mund të kemi pasur tërheqje, por

nuk kanë qenë tërheqje substanciale.

Sistemi bankar ka funksionuar shumë mirë. Ai ka kryer aktivitetin e tij operacional pa asnjë problem si në transaksionet operacionale ashtu edhe në transaksionet e *cash*-it. Pavarësisht kësaj, problem *de facto* është shtyrja e kësteve të kredive që krijon një implikim në treguesit financiarë të bankave të nivelit të dytë, pasi nuk do të tërheqin likuiditetin sipas parashikimit. Treguesi i kredive me probleme, deri tani, nuk ka pasur një rritje të ndjeshme, por natyrisht që në muajt në vijim ne do të kemi përkeqësim të disa shifrave si treguesi i kredive me probleme ose rritja e kreditimit në sistemin bankar. E rëndësishme është që bankat

kanë likuiditet dhe mjaftueshmëri kapitali. Pavarësisht gjendjes shumë të mirë të tyre, ne si rregullator duhet të jemi të kujdesshëm të mos e kalojmë të gjithë barrën e riskut te sistemi bankar, por të mbikëqyrim dhe monitorojmë me shumë kujdes të gjithë aktivitetin.


Pyetje: Ju flisni për një sistem bankar të shëndetshëm dhe për një ekonomi që gjithsesi ka likuiditete, megjithatë Qeveria Shqiptare vazhdimisht kërkon hua. Ajo ka siguruar një kredi të fundit prej 174 milion eurosh për të përballuar krizën nga FMN-ja. Çështja është çfarë ndodh me borxhin e shqiptarëve sepse ai është rritur vazhdimisht dhe para krizës ka qenë të paktën 65%?

Guvernatori: Sigurisht, borxhi ra në nivelin 65% të prodhimit të brendshëm bruto para krize, por gjatë kësaj periudhe, jo vetëm ne si BSH, por edhe institucionet ndërkombëtare dhe të gjitha bankat qendrore në mbarë botën, kanë dalë nga kriteret dhe parametrat e ruajtjes së nivelit të borxhit. Kjo goditje kaq e fortë ekonomike sigurisht që imponon edhe mosrespektimin e nivelit të borxhit për një periudhë të caktuar.

Natyrisht që Qeveria Shqiptare burimet e nevojshme për të përballuar këtë krizë do t'i gjejë përmes huasë. Kjo për shkak se bllokimi i ekonomisë, bllokimi i veprimtarive prodhuese, i bizneseve, turizmit dhe të gjitha industrive, ka bërë që të mos ketë të ardhura të nevojshme në buxhetin e shtetit. Pra, ashtu si në sektorin privat, është prishur normaliteti edhe në funksionimin e buxhetit të shtetit. Në këto kushte, të gjitha qeveritë janë të detyruara të marrin borxh, që t'i ndihmojë në kapërcimin e kësaj krize, borxh i cili do të menaxhohet në vitet në vijim. Kjo është mënyra se si do të arrijnë të gjitha qeveritë që të bëjnë kapërcimin e krizës.

Pra, niveli i borxhit patjetër do të rritet, rëndësi ka që ne ta kalojmë këtë moment goditjeje pa falimente, pa thyerje, dhe të jemi në gjendje të ruajmë stabilitetin financiar dhe monetar të vendit. E rëndësishme është gjithashtu që të kemi një ringritje ekonomike dhe për këtë ne do të na duhet të menaxhojmë gjithmonë e më mirë dhe fiskun. Banka qendrore, në fakt, ka objektiv kryesor politikën monetare, ndërsa politika fiskale menaxhohet nga qeveria.

Grafik 41. Deficiti, instrumentet e financimit të tij (majtas) dhe financuesit në tregun e brendshëm (djathtas)*



*Vlerat mbi boshtin horizontal për deficitin në këtë grafik nënkuptojnë që ka deficit fiskal, dhe ato nën zero nënkuptojnë suficit fiskal.
Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Banka e Shqipërisë.

Pyetje: Dy ditë më parë, “The Economist” shkruante: “Shumicën e ekonomistëve nuk i shqetëson fakti se qeveritë do të marrin hua në mënyrë të pamatur, por se do të ngurojnë për ta bërë këtë, për shkak të frikës irracionale nga rritja e borxhit publik. Kur flasim për terma ekonomikë, ne zakonisht krahasohemi me vendet e rajonit. Serbia dhe Maqedonia e Veriut kanë ndjekur politikën e ndjekjes së eksporteve dhe prodhimit, ndërsa Shqipëria është përqendruar veçanërisht te koncesionet, pra këto janë dhe aktivitetet që kanë rritur më së shumti borxhin, ndërkohë që tani na ka goditur edhe kjo krizë e re. Deri ku mund të mbajë borxhi publik i Shqipërisë?”

Guvernatori: Për këtë nuk ka një shifër ekzakte, pasi varet nga mirëmenaxhimi i financave publike; sa më mirë të menaxhohen financat publike aq më mirë do të shkojë niveli i borxhit. Para krize, objektivi kryesor i menaxhimit nga Qeveria Shqiptare ka qenë konsolidimi fiskal. Pra, ne kemi ndjekur një politikë monetare lehtësuese, e cila shkonte në drejtim të uljes së normave të interesit për të nxitur kreditimin, konsumin dhe investimet, dhe një politikë fiskale konsoliduese, e cila synonte uljen e nivelit të borxhit publik. Tashmë me këtë krizë sikurse dhe me goditjen që morëm nga tërmeti, do të jemi të detyruar të kalojmë nga konsolidimi fiskal në një farë lehtësimi fiskal. Është e vërtetë që sa më i lartë të jetë borxhi aq më e vështirë është të mirëmenaxhohet dhe aq më vështirësi ka qoftë likuidimi i detyrimeve nga ana e qeverisë, qoftë dhe tërheqja e investitorëve të huaj dhe të gjithë parametrave të tjerë

makroekonomikë, por në rast se do të ketë një menaxhim të mirë fiskal sigurisht që niveli i borxhit do të ulet përsëri. Për nivelin e borxhit ka një objektiv të përcaktuar me ligj organik nga i cili do të duhet të dilet në këtë periudhë, për t'iu rikthyer më pas me kalimin e krizës.

Pyetje: Zoti Sejko, në datë 8 prill, banka qendrore ka marrë vendimin për heqjen e komisioneve të transfertave bankare. Si po ecën ky proces?

Guvernatori: Procesi po ecën mirë. Ne kemi bërë ndryshime rregullative dhe kemi marrë vendimin për të hequr komisionet bankare që aplikojmë ne si Bankë Shqipërie dhe në këtë mënyrë, indirekt, ne i detyrojmë bankat e nivelit të dytë të heqin komisionet bankare vetëm për transfertat digjitale. Me këtë vendim kemi ecur paralel me masat e distancimit social dhe kemi krijuar lehtësi për klientët, individë ose biznese, për të kryer sa më shumë veprime digjitale. Në fakt, këto veprime janë rritur mjaftueshëm dhe kjo është në linjë me objektivin tonë të luftës kundër informalitetit dhe të rritjes së përfshirjes financiare – rritja e numrit të individëve me llogari dhe e veprimeve bankare. Kjo është një nga masat që kemi marrë në periudhën e krizës, paralel me masat e tjera.

“Ne kemi bërë ndryshime rregullative dhe kemi marrë vendim për të hequr komisionet bankare që aplikojmë ne si Bankë Shqipërie dhe në këtë mënyrë, indirekt, ne i detyrojmë bankat e nivelit të dytë të heqin komisionet bankare vetëm për transfertat digjitale.”

Pyetje: Një masë tjetër shumë e rëndësishme është edhe ristrukturimi i kredive, pra shtyrja e kësteve të kredive nga tre në gjashtë muaj. Megjithatë, do të ketë ndërkaq biznese që do të kenë nevojë për shtyrje të mëtejshme. A do të marrë një vendim tjetër Banka e Shqipërisë për këto raste ekstreme?

Guvernatori: Këtë jemi ende duke e shqyrtuar. Vendimi i parë, që ju përmendët, ishte për një shtyrje tremujore të kësteve të kredive, për shkak të mbylljes së aktivitetit dhe mospasjes së të ardhurave për të likuiduar detyrimet nga individët dhe bizneset. Bankat u treguan shumë mirëkuptuese në drejtim të ndryshimeve rregullative që ne si Bankë Shqipërie bëmë për shtyrjen me një tremujor të kësteve të kredisë. Ato vepruan shpejt dhe në mënyrë proaktive. Kemi pasur të bëjmë me dy miliard euro kredi të shtyra për një tremujor, nga katër miliard që është në total portofoli i kredive. Pra rreth 50% e portofolit të kredive është shtyrë, ose rreth 21 mijë raste. Pavarësisht kësaj, ne jemi të ndërgjegjshëm që bizneset vazhdojnë të qëndrojnë mbyllur. Cikli i prodhimit për shumë prej tyre do të vazhdojë

të jetë në vështirësi, të ardhurat e tyre nuk do të jenë në përputhje me projeksionet përpara krize dhe këto vështirësi natyrisht që do të pasqyrohen në shlyerjen e detyrimeve kundrejt sistemit bankar. Në këtë kontekst, ne jemi duke analizuar situatën me bankat e nivelit të dytë, për të parë nëse do të jetë e nevojshme një shtyrje tjetër. Natyrisht që për të mirën e biznesit kjo do të ishte e nevojshme, por nga ana tjetër, prioriteti ynë kryesor është stabiliteti financiar, pra t'i mbajmë bankat e shëndetshme.

Pyetje: Nga shifrat e deritanishme rezultojnë që bankat e nivelit të dytë janë të shëndetshme, megjithëse kanë fitime më të vogla krahasuar me një vit më parë.

Guvernatori: Patjetër, çdo aktivitet funksionon me fitim. Bankat janë biznese private dhe si çdo biznes tjetër kanë pasur fitimet e tyre, por efektet e krizës do të ndihen në kapital edhe në përfitueshmëri. Ne jemi ende në fillim dhe efektet financiare në institucionet financiare reflektohen gjithmonë me vonesë. Në muajt në vijim do të shohim një përkeqësim në portofolin e kredive, gjithashtu do të kemi një rritje më të moderuar ose një rënie në ritmet e kreditimit. Pavarësisht nga gjendja e mirë e likuiditetit në banka, ne na duhet t'i mbrojmë ato, në mënyrë që të kenë vijimësi të shëndetshme. Nuk duhet të harrojmë që të gjitha këto fonde dhe likuiditete për të cilat po flasim, janë depozitat e qytetarëve shqiptarë dhe ne duhet t'i mirëmenaxhojmë. Bankat janë ndërmjetës financiarë që duhet të kryejnë rolin e tyre, por nuk janë varka shpëtimi nga kjo krizë. Ato po luajnë një rol të rëndësishëm, megjithatë roli ynë si rregullator është që të kujdesemi që ato të bëjnë gjithçka në

“Bankat janë ndërmjetës financiarë që duhet të kryejnë rolin e tyre, por nuk janë varka shpëtimi nga kjo krizë.”

ndihmë të biznesit, por pa u thyer vetë.

Pyetje: Ju thatë pak më parë që nuk ka problem likuiditeti në ekonominë shqiptare. Çështja është si kanë ndikuar dy paketat e propozuara nga qeveria në kuadër të masave për të ndihmuar individët dhe biznesin në këtë krizë pandemie?

Guvernatori: Paketa e dytë është duke u përpunuar dhe do të prezantohet shumë shpejt. Deri tani, bizneset kanë përdorur vetëm paketën e parë të qeverisë, e cila ka qenë garancia sovrane për t'u përdorur për të paguar pagat e punonjësve. Nga shifrat e para dy ditëve – shifër jopërfundimtare pasi është në përditësim të vazhdueshëm – kemi të bëjmë me rreth 8.5 milionë euro, ndoshta 9 milion euro kredi të dhëna nga bankat për këtë qëllim. Nga informacioni më i fundit, në mos gaboju,

qeveria mori vendim edhe për të marrë përsipër pagesën e interesit për këto kredi. Duhet theksuar që, pavarësisht nga garancia sovrane, e cila merr përsipër riskun për këtë pjesë, shumë klientë kanë ekspozime edhe më të mëdha, pra kriteret e riskut janë pak më gjerë sesa niveli i kësaj garancie dhe kërkon një vështrim më të kujdesshëm nga ana e bankave. Ka raste klientësh që kanë pakënaqësi, por duhet të kemi parasysh që kjo vjen si pasojë e performancës së tyre të mëparshme me bankat, e ciklit të tyre të biznesit dhe e situatës së tyre financiare. Thënë ndryshe, jo gjithë klientët mund të jenë në gjendje të përfitojnë nga kjo garanci, por shumica e tyre po përfitojnë.


Pyetje: Ndërkaq, Banka e Shqipërisë ka nisur aplikimin e politikës monetare jokonvencionale. Mund ta shpjegoni se ku konsiston ajo, për të qenë pak më të qartë për ata që na ndjekin?

Guvernatori: Ne kemi njoftuar që do të vazhdojmë me lehtësimin e politikës me masat tona për një politikë monetare lehtësuese. Politika monetare lehtësuese është ulja e normës bazë të interesit, të cilën ne e kemi çuar në minimumin e saj historik prej 0.5%. Kjo do të thotë që njerëzit mund të marrin kredi me norma interesi më të ulëta. Kjo bëhet për të stimuluar kreditimin, por edhe konsumin dhe investimet. Një masë tjetër e jona si bankë qendrore është edhe politika monetare jokonvencionale, pra injektimi i likuiditetit në ekonomi. "Quantitative easing" ose në shqip "lehtësimi sasior" është një formë e injektimit të likuiditetit në treg. Në vendet e zhvilluara, likuiditeti injektohet duke blerë letra me vlerë të qeverive ose të korporatave. Në Shqipëri, duke qenë se nuk kemi një treg kapitalesh dhe nuk mund të funksionojë blerja e letrave me vlerë të korporatave, kjo do të kryhej duke blerë letrat me vlerë të Qeverisë Shqiptare nëpërmjet tregut sekondar, pra tregut bankar. Në vendin tonë, kjo lloj mase nuk është aplikuar ende, por në rast se do të shohim që niveli i deficitit buxhetor do të zgjerohet dhe qeveria do të ketë nevojë për likuiditet në një moment të caktuar, natyrisht që ne do të aplikojmë lehtësim sasior. Pra, ne jemi të përgatitur për ta përdorur atë. Qeveria Shqiptare, mesa kemi dijeni, po përgatitet për të marrë një eurobond dhe tërheqja e tij do të krijonte likuiditet të mjaftueshëm. Megjithatë, në muajt në vijim do të shohim si do të performojë ekonomia.

Pyetje: Zoti Guvernator, dua t'ju pyes, a ka ndërhyrë Banka e Shqipërisë këto kohë për të stabilizuar kursin e këmbimit valutor, sepse ditët e para të bllokimit nga pandemia u vu re një rritje shumë e shpejtë e kursit të këmbimit të euros?

Guvernatori: Kursi i këmbimit është një indikator shumë sensitiv që kryesisht përcaktohet nga kërkesë/oferta në treg. Ne kemi një regjim të lirë të kursit të këmbimit, dhe për sa kohë është kështu, ai do të përcaktohet nga kërkesa dhe oferta në treg. Duhet ta dini që faktori psikologjik ka një ndikim të fortë në nivelin e kursit të këmbimit. Kur ka goditje të forta, aktiviteti spekulativ shtohet dhe faktori psikologjik ndikon. Bankat qendrore dhe Banka e Shqipërisë, në këtë kontekst, kanë parametrat e tyre për të ndërhyrë. Ne nuk kemi një objektiv për kursin e këmbimit, por ndërhyjmë në rast se prishen disa parametra, pra kur niveli i kursit të këmbimit godet nivelin e inflacionit. Në vitin 2018 kemi ndërhyrë duke blerë një sasi eurosh për të stabilizuar kursin e këmbimit, ndërsa tani jemi në rastin e kundërt, pra tani është zhvlerësuar monedha kombëtare dhe Banka e Shqipërisë ka ndërhyrë shumë pak në momentin kulmor, duke shitur një sasi në dy ditë të caktuara. Në vijim, kursi është stabilizuar dhe për fat ka vazhduar të mbetet i tillë. Kursi i këmbimit, sikurse e kemi theksuar, përcaktohet nga të hyrat, pra ka disa burime fundamentale që sjellin euro në Shqipëri, siç janë investimet e huaja direkte, turizmi dhe remitancat. Natyrisht, këto burime do të goditen nga kriza dhe kjo do të sjellë një pakësim të euros dhe nga ana tjetër do të bjerë kërkesa. Pra përveç ofertës ka rënë dhe kërkesa, dhe kjo ka krijuar një kurs stabil. Në rast se periudha e verës do të ketë një aktivitet të rigjallëruar të turizmit, kjo do të ndikojë pozitivisht në stabilizimin e kursit të këmbimit. Në kushte fundamentale teorike, krizat sjellin zhvlerësim në kursin e këmbimit, pra mund të kemi inflacion, por praktikisht Shqipëria ka specifikat e veta. Partnerët tanë tregtarë janë në Eurozonë dhe ne kemi euro në sasi të mjaftueshme. Besoj se kursi do të jetë i stabilizuar dhe mund të mos ketë nevojë për ndërhyrje të fuqishme nga ana jonë, gjë që do të na gërryente rezervat.

Grafik 42. Kursi i këmbimit në tregun vendas dhe treguesi i anshmërisë për mbijmim/nënçmim për kursin eur/lek



Burimi: Banka e Shqipërisë.

*Treguesi i anshmërisë për mbijmim/nënçmim llogaritet si raport i numrit të ditëve kur kursi është mbijmuar kundrejt numrit të ditëve kur kursi është nënçmuar, në një horizont kohor trishqitës që mund të variojë, p.sh., nga 22 ditë (një muaj kalendarik) deri në 250 ditë (një vit kalendarik). Vlera 1 e këtij treguesi përfaqëson vlerën ekuilibër, ku numri i ditëve që kursi është mbijmuar është i barabartë me numrin e ditëve kur kursi është nënçmuar, dhe tregon se në treg nuk ka pasur anshmëri për mbijmim apo nënçmim. Nëse vlera e këtij treguesi është mbi 1 (nën 1), atëherë në treg ka sinjale për pritshmëri të njëanshme për mbijmim (nënçmim) të kursit.

INTERVISTË E GUVERNATORIT SEJKO PËR TELEVISIONIN ABC NEWS

- 20 maj 2020 -

Pyetje: Jemi në një periudhë krize dhe kjo i ka futur në lojë bankat qendrore dhe qeveritë, gjithandej. Në teori, kush duhet të përballojë një krizë të kësaj përmase, bankat qendrore, qeveritë apo të dyja bashkë?

Guvernatori: Natyrisht që këtë krizë do ta përballojnë së bashku qeveritë dhe bankat qendrore, por dhe të gjithë aktorët e tjerë, përfshirë këtu edhe sektorin privat. Pra, të gjithë duhet të jenë të përgatitur që efektet dhe pasojat e kësaj krize do të prekin të gjithë aktorët e tregut. Normalisht, qeveria ka rolin kryesor. Ne e kemi theksuar që janë politikat fiskale ato që marrin rolin kryesor në përballimin e pasojave të një krize. Ndërkohë që banka qendrore ka rolin e saj me politikën monetare dhe politikën makroprudenciale për të ndikuar në zbutjen e krizës. Ne si bankë qendrore kemi ulur normën e interesit, pra kemi ndikuar me politikën tonë monetare lehtësuese, për të reaguar në mënyrë proaktive në zbutjen e efekteve të kësaj krize, duke u përpjekur të stimulojmë kreditimin. Njëkohësisht kemi rritur dhe injektimin e likuiditetit nëpërmjet sistemit bankar, për të plotësuar nevojat e ekonomisë për likuiditet. Gjithashtu, edhe qeveria ka reaguar proaktivisht nga ana e saj.

“Banka Qendrore ka rolin e saj me politikën monetare dhe politikën makroprudenciale për të ndikuar në zbutjen e krizës.”

Pyetje: Ju keni dhënë një intervistë shumë të plotë dhe tejet teknike për revistën “Monitor” pak ditë më parë. Keni folur në takim me një pjesëmarrje shumë të zgjedhur njerëzish nga fusha e biznesit dhe e sistemit bankar, por jo të gjithë ata që na shohin sot janë lexues të sprovuar të revistës ekonomike. Më lejoni vetëm të shpjegoj shumë shkurt që ulja e normës së interesit - që ju e keni bërë, duke e çuar në 0.5%, që është niveli më i ulët historik - sipas jush, e bën parandë më të lirë dhe lehtëson shërbimin e kredisë. Pra, p.sh. nëse dikush ka marrë një kredi për shtëpi, presupozohet që ai të paguajë më pak, pra kjo e bën dhe më të lirë kredinë. Jam i saktë në këtë përkthim shqip-shqip të asaj që ju keni bërë si bankë qendrore?

Guvernatori: Jeni shumë i saktë.

Pyetje: Ju thatë që masën kryesore e ka marrë qeveria me politikat fiskale, pra me injektimin e ndihmës për bizneset, por do ta paguajmë të gjithë bashkë, pra edhe Banka e Shqipërisë, edhe niveli bankar? Si bëhet rakordimi me masat e qeverisë? Në gjuhë teknike, ju e quani harmonizim të politikës monetare me atë fiskale. Ju lutem, na e shpjegoni si bëhet kjo praktikisht?

Guvernatori: Banka qendrore është një institucion i pavarur dhe siç po e theksoja, ne nëpërmjet politikës sonë monetare lehtësuese, ulim normën e interesit për të rritur kreditimin në ekonomi dhe për të ulur koston e kredisë, por njëkohësisht për të stimuluar edhe investimet dhe konsumin. Nga ana tjetër, qeveria me politikat e saj fiskale - konkretisht në rastin e kësaj krize - ka rimbursuar ose ka kompensuar nevojat e popullsisë në radhë të parë, për pagën e luftës. Njëkohësisht, ajo ka lëshuar garancinë sovrane, e cila i ka dhënë mundësi bizneseve, për të marrë gjithashtu paga. Megjithatë, ai që unë desha të theksoja dhe në mendimin tim është më kryesori, është harmonizimi i politikës monetare me politikën fiskale. Politika jonë monetare ka qenë lehtësuese dhe para pandemisë, dhe kështu ka vazhduar të jetë edhe gjatë saj, duke ulur normën e interesit e duke rritur injektimin e likuiditetit në ekonomi. Ndërkohë që politika fiskale e qeverisë është dashur të ndryshojë. Tashmë nuk jemi më në një situatë harmonizimi ose koordinimi të politikës monetare lehtësuese të bankës qendrore me politikën fiskale konsoliduese nga ana e qeverisë, por dhe qeveria do të duhet të ndjekë një politikë fiskale lehtësuese. Gjithë këto masa të marra nga qeveria janë në drejtim të një politike fiskale lehtësuese, pasi ajo ka shtyrë taksat dhe tatimin mbi fitimin për një periudhë të caktuar, ka lëshuar garancinë sovrane në drejtim të bankave të nivelit të dytë për të ndihmuar biznesin për pagesën e pagave dhe një garanci e dytë sovrane në drejtim të nevojave të biznesit, është duke u firmosur me bankat e nivelit të dytë dhe do të bëhet efektive së shpejti.

Njëkohësisht, do doja të përmendja këtu dhe politikat makroprudenciale që ne ndjekim. Këto duken si fjalë të mëdha, por bëhet fjalë për ndryshimet rregullative në drejtim të lehtësive që ne i krijojmë sistemit bankar, nëpërmjet një shtyrjeje 3-mujore të kredive për bizneset dhe individët në vështirësi, si dhe për të pasur mundësi ristrukturimi të portofoleve të kredive të bizneseve për t'i ndihmuar ato ta kalojnë me sa më pak dhimbje këtë situatë të vështirë financiare. Dua gjithashtu të theksoj që stabiliteti monetar dhe stabiliteti financiar janë prioriteti ynë kryesor. Kjo do të thotë që ne jemi të gatshëm të bëjmë maksimumin,

me bashkëpunimin e sistemit bankar, për të kaluar këtë krizë, gjithnjë pa cenuar në themel shëndetin e tij.

Pyetje: Sa i përket harmonizimit të politikave mes jush dhe qeverisë, kush ndjek kë? Jeni ju që e ndiqni qeverinë apo qeveria që ju ndjek ju? Duket si pyetje kureshtare, naive, por do t'ua shpjegoj në vijim përse e ngre.

Guvernatori: Në një situatë të vështirë krize si kjo që po kalojmë, natyrisht që prioritet merr fisku, pra marrin politikat fiskale të qeverisë, pasi ato kanë dhe barrën kryesore. Nëpërmjet këtyre paketave dhe masave, qeveria merr përsipër koston financiare të krizës nga sektori privat në sektorin publik, pra kjo kosto transferohet. Sigurisht që kjo do të sjellë një rritje të borxhit dhe më pas në të ardhmen, kjo kosto do të transferohet në brezat e ardhshëm, pasi menaxhimi i buxhetit bëhet me taksat e qytetarëve. Natyrisht që banka qendrore po ndjek politikat e saj të përcaktuara me ligj, të cilat nuk do të thosha se ndjekin ekzaktësisht politikat e qeverisë, pasi pavarësisht faktit që politikat janë të harmonizuara, banka qendrore po kryen rolin e saj në funksion të parametrave makroekonomikë.

“Nëpërmjet këtyre paketave dhe masave, qeveria merr përsipër koston financiare të krizës nga sektori privat në sektorin publik”.

Pyetje: z. Guvernator, në datë 13 maj, ju kishit takimin me biznesin dhe sistemin bankar, ku mbajtët një fjalim mjaft të detajuar mbi sfidat me të cilat përballet Shqipëria në këtë kohë krize. Ju folët për rënie ekonomike, papunësi dhe varfëri. Do ta shtjellojmë ndoshta në fund të bisedës atë që na pret në vlerësimin tuaj si Guvernator i Bankës së Shqipërisë. Dy ditë më pas, në datë 15 maj, Kryeministri në komunikimin e tij me publikun tha, po e citoj: “Po ju them që në fund të vitit ne do të kemi rezultat ekonomik dhe financiar sipas parashikimit, më të mirë sesa në fund të vitit të kaluar, dhe në vitin e ardhshëm do të bëjmë një histori të madhe suksesi, kini besim për këtë”. Për këtë më parë ju pyeta se si harmonizoheni dhe rakordoheni me qeverinë, që vlerësimet tuaja si Guvernator dhe ato të Kryeministrit të mos të jenë kaq të ndryshme, në pamje të parë. A keni një koment se si do jemi ne në fund të vitit?

Guvernatori: Nuk besoj dhe nuk gjykoj që vlerësimet dhe gjykimet janë të distancuara, por natyrisht që Qeveria Shqiptare ka analizën e saj, ndërsa ne kemi analizën tonë. Unë ju thashë që në fillim të intervistës që banka është një institucion i pavarur. Në bazë të ligjit, ne jemi

gjithashtu dhe këshilltar i qeverisë, por më konkretisht ne koordinohemi në mënyrë intensive, sidomos në këtë situatë krize, me Ministrinë e Financave. Ne jemi pothuajse në komunikim të përditshëm për shumë elemente, si për shembull për menaxhimin e situatës së likuiditetit, e cila nuk mund të funksionojë nëse banka qendrore nuk është e ndërlidhur me Ministrinë e Financave, pasi ne jemi dhe mbartës dhe menaxhues të llogarive të qeverisë. Përveç Ministrisë së Financave, ne jemi gjithashtu në komunikim edhe me ministrin Ahmetaj, në cilësinë e koordinatorit të qeverisë për këtë gjendje. Megjithatë, pavarësisht komunikimit dhe koordinimit, banka qendrore ka vlerësimet dhe konkluzionet e saj në funksion të krizës, ndërsa qeveria ka konkluzionet e saj. Në përgjithësi, ne jemi në një linjë. E rëndësishme është që të kuptojmë se kjo është një situatë kalimtare dhe të harmonizojmë dhe koordinojmë politikat tona ekonomike si aktorë kryesorë publikë, në mënyrë që kjo krizë të kalojë sa më shpejt dhe fatura e saj të kompensohet sa më shpejt.

Pyetje: Guvernator, në takimin me biznesin, ju keni thënë se Banka e Shqipërisë injekton para çdo javë në sistemin financiar rreth 2% të PBB-së, pra injekton likuiditet. Paralelisht me to keni marrë masa operacionale për garantimin dhe furnizimin e ekonomisë me para fizike, në përgjigje të kërkesës së shtuar të saj. Si e bën Banka e Shqipërisë injektimin me likuiditet, sepse po flitet shumë këto kohë dhe në rrjete sociale për printim parash dhe hedhje të tyre në treg, frymëzuar dhe nga filmi “Casa de papel”.

“Për hir të së vërtetës, këtë periudhë ka pasur një nevojë në rritje nga sistemi bankar dhe nga ekonomia për likuiditet, të shkaktuar nga situata e pandemisë.”

“Paraja është hedhur në treg sipas nevojave të ekonomisë; ne as nuk kemi printuar as nuk kemi hedhur një prerje të re të imponuar nga kriza.”

Guvernatori: Jo, ne kemi bërë furnizimin e tregut me likuiditet, në mënyrë të vazhdueshme. Kemi plotësuar kërkesat dhe nevojat e ekonomisë për likuiditet nëpërmjet sistemit bankar. Për hir të së vërtetës, këtë periudhë ka pasur një nevojë në rritje nga sistemi bankar dhe nga ekonomia për likuiditet, të shkaktuar nga situata e pandemisë. Normalisht për printimin e parasë ekzistojnë parametra të caktuar. Perceptimi se mund të printohet sipas dëshirës është i gabuar. Banka qendrore ka formulat e saj, bën llogaritjen e qarkullimit monetar, dhe natyrisht që paratë hidhen në treg sipas nevojave të tij, por gjithmonë pa kapërcyer disa kufij, të cilët do të shkaktonte inflacion. Pra, paraja është hedhur në treg sipas nevojave të ekonomisë; ne as nuk kemi printuar as nuk kemi hedhur një prerje të

re të imponuar nga kriza. Porositë për prerjet e kartëmonedhave të reja janë bërë që vitin e kaluar. Lidhur me këtë nuk duhet të ketë keqkuptime. Prerjet e reja të kartëmonedhës që ne presim këtë vit janë porositur që vitin e kaluar, si pjesë e procesit të ndryshimit të emisionit të qarkullimit monetar të kartëmonedhës shqiptare, prezantuar vjet. Këtë vit, ne presim dy prerje të reja, dorëzimi i të cilave është shtyrë me një tremujor, pasi edhe kompanitë e printimit, që i prodhojnë ato, janë prekur nga pandemia. Këto kartëmonedha që priteshin në muajin qershor, ndoshta do të mbërrijnë në shtator ose tetor. Gjithsesi, kjo vonesë nuk na krijon asnjë problem, pasi dhe sasia që kemi në arkën stok të bankës qendrore, i plotëson më së miri nevojat për likuiditet të ekonomisë. Ne nuk kemi printuar dhe nuk do të printojmë para të reja, jashtë parametrave të qarkullimit monetar. Kjo është e panevojshme, jo vetëm se ne e kemi likuiditetin e nevojshëm për t'iu përgjigjur ekonomisë, por edhe sepse nëse ne do ta bënim këtë do të kishim një inflacion në rritje; do të shkaktohej një rritje çmimesh, nga e cila nuk do të kishte asnjë përfitim as biznesi dhe as qytetarët shqiptarë. Meqë ju përmendët intervistën time dhënë revistës "Monitor", doja të sqaroja më në detaj teorinë e "Helicopter Money", thënë shqip, teorinë e "hedhjes së parasë me helikopter". Me të kuptojmë injektimin direkt ose shpërndarjen e parasë direkt nga banka qendrore tek qytetarët, e cila nuk ndodh në praktikë. Banka qendrore, brenda detyrimeve dhe përcaktimeve të saj ligjore, funksionon duke mbështetur qeverinë. Në rast se deficiti buxhetor i përcaktuar me ligj zgjerohet, pra qeveria ka nevojë për likuiditet, banka qendrore është siguruksi i fundit në radhë i likuiditetit, pas konsumimit të të gjitha rrugëve të tjera. Pra, gjithmonë është qeveria që shikon nevojat e ekonomisë dhe të qytetarëve për të kaluar një situatë krize dhe banka qendrore luan rol mbështetës. Ajo nuk shkon direkt tek qytetari apo tek biznesi.

Pyetje: Atëherë nuk shkon banka qendrore tek qytetarët dhe tek biznesi, por ju thotë: "Banka qendrore mbështet qeverinë me likuiditet", a mundet t'ju ndërpres një sekondë këtu, për të sqaruar teleshikuesit. Inflacion është kur monedha zhvlerësohet. Për analogji, kur u ndërruan sistemet në fillimvitet '90, papritur Leku u zhvlerësua dhe kursimet e shumëkujt e humbën vlerën që kishin pasur në regjimin diktatorial. Kjo jep pak a shumë idenë e zhvlerësimit të Lekut. Në rast se qeveria, nëpërmjet stimulit të saj financiar, u jep para bizneseve apo qytetarëve, siç po bën sot, por për të financuar këtë emeton borxh, dhe ky borxh blihet më pas nga banka, a nuk kemi efektin e printimit të parave, në mënyrë të tërthortë? Sepse në teori borxhet e qeverive, ashtu sikurse borxhet e kolektiveve lokale, të ndërmarrjeve,

mund të blihen nga banka qendrore dhe kjo po ndodh sot që flasim Guvernator. P.sh. shifrat që kam këtu tregojnë që 3 banka qendrore në botë: Banka e Japonisë, Fed-i amerikan dhe Banka Qendrore Evropiane (BQE) kanë filluar të blejnë borxhe të sektorit privat. BQE-ja ka sot 20% të borxhit publik të Eurozonës dhe së shpejti do të shkojë në 25%, ndërkohë që ka 30% të borxhit publik gjerman. A mundet Banka e Shqipërisë të bëjë një gjë të kësaj natyre dhe a nuk do të ishte ky një lloj printimi apo hedhje paraje tej limiteve?

Guvernatori: Kjo që ju po parashtroni është vazhdimi i politikës monetare lehtësuese të një banke qendrore, të cilën ne e kemi parashikuar dhe e kemi komunikuar dhe në deklaratën e mbledhjes së fundit të Këshillit Mbikëqyrës, ku kemi thënë që BSH-ja do të vazhdojë me politikën e saj lehtësuese monetare dhe, në rast se do të jetë nevoja, do të fillojmë lehtësimin sasior. Pra, duke qenë se ne e kemi ulur normën e interesit në nivelet minimale historike prej 0.5% dhe nuk kemi shumë hapësirë për të bërë ulje të mëtejshme me efekt në ekonomi, për të transmetuar politikën monetare në tregjet financiare, banka qendrore do të vazhdojë me një lehtësim sasior. Ajo që ju përmendet ka të bëjë me lehtësimin sasior, kur banka qendrore do të blinte letrat me vlerë të qeverisë nëpërmjet sistemit bankar ose direkt. Në një farë mënyre, kjo është dhe ajo që unë thashë, pra që banka qendrore do të financonte deficitin buxhetor, jo në mënyrë direkte, por duke blerë letrat me vlerë të qeverisë. Në rastin tonë, lehtësimi sasior do të bëhej vetëm në këtë mënyrë, pra duke blerë letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare dhe jo letra me vlerë të tregut privat ose të korporatave. Në vendet e zhvilluara me

“Në rastin tonë, lehtësimi sasior do të bëhej vetëm në këtë mënyrë, pra duke blerë letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare dhe jo letra me vlerë të tregut privat ose të korporatave.”

tregje të zhvilluara kapitali, ku ka bursa dhe indekse të përcaktuara, tregje të formalizuara dhe rregulla loje të mirëpërcaktuara, bankat qendrore natyrisht që preferojnë të ndërhyjnë duke blerë edhe pjesë të borxhit të sektorit privat. Kjo ndodh në vende si Japonia, Anglia, SHBA-ja apo Eurozona. Niveli i riskut i këtyre tregjeve mund të jetë më i ulët sesa niveli i riskut të qeverive. Te ne kjo është e pamundur, pasi kemi një nivel të lartë informaliteti, i cili nuk i ka lejuar tregjet e kapitalit të zhvillohen

mjaftueshëm. Kështu, në rrethanat ku gjendemi, kjo mund të bëhej vetëm duke blerë letrat me vlerë të qeverisë, pra duke financuar qeverinë, gjithmonë në rast se janë konsumuar...


Pyetje: A ekziston ky skenar?

Guvernatori: Po, ekziston dhe ne e kemi komunikuar këtë për publikun. Pra, është një nga skenarët tanë - mund të themi se është skenari i fundit - në rast se qeveria do t'i ketë konsumuar të gjitha burimet e financimit. Kësaj i referohemi kur themi se banka qendrore është financuesja e fundit në radhë. Sipas standardeve teorike dhe praktike, në të gjithë botën, ky skenar do të ishte i fundit. Megjithatë, në rastin konkret, ne e dimë që qeveria jonë po shkon drejt Eurobondit.

Pyetje: Doja komentin tuaj për Eurobondin dhe a mendoni se do të ketë sukses?

Guvernatori: Qeveria po shkon drejt një Eurobondi të ri, prej 650 milionë eurosh, dhe është e pamundur të parashikohet nëse do të ketë sukses të plotë, pasi kjo situatë krize ka ndikuar në tronditjen e tregjeve financiare në të gjithë botën. Megjithatë, po shohim shenjat e para të rihapjes dhe rikthimit gradual në normalitet dhe besoj që tregjet financiare do të jenë më të gjallëruara gjatë qershorit, kur Ministria e Financave dhe Qeveria Shqiptare kanë parashikuar të dalin në treg për këtë Eurobond. Unë jam optimist, por edhe në rast se nuk do të ketë sukses, nga ana e qeverisë janë marrë masat për një dalje të dytë në muajt shtator-tetor. Sidoqoftë, në rast se Eurobondi do të ishte i suksesshëm, qeveria do të plotësonte nevojat e saj me një sasi të konsiderueshme likuiditeti. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe, qeveria ka siguruar edhe një kredi të menjëhershme prej 175 milionë eurosh nga FMN-ja. Ajo ka tërhequr dhe një sasi likuiditeti nga sistemi bankar shqiptar në një vlerë prej 120 milionë eurosh. Pra, për nevojat akute imediate, qeveria e ka siguruar likuiditetin e nevojshëm në valutë, ndërkohë që kanë vazhduar dhe ankandet e letrave me vlerë, të cilat organizohen nga Banka e Shqipërisë, për pjesën e nevojave në Lek. Në rast se Eurobondi do të kishte sukses, qeveria do t'i kishte siguruar nevojat e saj për likuiditet dhe skenari ynë i lehtësimit sasior nuk do të ishte i nevojshëm. Nga ana tjetër, sa më shpejt të vijë rimëkëmbja, aq më shpejt do të ketë një përmirësim në mbledhjen e të ardhurave, në drejtim të menaxhimit të të ardhurave në buxhetin e shtetit, pra fisku do të përmirësohej. Ne po marrim parasysh vetëm burimet e huadhënies, por në rast se do të kemi një sezon të mirë turistik dhe një ringritje të shpejtë ekonomike, natyrisht do të përmirësoheshin dhe bilancet e qeverisë, pra do të përmirësohej dhe do të shkonte drejt normalizimit situata me të ardhurat në buxhetin e shtetit. Ndërkohë që situata ku ne ndodhemi, për të gjitha këto elemente që unë listova, natyrshëm do të sillte një rritje të nivelit të borxhit publik.

Grafik 43. Borxhi i jashtëm bruto sipas instrumenteve (në raport ndaj PBB-së, në %)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pyetje: Dua t’ju pyes në këtë pikë, për teleshikuesit: nëse dy qytetarë do të hynin në një marrëdhënia private borxhi, mund të shkonin tek noteri dhe të bënin një deklaratë noteriale që borxhi të njihet. Kurse qeveria, në rastin konkret, kërkon borxh nëpërmjet një letre me vlerë, obligacione ose bono thesari, për tregun e brendshëm ose Eurobondin për tregun e jashtëm. Siç e thatë, kjo rrit borxhin. Ju keni thënë: “Stabiliteti monetar dhe financiar është i panegociueshëm për Bankën e Shqipërisë”, pra ideja është ekuilibri mes stimulit fiskal të qeverisë dhe stabilitetit monetar financiar. Deri në cilin nivel do të ishte i tolerueshëm borxhi i Shqipërisë dhe deri në cilin nivel do të ishte i rrezikshëm? Borxhi matet me PBB-në, që është e mira e përgjithshme që prodhon një vend. Kur borxhi ynë shkon në nivelin 70% të PBB-së, ne shqetësohemi, ndërkohë që ka vende p.sh. si SHBA-ja borxhi i së cilës në 2023 mund të kalojë 106% të PBB-së; Japonia e ka 200% të PBB-së; Italia 135% dhe pritet të shkojë 150% etj. Cili do të ishte një nivel i rrezikshëm për ne? Pasi kur fillon të funksionojë ekonomia dhe qeveria fillon të mbledhë të ardhura, ato shkojnë pastaj për të larë borxhin dhe jo për investime. Pra, në vlerësimin tuaj si Banka e Shqipërisë, cili është niveli ku borxhi bëhet i rrezikshëm?

Guvernatori: Para se t’ju kthej përgjigje lidhur me nivelin e borxhit, do të doja edhe njëherë të ndalesha te stabiliteti monetar dhe financiar - për ta thjeshtëzuar për interes të publikut - kur ne si bankë qendrore themi

se stabiliteti financiar është i pacenueshëm, do të thotë që ne tregojmë kujdesin maksimal për shëndetin e bankave të nivelit të dytë, në funksion të ruajtjes së depozitave të qytetarëve shqiptarë. Ne duam t'i mbajmë bankat të shëndetshme që të mos cenohen kursimet dhe depozitat e qytetarëve shqiptarë, dhe kjo është parësore për nga rëndësia dhe është e panegociueshme. Ne duam ta kalojmë krizën duke mbajtur një faturë të shpërndarë, pa mbingarkuar sistemin bankar.

Pyetje: Që të mos përsëriten ngjarjet e vitit 2001, kur pati panik bankar dhe njerëzit u dyndën nëpër banka...

Guvernatori: Po, është pikërisht kështu. Paniku lidhur me bankat duhet shmangur me çdo kusht, pasi kjo ka të bëjë me krizën e likuiditetit. Paniku bankar ndikon te likuiditeti, tek tërheqja e depozitave, por dhe te përkeqësimi në themel, në një situatë krize. Në rast se fatura e krizës do t'i vihej më shumë seç duhet sistemit financiar dhe atij bankar, atëherë do të prisheshin treguesit dhe parametrat kryesorë të sistemit bankar në ato përmasa që mund të kërkoheshin shtesa kapitali të papërballeshme nga aksionerët. Në këtë situatë, bankat nuk do të ishin në gjendje të respektonin detyrimet e tyre lidhur me depozitat. Ne duam ta parandalojmë këtë situatë dhe sigurisht do t'ia dalim. Për momentin, bankat janë të shëndetshme – këtë e kemi theksuar shumë herë - por në rast se fatura e krizës do t'i kalonte bankave, atëherë bilancet e tyre do të përkeqësoheshin dhe ne nuk do ta lejojmë që kjo të ndodhë. Pra këtë nënkuptojmë me panegociueshmëri të ruajtjes së sistemit financiar, të stabilitetit financiar. Nëpërmjet ndryshimeve rregullative, masave makroprudenciale, në bashkëpunim me sistemin bankar, ne do të bëjmë maksimumin për të ndihmuar qytetarët dhe bizneset, por gjithmonë pa cenuar shëndetin e sistemit financiar, pasojat e të cilit do të shfaqeshin në një moment të dytë. Pra, mund të kalojë kriza, por mund të shkaktojë një krizë të dytë edhe më të fortë.


Pyetje: Në teori, duke e çuar në 0.5 normën bazë, ju e keni bërë jo interesante për qytetarët që paratë e tyre t'i fusin në bankë. Atëherë ku do të investohen ato? Duke mos pasur fonde investimesh, ne investojmë kryesisht në të mira materiale, në prona të paluajtshme. Pra në teori, duke ulur normën bazë të lekut, nuk duhet të ketë shumë depozita nëpër banka apo jo?

Guvernatori: Po, e thënë në mënyrë të thjeshtuar. Politika monetare lehtësuese, me uljen e normës së interesit, si në drejtim të aseteve, ashtu dhe të detyrimeve, pra si në drejtim të kredisë ashtu dhe të depozitave,

është e pandarë. Në qoftë se ne ulim normën e interesit, transmetimi i politikës monetare shkon jo vetëm te kreditë, por edhe te depozitat; nga njëri kah ulët norma e interesit dhe fitojnë kredimarrësit, por humbasin depozituesit, në drejtim të interesave. Në fakt, politika monetare stimuluese ka pikërisht këtë qëllim, pra nxitjen e kreditimit, konsumit dhe investimeve. Në rastin konkret, ulja e normës do të nxiste investimet. Duke qenë se nuk ka interes që paratë të mbahen në banka, atëherë do të investoheshin në ekonomi, duke blerë pasuri të tjera; paraja do të qarkullonte. Pra falë kësaj politike, jo vetëm që rritet kreditimi me një kosto më të ulët, por edhe depozitat bankare përdoren në ekonomi. Në mënyrë teorike, kjo është ajo çka synon politika monetare lehtësuese.

Në fakt, realiteti është që depozitat e bankave, pavarësisht normave të ulëta të interesit, janë rritur në vazhdimësi. Rezultati i dëshiruar ka qenë rritja e investimeve në ekonomi, por natyrisht që është gjithashtu e rëndësishme që bankat të jenë të shëndetshme dhe të kenë depozita, dhe në rastin konkret kanë depozita të mjaftueshme. Raporti kredi-depozita në Republikën e Shqipërisë është 50% me 50%, pra 50% e totalit të asetëve të bankave janë depozita të lira; nga 9.5 miliardë, më pak se 4.5 miliardë janë kredi, pjesa tjetër janë depozita, të cilat bankat i kanë të vendosura në banka të tjera korrespondente ose i kanë investuar në letra të ndryshme me vlerë, sikurse ishte dhe Eurobondi i qeverisë. Sigurisht që ka disa parametra të tjerë, por unë po përiqem ta shpjegoj sa më thjesht për teleshikuesit.

Grafik 44. Interesi i depozitave të reja në lekë dhe euro



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ndërkohë, kur themi që nuk cenojmë stabilitetin financiar nga një anë, por nuk cenojmë as politikën monetare nga ana tjetër, publiku duhet të kuptojë që ne duam të ruajmë bankat dhe të ruajmë edhe çmimet. Kjo do të thotë që ne përqipemi që, nëpërmjet politikës sonë monetare, të mbajmë një nivel të caktuar inflacioni, i cili aktualisht është 3%.

Faktikisht, duke filluar nga kriza financiare e vitit 2008, Shqipëria dhe një pjesë e mirë e botës ka qenë në një situatë deflacioniste. Bankat qendrore janë detyruar të kenë sjellje të kundërt me atë historike ku përqipeshin ta mbanin nën kontroll inflacionin, ndërkohë që tashmë synohet rritja e moderuar e tij, në nivelin e 3%. Kjo krizë pritet ta deformojë pak situatën, megjithëse kjo do të shihet në të ardhmen. Ne do të donim që nëpërmjet politikës sonë monetare, niveli i çmimeve të mos cenohet. Po le të kthehemi përsëri te borxhi. Nuk kemi një nivel të përcaktuar borxhi që do të quhej nivel i rrezikshëm, pasi sikurse dhe ju e përmendët, disa nga shtetet me ekonomi më të forta, kanë një nivel borxhi që është mbi 100% në raport me PBB-në. Niveli ynë i borxhit ishte 72%; e ulëm deri në nivelin e 65%, pasi miratuam edhe një rregull fiskal, një ligj që na detyronte të ulnim borxhin pasi po shkonim drejt një politike fiskale konsoliduese që synon uljen e nivelit të borxhit publik. Kjo krizë e detyroi Qeverinë Shqiptare ta ndryshojë objektivin e saj e të shkojë drejt një politike fiskale lehtësuese. Masat që vijnë si reagim i domosdoshëm ndaj kësaj krize, bënë që të rritet niveli i borxhit.

“...duke filluar nga kriza financiare e vitit 2008, Shqipëria dhe një pjesë e mirë e botës, ka qenë në një situatë deflacioniste. Bankat qendrore janë detyruar të kenë sjellje të kundërt me atë historike ku përqipeshin ta mbanin nën kontroll inflacionin, ndërkohë që tashmë synohet rritja e moderuar e tij, në nivelin e 3%.”

Në të gjitha shtetet, të zhvilluara dhe të pazhvilluara, pavarësisht nga niveli i tyre i borxhit, po shohim një rritje të nivelit të borxhit midis 20-30%. Po ashtu, është e pamundur të parashikojmë me saktësi se sa do të rritet borxhi në vijim, pasi parametrat ekonomikë dhe makroekonomikë ndryshojnë muaj pas muaji. Unë nuk e di saktësisht sesa do të rritet borxhi pasi ne të kemi shfrytëzuar të gjitha ato burime huash që përmendëm - si do të reagojë ekonomia jonë, sa fleksibël dhe absorbuese do të jetë ajo ndaj goditjeve që vijnë nga pandemia - por natyrisht që dhe ne mund të kemi, në shifra të përafërta, një rritje të nivelit të borxhit, si shtetet e tjera. Sa më i ulët të jetë niveli i borxhit, sa më mirë ta menaxhojmë ne situatën, aq më mirë do të ishte për ekonominë shqiptare. Megjithatë, është fakt i pranuar gjerësisht që niveli i borxhit do të rritet. Edhe në

deklaratën e fundit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë thuhet që një rritje e borxhit publik është e pashmangshme. Në rast se ne do të reagojmë shpejt dhe pandemia do të përfundojë gjatë periudhës së verës, ekonomia do të fillojë ringritjen - pra, gjysma e dytë e vitit 2020 parashikohet me një rënie ekonomike, ndërsa për vitin 2021 parashikohet rikthimi i rritjes ekonomike. Po kështu, dhe niveli i borxhit, në funksion të ringritjes ekonomike, do të vijë duke u ulur. Ne do të pranojmë një rritje të nivelit të borxhit, në një përqindje të ngjashme me shumë shtete të tjera të goditura ekonomikisht nga pandemia, por duke filluar nga viti 2021, me ringritjen ekonomike, do të rikthehet dhe objektivi i uljes së nivelit të borxhit publik, gjë që natyrisht do të kërkojë kohë. Kjo goditje dhe ndikimi negativ i saj në ekonomi mund të kërkojnë më shumë se një vit, por e rëndësishme është që ne të mbajmë parasysh se ajo është kalimtare dhe viti 2021 do të sjellë ringritjen. Po aq e rëndësishme është gjithashtu ruajtja e zinxhirëve të prodhimit.

Pyetje: Si po ecën fondi i parë i garancisë? Siç e përmendët në fillim, qeveria ka miratuar dy garanci. Fondi i parë i garancisë sovraane, ku qeveria del garante për biznesin, ishte për pagat - siç e keni informuar publikun në një konferencë për shtyp, vetëm 10% e këtij fondi është përdorur - ndërkohë që pritet të detajohet fondi i dytë i garancisë, ai për bizneset në nevojë. Pse ka kaq pak interes z. Guvernator?

Guvernatori: Po. Deri tani, nga fondi i parë i garancisë kanë përfituruar 260 biznese, me një vlerë 3.6 miliardë lekë ose 29 milionë euro. Ndërkohë, ka rreth 350 aplikime të tjera, të cilat janë në proces. Kjo do të thotë se është përdorur rreth 30% e fondit të parë të garancisë prej 100 milionësh.

Pyetje: Pra, ka ndryshuar shifra, nga 10% në 30%?

“...sikurse e u shpjegua nga disa drejtues bankash, garancia nuk është një automat që furnizon me cash sipas kërkesës, por është një instrument që i krijon lehtësi biznesit për të mbuluar nevojat e pagesës së pagave.”

Guvernatori: Natyrisht, kjo shifër ndryshon çdo ditë, dhe shifra 30% i referohet të premtes së kaluar, pasi vetë përditësimi i shifrave merr disa ditë. Pra, që të jemi të saktë, deri të premtën e javës të kaluar, kanë qenë 260 raste me 29 milionë euro. Procesi po vijon, por pavarësisht nga garancia, bankat kanë disa kriterë rrisht për t’u marrë parasysh, pasi bizneset, sidomos ato të mëdha, kanë ekspozime të mëdha,

në më shumë se një bankë. Këto kërkojnë një analizë të caktuar risku që merr kohë. Pra sikurse u shpjegua nga disa drejtues bankash, garancia nuk është një automat që furnizon me *cash* sipas kërkesës, por është një instrument që i krijon lehtësi biznesit për të mbuluar nevojat e pagesës së pagave. Në lidhje me garancinë e dytë, ajo sapo është firmosur dhe mënyrën e funksionimit të saj do ta shohim kur ajo të bëhet efektive.

Pyetje: Guvernator, ju keni bërë të ditur një shifër, e cila është dinamike dhe mund të ketë ndryshuar, prej rreth mbi 20 mijë biznesesh me kredi pranë bankave në një shumë prej 2 miliardë eurosh, që kanë përfituar nga shtyrja 3-mujore e kredive. Në origjinë, edhe kjo shtyrje nuk duhet të ishte automatike, por mesa duket, në praktikë, sipas informacioneve që unë kam, ka funksionuar në mënyrë automatike. Bankat i kanë pranuar pa diferencim kërkesat që kanë ardhur për shtyrje kësti kredie. Çfarë do të ndodhë në qershor, kur të mbarojë afati i ristrukturimit të kredive? A do të shtyhet më tej? Do të bëni një vlerësim në atë moment, dhe a pritet të rritet bilanci negativ i bankave?

Guvernatori: Bankat kanë aprovuar 99% të aplikimeve për shtyrje kësti kredie, me një vlerë prej 2.1 miliardë eurosh në total. Pra, ato kanë reaguar në mënyrë proaktive. Me afrimin e përfundimit të afatit 3-mujor, ne si bankë qendrore, në bashkëpunim me sektorin bankar, jemi duke analizuar dhe duke parashikuar disa skenarë të caktuar, për të parë efektin që do të ketë një ndryshim tjetër rregullativ, në këtë drejtim. Natyrisht që bizneset janë në vështirësi, dhe do të duhet të ndërmerret një veprim tjetër, por kushtet konkrete duhen shqyrtuar me thellësi dhe me maturi, në mënyrë që, siç e përmenda më parë, të mos godasim bankat e nivelit të dytë. Deri në fund të muajit maj, ne do të detyrohemi që të marrim një vendim tjetër, pra t’iu krijojmë një lehtësi bankave për të bërë një shtyrje ose ristrukturim tjetër, sidomos për ata individë ose biznese që janë goditur më shumë nga kriza. Kjo nuk është një vendimmarrje e thjeshtë. Ne jemi duke bërë llogaritje për të parë efektet dhe implikimet, pasi nuk duam kurrsesi që ta kalojmë të tërë faturën e krizës nga sektori privat tek ai bankar. Pra, duhet të ketë një ndarje proporcionale të faturës së krizës midis aktorëve në treg. Natyrisht që bankat janë likuide, por ky likuiditet ka një limit; raportet dhe nivelet kanë disa caqe dhe

“Natyrisht që bankat janë likuide, por ky likuiditet ka një limit; raportet dhe nivelet kanë disa caqe dhe pikërisht për të respektuar këto caqe, për të ruajtur shëndetin e stabilitetit financiar, ne jemi duke e parë me shumë kujdes vendimmarrjen për një shtyrje tjetër.”

pikërisht për të respektuar këto caqe, për të ruajtur shëndetin e stabilitetit financiar, ne jemi duke e parë me shumë kujdes vendimmarrjen për një shtyrje tjetër. Nga kahu tjetër, në rast se ne nuk do të reagonim dhe nuk do të pranohej një shtyrje e dytë, bizneset do ta kishin të pamundur t'u përgjigjeshin bankave të nivelit të dytë, dhe kjo do të ishte diçka e keqe jo vetëm për bizneset, por edhe për bankat. Në funksion të kësaj, ne po marrim në analizë situatën dhe vendimi mbi masën e dytë në drejtim të lehtësisë për bizneset nga ana e bankave të nivelit të dytë do të publikohet shumë shpejt, pa mbaruar muaji maj. Pra, mund të ketë një shtyrje 3-mujore apo një ristrukturim në një afat më të gjatë, këtë po e shohim me kujdes. Ky është një vendim që i takon Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, për të cilin departamentet dhe ekspertët e Bankës së Shqipërisë po bëjnë analizat e nevojshme. Ato do t'i prezantohen Këshillit Mbikëqyrës në mbledhjen e radhës dhe vendimin e marrë nga Këshilli, ne do ta publikojmë.

Pyetje: Pyetja e fundit lidhur me krizën ekonomike: siç e preka në fillim të intervistës, kur thashë se Kryeministri mendon që fundi i vitit do të na gjejë me një rritje, juve keni folur për varfëri dhe pak më parë, thotë që kriza është kalimtare; në 2021 presim ringritje ekonomike. Unë kam pasur një komunikim me ish-presidentin dhe themeluesin e BERZH-it, ekonomistin e bankierin Jacques Attali, i cili ishte jashtëzakonisht pesimist. Ai u shpreh se kjo krizë, përmasat e të cilës janë ende të pamatshme, është më e rëndë se kriza e 1929-ës. A keni një koment lidhur me këtë? A jeni ju optimist apo ndani të njëjtin mendim me z. Attali?

Guvernatori: Unë nuk jam pesimist dhe as optimist, por përpiqem të jem realist. Pasojat e realizmit, në fund të fundit, janë pozitive. Bazuar në analiza, tregues dhe statistika që kemi, përgjithësisht ne jemi realistë dhe shpeshherë realizmi shihet si shenjë konservatorizmi nga ana e bankës qendrore. Megjithatë, në lidhje me atë që ju thotë mbi Jacques Attali, unë do të thosha që ende nuk mund ta përcaktojmë nëse kjo krizë do të jetë më e rëndë se kriza e vitit 1929. Një krahasim i plotë me krizën e asaj periudhe është i pamundur, pasi bota ka qenë në një situatë të ndryshme ekonomike dhe sociale, pra në një kontekst krejtësisht të ndryshëm. Bota ka pasur një nivel më të lartë varfërie, një standard shumë më të ulët; në atë kohë kriza barazohej me gavetën e supës, ndërkohë që sot situata është e ndryshme. Sado e fortë të jetë kriza, ne jemi të ndërgjegjshëm që nuk do të shkojmë drejt radhës për bukën e gojës. Njëkohësisht, ne po përpiqemi që të ulim ndikimin e krizës në financat e bizneseve dhe familjeve shqiptare dhe kjo po ndodh në të

gjithë botën. Humbjet e shkaktuara nga kjo krizë ne i shohim të lidhura me nivelin e falimenteve të bizneseve të transmetuar më pas dhe në rritjen e papunësisë. Natyrisht që ne do të kemi një rritje të nivelit të papunësisë dhe një rënie të ekonomisë, pra një situatë recesioni. Lidhur me këtë situatë, nga analizat e institucioneve të ndryshme ndërkombëtare si FMN, BB, BERZH, ashtu si dhe nga banka të ndryshme qendrore, ka parashikime të përafërta, por fakti që do të ketë një recesion është i pranuar nga të gjithë. Ky recesion ekonomik për vitin 2020 është midis niveleve -8 dhe -5%, pra mund të ketë një rënie ekonomike prej -8 dhe -5%. E rëndësishme është që kemi të bëjmë me një goditje kalimtare që vjen nga faktori shëndetësor, nuk është krizë financiare që vjen nga sektori financiar siç ndodhi në vitin 2008. Kjo krizë e gjeti sistemin financiar në një situatë shumë më të mirë se kriza e 2008-ës, por nga ana tjetër pasojat dhe efektet negative të kësaj krize në sistemin financiar do të shihen në vijim, ndoshta në vitin 2021. Duke i ditur të gjitha këto, duhet të përpiqemi të mos biem në fatalitet. Të gjithë aktorët privatë dhe publikë në treg, duhet të kuptojnë që fatura e krizës duhet të ndahet, por natyrisht që, siç e diskutuam, barrën më të madhe e merr fisku. Sa më shpejt të nisë ringritja, sa më të qartë e më pak fatalistë të jemi, aq më shpejt do të rimëkëmbemi dhe e ardhmja do të jetë më e mirë. Në rast se nuk do të kemi mbyllje të tjera të ekonomisë të shkaktuara nga pandemia, viti 2021 do të jetë vit i ringritjes ekonomike. Sezoni turistik që po afron do të na tregojë diçka më shumë për të ardhmen.

Pyetje: Z. Guvernator, ju faleminderit shumë për kohën dhe tonet e thjeshta me të cilat na shpjeguat situatën në të cilën ndodhemi!

Guvernatori: Faleminderit juve!

INTERVISTË E GUVERNATORIT SEJKO PËR TELEVISIONIN NEWS24

- 29 maj 2020 -

Pyetje: Përshëndetje zoti Sejko! Është kënaqësi të jemi sërish së bashku në një komunikim. Dje Kryeministri Rama na njohu me atë që ai vetë e konsideroi si lajm i mirë, me firmosjen e përbashkët për një shtyrje të mëtejshme tremujore të kësteve të kredive deri më 31.8.2020. A mund të na jepni detaje në lidhje me këtë vendim?

Guvernatori: Gjatë kësaj periudhe, ne kemi bërë analiza të vazhdueshme të situatës makroekonomike, si dhe të situatës financiare në raport me bankat e nivelit të dytë. Si rezultat i masave shtrënguese të marra për kufizimin e pandemisë, klientët e bankave kanë qenë në vështirësi financiare dhe një tremujor nuk do ta zgjidhte problemin për shlyerjen e kredive në vazhdimësi, sipas rregullave dhe kësteve të parashikuara nga kontratat e kredisë. Në këto kushte, pasi bëmë një analizë të sistemit financiar dhe bazuar në kërkesën e Shoqatës së Bankave dhe të shoqatave të biznesit, vendosëm që të bëjmë edhe një shtyrje tjetër tremujore të kësteve të kredive. Pas marrjes së vendimit nga Këshilli Mbikëqyrës, ne firmosëm bashkërisht me Kryeministrin e Republikës së Shqipërisë, - pasi përveç efekteve që ka në raport me bilancet e bankave të nivelit të dytë, ky vendim ka efekt dhe implikime edhe mbi fiskun dhe tatimet, si për bankat ashtu dhe për klientët që do të përfitojnë nga shtyrja tremujore. Pra, në rastin konkret, përmes këtij vendimi, ne kemi lehtësuar bankat për të shtyrë këstet e kredive me tre muaj, për ata klientë të cilët do vazhdojnë të kenë vështirësi financiare si rezultat i pandemisë dhe kjo shtyrje është e vlefshme deri më datë 31 gusht. Pra, për ata klientë të cilët do të aplikojnë dhe njëherë tek bankat dhe në varësi të analizës që do të bëjnë bankat e nivelit të dytë, do të kemi një shtyrje të kësteve të kredive edhe për një tremujor.

“... kemi lehtësuar bankat për të shtyrë këstet e kredive me tre muaj, për ata klientë të cilët do vazhdojnë të kenë vështirësi financiare si rezultat i pandemisë dhe kjo shtyrje është e vlefshme deri më datë 31 gusht 2020.”

Pyetje: Për shkak të situatës së krijuar në vend si pasojë e COVID-19 edhe më herët, pra në periudhën mars-prill-maj, ju së bashku me Kryeministrin e vendit nënshkruat një urdhër për shtyrjen e kësteve

të kredive, për çdo individ dhe biznes. A do të aplikohet përsëri e njëjta metodë?

Guvernatori: Po, ne kemi nënshkruar dje të njëjtin urdhër me Kryeministrin. Pra do të veprohet në të njëjtën formë si është vepruar edhe herën e parë. Ky vendim është në kuadrin e koordinimit ndërinstitucional dhe të gjitha masave të marra në funksion të krijimit të lehtësirave fiskale dhe monetare për sistemin bankar dhe ekonominë e vendit, për të tejkaluar situatën e krizës të krijuar nga pandemia.

Pyetje: Kjo është shtyrja e fundit që ju bëni z. Guvernator?

Guvernatori: Po, kjo duhet të jetë shtyrja e fundit. Dje në Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, paralelisht me vendimin për shtyrjen e kësteve, janë bërë edhe ndryshime rregullative për t'u mundësuar bankave një ristrukturim më të thellë se një shtyrje tremujore, për ata klientë të cilët do të hasin vështirësi më të mëdha nga kriza. Këtu mund të futen klientë dhe industri të ndryshme. Kjo është lënë në gjykimin e bankave, pasi ato e kanë informacionin e plotë dhe gjykojnë më saktë lidhur me vështirësitë dhe nevojën për ristrukturim të industrive të ndryshme si turizmi, fasonet, transporti etj. Ristrukturimi mund të zgjasë 6 muaj, 9 muaj, 1 vit ose më gjatë, dhe do të jetë specifik, rast pas rasti, në varësi të ciklit të biznesit të klientit dhe industrisë së caktuar. Kështu, vendimi i djeshëm u ka krijuar mundësi rregullative bankave për të qenë më proaktive në raport me këto ristrukturime për klientë dhe për industri të caktuara. Shtyrja tremujore do të jetë e fundit, pasi me ndryshimet rregullative që kemi bërë, bankat kanë mundësi që, në bashkëpunim me klientët e tyre, të bëjnë marrëveshje të reja dhe ristrukturim kredish me afate më të gjata. Këto janë masa që lehtësojnë klientët, por edhe bankat, në raport me menaxhimin e pasqyrave të të ardhurave dhe shpenzimeve të tyre.

Pyetje: Nga informacioni që ju keni, me vendimin e mëparshëm, sa është niveli i kredive të shtyra nga bankat si pasojë e vështirësive financiare të krijuara COVID-19 në vend?

“... kemi 23 mijë klientë, me një portofol total prej 2 miliardë eurosh që kanë përfituar nga vendimi i Bankës së Shqipërisë për shtyrjen e pagesave të kësteve të kredisë.”

Guvernatori: Në tremujorin e parë të shtyrjes së kësteve, ne kemi 23 mijë klientë, me një portofol në total prej 2 miliardë eurosh që kanë përfituar nga vendimi i Bankës së Shqipërisë për shtyrjen e pagesave të

kësteve të kredisë; këstet e kredive janë në një nivel më të ulët, prej rreth 75-80 milionë euro. Ne do të shohim sesi do të evoluojë situata në këtë tremujor, pasi aktiviteti ekonomik po rifillon dhe disa nga bizneset mund të kenë mundësi pune. Kjo do të shihet në vijim. Ne mund të konfirmojmë vetëm shifrën e tremujorit të parë, por besoj se gjatë tremujorit të dytë do të jetë një shifër më e ulët.

Pyetje: Z. Guvernator, besoj se jeni në dijeni që ka pasur problematika sa i përket aplikimit për kredi me garanci sovrane. A janë zgjidhur ato?

Guvernatori: Në përgjithësi, bankat kanë procedurat e tyre. Ne duhet të jemi të ndërgjegjshëm që kjo ka qenë një periudhë e stresuar për klientët, për bankat, por edhe për autoritetet publike. Në një situatë të tillë, klientët, me të drejtë, kanë pasur kërkesa për një shqyrtim sa më të shpejtë dhe bankat kanë reaguar në mënyrë tepër proaktive. Shifrat që unë përmenda lidhur me shtyrjen e kësteve janë bërë në një kohë rekord; duhet kuptuar që kjo është një punë kolosale e kryer në mënyrë të lavdërueshme dhe tepër profesionale nga ana e bankave. Po kështu, edhe garancia e parë sovrane që ka si qëllim pagesat e pagave, është akoma në proces. Me shifrat e javës së fundit, janë 35 milionë euro kredi të lëvruara për këtë qëllim, në 350 raste, si dhe 350 raste të tjera në proces shqyrtimi. Natyrisht që procesi merr kohë, pasi bankat kanë kriteret e tyre të riskut. Vetë Shoqata e Bankave ka theksuar se këto garanci nuk janë një automat që prodhon *cash* sipas kërkesës, por gjithçka do të bëhet sipas procedurave dhe duke respektuar kriteret e caktuara.

Pyetje: A ndërhytë ju si institucion që ta rregullonit këtë marrëdhënie që komplikohet për shkak të pandemisë?

Guvernatori: Sigurisht që ne jemi në kontakt të vazhdueshëm me bankat e nivelit të dytë për të marrë informacionin dhe për të parë problemet. Njëkohësisht, ne si institucion mbikëqyrës dhe rregullator për bankat, në bazë të ligjit, presim dhe ankesat e klientëve lidhur me probleme të ndryshme që ata kanë me bankat e nivelit të dytë. Pra, bazuar në ankesat e klientëve, por edhe në një monitorim dhe bashkëpunim të ngushtë me sistemin bankar, ndërhyrjet janë të vazhdueshme; puna është e vazhdueshme për të koordinuar të gjitha veprimet, në mënyrë që bankat të jenë sa më eficiente në ndihmën për klientët dhe bizneset, por ndërkohë të respektohen procedurat, si dhe të ruhet gjendja e stabilitetit financiar të vendit. Ne jemi të angazhuar në koordinimin e procesit. Në

rastin konkret, natyrisht që ne kemi ndërhyrë për të ndihmuar procesin sa i përket bankave, por roli ynë është më i gjerë, pasi po shërbejmë edhe si koordinatorë me të gjitha institucionet e tjera publike, veçanërisht me Ministrinë e Financave, si dhe me ministrin koordinues për këtë çështje.

Pyetje: Zoti Sejko, më lejoni t'ju pyes pak edhe për ecurinë e ekonomisë shqiptare. Në momentet e para të pandemisë, kur biseduam për herë të parë së bashku, ju kërkoja të bënim një parashikim sesi do të ishte situata ekonomike në vendin tonë. Ju u shprehët se ishte ende herët për të folur për këtë. Ndërkohë, institucione ndërkombëtare financiare si FMN-ja, BB-ja, BERZH-i kanë bërë parashikime jo fort të mira për ekonominë shqiptare; flitet për një rënie ekonomike 9%, më të ultën në Ballkan. Çfarë pritshmëri keni ju zoti Sejko?

Guvernatori: Ne vazhdimisht jemi duke bërë analiza dhe parashikime për ecurinë e ekonomisë shqiptare, pasi kjo është detyra jonë. Tashmë pranohet nga të gjithë se jo vetëm Shqipëria, por dhe rajoni, Eurozona e më gjerë, në vitin 2020, do të kenë një rënie të fortë ekonomike, pasi të gjitha shtetet kanë qenë të detyruara të mbyllen, të marrin masa distancimi dhe izolimi social për t'u mbrojtur nga pandemia. Kjo situatë natyrisht ka pasur një efekt të fortë në ekonomi, i cili do të shkaktojë një rënie të fortë ekonomike për vitin 2020. Shifrat e parashikuara të rënies ekonomike, si për shtetet e zhvilluara edhe për shtetet në zhvillim, janë të thella, jo vetëm nga BERZH-i, por dhe nga vlerësimi që ka bërë FMN-ja dhe BB-ja. Për shtete më të zhvilluara, do të kemi shifra në nivelet -9 apo -10%. Në vlerësimin e deritanishëm - pasi situata evoluon dhe është për t'u parë sesi do të jetë reagimi pas hapjes - ne kemi vlerësuar që viti 2020 do të ketë një rënie ekonomike midis vlerës 5% dhe 8%, pra -5 dhe -8%. Në raportin dhe vlerësimin më të fundit me modelin e politikës monetare, ne kemi parashikuar një rënie prej 6% për këtë vit. Megjithatë, kjo shifër nuk është përfundimtare, pasi ne vazhdojmë dhe përpunojmë shifra, matim ekonominë dhe shikojmë zhvillimin. Ndërkohë, ne po koordinojmë masat, në mënyrë që të kemi një ringritje sa më të shpejtë të ekonomisë dhe të reagojmë në mënyrë sa më të eficiente dhe produktive. Parashikimi është që, në rast se nuk do të kemi rikthim të pandemisë, viti 2021 do të jetë viti i rimëkëmbjes ekonomike. Ringritja do të jetë shumë më e fortë, pra kjo rënie e vitit 2020 do të rikuperohet ndoshta me ritme të shpejta në vitin 2021. E rëndësishme është që ne të reagojmë në mënyrë sa më proaktive, në mënyrë që periodha e verës të jetë një periudhë e shëndetshme ekonomike dhe në vazhdimësi të arrijmë të rikuperojmë humbjet që kemi pasur nga periodha e mëparshme.

Pyetje: Kur e parashikoni ju ringritjen e ekonomisë shqiptare, rimëkëmbjen e saj?

Guvernatori: Në rast se nuk do të kemi një rikthim të pandemisë dhe ekonomia do të rihapet gradualisht, ne parashikojmë që ringritja do të fillojë që në tremujorin e parë të vitit 2021. Sipas parashikimit, goditja më e fortë që ka marrë ekonomia shqiptare ka qenë në tremujorin e dytë të vitit 2020, ndërsa tremujori i tretë dhe ai i katërt

“Parashikimi është që, në rast se nuk do të kemi rikthim të pandemisë, viti 2021 do të jetë viti i rimëkëmbjes ekonomike...”

2020 janë parashikuar me recesion, por jo aq të fortë. Pra, ringritja parashikohet të vijë që në periudhën e verës, por shifrat pozitive dhe largimi nga recesioni do të vijnë në vitin 2021. Këto janë parashikimet tona si bankë qendrore. Paralelisht me këto parashikime, për ne është shumë e rëndësishme që të ruhet gjendja e stabilitetit financiar, stabilitetit monetar dhe makroekonomik të vendit. Deri tani, ne kemi një gjendje të mirë të stabilitetit financiar; bankat kanë likuiditet të mirë; kanë një normë të lartë mjaftueshmërie kapitali; dhe kanë reaguar shumë mirë gjatë kësaj shtatë krize. Periudha më e vështirë është tejkaluar dhe kemi rezerva dhe mundësi financiare që të përballohet me sukses dhe situata në vazhdimësi, por sigurisht që edhe stabiliteti monetar ka qenë i mirë. Ne kemi një normë të inflacionit nën kontroll, pavarësisht se është nën objektivin e Bankës së Shqipërisë - duhet të kemi parasysh që tashmë parametrat dhe objektivat kanë ndryshuar për shkak të goditjes tejtejt të fortë – si dhe stabiliteti në kursin e këmbimit. Pra, parametrat makroekonomikë, financiarë dhe monetarë janë stabël. Ruajtja e këtyre parametrave do të shmangë çdo goditje tjetër dhe do të ndihmojë për një rimëkëmbje më të shpejtë të ekonomisë. Për momentin tregjet financiare janë të qeta, por natyrisht që ka nevojë për lehtësira fiskale dhe financiare, për të ndihmuar bankat dhe klientët në këtë situatë të vështirë. Deri tani, fati e krizës është transferuar nga sektori privat në sektorin publik, por sigurisht që duhet të jemi të qartë që kjo krizë do të ketë ndikime negative në të gjithë aktorët e tregut, privatë dhe publikë; është e nevojshme një shpërndarje proporcionale e faturës së krizës midis bizneseve, individëve, buxhetit dhe sistemit bankar.

Pyetje: Le të jemi solidarë dhe ta tregojmë veten të gjithë edhe në këtë fazë. Pyetje nga publiku: a ka mundësi shtyrjeje kësti edhe për ne individët?

“... shtyrja e dytë e pagesave të kësteve për kreditë bankare është e vlefshme si për individët ashtu edhe për bizneset.”

Guvernatori: Po, shtyrja e kësteve është e vlefshme si për individët ashtu edhe për bizneset. Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë i përfshin të gjitha kategoritë e klientëve të bankave të nivelit të dytë. Megjithatë, kjo nuk është një shtyrje automatike. Qytetari i interesuar duhet të kontaktojë me bankën, të aplikojë për shtyrje dhe të tregojë vështirësitë e tij financiare. Bankës i duhet të vlerësojë nëse klienti ka vërtet mungesë aftësie paguese dhe në këto raste kredia do të shtyhet. Pra, kjo shtyrje vlen vetëm për ata që kanë vërtet vështirësi.

Pyetje: Duhet ta vërtetojnë që janë realisht në vështirësi dhe nuk mund të paguajnë? Në ç’mënyrë bëhet kjo?

Guvernatori: Po, sigurisht. Kështu ka ndodhur edhe në shtyrjen e parë, pra klientët kanë vërtetuar para bankës që kanë pasur vështirësi financiare. Totali i portofolit të kredive në bankat e nivelit të dytë është rreth vlerës 4 miliardë euro, ndërkohë portofoli i kredive të shtyra është 2 miliardë euro, pra 50% e të gjithë klientëve janë goditur nga kriza dhe kanë pasur nevojë për shtyrje, ndërkohë që pjesa tjetër kanë vazhduar shlyerjen e kësteve rregullisht. Kështu do të veprohet edhe këtë herë.

Pyetje: Një pyetje tjetër nga publiku: Kam një biznes dhe më është dashur të marr kredi për shkak të dëmeve që pësova nga tërmeti që goditi Shqipërinë. Më pas mu desh të merrja përsëri kredi për shkak të COVID-19. Tani jam në vështirësi financiare. Lehtësia vlen vetëm për kredinë e fundit apo edhe për atë të marrë për shkak të tërmetit?

Guvernatori: Besoj se vlen për të gjitha ekspozimet që ka klientja, pavarësisht arsyes përse është marrë kredia. Ekspozimi që ajo ka ndaj bankës është në total. Ajo do të duhet të komunikojë me bankën dhe në rast se do të vërtetojë që ka vështirësi, sigurisht që do të përfitojë nga lehtësitë rregullative që ne kemi bërë, por kjo do të duhet të sqarohet me bankën.

INTERVISTË E GUVERNATORIT SEJKO PËR EMISIONIN “PËRBALLË” NË TELEVIZIONIN RTSH

- 7 korrik 2020 -

Pyetje: Nëse bëjmë një krahasim me krizën financiare të viteve 2008-2009 apo me Depresionin e Madh të viteve '30, çfarë vendi zë kjo krizë që nuk është thjesht financiare, por dhe shëndetësore e ekonomike?

Guvernatori: Kjo krizë ka një specifikë, ajo po gjenerohet nga faktori shëndetësor. Pra, këtë herë kemi të bëjmë me një krizë që vjen nga pandemia dhe po reflektohet në ekonomi. Krizat e mëparshme kanë qenë kriza të pastra ekonomike që vinin nga sektori financiar. Në vitet '30 ka pasur humbje të mëdha nga kriza, ndërsa kriza e vitit 2008 ka qenë një krizë që ka ardhur nga sektori financiar; efektet u reflektuan në ekonomi, por ajo ka qenë një krizë e pastër e sektorit financiar - fillimisht falimentoi Lehman Brothers dhe më pas u shfaqën implikimet e Goldman Sachs. Problemet e tregut amerikan u reflektuan në tregun evropian dhe kriza u bë mbarëbotërore. Kjo e tanishmja është një krizë që vjen nga sektori shëndetësor dhe natyrisht do të reflektohet dhe në ekonomi. Pra, është e vështirë t'i krahasojmë me njëra-tjetrën. Një shifër e përafërt, e kalkuluar për krizën e viteve '30, flet për një rënie të prodhimit të brendshëm bruto në nivelin 15%. Pra ka qenë një krizë e thellë, por duhet pasur parasysh që bota ka qenë më e varfër dhe ekonomia...

“Krizat e mëparshme kanë qenë kriza të pastra financiare, ndërsa kriza e fundit po vjen si rezultat i një faktori shëndetësor.”

Pyetje: ...dhe më pak e ndërlydhur.

Guvernatori: Po, edhe më pak e ndërlydhur. Sigurisht që bëhej fjalë për një krizë të mirëfilltë urie. Në ditët e sotme, bota ka akumuluar më shumë pasuri dhe reflektimi i krizës nuk është në ato përmasa.

Kriza e vitit 2008 ishte po ashtu një krizë e fortë, por rënia ishte shumë herë më e ulët se sa parashikohet për këtë krizë. Shifrat janë në përpunim, pasi jemi në vitin e parë të krizës dhe efektet maten tremujor pas tremujori. Sigurisht që kjo është kriza më e thellë e shekullit 21, jo vetëm në aspektin

shëndetësor, por dhe në atë ekonomik, dhe kjo vlen për mbarë botën. Duket se të gjitha vendet janë prekur nga COVID-19, megjithëse ka pasiguri në shifra. Po aq pasiguri ka edhe për evoluimin e virusit dhe reflektimet në situatën ekonomike dhe financiare të mbarë globit.

Pyetje: Guvernator, si po punoni këto ditë në Bankën e Shqipërisë? Çfarë masash janë marrë për mbrojtjen e shëndetit? A po punoni nga shtëpia, apo punonjësit e bankës qendrore nuk e kanë luksin të punojnë nga shtëpia?

Guvernatori: Një pjesë e punonjësve po punojnë në distancë, ndërsa disa departamente puna e të cilave nuk mund të kryhet në distancë, shfrytëzojnë ambientet e BSH-së. Ne kemi një plan realisht funksional për ruajtjen e masave të distancimit social. Brenda mundësive tona, po punohet me kapacitetet jo të plotë, por banka po i kryen të gjitha detyrat funksionale.


Pyetje: Nëse flasim për atë që ju e quajtet elementi i pasigurisë, kjo vjen për shkak të frikës nga e panjohura dhe mesazheve kontradiktore që vijnë nga shëndetësia. Ngjan sikur e vetmja recetë është që të rritet borxhi. A ka ndonjë formulë tjetër? Në krizat e mëparshme bota ka nxjerrë disa mësimë të mëdha dhe ka vazhduar ciklin e rritjes së shpejtë të ekonomisë. A është shpejt për të folur për mësimë të mëdha nga kjo krizë?

Guvernatori: Pasiguria, ashtu siç e thatë, vjen në radhë të parë nga evoluimi i sëmundjes. Në fillim u mendua që virusi do të zhdukej në një periudhë tremujore, ashtu si kanë ndodhur me pandemitë e kaluara, si SARS COV 1 dhe H1N1. Pra, përgatitja ishte për një periudhë më të shkurtër, por për sa kohë pandemia dhe masat e distancimit social vijojnë, edhe konsumi natyrisht që do të bjerë; kështu do të ishte edhe pa masat e distancimit social, pasi psikologjia e rënduar e njerëzve në një periudhë pandemie, ndikon tek konsumi. Në rast se bie konsumi, sigurisht që do të ndikohet edhe prodhimi, e kështu me radhë të gjithë faktorët zinxhir. Sa i përket nxjerrjes së mësimëve, sigurisht që është ende herët, pasi ato nxirren në përfundim të krizës, por për të reaguar dhe reflektuar nuk është kurrë herët.

Pyetje: Një nga elementet e frikës apo pasigurisë së konsumatorit është paraja. Pyetja që lind normalisht në këto raste është sa të sigurtat janë paratë? Sa të sigurtat janë depozitat? Si është gjendja e likuiditetit në sistemin financiar bankar? A ka risqe? A ka parashikuar banka skenarin më të keq, në situata të tilla?

Guvernatori: Për të qenë realist, risqe ka gjithmonë, në të gjitha kohërat, madje dhe në ato më të mirat. Në rastin konkret, në shumë komunikime publike, ne kemi theksuar që fati ynë ishte që kjo krizë e gjeti sistemin financiar shumë të shëndetshëm, me një normë të lartë mjaftueshmërie kapitali. Pra reformat e ndërmarra në sektorin financiar dhe atë bankar shqiptar dhanë frytet e tyre gjatë këtyre viteve. Për fat, sektori financiar është në një gjendje shumë të mirë; ka pasur një nivel të lartë kredish me probleme, por përmes një reforme specifike të ndërmarrë nga ne, ia dolëm që ky nivel të ulet ndjeshëm. Bilancet e bankave vazhduan të përmirësohen dhe para krizës ishin të shëndetshme. Po kështu, bankat kanë pasur mjaftueshmëri të lartë kapitali. Pa dashur ta lodh publikun me detaje të tepërta, ne kemi kaluar në një proces konsolidimi të sektorit bankar, i cili ka ndikuar pozitivisht qoftë në kreditimin e ekonomisë, qoftë në vazhdimin e uljes së kredive me probleme. Bankat kanë likuiditet të mjaftueshëm, dhe këtë krizë e kanë përballuar dhe do ta përballojnë me sukses. Ne kemi ngritur skenarët tanë dhe bëjmë stress teste në vijimësi. Ato janë pjesë e procedurës dhe detyrë e jona si bankë qendrore. Këta skenarë janë në përputhje me standardet dhe metodologjinë e BQE-së dhe ABE-së (Autoritetit Bankar Evropian). Testet na vërtetojnë që edhe në skenarin më të keq, sistemi bankar do ta përballonte me sukses krizën. Pra, situata aktuale garanton që sistemi bankar është i shëndetshëm, por duhet të tregohemi të kujdesshëm që këtë mos e keqinterpretojmë si një mundësi që të gjithë faturën e krizës t’ia faturojmë sektorit bankar.

Grafik 45. Ecuria e levës financiare sipas përbërësve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pyetje: Kujt duhet t'ia faturojmë?

Guvernatori: Fatura duhet të shpërndahet proporcionalisht mes sektorit publik, sektorit bankar dhe sektorit privat, pra të gjithë aktorëve në treg.

Pyetje: A nuk është koha që sistemi bankar të jetë pak më zemërgjerë? Pra, të marrë më shumë barrë se të tjerët, për shkak të specifikave, të një lloji komoditeti apo një risku më të ulët se të tjerët?


Guvernatori: Besoj se sistemi bankar ka marrë një risk të mjaftueshëm me masat e marra, pra me shtyrjen për dy tremujorë të kësteve të kredive dhe me bashkërendimin e veprimeve për kreditim, me paketat e qeverisë. Sektori bankar ka ristrukturuar, ka shtyrë, rreth 2 miliardë euro në 25000 raste këstesh kredish; janë ngrirë kreditë për një gjashtëmujor. Ai po punon proaktivisht për ristrukturime të kredive dhe portofoleve të bizneseve, dhe njëkohësisht ka kredituar një numër të konsiderueshëm biznesesh për paketat e qeverisë. Megjithatë, duhet kuptuar që sektori bankar punon me depozitat e qytetarëve. Pra, vetëm 10% e kapitalit të aseteve të sektorit bankar janë kapitale të aksionerëve, ndërsa 90% janë depozita të qytetarëve. Në rast se ne me pritshmëritë tona do ta rëndonim sektorin bankar që të merrte përsipër më shumë risk, do të cenonim direkt stabilitetin financiar të vendit, sigurinë e depozitave. Ne si bankë qendrore nuk do donim ta bënim këtë dhe e kemi theksuar se ky është një parakusht i padiskutueshëm për çdo lloj reforme dhe ndërmarrjeje për kapërcimin e krizës; në asnjë mënyrë nuk duhet të cenohet stabiliteti financiar i vendit. Pra sektori bankar është i shëndetshëm, i kalon stress testet dhe po vazhdon të rezistojë, por nuk duhet të gabohemi dhe të shkaktojmë atë që nuk duhet të ndodhë.

Pyetje: Kur jemi në ditë të keqe i drejtohem i borxhit, dhe ju, para 5 ditësh, keni thënë që rritja e borxhit publik është një e keqe e domosdoshme. Ne e pranojmë rritjen e borxhit, po nuk kemi folur konkretisht deri në çfarë mase mund të marrim borxh? Sa mbajnë eshtrat e sistemit që të mos thyhet?

Guvernatori: Referuar borxhit, nga analizat ose shifrat e fudit, nga të gjitha shtetet, kjo krizë është kaluar me marrje borxhi. Pra, niveli i borxhit është rritur në përgjithësi në të gjitha shtetet, të zhvilluara dhe të pazhvilluara. Deri tani, borxhi është rritur në një mesatare 20-30% në vende të ndryshme. Them deri tani, pasi kjo krizë mund të zgjasë dhe rrjedhimisht kjo mesatare mund të rritet në të ardhmen. Unë jam shprehur se borxhi është një e keqe e domosdoshme duke iu referuar situatës

aktuale. Në bashkëpunim me institucionet financiare ndërkombëtare si FMN-ja dhe BB-ja, është rakorduar për masat e marra për tejkalimin e krizës, pra rritja e nivelit të borxhit është rakorduar dhe dakorduar me ta. FMN-ja ishte institucioni i parë që i ofroi Shqipërisë menjëherë një kredi prej 180 milionë eurosh. Në raport me borxhin, strategjia para krize ka qenë konsolidimi fiskal; Shteti Shqiptar kishte dhe një target për ulje të borxhit. Në këtë kuadër, parlamenti miratoi dhe një ligj, por natyrisht që kjo krizë e prishi këtë rregull, dhe siç e thashë, me FMN-në u ra dakord që borxhi të rritej pikërisht për t'i bërë ballë krizës. Pa këtë shmangia e falimentimit të bizneseve do të ishte e pamundur, dhe po aq i pamundur do të ishte edhe funksionimi normal i administratës shtetërore dhe i ekonomisë në përgjithësi.

Grafik 46. Përbërja e borxhit të brendshëm në lekë të emetuar gjatë 2016-6MI 2020



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Rritja e borxhit është një e keqe në princip, megjithatë në një situatë kaq të veçantë ishte krejtësisht e pashmangshme. Kjo është e qartë jo vetëm për ne, por edhe për të gjitha shtetet e botës. E rëndësishme është që borxhi të menaxhohet sa më mirë - dhe ky është një postulat që vlen për të gjitha kohërat - dhe më pas, duke filluar nga viti 2021 dhe më tutje, me kapërcimin e krizës, të kemi një orientim sa më të mirë, përsëri drejt konsolidimit fiskal, drejt uljes së borxhit. Ne do të na duhet të punojmë shumë shpejt për të ulur nivelin e borxhit dhe kjo sigurisht që kërkon reforma serioze ekonomike.

Pyetje: Domethënë vjet në nëntor kishim tërmetin, në pranverë COVID-19, në vjeshtë përsëri COVID-19, ndërsa pranverën tjetër kemi zgjedhjet parlamentare. A ka pasur kohë më të keqe në kuptimin e asaj që ju e quani disiplinë fiskale?

Guvernatori: Kjo është e vërtetë. Fatkeqësisht, për shkaqe natyrore, ekonomia ka pësuar disa goditje me radhë në një periudhë shumë të shkurtër. Nuk mund të them që ka pasur kohë më të keqe. Mund të përmendim vitin '97, kur ekonomia e vendit dhe jeta jonë në përgjithësi pësoi një goditje të rëndë. Ishte një goditje që, në një farë mënyre, erdhi nga sektori financiar, nga skemat piramidale, të cilat prekën kursimet e popullatës, dhe stabiliteti financiar i vendit u cenua. Ajo që ndodhi e çoi ekonominë në recesion, rriti nivelin e borxhit dhe deformoi disa parametra makroekonomikë. Ndërkohë që kriza që po jetojmë, pavarësisht disa ngjashmërive sa i përket parametrave makroekonomikë, nuk ngjason shumë me të. Efektet e kësaj krize të ardhura nga pandemia janë ende në proces matjeje tremujor pas tremujori, dhe thellësia e goditjes, rënia e rritjes ekonomike dhe ndikimi në rënieën e PBB-së do të qartësohen në vijim.

Pyetje: Pra, do të marrim borxhe, por presim dhe që ekonomia të vazhdojë recesionin. Lidhur me parashikimet për rënieën ekonomike, BB-ja, BERZH-i dhe FMN-ja japin nivele të ndryshme nga 4.5% në 9%. Vetë banka qendrore a ka ndonjë parashikim të përditësuar për nivelin e rënieës ekonomike për 2020?

Guvernatori: Patjetër, parashikimi i Bankës së Shqipërisë për rënieën ekonomike për 2020-n, është në nivelin 6%. Këto shifra rishikohen, por për momentin ne jemi në nivelin e 6% rënie ekonomike për vitin 2020 dhe një ringritje të shpejtë ekonomike në vitin 2021. Pra, parashikimi ynë si bankë qendrore është për një ecuri në formë V-je. Natyrisht që institucione të ndryshme kanë parashikime të ndryshme, por ato nuk variojnë shumë nga njëra-tjetra. Në momente si këto, parashikimet ndryshojnë shpesh dhe shifrat rishikohen vazhdimisht. Jo vetëm Shqipëria po dhe të gjitha vendet rreth nesh, kanë parashikim negativ për rritjen, madje shumë herë më të thellë, në nivele mbi 10%. Parashikimi ka ardhur duke u përkeqësuar, pasi p.sh. Greqia ka një ndikim të fortë nga turizmi, në rritjen ekonomike. Megjithatë, pavarësisht rënieës së këtij viti, parashikohet një ringritje e shpejtë në vitin 2021.

Pyetje: Para se të shkojmë te ringritja e shpejtë, e cila meriton një diskutim, në raportin vjetor ju keni thënë që ekonomia shqiptare

parashikohet të ketë rënie gjatë 2020, e cila do të shoqërohet me: rritje të papunësisë (17 000 vende pune të humbura); rënie të të ardhurave familjare; përkeqësim të situatës financiare të bizneseve; dhe shtim të kredive me probleme në sektorin bankar. Nëse është kështu edhe për 5 muajt në vijim, qëndron optimizmi për një ngritje në formë V-je? Ne nuk jemi ndonjë ekonomi prodhuese...

Guvernatori: Ne jemi një ekonomi e vogël fleksibël, pavarësisht se nuk jemi ekonomi prodhuese.

Pyetje: Nga çfarë vjen ky elasticitet?

Guvernatori: Ne kemi industri shërbimesh; jemi një shtet i vogël, me një ekonomi e cila, në raste krizash, mund të reagojë në mënyrë fleksibël dhe shumë më shpejt se ekonomi më të mëdha. Problemi më i madh është vijimësia e pandemisë. Parashikimet tona të hershme ishin që me fillimin e sezonit veror do të kishim një shpërthim të turizmit...

Pyetje: A mos u vlerësua më pozitivisht se sa duhet?

Guvernatori: Këto ishin parashikimet tona ekonomike, të bazuara në parashikimet e mjekësisë për kohëzgjatjen e pandemisë. Mesa duket, situata do të vazhdojë të mbetet e vështirë dhe me kufizime në lëvizjen e lirë. Kjo është e kuptueshme, pasi shifrat e të prekurve janë në rritje. Parashikimi ynë i bërë publik në deklaratën e politikës monetare dhe reflektuar më pas në raportet e publikuara, është që tremujori i dytë do të ketë goditje më të fortë nga kriza, por rënia ekonomike do të vazhdojë dhe në tremujorin e tretë dhe të katërt të vitin 2020; ringritja ekonomike do të vijë në vitin 2021.

Pyetje: Parashikim optimist?

Guvernatori: Ky është një parashikim realist, gjithmonë duke pasur parasysh skenarin që nuk do të kemi një valë të dytë mbylljeje. Kemi theksuar që nëse do të ketë një valë të dytë, do të duhet të rishikojmë skenarin.

Pyetje: A po mbaron vala e parë?

Guvernatori: Ne i referohemi deklaratave të ekspertëve të shëndetësisë. Sipas një deklaratë të fundit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, e keqja nuk ka kaluar ende. Ka një mori deklaratash dhe informacionesh, si pozitive ashtu dhe negative, pra pasiguria është e madhe.

Pyetje: Mund të deshifrojmë një gjuhë diplomatike nga ana juaj kur shpreheni se ekonomia shqiptare i ka premiset ta përballojë me sukses këtë goditje. Megjithatë, ju thoni që aktorët publikë dhe operatorët privatë duhet të marrin vendimet e duhura, në kohën e duhur dhe në mënyrë të koordinuar.

Guvernatori: Kjo nuk është gjuhë diplomatike; është e drejtpërdrejtë dhe realiste.

Pyetje: Cilat janë vendimet e duhura?

Guvernatori: E rritheksoj që ne duhet të jemi të qartë që fatura e krizës duhet të ndahet proporcionalisht midis gjithë aktorëve.

Pyetje: Deri në momentin që flasim kush po e paguan këtë faturë?

Guvernatori: Deri tani, faktikisht faturën po e paguajmë të gjithë.

Pyetje: Në mënyrë të barabartë?

Guvernatori: Po, në mënyrë të barabartë. Secili ka marrë një pjesë nga barra e kësaj krize.

Pyetje: Në fillim pamë përpjekje për t'ia lënë barrën njëri-tjetrit.

Guvernatori: Natyrisht që kjo ndodh. Për hir të së vërtetës, pritshmëritë janë gjithmonë të larta për institucionet publike, pasi atyre u takon të administrojnë krizat. Po sigurisht që në deklaratën tonë, ne kemi bërë thirrje që të gjitha autoritetet publike të bëjnë reforma dhe të koordinohemi me njëra-tjetrën. Natyrisht që edhe bizneset duhet ta kuptojnë sa më drejt këtë situatë krize, pasi shpeshherë ka dhe keqkuptime. Pra, duhet kuptuar që duhet të ketë një riorientim të biznesit, në përputhje me situatën e re. Duhet bërë një optimizim dhe riorientim i shpenzimeve, i kostove, si dhe i strategjive; ndoshta disa investime duhen ndërprerë; bashkëpunimi me bankat duhet të jetë sa më optimal; pritshmëritë duhet të jenë sa më realiste dhe jo optimiste. Nga kontaktet që ne kemi, mendoj se tashmë edhe bizneset janë realiste. Është e vërtetë që si pasojë e "hutimit" të përgjithshëm, në fillim të pandemisë, nga aktorë të ndryshëm kishte një prirje për të shmangur përgjegjësinë, por tashmë situata është më e qartë.

Pyetje: E kuptojnë që jemi të gjithë në një barkë.

Guvernatori: Po, tashmë e kanë të qartë që jemi të gjithë në një barkë. Faktikisht këtë e kemi të qartë të gjithë, por çka nuk është ende e qartë

është kohëzgjatja e kësaj situatë. Jam i mendimit që shumëçka varet nga zhvillimi i vaksinës ose i mjekimit.

Pyetje: Qeveritë, në kohën e COVID-19, janë kthyer në aktorë të dorës së parë, mirëpo për nga natyra ato nuk i dëgjojnë këshillat, megjithëse në kohë krizash ato janë të domosdoshme. Cila është këshilla standarde që ka banka qendrore për qeverinë në këtë kohë të pazakontë?

Guvernatori: Ne si bankë qendrore, kemi dhe rolin e këshilltarit të qeverisë. Në rastin konkret nuk kemi qenë vetëm këshilltarë, por edhe bashkëpunëtorë. Në deklaratat tona kemi bërë thirrje për të pasur një bashkëpunim sa më të afërt midis gjithë aktorëve - qeveri, bankë qendrore, biznes privat - që kanë një rol në tejkalimin e krizës. Natyrisht që situata është tepër komplekse dhe mendoj se deri tani është mirëmenaxhuar. Është kapërcyer një periudhë shumë e vështirë, një situatë paniku, e ndikuar dhe nga zhvillimet që shihnim në shtete të ndryshme të zhvilluara, si Anglia apo Italia, dhe reagimi i qytetarëve të tyre. Për fat si dhe falë një reagimi shumë të mirë qytetar në vendin tonë, periudha tepër e vështirë tremujore e izolimit, u tejkalua me sukses. Po ashtu, ndikim fundamental pati edhe një koordinim shumë i mirë midis institucioneve publike. Ne si bankë qendrore ndërmorëm disa masa si ulja e normës së interesit, furnizimi i pakufizuar i tregut me likuiditet etj.

Tabelë 7. Masat e marra nga autoritetet qeverisëse në vende të zgjedhura

	Fiskale				Monetare dhe makroprudenciale					
	Transferta Cash	Mbështetje punësimi	Garanci për kredi	Shtyrje detyrimesh tatumore	Norma e interesit	Blejje letrash me vlerë të qeverisë	Ofrim likuiditeti	Rezerva e detyruar	Mora- torium këste kreditie	Kapital amorizues
SHBA	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Eurozonë		✓	✓	-		✓	✓		✓	✓
Mbretëri e Bashkuar		✓	✓	✓	✓	✓	✓		✓	✓
Çeki	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓		✓	
Rumani	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓		✓	
Poloni	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	
Hungari	✓	✓	✓	✓			✓		✓	✓
Serbi	✓	✓	✓	✓	✓		✓		✓	
Kroaci	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	
Kosovë	✓			✓				✓	✓	✓
Maqedoni e Veriut	✓	✓	✓	✓	✓			✓	✓	✓
Shqipëri	✓	✓	✓	✓	✓		✓		✓	

Burimi: FMN.

Pyetje: A janë hedhur mjaftueshëm para në sistem?

Guvernatori: Po, referuar nevojave, situatës dhe kapaciteteve që ka Shqipëria, janë hedhur para mjaftueshëm nga banka qendrore, bankat e nivelit të dytë, por dhe nga qeveria nëpërmjet borxhit të marrë. Pra përveç eurobondit më të fundit prej 650 milionë eurosh, janë marrë edhe 120 milionë euro nga bankat lokale, si dhe 180 milionë euro nga FMN-ja. Ndërkohë që paraja kombëtare në qarkullim, ose paraja e hedhur nga banka qendrore nëpërmjet sistemit bankar, ka qenë 35% më e lartë se sa në periudhat e mëparshme. Kjo rritje ka qenë e nevojshme pasi masat izoluese i kanë shtyrë njerëzit të tërheqin *cash* në sasi të mëdha, për çdo eventualitet. Sistemi bankar ka qenë shumë likuid dhe i është përgjigjur tregut me *cash*, rregullisht dhe sipas nevojave. Për fat dhe ne kemi qenë në një situatë shumë të mirë, pra banka qendrore ka pasur rezervat e nevojshme me likuiditet në monedhë vendase, por edhe për likuiditet në monedhë të huaj nuk ka pasur probleme, pasi bankat e nivelit të dytë kanë sasi të konsiderueshme euroje. Megjithatë, çështja nuk është vetëm të paraja e hedhur, por edhe të funksionimi i strukturës ekonomike. Ne kemi një strukturë ekonomike të orientuar drejt konsumit dhe jo drejt prodhimit.


Pyetje: Në qoftë se flasim për para të hedhur, për kredi të dhënë, a kemi guxim të themi sot që japim kredi për prodhim? Apo kjo është thembra e Akilit?

Guvernatori: Do të duhet t'ju përgjigjem në funksion të kreditimit gjatë gjithë kësaj periudhe, para krize dhe gjatë saj. Si pasojë e shumë masave të marra nga ana jonë si institucion mbikëqyrës dhe rregullator, ecuria e kreditimit ka ardhur në rritje gjatë gjithë këtyre viteve. Në një moment të caktuar ka pasur pakënaqësi ndaj sektorit bankar për shkak të një kreditimi të perceptuar si "të vakët" ose negativ. Në fakt, duke hequr kreditë e shlyera dhe efektin e kursit të këmbimit, kreditimi ka qenë në nivel pozitiv, por jo aq sa duhej. Politika jonë monetare lehtësuese, në radhë të parë, synon rritjen e kreditimit për të stimuluar ekonominë, dhe më pas rritjen e konsumit dhe investimeve. Ulja e normës së interesit synon pikërisht këtë, pra të ulët kostoja e kredisë që të nxitet marrja e kredisë për të zhvilluar punë dhe biznese. Kreditimi është rritur si pasojë e politikës monetare stimuluese, por po ashtu edhe e uljes së kredive me probleme. Nga kahu tjetër, bankat janë treguar të shtrënguara në kredidhënie, pasi kredia e keqe u rrit dhe kjo i trembi ato.

Pyetje: Në raport shpreheni se kreditë e këqija nga 25% që ishin në vitin 2014, kanë shkuar në 8.4% në vitin 2019, një shifër përsëri relativisht e lartë. A ka ende biznese në Shqipëri që kredinë e konsiderojnë si një lloj granti?

Guvernatori: Ky perceptim ka ndryshuar shumë, veçanërisht në vitet e fundit. Bizneset në Shqipëri janë qartësuar që kredia duhet paguar, pra marrëveshja me bankën për një detyrim të caktuar duhet shlyer, dhe shlyerja duhet të bëhet brenda afatit. Sigurisht që problemet ekzistojnë ende, por ka ndjeshëm më pak se dikur. Ne arritëm një sukses: kredia me probleme arriti në nivelin e 8.1% dhe para krizës po vazhonte të ulej. Kreditimi në ekonomi u rrit.

Grafik 47. Raporti i kredive me probleme



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pyetje: Po tani a keni parashikuar rritje të kredisë me probleme?

Guvernatori: Po, sigurisht që kjo krizë do të shoqërohet me deformime, megjithëse nivelet janë ende të paparashikueshme. Kriza do të ketë efektet e saj si në nivelin e kredisë së keqe, ashtu dhe në nivelin e rritjes së kreditimit. Të gjitha ato që ju lexuat dhe nga raporti jonë i politikës monetare do të kenë ndikim te bizneset, individët dhe familjet. Bankat do të jenë më të kujdesshme në kredidhënie dhe do të bëjnë analiza me kriteret e rishikuara të riskut. Po ashtu edhe oreksi i bizneseve për kredi do të ndryshojë dhe planet e tyre të zhvillimit dhe të investimit do të jenë më të kujdesshme. Pra, është logjike që nevoja për kredi, si dhe oreksi

për kredi, si nga bizneset ashtu edhe nga bankat, do të vijë në rënie. Disa biznese mund të mos i bëjnë dot ballë situatës dhe mund të jenë të paafta të shlyejnë në afat kreditë dhe detyrimet, pavarësisht nga masat që ne kemi marrë për shtyrjen e kësteve.

Pyetje: Z. Guvernator, një nga sfidat e ekonomisë shqiptare që ju e keni nënvizuar është që rritja ekonomike të mos bazohet te konsumi dhe te ndërtimi, por te prodhimi dhe te eksporti. Kur besoni që Shqipëria do të jetë gati ta bëjë këtë kapërcim pindarik?

Guvernatori: Ne po flasim për masat për tejkalimin e një situatë të vështirë ekonomike që vjen nga kriza e shkaktuar nga pandemia. Kjo që ju po ngrini ka të bëjë me reforma strukturore që duhen ndërmarrë për orientimin dhe zhvillimin e ekonomisë shqiptare. Ajo që ne kemi theksuar vazhdimisht ka të bëjë me kalimin nga një ekonomi e bazuar në remitanca dhe me nivel të lartë informaliteti, në një ekonomi më të formalizuar dhe të orientuar nga eksportet dhe prodhimi.

Sigurisht që dhe turizmi është një eksport shërbimesh dhe është një industri kryesore, por në përgjithësi, agroturizmi, bujqësia dhe disa industri të cilat mund të jenë më tipike për Shqipërinë do të duhet të zhvillohen, dhe paralelisht me to duhet të ulet dhe niveli i informalitetit. Sa më shumë të ulet niveli i informalitetit aq më shumë do të rriteshin të ardhurat në buxhetin e shtetit dhe kapacitetet për investim për shkolla, spitale, dhe veçanërisht në infrastrukturë, gjë që nga ana e saj do të sillte më shumë investime të huaja në Shqipëri. Ulja e informalitetit do të rriste sigurinë, e ndërthurur me reforma strukturore në legjislacionin për të drejtën e pronësisë. Pra, gjërat janë të ndërlydhura. Këto reforma strukturore që janë ndërmarrë duhet të vazhdojnë më tej; nuk mendoj që për shkak të krizës do të duhet të kemi ndryshime në modelin tonë ekonomik, në reformat tona strukturore. Ne do të duhet t'i vazhdojmë këto reforma strukturore. Megjithatë, në këtë situatë, paralelisht me to, duhet të jemi fleksibël për të kapërcyer situatën e vështirë, sikurse kemi vepruar deri tani. Shpresojmë që viti 2021 do të kthejë normalitetin dhe një nga reformat që do të kërkojë përpjekje të forta do të jetë ulja e nivelit të borxhit publik.

Pyetje: Do të fillojmë që sot të lajmë borxhin që po marrim apo do t'ia lëmë gjeneratës pasardhëse?

Guvernatori: Po, ne duhet të përpiqemi ta ulim sa më shumë borxhin, por sigurisht që ai nuk do të shkojë kurrë në zero. E mira do të ishte

që një gjeneratë t'i lërë një borxh sa më të ulët gjeneratës pasardhëse, prandaj themi që duhet ta ulim nivelin e borxhit, por sigurisht që merret borxh dhe likuidohet borxh nga borxhi i kaluar; niveli i borxhit duhet të vijë në rënie, por ai nuk është një shifër absolute. Ka shtete që kanë nivel të lartë borxhi dhe nivel shumë të lartë zhvillimi dhe mirëqenieje ekonomike.

Pyetje: Për shkak se prodhojnë...

Guvernatori: Po, ndër shumë faktorë të tjerë edhe për shkak se prodhojnë.

Pyetje: Kanë një ekonomi më të fortë...

Guvernatori: Kanë ekonomi dhe shtet ligjor më të fortë. Nëse ne i zhvillojmë këto të dyja paralelisht, mund të kemi nivel borxhi 60, 70 apo 80%, por të kemi edhe një ekonomi me produktivitet më të lartë.

Pyetje: Në kohë krizash, një nga pasiguritë lidhet me monedhën. Banka e Shqipërisë ka ndërhyrë në treg në datat 27 dhe 30 mars, kur 1 euro këmbëhej me 135 lekë, dhe vetëm në një muaj leku u zhvlerësua me 7%. Sa stabël është monedha kombëtare në perspektivën e një përkeqësimi të situatës së shëndetit publik, pra të një vale të dytë në stinën e vjeshtës?

Guvernatori: Lidhur me këtë do përpiqem të jap një përgjigje në mënyrë të përmbledhur, pasi kjo është një nga çështjet delikate për të cilën diskutohet vazhdimisht. Kjo është normale, për sa kohë që ekonomia shqiptare ka nivel të lartë euroizimi dhe ekspozim të qytetarëve dhe bizneseve ndaj riskut të këmbimit valutor, pasi disa i kanë të ardhurat në euro dhe disa në monedhën kombëtare. Së pari, monedha kombëtare Lek, përgjithësisht, ka qenë një monedhë stabël, me përjashtim të viteve 1997 dhe 2008, kur pësoi zhvlerësim të fortë. Pra, monedha kombëtare ka rezistuar mjaft mirë me gjithë vështirësitë e ekonomisë shqiptare; Leku ka qenë i qëndrueshëm...

Pyetje: Çfarë e ka bërë Lekun kaq të qëndrueshëm?


Guvernatori: Kjo është një analizë shumë e thellë dhe e gjerë. Gjatë gjithë kësaj periudhe, kemi pasur një regjim të lirë të kursit të këmbimit, pra banka qendrore nuk ka ndërhyrë në treg, me përjashtim të momenteve të vështira të krizave, kur janë prekur parametrat kryesorë. Këto momente

janë të mirëpërcaktuara në rregulloret e bankës qendrore dhe përfshijnë goditjet e inflacionit, spekulimet dhe prishjet e parametrave, zgjerimin e *spread*-eve në treg. Megjithatë, këto janë raste të veçanta, fenomene që ndodhin rrallë. Për të mos e ndikuar tregun, ndërhyrjet e bankës qendrore në treg bëhen publike tre muaj më pas - kjo për të shmangur përpjekjet e spekulantëve për të përfituar. Pra, në momentin imediat kur kryhet, ndërhyrja në treg përbën sekret bankar. Mund të themi se monedha jonë kombëtare ka qenë stabël, madje ka mbetur e tillë edhe në këtë periudhë pandemie, ndonjëherë edhe më e fortë se shumë monedha të tjera. Duke përjashtuar një periudhë të shkurtër në fillim të pandemisë ku veprroi efekti psikologjik dhe kishte mungesë eurosh në treg, si pasojë e ndërprerjes së fluturimeve, po shohim që Leku po qëndron stabël.

Pyetje: Pyetja e fundit për ju z. Guvernator ka të bëjë me perceptimin se një bankë mund të bëjë çdo gjë. Por çfarë nuk mund të bëjë një bankë?

Guvernatori: Operacionet e bankave janë të përcaktuara me ligj. Ato janë ndërmjetës financiarë, marrin depozita dhe i investojnë këto në kredi. Pra, një bankë ka një rol shumë të rëndësishëm, pasi jo vetëm që është siguruuesi i depozitave të qytetarëve, por është dhe zhvilluesi i ekonomisë së vendit, nëpërmjet kreditimit në sektorët kyç të ekonomisë ose mbështetjes që i jep qytetarëve. Kështu, banka nga njëra anë i garanton tepricat e likuiditeti ose kursimet qytetarëve duke u dhënë një fitim mbi to dhe nga ana tjetër i ndihmon qytetarët që kanë nevojë të zhvillojnë bizneset e tyre ose planet e tyre për investime duke i kredituar. Paralelisht me këtë, me zhvillimet e reja teknologjike, banka kryen edhe disa operacione të tjera si transfertat dhe shërbimet bankare. Këto janë operacionet bazë klasike që duhet të kryejë një bankë. Bankat janë të rregulluara me ligj dhe mbikëqyren nga banka qendrore, në mënyrë që të mos spekulojnë dhe të zhvillojnë një aktivitet të shëndetshëm financiar - ky është stabiliteti financiar i vendit që ne përmendim. Banka natyrisht që nuk kryen dot ato operacione që nuk i ka të përcaktuara me ligj. E thënë thjesht, ajo nuk del dot jashtë "listës së punëve".

Grafik 48. Indeksi i shëndetit bankar*



*Rritja e vlerës së treguesit tregon stabilitet më të ulët. Gjerësia e çdo dimensionit nënkupton kontributin e tij ndaj rrezikut.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pyetje: A mund të merren bankat me aktivitet të paligjshëm pastrimi parash?

Guvernatori: Patjetër që jo. Kjo bën pjesë në listën e rreziqeve sepse ka të bëjë me riskun e imazhit, një nga risqet më të mëdha në ditën tona.

Gazetari: Guvernator Sejko faleminderit që ishit në emisionin “Përballë” në televizionin publik shqiptar!

Guvernatori: Faleminderit juve!

FOTO GALERI / PHOTO GALLERY

Governatori Sejko në Forumin për vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, të organizuar nga "Euromoney", 15 janar 2020/
Governor Sejko: The Central and Eastern European Forum organised by Euromoney - 15 January 2020



Governatori Sejko në Forumin për vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, të organizuar nga "Euromoney", 15 janar 2020/
Governor Sejko: The Central and Eastern European Forum organised by Euromoney - 15 January 2020



Gubernur Sejko me Ambasadorin Norvegjez, SH.T.Z. Jens Erik Grøndahl, 17 janar 2020/
Governor Sejko with H.E.Mr. Jens Erik Grøndahl, Ambassador Norway to Albania - 17 January 2020



Gubernur Sejko me delegacionin e Bankës Botërore, 6 shkurt 2020/
Governor Sejko meets the representatives of the World Bank Group - 6 February 2020



Takim i Shoqatës Shqiptare të Bankave, 12 shkurt 2020/
Meeting of the Albanian Association of Banks - 12 February 2020



Gubernatori Sejko me Ambasadorin Italian, SH.T.Z. Fabrizio Bucci, 13 shkurt 2020/
Governor Sejko with H.E.Mr.Fabrizio Bucci, Ambassador of Italy to Albania, 13 February 2020



Mbledhja e Konstituencës së Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe të Grupit të Bankës Botërore, 28 shkurt 2020/
Governor Sejko attends the IMF/World Bank Constituency Meeting - 28 February 2020



Leksion i Gubernatorit Sejko në London School of Economics and Political Science (LSE), 2 mars 2020/
Governor Sejko delivers a lecture at the London School of Economics and Political Science (LSE) - 2 March 2020




Takimi me sistemin bankar dhe biznesin "Marrëdhëniet Biznes - Bankë", 13 maj 2020/
Governor Sejko: Meeting with the banking system and business community on "Bank - Business relationships" - 13 May 2020



Governatori Sejko në Komisionin Parlamentar të Ekonomisë dhe Financave, 1 qershor 2020/
Governor Sejko at the Parliamentary Committee on Economy and Finance - 1 June 2020



Gubernur Sejko në takim të Klubit të Governorëve të vendeve të Azisë Qendrore, Rajonit të Detit të Zi dhe Ballkanit, 2 qershor 2020/
Governors' Club of Central Asia, Black Sea Region and Balkan Countries - 2 June 2020



Mbledhje e Këshillit Mbikëqyrës, 3 qershor 2020/
Meeting of the Supervisory Council of the Bank of Albania - 3 June 2020



Guvernatori Sejko me Ambasadorin Austriak, Sh.T.Z. Christian Steiner, 11 qershor 2020/
Governor Sejko with H.E.Mr. Christian Steiner, Ambassador of Austria to Albania - 11 June 2020



Promovimi i librit "Kriza ekonomike në kohën e koronavirusit", 7 korrik 2020/
The promotion ceremony of the book: "Economic crisis in times of coronavirus" - 7 July 2020



*Takim online me misionin e FMN-së, 2 korrik 2020/
Virtual meeting with the IMF mission - 2 July 2020*



*Governatori Sejko me Misionin e FMN-së për Shqipërinë, 18 shtator 2020/
Governor Sejko meets the IMF Mission for Albania - 18 September 2020*



Mbledhjet Vjetore të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore, 20 tetor 2020/
The 2020 Annual Meetings of the International Monetary Fund and the World Bank Group - 20 October 2020



Governatori Sejko në takimin e Ministrave të Financave dhe Governorëve të Bankave Qendrore të vendeve të EQJL-së, me Drejtoren e Përgjithshme të FMN-së, zj. Kristalina Georgieva, 23 tetor 2020/
Governor Sejko attends the CESEE meeting of Finance Ministers and Central Bank Governors, with the International Monetary Fund Managing Director, Ms Kristalina Georgieva - 23 October 2020



Governatori Sejko me Ambasadorin Rumun, SH.T.Z. Mircea Perpelea, 18 nëntor 2020/
Governor Sejko with the H.E.Mr. Mircea Perpelea, Ambassador of Romania to Albania - 18 November 2020



Workshop-i XIV i Kërkimeve Ekonomike për Evropën Juglindore, 10 dhjetor 2020/
14th South-Eastern European Economic Research Workshop - 10 December 2020

Meeting Info Hide Menu Bar
& Video Participant Meeting Help

Albania - Donald Duraj Me	Ledia Koroshi Host			
Adelajda Matuka	Ariana Bimo	Artan	Artan Sulejmani	Bledar Hoda
Denada Rada	Elisabeth Beckmann	Elona	Enri Herri	ermir maliqaj

Governatori Sejko në takim me Ambasadorin Spanjoll, SH.T.Z. Marcos Alonso Alonso, 11 dhjetor 2020/
Governor Sejko meets with H.E. Mr. Marcos Alonso Alonso, Ambassador of Spain to Albania - 11 December 2020



Ceremonia e shpalljes së çmimeve fituese të konkursit të hapur "Çmimi i Governorit për Diplomën më të Mirë për vitin 2020", 21 dhjetor 2020/
Governor's Award Ceremony for the "Best Diploma Thesis 2020" - 21 December 2020

